





FLORI RUQI
DIADEMË LETRARE V

FLORI BRUQI

DIADEMË LETRARE V


Klubi i Përgjishëm
Tiranë

Tiranë, 2024

Titulli : Ddiademë letrare V
Autori: Flori Bruqi
Redaktor: Izet Duraku
Recenzent: Rexhep Shahu
Arti grafik: Blendi Shahu
Botues: Klubi i Poezisë
© Të gjitha të drejtat janë të Flori Bruqit
ISBN 9789928337382
Shtypshkronja Vision Print Prishtinë

Tiranë, 2024

FLORI BRUQI

DIADEMË LETRARE V



Tiranë, 2024

140 VJET NGA SHFAROSJA E SHQIPTARËVE NË SANXHAKUN E NISHIT...

...Zërat, lotët, klithmat e dhimbjeve të mijëra njerëzve u fshehën e u mbuluan kujdesshëm nga dëbora e acari i hidhur i mesditave të vitit 1877-1878. ...

Asnjë mundësi tjetër nuk iu dha karvanit të shqiptarëve për dëbimin e tyre më dhunë nga trojet e veta stërgjyshëore, veç largimit të tyre të pa kthim nga tokat në Sanxhakun e Nishit...

Pas atyre ju mbeti gjithçka: Shtëpitë, kullat, oborret, fushat dhe varret e të parëve të tyre....

Kanë kaluar 140 vjet nga dëbimi masiv i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit....

Është periudha kur dhuna masive e ushtrisë serbe masakroi e debtoi popullsinë e pafajshme shqiptare.

Zona të shkatërruara dhe të u masakruara, duke lënë pas veç gjurmët e shqiptarëve të dëbuar më dhunë nga trojet e tyre etnike.

Pikërisht këtë gjurmë e ndoqem edhe ne për t'a risjellë historinë dhe atë që nuk është e shuar ende në këto teritore.

Në vitin 1875 shpërtheu Kriza e Lindjes, me kryengritje të mëdha anti -osmane në Bosnjë dhe Hercegovinë .

Ato u pasuan nga revolta e shumë popujve të tjerë, siç ishin Bullgarët, e një vit më pas (1876) edhe serbët e malazezet.

Të tilla pati edhe në Shqipëri edhe pse ndrojtja ishte shumë e madhe për një arsye te thjeshtë.

Grekët në vitin 1844 patën shpallur atë që njihej si “Projekti i Megalidesë”- pra Pushtimin e Jugut të Shqipërisë.

Në të nëjtën ditë edhe serbet u trumbetuan nat Certanjën që synonte shtrirjen në tokat shqiptare.

Pra Shqipëria gjendej në një mostre të frikshme që do të ndihej shumë shpejt pikërisht gjatë krizës së lindjes. Më 1877, Rusia Cariste i shpallën luftë Perandorisë Osmane, ndërkohë që paralelisht duke kuptuar dobësimin e tyre u hodhën edhe Serbet e Malazeztë që u nisën për shpërbërjen e Sanxhakut të Nishit më dhunë.

Janë rreth 740 fshatra shqiptare, që u boshatisën plotësisht. Banorët e tyre u dëbuan me dhunë, kurse një pjesë mundi të vendoset në zonat e tjera.

Por pati edhe shumë të dëbuar të cilët vdiqën nga uria dhe të ftohtit në atë rrugëtim të kobshëm.

Dëshmitë janë jo thjeshtë rrëqethëse por thuajse të pa besueshme për shkak të nivelit të dhunës, që vështirë të besohet se njerëzit, mund t’jua bëjnë njerëzve të tjerë një gjë të tillë...

Shqiptarët e zhveshur e të zbathur, nëpër të ftohtit e acartë të dhjetorit i braktisën nga dhuna shtëpitë e tyre.

Atë natë vdiqën shumë gra e pleq, e shumë fëmijë, të hedhur e të ngrirë grykës së Gërdelicës deri në Vranjë e Kumanovë.

Shumë fëmijë që ishin në shpinë të nënve u ngrinë dhe vdiqën.

Kishte raste të shumta kur edhe pleqtë vdisnin nga të ftohtit. Këto janë fshatrat e shqiptareve, për të cilët serbet nuk kanë ditur kurrë, kurse tani në këto fshatra nuk ka mbetur asnjë shqiptar.

Prandaj askush nga serbet nuk dinë si quhen ato fshatra.

U dogjën e u poqën me zjarr e hekur më shumë se 700 vendbanime shqiptarë si në Toplicë, Nish Vranjë e Leskoc, kurse bota përparimtare e Evropës plakë nuk reagoi fare kundër atij kursi kriminal serbo-rus.

Shefki Ukaj shkruan: “Muhaxhirve” në Kosovë duke folur për këtë rast ka thënë se nga të parët kishte dëgjuar, se atë kohë kishte ndodhur që nënës i kishte rrëshqitur fëmijët prej dorës dhe nga acari dhe bora e madhe fëmija ka mbet në borë dhe nena nuk ka mundur të kthehet dhe ta marrë fëmijën e vet. Thonë edhe sigurisht kjo është ekzakte, pasi kur turqit kanë bërë regjistrimin e popullsisë kanë shtirë ne evidencë se atje iu ka mbetur edhe maca e qeni dhe të gjitha bagëtitë.

“Popullata e pafajshme atëkohë janë nisur me qerre ashtu siç kanë mundur mi shpëtue fëmijët dhe është për tu çuditur si kanë arritur të shpëtojnë fëmijët edhe

pse një pjesë e fëmijëve kanë mbetur sepse nuk kanë arritur ti marrin me vete. Që faktikisht kur bëhet kjo rikujtuese është një rikujtuese shumë e dhembshme për egzodin e shqiptarëve nga trolli i tyre etnikë.

Edhe studiuesi Adem Ajvazi, ka thënë se në mënyrën ma brutale brenda një kohë shumë të shkurtër ushtria serbe i detyroi dhunshëm gra, fëmijë e pleq e banorë në tërësi të dalin vetëm me rroba të trupit.

“Organizoi gjoja se në emër të ikjes së aty ku zhvillohen luftimet organizoi ikjen në mënyra të ndryshme me karroca kuajsh e çerre të ndryshme mirëpo qëllimi ishte që sa më shpejt të zbrazej ajo tokë që sa më shpejt të kryhet puna sipas tyre, me qëllim që mos të ketë më implikime ndërkombëtarë.

Jo vetëm që asgjë nuk u ndal, por Traktati i Shën Stefanit në mars të vitit 1878, si dhe pas Kongresi i Berlinit zyrtarizuan projektin serb duke iu dhënë këtyre të fundit të gjitha këto territore më popullsi shqiptare: Nishi, Toplica, Jablanica Masurica , e me radhe.

Tashmë duheshin ti përshtatshin realitet të ri imponuar. Ushtritë serbe nuk kishin më pse të fshiheshin dhe mund të vijonin qetë spastrimin etnik të plote nga popullsia autoktone.

Dhe askush nuk mund të thotë një shifër të saktë të të dëbuarve më dhunë.

Autor të ndryshëm japin të dhëna të ndryshme, sepse asnjëherë nuk është lejuar, apo ndërmarr një studim i organizuar nga Institucionet Shkencorë jugosllave apo Krahinore të Kosovës.

Mendohet se janë rreth 300 mijë shqiptarë që lanë trojet e tyre, nga të cilët mese 70 mijë janë vrarë masakruar apo kanë vdekur edhe rrugës.

Ka mjaft studiues të tjerë që këto shifra i quajnë të minimizuara apo të deformatuara, duke pretenduar se numri është edhe shumë më i madh”, shkruan studiuesi Adem Ajvazi.

Publicisti Shefki Ukaj sërish ka treguar se ti gjitha informatat t1% deritashme që janë të verifikuara dhe që i posedojnë Arkivi i Kosovës, flasin për 700 vendbanime, ku ka ndodhur spastrimi etnik në një territor a prej 11 mijë kilometrash katrore d.m.th edhe ma i madh se territori i sotëm i Republikës së Kosovës. Ky territor me histori të thellë, kryeqendrën e kishte Nishin, i cili ndodhej rreth 200 kilometra nga Beogradi e ku do të niseshin edhe hulumtimet në teren.

POashtu edhe gazetari shqiptar zt.Marin Mema i cili edhe ka realizuar këtë histori të dhimbshme, ka treguar se Nishi po ashtu kishte gjurmët e veta historike....

Gjurmë shqiptare- nga “Nishi tek Molla e kuqe “
Z..Mema në emisionin e tij Televiziv ka thënë :”se shumëçka është shkatërruar, si p.sh Varrezat e vjetra të shqiptareve por jo gjithçka është zhdukur, duke filluar nga kalaja tek figurat historike apo tek investimet e kryera nga shqiptarët para largimit të tyre. Këto janë vetëm disa elemente që lidhin qytetin e Nishit me banoret e dikurshëm me shqiptaret.
Të mos harrojmë që në këtë qytetet deri më 1878 jetonin mesë 2.000 mijë familje shqiptare.

Ndryshe nga sot ku është edhe vështirë të ndjekësh pas këtë gjurmë.

Fotografitë e vjetra të qytetarit tregojnë një tjetër fytyrë të tij, që sot është vështirë e identifikueshme monumentet objekte e ndryshme e deri varret e shqiptareve janë shkatërruar.

Vetëm xhamia e ndërtuar nga Islam Aga i Gjakovës qëndron ende në këmbë. Duket e pabesueshme të mendosh se deri në vitet 1877-1878, jetonin një numër i madh shqiptarësh.

Lagjet e tëra u shuan ndërsa shtëpitë bujtën pronarët e rinj. Konsulli i Turqisë në Nish shkruan për lagje të veçanta ku ndodheshin deri në 300 e më shumë shtëpi shqiptarësh.

Ato ishin prona të pasurish të cilët u detyronin më pas të linin apo shisnin gjithçka, dhe të iknin në Turqi, apo të merrnin rrugën në këmbë drejt trojeve të tjera me shqiptarë. Të tilla lagje kishte kudo në Nish nga të cilat siç theksohet nga burimet e kohës, mbetëm pa u shembur jo më shumë se 20 shtëpi.

Megjithatë historia e qytetit shkon shumë më thellë, që në kohët më të lashta.

Është fakt se Kalaja e Nishit ka themele që i përkasin periudhës së Dardaneve, çka konfirmohet edhe nga zbulimet e shumta arkeologjike.

Por për fat të keq, kjo pjesë ose mbulohet, ose manipulohet ose nuk tregohet kurrë e plotë. A thua sikur nuk ka ekzistuar kurrë.

Nishi apo Najsusi, siç njihet në antikitet, është vendlindja e Konstadint të Madh, Perandorit Ilir, që e themeloi Konstadino Pojën (Stambollin e sotëm).

Në periudhën e tij, persekutimi i ashpër ndaj të krishterëve, morri fund.

Perandoria Romake u riorganizua, në planin Ushtarak dhe ekonomikë. Ndaj ai edhe sot konsiderohet si njëri prej më të mëdhenjve të historisë.

Drejtimi i Konstadinit të madh në mbi 30 vite të shekullit të IV lidhet me një periudhë kur dyndjet skllave donin ende qindra vite që të nisnin.

Edhe vet Nishi ka një histori të tillë, por reklamimi bëhet vetëm në atë pjesë, që u inversion autoriteteve serbe.

Thuhet se Kalaja është ndërtuar e rindërtuar disa herë, nga Romakët, Bizantët, Skllavet Bullgarë, Serbet e Osmanët, por askund nuk përmendet, që themeluesit e kësaj kalaje ishin Ilirët.

Fundja logjika është e thjeshtë. Kur Romakët erdhën ketë vend çka tregohet edhe nga këto stelat mortore, atëherë lind pyetja, se cilët ishin banoret vendas”, ka thënë gazetari shqiptar Marin Mema.

Arkeologu shqiptar akademik prof.dr. Neritan Ceka ka thënë se në të gjitha burimet antike del se ishin Dardanet ata që jetonin aty.

“Nuk ka popullsi tjetër, që në ngjarjet e shekullit të III. Bile mund të themi se është zona më e hershme që përmendet si Ilire që në shek e V, Erodoti i vendos Ilirët në lumin ‘Angrus’, që është pikërisht zona e Moravës Jugore, dhe pjesa më verilindore e trevës Dardane. Dhe që nga kjo kohë nuk përmendet asnjë popullsi tjetër atje.

Për të ndjekur një vijë logjike tjetër të historisë nga Najsusi Dardan dhe Konstadini i Madh duhet

domosdoshmërisht vizituar edhe një sy tjetër shumë i rëndësishëm.

Në këtë mënyrë historia nuk u mbet asnjë hallk të sajën dhe vijon natyrshëm deri në shpërnguljet e dhunshme të banoreve.

Justiniani i Parë, është njëri ndër figurat më të rëndësishme të lashtësisë.

Gjatë sundimit të tij nga viti 5027 në atë 5065, Dardania u kthye në një kryeqendër investimesh.

Dhe mes shumë të tjerave që ai i realizoi ishte edhe 'Justiniana Primo', një qendër me një histori e jashtëzakonshme e lidhur natyrshëm me popullsinë autoktone Ilire.

Dhe sigurisht se për të kuptuar këtë pjesë thelbësore të historisë duhet të vizitojmë edhe këtë vend të rëndësishëm arkeologjik, i cili ngrihet vetëm 70 kilometra nga qyteti i Nishit.

Mjaft investime të nisura nga Konstadini i madh i përfundoi apo i zgjeroi dhe i përshtati Justiniani i Parë.

Mes shumë të tillave bien në sy dy qytetet të rëndësishme, njëri ndodhet në Kosovë dhe tjetri në destinacionin tonë. Dhe ajo që dallohet menjëherë është se Justiniana Prima edhe pse përfaqëson një vlerë të trashëgimisë Botërore, është lënë krejtësisht mënjanë. Kjo pa dyshim, se e ka një arsye dhe mjaft të fortë.

Historia e Justiniana Prima është mese e qartë, e kjo pranohet edhe nga vet autoritet përkatëse të këtij siti arkeologjik.

Ky qytet është para sllav, përkundrazi ai u braktis me dyndjet e këtyre të fundit. Të paktën në këtë rast edhe vet autoritet pranojnë historinë ashtu siç është.

Ky është një qytet i ngritur në trojet Ilire, nga një Perandor Ilir i Bizantit- Justiniani i Parë.

Tabelat thonë pikërisht qyteti u ngrit nga Perandori Justinian jo larg vendlindjes së tij, me synimin që të shndërrohet në selinë e prefekturës së Ilirisë.

Më poshtë qartazi është e shkruar se ai u braktis në shek. e VII, si pasojë e dyndjeve sllave.

Pra e thënë më thjesht, ky vendbanim ashtu si Nishi i lashtë, jetohej natyrshëm nga vendasit – Dardanët.

Arkeologu akademik prof.dr.Neritan Ceka po ashtu ka theksuar se aty ka një origjinë të pastër Ilire sepse vjen nga Justini i qytetit Dardan – Ilir sic thotë thotë edhe biografi i tij Prekopre Cezares, dhe natyrisht se bën pjesë në klasën sunduese e i cili u kulturua dhe u edukua në Bizant, u martuar me Bizantinin Theodorën ishte pjesë e klasës së lartë të Bizantit, por megjithatë shumë prezent në vendin tonë.

Ka një numër të pafund ndërtimesh që lidhen me Justinianin sepse verifikohej një pjesë e madhe e qyteteve nuk ka qytet që nuk u verifikua në kohën e Justinianit pra në Kohën e Bizantine” ka thënë akademiku dhe profesori i ndritur Neritan Ceka.

Por nëse kjo pjesë e historisë duket disi e ftohtë dhe e largët, ka mjaft elemente të tjerë, që frymojnë ende qartazi të shkuarën e tyre.

Treguesit historik më të drejte e të qartë vijnë nga Toponomia, që ende ruhen në zona të tëra.

Dhe askujt nuk duhet ti dukej absurde kur fshatrat kanë emra shqiptarë, por në to nuk ka asnjë banorë të tillë.

Rajoni i Toplicës ka qenë njëri ndër rajonet më të prekura nga dëbimi masiv dhe masakrat.

Mjafton të kujtosh se shqiptaret në tërësi këndeje kanë qenë më 80 për qind.

Ushtria serbe e mbështeturë nga ajo e Carëve rusë i dhanë jetë me çdo kusht strategjisë së tokës së djegur.

Megjithatë ,çuditërisht jo gjithçka është zhdukur.

Mjafton të shikosh emrin e fshatit ‘Arbnas’.

Në zona të tilla duhet pasur kujdese.

Pyetjet duhet të jenë në dukje naive që askush të mos dyshoj mbi përmbajtjen dhe qëllimin e tyre, aq më pak banorëve të ri duhet thënë se jemi shqiptar.

Ndaj bashkëpunëtorët tonë nuk paraqiten si të tillë po ashtu as makina nuk ka targa shqiptare, por ndërkombëtare, përndryshe gjithçka do të ishte e pamundur.

Si e shpjegohet faktin se fshati quhet “Arbanas” banoret e sotëm serb.... heshtin...

Historia e dhimbshme e Prokuples ku jetonin mbi 24 mijë shqiptarë

Grupi i gazetarëve e kanë ndaluar makinën e cila nuk kishte targa shqiptare dhe kanë pyetur dy pleq të shtyrë në moshë.

“Si po jetoni? Ata janë përgjigjur se po jetojnë vështirë dhe me mund. Ndërsa tjetri ka shtuar se s’ke ç’të bësh duhet të jetojmë”.

Ata po ashtu iu kanë treguar gazetareve pa e ditur që ata ishin shqiptarë dhe misionin i tyre ishte që të mësohej e vërteta, se aty në atë fshat me emrin “Arbanas” dikur ka pasur 180 shtëpi, e sot sipas tyre duhet ti ketë diku 120 shtëpi.

Po ashtu ata kanë treguar se ky vendbanim është i vjetër ku ka disa që kanë ardhur.

Pyetja tjetër e radhës nga gazetarët ishte se “përse e mban emrin ky fshat “Arbanas”?

Ndërsa serbët e moshuar të ulur në tokë, thonë se kanë dëgjuar se ky fshat ka jetuar dikur me shqiptar.

“Ku ta dish, ashtu na kanë thënë të vjetrit që dikur kanë qenë vend i banuar me shqiptar.

Dhe a është e saktë apo jo ku ta dimë ne”, janë përgjigjur fshataret serb të cilët tani jetojnë në atë vend.

Por sipas dokumenteve “Arbansi” është një fshat mesjetar që shfaqet në shekullin XII.

Në veprën e tij të detajuar vendbanimet dhe popullsia e Albanëve të Kosovës profesor dr.Iljaz Rexha e ven theksin tek ekzistenca e mjaft qendrave të hershme që mbajnë këtë emër.

Këto fshatra gjenden si në dokumente sllave ashtu më pas edhe në atë të Portës së Lartë, duke treguar një vazhdimësi të qartë.

Dhe pavarësisht prapashtesave Bullgarëve sllave ato nuk e humbën kuptimin edhe pse në të njëjtën mënyrë u regjistruan nga Administrata Osmane.

Në Mesjetë shqiptarët e verifikonin vetën si Arbnor, ndaj edhe emrat e tillë ishin kudo ku ata jetonin. Të njëjtën gjë mund ta prekësh jo larg nga “Arbanasi” ku

ndodhej një tjetër qendër sot, dhe e quajtur “Alabama”. Edhe kjo deformimin e emrit e ka marrë nga Administrata sllave.

Gazetarët sërish ndalojnë veturën në këtë vend për të folur nga afër me banorët tashmë të banuar me serb, me qëllim që të marrin informacione.

Gazetarët pyesin një fshatar serb aty:

“Më falni ku ndodhemi? - Në “Alabama”- ia kthen fshatari gazetarëve.

Atëherë e paskemi humbur rrugën i thonë gazetarët banorit, sepse ne deshtëm të shkonim në Bllacë.

“Jo jo ia kthen banori serb nuk e keni humbur rrugën por vetëm vazhdoni drejt rrugën”.

Por a ka pasur ndonjë emër tjetër më parë ky fshat pyesin gazetarët.

“Nuk e di, nuk e di” ia kthen banori, kështu që gazetarët vazhdojnë rrugën, duke falënderuar atë për ndihmën.

Pra askush nuk tregon më shumë. Histografia ka mbytur gjithçka, ashtu si këto vende që duhet me çdo kusht të heshtin.

Rajoni i Toplicës ka pasur dikur një popullsi mbi 80 për qind shqiptare dhe askush nuk donte ta dinte këtë statistikë e cila është pranuar edhe nga vet autorët serbe.

Edhe pse sot këtu nuk gjejmë as edhe një për qind shqiptar.

Kaq mjafton për të treguar fatin tragjik që kanë pasur banorët autoktonë të këtyre zonave.

Andaj nuk mund të mos impresionohesh nga faktet që tregojnë numrin e shqiptarëve të dikurshëm në këto anë.

Kryeqendra e Toplicës është Prokople një qytet që së bashku me rrethinat numërojnë sot më shumë 44 mijë banorë. Qendra e derdhur mes gjelbërimit nuk ka asgjë që të lidh me shqiptaret e dikurshëm.

Për një kalimtar apo turist të thjeshtë Prokuple duket është një qytet si shumë te tjerët.

E pamundur të kuptosh se çfarë qëndron pas këtij vendi të qetë, nëse nuk ke shfletuar më parë dokumentet apo dëshmitë rënqethëse të të larguarve.

E pra dikur në qarkun e Prokuples jetonin rreth 24 mijë shqiptar dhe rreth 1.500 apo diçka më shumë banorë serb.

Kjo është e vërteta e cila të shoqëron pashmangshmërisht në çdo hap e mendim.

Si mund të zhduken mijëra njerëz, historitë e tyre personale, zërat kujtimet lotët si mund të shuhet e mohohet gjithçka.

E vështirë të mos prekesh ashtu siç i ndodh edhe shoqëruesve të gazetarë Të top Cnanalit nga Kosova.

Ne jemi të vetëdijshëm se këta kanë kryer punë me neve dhe nuk kanë pas më se çka të fshehin kështu që nuk është më rrezik për ta, sepse ne e dimë shumë mirë nga autoret e ndryshëm tanë dhe ata serb, që këtu ka fshatra që janë zhduk dhe fare më nuk i dihet as emri”, thotë studiuesi shqiptar Azizi.

Autori serb Mita Rakic në veprën e tij , “Serbia e re“ e quan këtë pjesë të re, pasi mundeni me marr me mend, vjen në këtë tokë, e sheh të zbrazët të banuar

me shqiptarë dhe këtë trevë të okupuar nga Serbia në vitin 1878 e titullon me emrin “ Serbia e Re” .

Madje në libër thuhet se ne një vendbanim të djegur shkruam e hi të cilit as që i dihet emri i atyre fshatrave.

Dhe për ta nuk paraqet problem pse ne i kemi trashëguar emrat e këtyre vendbanimeve në Kosovë”...

Studiuesi Florent Hasani po ashtu ka thënë se pas dëbimit të shqiptarëve nga këto teritore ato do të populloheshin me ushtrinë serbe dhe malazeze si element për të serbizuar këtë territor.

“Këto popullsi do të lejonin me favore të ndryshme p.sh një familje do të merrte shtëpi dhe pasuri falas nga 20 hektar tokë të punueshme dhe nga 10 hektar sipërfaqe malore.

Dhe kjo nënkupton se ato të gjitha më parë ishin pasuri të shqiptarëve të cilët ishin dëbuar më dhunë nga këto troje”, ka thënë Hasani.

Më pas thuhet që këto me shumë lehtësi të tjera iu ofruan popullsisë serbe, për ti sjellë dhe populluar këto teritore.

Gjithçka u bë me një shpejtësi marramendëse si formë për të mbyllur menjëherë këtë çështje e për të vazhduar marshimin më tej në teritore të shqiptarëve. Shumicën dërmuese të mbiemrave i gjen sot në Kosovë.

U dëbuan si familje, e tashmë janë fshatra të tërë që rrënjët i kanë nga ky vend:

si Lepaja, Pllana, Nishliu, Llapashtica, Breznica, Rudari Stublla, Bllaca e pafund fshatra të tjerë, pa lënë mënjanë mbiemrin e përgjithshëm Muhaxhiri.

Të gjithë vijnë nga këtu, dhe të parët e tyre jetonin prej shekujsh në këtë vend.

Ndërsa mbiemrat i ruajtën si formë për të treguar për të mos harruar me shpresën për tu rikthyer dikur aty ku kanë varret e të parëve të tyre.

Popullsia e Sanxhikut sipas autorëve të huaj dhe vendas

Sipas studiuesit Ismet Azizi “Migrimet e dhunshme u zhvilluan në drejtime që ishin të përcaktuara nga vetë koha dhe rrethanat politike. Efektet e tyre anësore ishin kryengritjet dhe trazirat shpeshta. Struktura aktuale e popullsisë nuk është identike me atë nga e kaluara. Por, kryesisht janë të pranishëm vëllazëritë dhe fiset më të mëdha, të përmendura ...

1. Sanxhaku i Shkupit (Uskub), i cili përfshirë qytetin e Shkupit, Kumanovës, Kaçanikun, Shtipin, Kratovën dhe Koçanin.

2. Sanxhaku i Prizren, ka përfshirë qytetet e Prizrenit dhe të Tetovës.

3. Sanxhaku i Pejës (İpek), ka përfshirë Pejën, Gjakovën, Gucinë, Beranën dhe Tërgovishtën. (Rozhajën dhe Tutinin).

4. Sanxhaku i Prishtinë ka përfshirë Prishtinën, Mitrovicën, Vushtrinë, Gjilanin dhe Preshevën.

5. Sanxhaku i Novi Pazarit (Yeni Pazar), ka përfshirë qytetet : Novi Pazar, Sjenicë, Kolashin, Nova Varosh dhe Prijepolje.

Sipas konsullit Theodora Iphena, Sanxhaku në shkurt të vitit 1877 përfundimisht ndahet nga Vilajeti i Bosnjës dhe përfshihet në vilajetin e Kosovës.

Ne jemi përqendruar ekskluzivisht në zonën e ngushtë të tij, dhe në qytetet : Jeni Pazarit (Novi Pazar) Plevla, (Taslixha) Prijepole, Kolashin, Bijelo Pole (Akova), Nova Varosh, Berane(Ivangrad), dhe Tërgovishtë (Rozhajë), edhe pse ndarjet gjeografike dhe administrative ishin të shpeshta.

Sa përket popullsisë dhe ndarjes etnografike dhe vlerësimin gjeografik të Sanxhakut , duhet të ndahet në pjesën veriore dhe at të jugut. ” Në pjesën veriore popullsia, me përjashtim të një pjese të vogël, është homogjene sllave, konkretisht fiset boshnjake.

Në rrethin e Plevlës, Prijepoljes, Kolashin, Bijelo Poles, Beranës, Nova Varoshit, jetojnë kryesisht fiset boshnjake, ndërsa në Sjenicë, Novi Pazar dhe Rozhajë e Mitrovicë jeton elementi kombëtar shqiptar.

Shqiptarët kanë një forcë ekspansioniste shumë të fortë, në vetvete edhe janë aq të forta sa që kalojnë kufijtë e Shqipërisë, në veri dhe në lindje në brendësi të Sanxhakut.

Elementi shqiptar më së shumti paraqitet në qarkun e Rozhajës, sidomos në luginën e lumit Ibër, përgjatë luginës së Ibrit deri në Mitrovicë.

Me Rozhajën në veri i bashkohet Peshteri, i cili një pjesë i takon Novi Pazarit dhe Sjenicës.

Aty jetojnë gjithsejt rreth 30.000 shqiptarë.

Për popullsinë e Sanxhakut në këtë kohë ka shkruan në shkrimet e tij, edhe historiani Gaston Gravje .

I pari ka përshkruar gjendjen ekzistuese pas largimit të turqve nga ky rajon. Pikërisht, për shkak të boshllëqeve të shkaktuara nga këto migrime të dhunshme, shqiptarët (Kelmendët, Hoti, e Gruda) kanë

ardhur dhe janë vendosur në Peshter dhe Rozhajë, madje në Tutin, Sjenicë dhe Novi Pazar, ku ende i gjejmë.

Nga e gjithë Sanxhaku, Peshteri në vitin 1912, në fakt e gjithë zona ka qenë e pushtuar nga elementi shqiptar.

Me përjashtim të fshatit Suhodo, Buxhevë dhe Dojkë, të cilat janë plotësisht ose pjesërisht sllave, të tjerat janë shqiptare.

Megjithatë për dallim nga shqiptarët e Kosovës shqiptarët e Peshterit janë vendos me familje nga fise të ndryshme (Kelmend, Kuç, Shalë, Hot, Grudë etj).

Të ndikuar nga myslimanët boshnjakë, mësuan gjuhën e tyre dhe madje morën edhe disa nga zakonet e tyre, ndërsa gjuha e tyre dukshëm u largua nga gjuha e folur nga pjesa tjetër, gegërishte (dialekt i gjuhës shqipe në veri të Shqipërisë).

Megjithatë, ky popull ruajti veçoritë e racës së tij (etnia). Askush, madje as bariu i vogël nuk ndahet nga pushka e tij.

Autoritetet turke kanë mbetur vetëm në emër. Hakmarrja është e pranishme sikur të ishin në mes të Shqipërisë.

Pasiguria është këtu më shumë se kudo në Sanxhak. Sipas publicistit Milisav V. Lutovac, banorët e Rozhajës dhe me gjerë ata të Tutinit, konsiderohet se kanë formën e tyre origjinale të fiseve të Malësisë (Shqipërisë veriore), ata formuan vëllazëri të reja të cilat kanë ruajtur organizimin e vjetër fisnor duke mos shkëputur lidhjet me ëmrin Shqipëri, dhe nëse paraqitet nevoja , ata veprojnë të bashkuar.

Edhe pse kanë pranuar fenë islame, ata nuk kanë hequr dorë nga jeta fisnore.

Për më tepër, ata janë angazhuar të gjithë së bashku që fiset të mbijetojnë duke i përhapë vëllazëritë e tyre.

Si pasojë e vetëkënaqësisë janë fshatra të veçanta, lagje, çarshitë.

Për nga fiset ata janë përbërë nga: Kelmendi, Hoti, Gruda Shkreli Shala dhe fiset tjera të malësisë në Mal të Zi.

Kuçët u vendosën në luginën e lumit Lim, duke zbritur nga lartësitë në luginat pjellore dhe kanë vazhduar deri në Priboj.

Etnografi serb Jovan N. Tomic, thotë: “ai që hedh shikimin në hartën etnografike të Sanxhakut në veprën e studiuesit serb Jovan Cvijiq “Bazat e Gjeografisë dhe gjeologjisë të Serbisë së Vjetër dhe Maqedonisë”, do të bjerë në sy një trevë pothuajse në mes të Sanxhakut, i ngjyrosur me një ngjyrë e përhimë në të verdhë, dhe për rreth ka disa oaza të kaltra, nëpër të cilin janë vendosura gjysmë hënëzat ngjyrë të kuqe.”

“Kjo është rrafshnalta e Peshterit. Këta Shqiptarë në Peshter janë të parët dhe me vendbanime më të vjetra në Sanxhak, të cilët autoritetet turke i sollën atje dhe kryesisht kanë prejardhje nga fisi katolik Kelmend.

Ata Imigruan në Peshter si blegtorë dhe u vendosën në tërë rrafshnaltën.

Në vitin 1707 ka pasur 274 shtëpi, të shpërndara në të gjitha anët.”

Studiuesi Frok Zefi në punimin e tij shkencor, shkruan, “Peshkopi shkupjan Mihael Summa shkroi

për Romën nga Beogradi më 6 qershor të vitit 1739 , për mbarimin e dhimbshëm të luftës austro-turke, dhe për atë në të cilën ai personalisht dhe besimtarët (shqiptarët krishterë) nga Peshteri si dhe shumë të tjerë duhej të kalonin nën sundimin austriak.

Në një letër të shkruar në Vjenë më 10 nëntor 1736, autoritetet ushtarake do të informojë perandorin Karlin e VI-të, se si Kryepeshkopit Mihael Summa në marrëveshje me komandantin ushtarak të Jagodinës, kolonelin Schnepfer në dioqezën e tij ngriti krishterët të revoltohet kundër turqve.

Turqit kishin marrë vesh për këtë dhe nuk guxoi të kthehet në Shkup.”

Në raportin e tij Don Pavai Zogani shkruan Kongregatës për përhapjen e besimit, që më 20 gusht 1767 përmend gjendjen në Peshteri ku në fshatin Ugëll ka mbetur vetëm një familje katolike, dhe në fshtrat tjera, aty këtu ndonjë plakë vjetër.

Peshterasit kanë hequr dorë nga besimi katolik në vitin 1745 dhe më pas kisha katolike në Kamenicë ka pushuar së ekzistuar.

Sipas, Sami Frashërit, Trgovishta gjegjësisht Rozhaja gjendet në Vilajetin e Kosovës , në Sanxhakun e Pejës. Është një qytet i vogël dhe me të njëjtin emër, i cili është i vendosur në anën verilindore të Pejës me, përafërsisht ka 3.000 banorë.

Ka 62 fshatra, banorët e të cilëve janë kryesisht shqiptarë dhe një pjesë të vogël folës të gjuhës boshnjake.

Në brendësi të vendbanimit janë 6 xhamia, 150 magazinat dhe dyqane, 6 mejtepe, dhe 1 kishë.

Klima është shumë e ftohtë, dimrat janë të gjatë dhe të fortë. (Të dhënat i referohen fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë).

Georg von Gyurkovics “Gurkoviç njihet si përkrahës i Perandorisë Austro-Hungareze.

Më shumë se dy mijë vjet të shqiptarët jetojnë në ato zona, thotë Gurkoviç në librin Albanian , Shqiptarët janë një racë e ashpër dhe e egër “.

Ata u vendosën në këto zona tashmë dhe kanë mbetur deri më sot “ (sipas Krieger, Hirten und Rauber), dhe se më “me armët shqiptare në duart e tyre, por, pa libra shqiptare.” Jetojnë në Gadishullin Ballkanik shumë gjuhësh, thotë serbi Gurkoviç.

Sipas bindjes të tij, kjo zone para se gjithash ka një term etnik dhe jo politik apo historik. pasi nuk është shtet apo krahinë unike.

Kufiri etnik arrin deri te malet e Sharrit, por shtrihet në jug të Serbisë, ndërsa në veri arrin në Kolashin, Guci dhe Plavë, përgjatë Ibrit deri në Rozhajë.

Në web faqen për mbiemrat malazezë shkruan, Klimen, para ardhësi i tyre (rreth vitit 1330) nga Travniku (Bosnja), trashëgimtari mandej Klimen erdhi në Piper, nga aty në Kuç.

Me zhvillimin e familjes shumohen si vëllazëri (Fis).

Vëllazëritë e tyre janë shënuar si: Klimen, Klimendi, Klimenda, Klimençanin, ka në Nikshiq, Tivar, Tuz, Ulqin, Rijeka Crnojevica, Zetë, Pastrovic, Podgoricë, në gjirin e Kotorrit, Grbalj, në fushën e Bijelo Polje, në zonën e Novi Pazarit, Guci, Rozhajë, fshatrat e Sremit (Mirkovci, Nikinci dhe Hrtkovci), Kovilj (Baçkë), Guzi

(Velipojë), Shkodër, Durrës dhe Tiranë (Shqipëri), në rrethinën e Pejës si: Rugovë, Gjakovë dhe Prizren.

Sipas Andrija Joviçeviq, Kliment / Kelmendasët janë përhapur nëpër luginën e lumit Lim në Sjenicë dhe Peshter, dhe më tej në Novi Pazari.

Këto fise janë përhapur në Dukagjin, ku me kafshët e tyre kanë zbritur në Gjakovë, ndërsa të tjerët u ndalën për të kaluar në bregdetin Adriatik nga Ulqini në Durrës. atje janë të zhvendosur dhe të shpërndara nga deti Adriatik deri te lumi Sava dhe Danubi, nga Llovqeni deri te Gjakova dhe Prizreni.

Mariano Bolizza, thotë se Kelmendët kanë arrit deri në Pllovdivë të Bullagarisë.

Familjet e ardhacakë nga “Arnautllaku” (nga ish Sanxhaku i Novi Pazarit) përfaqëson grupin mjaft të dallueshëm në mesin myslimanëve të Zhepës.

Imigrimi i tyre në Bosnjë bie në periudhën e pushtimit nga Perandoria Austro-Hungareze, dhe pas ndarjes definitive Sanxhakut të Novi Pazarit nga të Vilajeti i Bosnjës (1877). Vendosja e tyre në Zhepë, sa mundë të konstatohet nga tregimet, ishte bërë pjesërisht në faza, ndërsa disa fise kanë lëvizur direkt nga Sanxhaku.

Sot në zona e Zhepës ka 13 vëllazëri, të cilët kanë ardhur nga \”Arnautllak\” (rrallë dëgjohet për ta thënia “Arnaut”, por të gjithë thonë: “Ne jemi nga Arnautllaku”).

Vetëm në fshatin Krnjiq, sot jetojnë pesë vëllazëri të cilët përkasin të ardhur nga Sanxhaku i Novi Pazarit.

Është interesant se këtu vendasit të ardhurit nga Sanxhaku i quajnë Arnaut- Shqiptarë .

Terrori dhe dhuna shtetërore kundër lëvizjes shqiptare në Sanxhak dhe Kosovë në fillim të viteve 20-të të shek. XX

Mbretëria Serbo-Kroate-Sllovene, për ta shkatërruar lëvizjen kombëtare të shqiptarëve, përdori dhunë dhe terror të paparë që ishte një gjenocid i vërtetë. Sipas dekret ligjit të prillit të viti 1922, territori i Kosovës u nda. Krahina e Rashkës (Sanxhakut) me qendër në Çaçak, nga territori i Kosovës përfshinte rrethin e Zveçanit. Në bazë të propozimit të komandës së Armatës III në Shkup, nën të cilën gjendej edhe Kosova, të datës 1.11.1918, u bë detajizimi i ndarjes territoriale, që, për shkak të pozitës gjeografike dhe kushteve të komunikacionit, si tërësi gjeografike, Armata III ndahet në këto tri krahina divizionesh: e Manastirit, e Vardarit dhe e Kosovës. Divizionit të Kosovës me qendër në Prishtinë i takonte edhe Qarku i Regjimentit të Novi Pazarit, i cili përfshinte këto rrethe administrative: atë të Senicës, të Dezhevës (Pazarit të Ri), të Shtavicës (Tutinit), të Mitrovicës, të Vuçitërnës, të Drenicës – Llaushës, të Istogut, të Rozhajës dhe të Pejës. Mbretëria Serbe-Kroate-Sllovene gjatë sundimit të saj, si qëllim të parë dhe të fundit kishte ndërrimin e strukturën etnike në trojet shqiptare. Për të arritur këto synime dhe për të pasur mbështetje formale juridike kundrejt opinionit të huaj, ajo nxori edhe legjislacionin agraro-kolonizues. Ajo filloi me ligjin e 25 shtatorit të viti 1919, dhe vazhdoi me nxjerrjen e ligjit të viti 1931 me plotësime e përmirësime të viti 1933. Për realizimin sa më të suksesshëm të “Reformës Agrare” dhe të kolonizimit, u krijua Ministria e

reformës Agrare, kurse në Shkup u ngrit drejtoria e Lartë Agrare me degë në disa qytete shqiptare. Ky legjislacion i vinte në pozitë diskriminuese fshatarët shqiptarë kundrejt minoritetit sllav dhe kolonëve të ardhur nga viset e tjera të mbretërisë Serbe-Kroate-Sllovene. Menjëherë pas ripushtimit të Kosovës dhe të viseve tjera shqiptare, filluan përpjekjet për shpronësimin e shqiptarëve. Tokat e pjesëmarrësve të lëvizjes kombëtare ishin preja e parë për kolonët, nëpunësit, ushtarakët, xhandarët dhe çetnikët sllavë. Po kështu u veprua edhe ndaj strehuesve të tyre, shpeshherë edhe ndaj të gjithë fshatit ku zhvilloheshin përleshjet e armatosura. U shpronësuan gjithashtu të ashtuquajturat toka të braktisura, ku përfshiheshin kullotat e përbashkëta të fshatrave dhe tokat e pronarëve shqiptarë që përkohësisht e kishin braktisur vendin për shkak të pasigurisë së jetesës. Shpronësimi dhe zvogëlimi i sipërfaqes së tokës së punueshme u intensifikua pas vitit 1923, kur komisioneve agrare u lejohej që të sekuestronin, sipas nevojës, edhe toka që nuk ishin paraparë në legjislacion. Organet që zbatonin Reformën Agrare, duke përdorur edhe mungesën e tapive të tokave të shumicës dërmuese të fshatarësisë shqiptare, e cila i trashëgonte ato që nga periudha e sundimit osman, i shpronësonin si uzurpatorë tokash. Komisionet agrare kolonizuese, gjatë formimit të komplekseve për kolonizim, sekuestruan tokat që shqiptarët ua kishin blerë çifligarëve gjatë Luftës së Parë Botërore dhe i cilësuan ato si kategori të tokave të braktisura. Kurse për blerësit serbë këto veprime u quajtën të ligjshme.

Sipas ligjit të viti 1931, me plotësimin e përmirësime të viti 1933, fshatarëve shqiptarë mund t'u sekuestrohej toka deri te pragu i shtëpisë. Kishte raste, sidomos në Rrafshin e Dukagjinit, që kolonët sllavë vendoseshin edhe në katet e sipërme të shtëpive të shqiptarëve, kurse pronarët me familje ishin të detyruar të jetonin në katet përdhese të shtëpive të tyre. Shpronësimet nuk i shpëtuan as pronat e institucioneve fetare shqiptare, si myslimane ashtu edhe katolike.

Masakra dhe shfarosja e Sanxhaklinjëve në fshatrat Shahoviq, Pavino Pole, Bijelo Pole (Akovë), rajoni i Sanxhakut nën pushtimin e Malit të Zi (9 nëntor 1924) Në 25-26 korrik të viti 1924, pushteti serb, pasi pushtoi zonat e lira të Kosovës, vrau prijësin e kaçakëve, Azem Galicën dhe udhëheqësit kryesor të çetave kryengritëse. Pas likuidimit të forcave kryesore të çetave të armatosura, regjimi serb u përqendrua në shkatërrimin e Xhemijetit. Në fillim të viti 1925, në prag të zgjedhjeve parlamentare, u morën masa të jashtëzakonshme represive ndaj shqiptarëve. Duke shfrytëzuar "Ligjin mbi mbrojtjen e shtetit", në hullinë e sulmeve kundër Xhemijetit autoritete serbe burgosën tipografët e gazetës "HAK" dhe më pas e ndaluan zyrtarisht gazetën, duke akuzuar se botonte informata që cenonin autoritet serbe. Ndërkaq, në prag të zgjedhjeve parlamentare të caktuara për 8 shkurt 1925, u burgos Ferat Draga. Me një procedurë të shkurtër u dënua me 101 vjet burg. Me këto përndjekje të qeverisë mori fund veprimtaria e hapur e organizatës së shqiptarëve Xhemijeti. Pas kësaj, autoritetet e Beogradit e liruan Ferhat Dragën. Në këto

kushte Xhemijeti pushoi së ekzistuari si parti legale e organizuar. Përveç këtyre, pushteti përdori vrasjet në masë, djegiet e rrënimet e fshatrave me artileri, bombardime me aeroplanë, burgosjet dhe internimet në Serbi, sidomos për familjet e pjesëtarëve të lëvizjes kombëtare. Sa i përket Sanxhakut, pjesa e tij e ndodhur në Mal të Zi, kishte pësuar shumë keq, në krahasim me atë të Serbisë. Masakra në Shahoviq, Pavino Pole, Vranesh dhe fshatrat përreth, ishte krimi më i madh kundër popullsisë të përkatësisë myslimane gjatë kohës së paqes në Mbretërinë SKS.

Në ditën e pafat të 9 nëntorit të viti 1924, ndodhi drama më e përgjakur mbi popullatën e Shahoviqit. U vranë, u therën u plaçkitën dhe janë djegur më shumë se 650 persona. Mbi 100 familje janë shpërngulur për Turqi, ndërsa 150 në Bosnjë, në Brčko. Qëllimi ishte që kjo popullatë të shpërngulen definitivisht. Ky krim ndodhi si pretekst për vrasjen e kryeshefit të Srezit të Kolashinit, mësuesin e pensionuar Boshko Boshkoviqin. Kjo vrasje i ishte ngarkuar Jusuf Mehoniqit, udhëheqësit kaçak, i cili në këtë kohë ndodhej në Shqipëri. Gjatë natës ndërmjet 9 dhe 10 nëntor 1924, është përpiluar plani për likuidimin e banorëve të Shahoviqit. Në mesin e njerëzve që kanë bërë këtë plan ka qenë edhe Nikolla Gjillas, babai i Millovan Gjillasit, i cili më vonë shkruan në librin e tij edhe lidhur me këtë krim të tmerrshëm. Aksionin për shfarosjen e Shahoviqit i besohet Nikolla Gjillasit me gjithsej 2000 njerëz të armatosur nga viset e ndryshme të malit të Zi. Për këtë rast Millovan Gjillas në librin e tij shkruan: klerikëve myslimanë u janë shkukur

mjekrat dhe u është gdhendur kryqi në kokat e tyre. Në një fshat një grup të njerëzve i kanë lidhur me tela rreth stogut me kashtë dhe u është vënë zjarri. Pas kësaj, njerëzit gjatë kishin përfolur për mënyrën e djegies së njerëzve në flakë. Një grup i tyre kishin sulmuar një fshatar në shtëpi të tij në një zonë të largët. Fshatari sapo kishte rrjep një qengj të varur në një kumbull. Kishin për qëllim edhe atë ta pushkatojnë, mandej për t'ia djegur shtëpinë e tij, por qengji i rrjepur i kishte nxitur që edhe me fshatarin e gjallë të veprojnë njësoj siç kishte vepruar ai pak më parë me qengjin. Njëri prej tyre e godet me sëpatë, së pari e var në kumbullën e njëjtë ku ishte i varur qengji, një kasap me përvojë e ndanë trupin e fshatarit me sëpatë përgjysmë...Në librin në gjuhën serbe “Vendi pa drejtësi” (angl. Land Without Justice), (Besuda zemlja, 2005), këto pjesë të dëshmimeve të krimeve, të cilat gjenden në versionin në gjuhën angleze, janë hequr.Kryetari i Xhemijetit, Ferhat bej Draga, më 14 nëntor të viti 1924, iu drejtua ministrit të Punëve të Brendshme me një mocion lidhur me mizoritë e tmerrshme në këtë rajon. Ky mocion u botua në “Pravda” të Sarajevës (nr. 262) të 18 nëntorit. Aty, në mes të tjerash, thuhet: “Zoti ministër! Kjo masakër si një veprim i përbashkët i autoriteteve policore lokale dhe Vasojeviqëve, përgjegjës janë autoritetet policore, të cilët kanë qenë me kohë të paralajmëruara për rrezikun dhe nuk ndërmorën asnjë veprim për ta parandaluar këtë masakër. Në këto rrethana përgjegjësia është më e madhe e pushtetit sesa e bandave, sepse deri tash askush nuk është

arrestuar“.Gazeta “Politika” e Beogradit nr. 5949 e datës 15 nëntor 1924, raporton me titullin: “Protesta e Ferhat Beg Dragës me rastin e hakmarrjes së Vasojeviqëve ndaj vrasjes së Boshko Boshkoviç”, ku shkruan për veprimin e Ferat beut, i cili i dërgoi një letër proteste ministrit të Punëve të Brendshme V. Maksimoviçit. Gazeta “Politika”, kështu kishte parë të nevojshme të shkruajë në lidhje të një letër proteste të Ferat beut dhe krimet e kryera ndaj qindra burrave të pafajshëm, grave dhe fëmijëve. Më shumë ka pasur viktima sesa shkronja të harxhuara për këtë artikull të botuar në gazetën “Politika”. Krejt kjo flet për qëllimin e paramenduar të spastrimit etnik dhe fshehjes me qëllim që askush mos të thirret në përgjegjësi.Ish-bejlerët dhe agallarët kanë pasur ndikim të madh tek Xhemijeti. Njëri nga ta ka qenë Aqif Efendi Blyta, i cili me këmbëngulësinë e tij dhe politikën e guximshme, arriti t’i kthej shumë myslimanë të cilët në vitin 1920, votuan për Partinë Radikale. Ai arriti të forcojë radhët e partisë myslimane të Xhemijetit, kështu që shumë shpejt u bë partia më e fortë në Sanxhak. Nikolla Pashiqi qysh herët kishte vërejtur se pengesë kryesore për realizimin e planit serbomadh, të cilin e kishte paraparë për Sanxhakun, ishte Aqif Blyta. Për këtë arsye, ai në vitin 1925, ndërmori një terror të madh në Pazar të Ri dhe në të njëjtën kohë porosit likuidimin e këtij politikani me ndikim. Qëllimi i tij ishte të fusë frikë e tmerr dhe të shkaktojë huti në popullatën myslimane të kësaj treve. Për fat të mirë idetë e tij nuk u realizuan.Për këto rrethana të vështira, gazeta “Hak” shkruan se “shumë vëllezër shqiptar u mbuluan me

tokë, ndërsa shumë të tjerë u shpërndanë andej e këndeje në gjendje fare të keqe”. Në këto rrethana Bajram Curri dhe Hasan Prishtina arritën të protestojnë në shtator të viti 1924, pranë Lidhjes së Kombeve në Gjenevë. Në pikën 5 të kësaj proteste thuhet: “Ky regjim hekuri, zjarri dhe grabitjeje në Kosovë përmban shkakun kryesor të një emigrimi në masë të popullsisë shqiptare në Turqi, emigrim ky që bëhet në kondita të tmerrshme që u kushton me jetë qindra familjeve, ndërsa pjesa tjetër që mbetet dënohet me një mjerim të papërshkrueshëm”. Në të përjavshmen e Beogradit “Republika”, përveç të dhënave të ndryshme të publikuara është edhe ajo me titull “Masakra në Serbinë Jugore” në të cilën thuhet: “Nga e tërë Serbia jugore dëgjohen zëra të trishtueshëm. E tërë popullata myslimane është shpallur kaçake, e lënë në mëshirën e policisë dhe xhandarëve. Mandej gazeta shkupjane e myslimanëve “Hak” sjell lista të gjata të grave dhe fëmijëve nga të cilët shumë prej tyre kanë humbur jetën në mënyra të papërshkrueshme. Nëpër tërë Serbinë Jugore ndihet ulërima të qytetarëve dhe derdhja e gjakut të tyre. Për t’u pastruar Serbia jugore nga kaçakët, të cilët i krijoi administrata jonë e ndryshkur, ministri i punëve të brendshme lëshoi aso farë udhëzimesh pushtetit policor të çmendur e të egër, sa që ata i shpallën luftë tërë popullatës. Edhe polici më i thjeshtë mund të vrasë sot, të plaçkitë kënd të dojë në Serbinë Jugore dhe askush mos të trazohet. Kërkoj që krimet e pushtetarëve të ndalen dhe të caktohet komisioni, i cili kriminelët dhe urdhërdhënësit t’i hedhë para gjykatës.

Në ndërkohë u formua komisioni për hulumtimin e situatës në Sanxhak. Komisioni përpiloi raportin, i cili konstaton se në Sanxhak ekziston ndarje e popullsisë në pikëpamje fetare dhe politike si rezultat i marrëdhënieve edhe nga e kaluara, edhe pas viti 1918. Këto marrëdhënie janë përkeqësuar posaçërisht pas aplikimit të reformës agrare dhe keqpërdorimit të aparatit shtetëror.

Komisioni i cili punoi për të hetuar këto krime, ka pasur mjaft material të konstatojë se “ushtarët”, duke menduar në çetnikët e Kosta Peçancit, nuk kanë kursyer as pasurinë as nderin e individëve. Por këto hetime nuk sollën qetësi dhe mirëqenie myslimanëve. Në trevën e Tutinit çetnikët e Kosta Peçancit, edhe pse nuk kishte asnjë lloj arsyeje, kryen krime të trishtueshme. Vetëm në fshatin Starçeviq në vitin 1922, së pari vranë Galën, Beqirin dhe Zeqirin, e që të nesërmen vranë edhe 28 persona tjerë të familjes së madhe Rizvanoviq. Tefikun dhe Bajramin mysafirë nga Kosova (të fshatrave Kelepole dhe Malindubrava). Në këtë kohë kanë pësuar edhe banorët e trevave tjera në Sanxhak dhe Kosovë. “Pravda” e Sarajevës ka shkruar për masakrën e Prishtinës, Podujevës, Mitrovicës, Çiçavicës, Tutinit, Jannjevës, Vrellës, Shtimes si dhe masakrën e tmerrshme të Dumnicës në shkurt të viti 1924. Njëzet e tre (23) të vrarë nga të cilët vetëm 8 arritën t’i varrosnin imamët, ndërsa të tjerët ishin bërë shkumb dhe hi. Të gjitha këto vrasje nga ana e qeverisë janë konsideruar si aksion kundër kaçakëve dhe hajdutëve dhe se kanë pasuar kaçakët dhe jatakët e tyre. Duke vërejtur këtë gjendje, njerëzit përparimtarë

nuk pajtoheshin me qëndrimin shovinist të borgjezisë serbomadhe. Më 1921, Kosta Novakoviç, përfaqësues i punëtorëve dhe i fshatarëve të Jugosllavisë, u ngrit në Parlamentin e Beogradit dhe me dokumente në dorë foli për krimet e qeverisë në Kosovë. Nga presionet në të gjitha anët, qeveria turke, e shtyrë edhe nga intervenimet direkte dhe të përhershme, pati pezulluar pranimin e muhaxhirëve, por qeveria e Mbretërisë SKS me çdo kusht luftonte që emigrimi të vazhdohej. Qeveria Jugosllave dhe ajo turke kishin arritur të projektojnë një marrëveshje më 1926, për shpërnguljen e 3-400 000 shqiptarëve nga Kosova dhe se kjo çështje shumë kohë që përmendur në shtypin turk, sidomos në fletoren “Haqimijeti Milije” dhe “Milijet”, të 17 prillit 1926. Lidhur me këtë, qeveria jugosllave bënte mistifikime në opinion edhe me statistika edhe me terror, duke i quajtur shqiptarët turq. (“Shqipëria e Re”, janar 1925.) Lidhur me pozitën e vështirë të shqiptarëve në Kosovë pati intervenuar edhe Hasan Prishtina më 1927, pranë Lidhjeve të Kombeve në Gjenevë. Hasan Prishtina njoftoi opinionin botëror se shqiptarët në Kosovë po i nënshtrohen shfarosjes dhe se ata po shpërngulen në masë. Shpërngulja, thuhet aty, vinte për shkak se ata nuk janë të barabartë me qytetarët tjerë. Dëshmia më e fortë për këtë është se ata nuk kanë asnjë shkollë të veten, shkruante Hasan Prishtinë (cit. “Liria kombëtare”, Gjenevë 1927). *Vijon (Artikulli është pjesë e punimit të Masterit ” Roli diplomatik i Aqif Blytës në mbrojtjen e Pazarit të Ri”)

Shpërngulja e popullatës shqiptare nga Sanxhaku i Nishit

Shpërngulja e popullit Shqiptar nga trojet e veta stërgjyshore, ishte bërë me një dhunë sistematike nga serbët që nga 1877, si nga sanxhaku i Nishit, e nga Leskovci, Vranjë, Prokuplë, Krushevcit, Kurshumlisë e me radhë, ku gjatë një periudhe kohore shumë të gjatë bën një gjenocid serbët, dhe shpërngulën me dhunë shqiptarët nga vendbanimet e tyre Ilire Dardane, sidomos në kohën e Lidhjes së Prizrenit të vitit 1877-1878. Serbët duke shpërngulën Shqiptarët vetëm se për të arritur qëllimet e tyre ogurë zeza sllave, e bënë spastrim etnik, me represalje serbët gjithë popullin shqiptarë e larguan nga vatrat e tyre. Shqiptarët i lanë pasurit e tyre, ashtu si zogu kur len folen u bën muhaxher prej tokës vetë, që e kishin lënë dhe murën rrugën e panjohur për në mbrendësi në drejtim të Kosovës, e drejt Maqedonisë dhe Turqisë e vende tjera. Shqiptarët kurrë nuk u kthyen dot aty ku ishin, mbetën toponimet sot e asaj dite. me emrtime në gjuhën shqipe. Mbi 740 fshatra të banuar me shqiptare prej Sanxhakut të Nishit u përdjekën nga toka e vet u shpërngulën me dhunë, të vazhdushme, sistematike në dimrin e vitit 1877 me plot acar që vdiqën fëmit e pleqt rrugës bagëti e bujqësi, e në tokat shqiptare, vendosën serb nga anët e ndryshme të Serbisë që serbët janë stacionuar fshat për fshat e gjithë pasurin e shqiptarëve e murën falas. Në disa kaza të Sanxhakut të Nishit, sidomos në atë të Prokuplës dhe të Kurshumlisë, shumicën e popullsisë e përbënin shqiptarët. Në kohën e depërtimit të

ushtrisë serbe në këtë rajon të gjithë shqiptarët u shpërngulën për në Kosovë, Maqedoni, Turqi dhe në vende të tjera. Lidhja e Prizrenit në vendimet e para në Librin e vendimeve kundërshtonte dhe protestonte për shpërnguljen e shqiptarëve nga sanxhaku i Nishit. Në kohën e Krizës së madh lindore 1875-1878, në Gadishullin Ballkanik u bënë ndryshime të mëdha shoqërore politike dhe etnike. Në disa kaza të Sanxhakut të Nishit, sidomos në atë të Prokuples dhe të Kurshumlisë, shumicën e popullsisë e përbënin shqiptarët. Nishi kishte rreth 2000 shtëpi shqiptare, Piroti kishte 400 shtëpi shqiptare, Leskovci kishte 1000 shtëpi shqiptare, Prokupla kishte 650 shtëpi shqiptare, Tërni kishte 15 shtëpi shqiptare, Vranja kishte 800 shtëpi shqiptare dhe Kurshumlia me 150 shtëpi shqiptare. Rrethi i Kosanicës 5951 shqiptarë banorë. Shqiptarët nuk ishin të privilegjuar nën sundimin e të huajve. Në Kosovë janë shpërngulur më shumë se 30.000 shqiptarë. Para aneksimit të qytetit të Nishit nga Serbia, në qytet kishte 300 shtëpi me 1500 shqiptarë. Në rrethet e Bujanovcit, të Preshevës, në Kumanovë dhe vende të tjera gjenden muhaxhirë shqiptarë të ardhur nga kazaja e Pirotit dhe Nishit. Shqiptarët e kazasë së Vranjës janë shpërngulur në drejtim të Preshevës, Bujanovcit, Kumanovës, Shkupit dhe në vendet tjera në Maqedoni.

Nga Prokupla, Leskovci, Nishit, Vranja, Kurshumlia dhe Piroti numri i shqiptarëve të shpërngulur drejt Kosovës, Maqedonisë, Turqisë dhe vende tjera ka qenë shumë më i madh. Gjatë vitit 1878 nëpërmjet të Selanikut një numër i emigrantëve u dërgua në

Anadoll dhe Siri. Me Paqen e Shën Stefanit me 3 mars 1878 Rusia krijoi Bullgarinë e Madhe, Serbia zgjerohej në drejtim të Novi Pazarit kah Kosova me një pjesë të territorit të Sanxhakut të Prishtinës. Në territorin që shtrihet në mes të Kurshumlisë dhe të Prokuples nuk kishte mbetur asnjë shqiptar, sepse ishin detyruar ta lëshonin vendin dhe të shpërnguleshin në drejtim të Kosovës. Mbi 100 fshatra shqiptare në luginën e Toplicës dhe të Vranjës u dëbuan nga serbët në mënyrë të pamëshirshme nga vendbanimet e tyre. Shqiptarët janë bartur poshtë e lart, duke vuajtur nga uria në vendin e egër përtej kufirit të ri serb.

Toplica shqiptare dhe Sjenica

Shqiptarët nuk kishin leje të mbledhin te lashtat e tokës së tyre, të cilat korreshin nga ushtarët serbë. Shumica e muhaxhirëve shqiptarë u vendosën në Vilajetin e Kosovës, në sanxhakun e Prishtinës, sidomos në rrethinën e Vuçitërnës, të Gjilanit, të Mitrovicës, e më pak në Rrafshin e Dukagjinit. Në maj të vitit 1878 janë shpërngulur 5000 Shqiptar nga rrethina e Vranjes. Shqiptarët janë shpërngulur në kushte shumë të vështira në dimër të viteve 1877-1878, masivisht, kanë lanë shtëpitë dhe gjënë e gjallë, me fëmijë në dorë, këmbë pa ushqim, zbathur e të zhveshur. Më 24 korrik 1879, në Qarkun e Toplicës gjithë treva prej Merdari deri ke Prokupla është e zbrazur, nga shqiptarët. Shumë prej tyre janë ngrirë nga të ftoftit dhe kanë vdekur gjatë rrugës.

Shpërnguljen e shqiptarëve nga trojet e veta stërgjyshore Ilire, ishte bër nën kërcemin e armëve e të dhunës të organizuar nga serbosllavët ishin

përndjekur shqiptarët nga Sanxhaku i Nishit dhe viset tjera të banuara kryesisht me shqiptar autokton, që ishin në tokat e tyre, në pasurin e vet e në shtëpit e tyre. Shqiptarëve ju mohua e drejta për të jetuar në trojet e veta, që sot e asaj dite kanë mbetur pasuria në duart e atyre serbëve që kurr nuk u ngopën me trojet e shqiptarve, që bën reprezalje të pa para deri në atë kohë ndaj popullatës shqiptare dhe shpërngulën me dhunë mbi 740 fshatra të pastërta etnike shqiptare, gjitha këto ndodhën gjatë viteve 1877-1878, dhe kështu shpërngulën, shqiptarët, si për Kosovë në brendësi të saj në Vushtri, Gjilan, Mitrovicë, në Rrafshin e Dukagjinit, dhe në Maqedoni dhe për në Turqi e vende tjera. Në Vendbanimet e shqiptarve si të Sanxhakut të Nishit, Leskovcit, Vranjës, Kurshumlisë, Novi Pazarit, Prokuplës, Toplicës, i vendosën me serb nga pashallaku i Beogradit dhe nga viset e Vojvodinës dhe viseve tjera qendrore të Serbisë. Gjinden emra të fshatrve me emërtime e toponime në gjuhën shqipe si Brestovc, Huruglica, Devqët nga fshati Devqa e Poshtme dhe e Epërme, Kostanicët nga fshati Kostanica, Lepajët nga fshati Lepaja, Pojatët nga Pojata, Reçicët nga Reçica etj. Lidhja e Prizrenit reagoi në gjitha mënyrat e mundshme, por kjo nuk mundi të ndal shpërnguljen më masive që ishte deri në ato kohra që ishin ditët më të vështira për popullin shqiptar, që kurrë nuk do të harrohen, se thonë të vjetrit po e harruat të kaluarën ajo do përsëritet përsëri, kombi shqiptar do të shiqoj drejt së ardhmës por duke mos harruar kurrë të kaluarën e tij. Serbia “tenton ” ta ndal shqiptarizimin e Serbisë?!

Shqiptarët në Serbi janë një pakicë etnike, që përbëjnë një komunitet me nga 50,000 deri 80,000 banorë. Sipas censusit të vitit 2002, në Serbi u deklaruan 61,647 shqiptarë (ose 0.82% e popullsisë), nga këto 59,952 (ose 1.10%) në Serbinë Qendrore dhe 1,695 (0.08%) në Vojvodinë. Shumica e shqiptarëve bojkotuan censusin e vitit 2011, që rezultoi në regjistrimin e vetëm 5,809 shqiptarëve në Serbi.

Shqiptarët në Serbi përbëjnë me shekuj në jug të vendit një popullsi autoktone. Ata sot, kryesisht jetojnë në Luginën e Preshevës, një trevë kufitare në mes Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë, dhe sipas censusit të vitit 2002 në dy komuna përbëjnë shumicën e popullsisë, në komunën e Preshevës (89.10%) dhe të Bujanocit (54,69%), ndërsa përbëjnë një pakicë të konsiderueshme në komunën e Medvegjës (26.17%).

Përveç këtyre trevave, shqiptarët jetojnë edhe në jugperëndim të Serbisë, gjegjësisht në Sanxhakun e Pazarit të Ri. Popullsinë e Peshterrit e përbëjnë kryesisht boshnjakët që janë kryesisht pasardhës të shqiptarëve. Për shkak të çështjeve politike që lidhen me shqiptarët pas Luftës së Dytë Botërore, banorët shqiptar kanë deklaruar veten e tyre si boshnjakë për të shmangur diskriminimin. Gjuha shqipe ende flitet nga disa fshatarët shqiptarë në Peshterr.

Qyteti më i madh shqiptar dhe qendra e shqiptarëve në Serbi është Presheva, selia e Këshillit Kombëtar Shqiptar, institucion i vetëqeverisjes i shqiptarëve në Serbi.

Në komunat e Preshevës dhe Bujanocit shqiptarët përbëjnë shumicën e popullsisë (89.10% në Preshevë dhe 54.69% në Bujanoc sipas censusit 2002). Në komunën e Medvegjës, shqiptarët janë grupi i dytë më i madh etnik (pas serbëve), me 28.67% në vitin 1991 dhe 26.17% në vitin 2002.

Rajoni i Bujanocit dhe Preshevës, ndonjëher dhe i Medvegjës, njihet si Lugina e Preshevës. Disa shqiptarë ende u referohen kësaj lugine si “Kosovë lindore”.

Rrafshnalta e Peshterit

Është dhe një komunitet i vogël shqiptar që jeton në rajonin e Peshterit në Sanxhak (gjëgjësisht në fshatra si Borovshticë, Doliq dhe Ugël). Sot, ata vetëdeklarohen “boshnjakë” ose “myslimanë” (sipas kombësisë).

Beogradi

Kryeqyteti i Serbisë, Beogradi, ka një bashkësi të vogël shqiptare. Në regjistrimin e vitit 1981 u deklaruan 8,212 shqiptarë në Beograd, ndërsa në vitin 1991 u deklaruan 4,985 të tillë. Pas Luftës së Kosovës, ky numër u ul në 1,492.

Në vitin 1992, shqiptarët e Serbisë jugore organizuar një referendum në të cilën ata votuan se Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc duhet të bashkohet me Kosovën. Ndërmjet 1999 dhe 2001, një shqiptar etnik organizatë guerile, Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit (në gjuhën shqipe Ushtria Çlirimtare e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, UÇPMB), ishte operacionale në këtë rajon me një

qëllim të shkëputet nga këto tri komuna RF të Jugosllavisë dhe të bashkohen me ato të Kosovës, pas arritjes së pavarësisë. Aktiviteteve të tërhequr më pak ndërkombëtare interesimit të medias se ngjarjet të lidhura e Kosovës dhe Republikën e Maqedonisë.

“Okupimi i heshtur” i Nishit dhe jugut të Serbisë nga shqiptarët apo rikthim ne trojet e tyre te historike?

Arsyet për këtë janë mungesa e parave dhe qëllimi i shqiptarëve eshte për të zgjeruar jashtë Republikës se Kosoves. Në pesë vitet e fundit në territorin e Nishit, sipas vlerësimeve zyrtare, jetojnë rreth 11.000 shqiptarë nga Kosova, shkruan portali më i madh rus, Sputnik.

Sipas gazetes Sputnik “shqiptarët e Kosovës masivisht nga viti 2010 deri në vitin 2015 për të blerë apartamente, tokë dhe tokë të punueshme në Nish, Leskovc, Vranjë, Kurshumli, Prokuplje–“ Po ashtu mediat serbe se shqiptarët janë më të interesuar në zonën rreth Vranjë përgjatë kufirit me Bujanoc, Toplica (Prokuplje, Kursumli, Blace ...) deri ne Nish, qytet ky per te cilin shiptaret pretedojne te jete kufiri mes serbeve dhe shqiptareve. Keshtu, vetn në qytetin e Nishit, sipas të dhënave jozyrtare për tre vitet e fundit, rreth 1.500 shqiptarë blerë apartamente në kete qytet, ndërsa shifra shihet në fushën më të gjerë të Nishit mbi 11.000 shqiptare.

Në fakt, çdo gjë është duke shkuar sipas ligjit. Për shembull: një shqiptar për të holla serbe për të blerë emrin e tij në një pronë, dhe gjykata të bëjë një marrëveshje sipas të cilës shqiptari, thuhet saktësisht se shuma huazohet nga serbi, si një garanci, që është,

rezervat që paratë e tij të kthehen, sipas pasurisë së lartpërmendur .

Serbi, nese “nuk do të kthehen paratë në kohë”, në këtë mënyrë shqiptarët të bëhen pronarë të banesave, por në të njëjtën kohë nuk ka lënë një shenjë në shitje. Serbët ranë dakord për të marrë një përqindje të parave, dhe shpesh në këtë histori janë agjencitë e përfshira dhe reale e pasurive, por edhe avokatët serbë dhe shqiptarë.

Natyrisht, meqe shqiptarët nga Kosova ende konsiderohen si “qytetarë të shtetit të Serbisë” dhe në këtë kuptim mund të blejnë lirisht prona në Serbi.

Megjithatë, problemi është se ata nuk e njohin Serbinë si shtetin e tyre, dhe për këtë arsye të angazhohen serbët për të bërë punën për ta, kane shkruar ne v vazhdim gaazetat serbe.

Për shkak të fluksit të madh të shqiptarëve nga Kosova vitin e kaluar, qyteti i Nishit edhe u shfaq fletushka me moton dhe parulla “Ndal shqiptarizimin e Nishit („Stop albanizaciji Srbije“)

Në këtë fletushkë thuhet se shqiptarët e Kosovës me anë të ndërmjetësve të bëhen pronarë të mbi 300 njësive të banimit në qytet.

Novi Pazar është gjithashtu në listën e vendeve të dëshirueshme, por ka blerës të interesuar kryesisht për fermat e mëdha, larg nga qyteti.

Në Prokuplje, Blace dhe Kurshumlisë fermat janë veçanërisht interesante për shqiptarët. Pranë Kosovë, dhe janë shumë të lirë. Shqiptarët për fermë në rajonin japin çmim disa herë më të lartë se ajo që është e vërtetë-

Në komunën e Kurshumlisë edhe 10 fshatra ku nuk ka popullsisë dhe shumë prej tyre janë shqiptarë të “uzurpuar”.Burimet pohojnë se shqiptarët, kryesisht nga Podujeva, në fund të vitit 2014, rreth Kursumlija kane blerë rreth 50 pronave.

Në territorin e Leskovcit edhe ku toka është shumë e përshtatshme për fruta dhe perime shtëpi të ruajtura, shqiptarët i blejnë vete me për 5.000 euro.

Ky interes shqiptarët të pronës serbe në jug të Serbisë, e lidhur shumë me qëllimin e tyre për të “zgjeruar” kufirin administrativ të Kosovës në disa pjesë të Serbisë.

Gazetarë nga mediat lokale në ato qytete thonë se çdo gjë ndodh nën maskën e një të padukshme dhe të heshtur, dhe të jetë në rrugë dhe fshatrat e jugut të Serbisë janë gjithnjë të dëgjojë gjuhën shqipe.

Qytetarët e këtyre pjesëve të Serbisë jetojnë në frikë se për shkak të rritjes së fluksit të shqiptarëve nga Kosova të vuajnë fatin e serbëve nga Kosova. Ata besojnë se serbët shqiptarët të vendosin për të shitur shtëpinë dhe tokën, sepse këto komuna përkasin komunat më të varfra në Serbi.

Prandaj, ata janë të bindur se në të ardhmen në këto fusha do të jetë gjithnjë shqiptarët dhe serbët dhe të gjithë aq më pak që është pjesë e “pushtimit paqësor” në jug të Serbisë.

Nese Nishi paska 11.000 shqiptare, me shume se Medvegja atëhere unde thuhet se ky qytet eshte i treti me rdhe sipas numrit te popullsisë shqiptare pas Presheves e Bujanocit.

Ne fakt Nishi dikur kishte 110.000 shqipare dmth disa fishe me shume se sa sot.

Duke ju referuar statistikave serbe, në Serbi nga 150 komuna, vetëm në 18 komuna nuk ka shqiptarë. Këto vendbanime dhe qytetare gjenden jo vetëm ne Luginen e Preshevës, por edhe një Vranje, e Leskovc.. deri ne Nish e Beograd, madje edhe ne skaj të Serbise – ne Suboticë.

Sot ne Serbi bashke me Luginen e Preshevës, jetojnë mbi 300.000 shqiptare, kupto ne 132 komuna tjera te shtrira ne teritorin e Serbisë

DHUNA GJENODICALE E KISHËS SERBE

Doktrina e shenjt serbe për asgjësimin dhe dëbimin e elementit shqiptar nga trojet etnike të tyre daton që nga lashtësia, që nga momenti i infiltrimit të popullit sllav në këto anë, në shek. XII. Përzënia e shqiptarëve nga trojet e veta, si nga Qupria, Aleksinci ... u inspirua nga Millosh Obrenoviqi , i cili përdori të njëjtat forma si pasardhësit e tij, duke masakruar popullatën shqiptare dhe duke e detyruar atë që të largohet nga trojet e veta, për t'u mos u kthyer më kurrë atje. Kjo ide më vonë filloi të institucionalizohet në qarqet shovene serbe dhe të bëhet preokupim qenësor i tyre. Personalitete dhe institucione më të njohura serbe në janë përpjekur për institucionalizimin dhe aplikimin e kësaj Doktrine gjatë historisë kanë qenë:

“Naçertanje” është platforma e Ilija Garashanit krijuar në bazë të Doktrinës së shenjtë serbe. “Naçertanje” konkretisht bazohej në programin e shfarosjës dhe dëbimit të shqiptarve me dhunë në përputhje me reagimet e opinionit të jashtëm ndërkombëtar. Kjo platforme e luftës speciale ka shërbyer si plan program i Pashiqit, krajl Nikolla, Qubrilloviqi, Andriqi, Rankoviqi, Mugosha, Tempo, Joviqi, Trajkoviqi, Milosheviqi.

Synimi i serbëve, që nga Naçertania (1844) e deri te Patkoi (1999) ka qenë dhe është gjithnjë i njejtë: – jo si të jetohej me shqiptarët në Kosovë por si të shfarosen shqiptarët e Kosovës.

Zatën e tërë politika shtetërore serbe, që nga viti 1884, ishte një politikë kriminele ndaj të gjithë kombeve të tjera, veçmas atij shqiptar, ishte etnocid, dhe nuk mund behet pastrimi i ndërgjegjës shtetërore e as intelektuale pa i publikuar të gjitha ato projekte kriminale dhe pa i kërkuar sidomos popullit shqiptar falje publike, për të gjitha ato të zeza që i sollën në trojet e veta stërgjyshore që me shkeljen e këmbës në Dardanin antike e Kosovën historike. Vetëm kështu, siç thotë Noel Malkolm, serbet e thjeshtë do të jenë të lirë nga e kaluara e vendit të tyre, kur të mësohen të ballafaqohen me të vërtetën. Nuk ishte Millosheviqi ai që ngriti lart ndjenjat nacionale për një Serbi të Madhe të cilat shërbejnë si një ushqim. Shkaku i të këqijave në Ballkan ka qenë nasionalizmi serb. Nacionalizmi në Serbi ka ekzistuar para Milosheviqit dhe do të ekzistojë edhe pas Millosheviqit... Nuk ka dallim ndërmjet politikanëve e intelektualëve si dhe kishës nga

Millosheviqi. Të mendosh ndryshe është një gabim i madh. Politika pansllaviste serbe, për shfarosjen e shqiptarëve... ekziton që nga përpilimi i Naçertanies më 1844.

“Idetë dhe planet për Serbi të Madhe etnikisht homogjene, i kanë rrënjët thellë në politikën e Serbisë, të kodifikuara me memorandumin intern “Naçertanije”, të ish ministrit serb Ilija Garashanit, më 1844” (“Serbia’s Secret War”, Philip J. Cohen). Këto ide tanimë njihen botërisht. Fillet e “Naçertanjes” janë pjesë e programeve sllavomëdha të Rusisë, të cilat kanë marrë rrugë e gjetur zbatim në periudhat e mëpastajme të regjimeve serbe, gjer në ditët e sotme, me një synim kryesor: dalja në detra të ngrohta nëpërmes zhdukjes dhe shpërnguljes së shqiptarëve.”

– Andi Ballshi Nga VËSHTRIM MBI LIBRIN: «SEKRETI I SUNDIMIT TË BOTËS» të Fatos Aliut, Tiranë, 2002, Pos Naçertanies, nga e kanë burimin edhe planet dhe programet tjera për shfarosjen e shqiptarëve, me të cilat udhëhiqet edhe sot, dhe derisa të mos i nxjerr nga sirtarët dhe t’i publikojë, këto plane, Serbia kurrë nuk do të demokratizohet. Sipas historianit Dr. Hakif Bajrami, por edhe të tjerëve që janë marrë me këtë çështje, edhe sot ekzistojnë këto plane:

Më 1912, Milan Obradoviq, përpiloi prog. për shfarosjen e hebrenjve, duke i therur, duke i lënë të ngordhë urie dhe duke i tembur që të ikin nga sytë dhe këmbët! Më 1913, programi i Vladan Gjorgjeviqit, për shfarosjen e shqiptarëve. “Krejt tokën ose asgjësim të popullit kundërshtar”. Programi i likuidimit të shqiptarëve, 1921 (Pushteti serb krijoi kampe të

përqëndrimit për shqiptarë, Programi i Çubroloviqit, 1937 (për shfarosje totale...1938, lidhja e Konventes me Turqinë dhe Greqinë për depërtimin e shqiptarëve në Anadoll Programi i Ivo Andriqit, 1939 Programi i Moleviqit, 1941 Programi i Drazha Mihailoviqit, 1942 Programi i Çubroloviqit, 1944 e 45; më 1945 Programi i një mësuesi serb nga Vushtria, për shfarosjen e “arnautëve”, të cilin e zbatoi me përpikëri A. Rankoviqi. Programi për likuidimin e shqiptarëve, 1950 Memoradumi i Akademisë serbe, 1986, si dhe shumë ligje të tjera për kolonizim, popullizimin e Kosovës me serb që nga vitit 1865 deri më 1995. (Më 1995, Milosheviqi dhe Arkani marrin vendim që të shfarosen 51 për qind e shqiptarëve të Kosovës dhe kjo trevë të serbizohet. Këto plane nuk ishin vetëm të intelektualeve e politikanëve serbë, por edhe plane të Kishës ortodokse... Vlladan Gjorgjeviq, kryeministërt serb, (1913), në librin “Shqiptarët dhe Fuqitë e Mëdha”, shkruan se shqiptarët ishin indian të evropës, të cilët të kujtojnë “njerëzit e lashtë, që flinin nëpër drunj, ku mbaheshin me bishtat e tyre”. Libri i Vlladanit nuk ishte satirë, por një shkrim luftarak për pengimin e themelimit të shtetit shqiptar... (Për Milosheviqin shqiptarët, (1999), ishin “minj” !!! dhe ankohej pse evropianët, “nuk po na leni t’i vrasim...”. Pra shqiptarët, gjithnjë, sipas politikanëve, “akademikëve” serbë, por edhe Kishës — “ Serbia e udhëhequr nga shovinistë dhe racistë si Aleksandër Vuçiq, Ivica Daçiq dhe Vulin nuk është penduar fare për krimet kundër civilizimit. Ata janë në vuajtje e sipër dhe e fajësojnë kriminelin e luftës

Milosheviq pse nuk ja ka arritur qëllimit për ta zhdukur kombin shqiptar. Ata po vazhdojnë me urrejtje të hapur kundër shqiptarëve dhe fqinjëve tjerë bazuar në rrena dhe propagandë mashtruese armiqësore.

Mashtrimet e tyre, për interesa të ndryshme, po i han një pjesë e madhe e Europës, disa zyrtarë amerikanë dhe shumë politikanë shqiptarë me përkrahësit e tyre në media, të cilët patrioti At Gjergj Fishta do t'i quante me një emër të përbashkët, Zuzarë.

Ata janë shumë të preokupuar dhe po veprojnë hapur për ta rehabilituar shtetin primitiv racist serb, me përkëdhelje, falje të krimeve, dhënie territori shqiptar, komunë të pastër etnike serbe dhe ekstraterritorialitet të manastireve .

ortodokse. Kjo, me qëllim të shkatërrimit të shtetit të Kosovës, ndarjen e tij dhe daljen e Serbisë në detin Adriatik duke e shfrytëzuar projektin mashtrues caristo-komunist "Open Ballkan" të vllëhut-Arumunit, Edi Kristaq Rama, Kryeministër i Republikës së Shqipërisë.

Prej të gjithave, më e dhimbshme është harresa e jonë dhe përpjekja për faljen e krimeve serbe. Me mijëra kriminel serb kalërojnë të lirë nëpër Beograd e Serbi, ndërsa luftëtarët shqiptar të lirisë gjykohen në Hagë. Familjet shqiptare ende presin me ankth për t'i gjetur 1600 të dashurit e tyre të zhdukur nga Serbia. Profesor Pllana i ka dokumentuar shumë mirë krimet serbe në librin e tij të madh "Terrori i Serbisë pushtuese mbi shqiptarët 1844-1999". Nga ky libër doli edhe libri i xhepit "Never Forget" i cili e bën më të

lehtë shpërndarjen dhe depërtimin e të vërtetës shqiptare mbi gjenocidin serb kudo në Trojet tona dhe në instancat ndërkombëtare.

Ideja për këtë libër xhepi ishte në mendjen time me vite, lidhet me një libër tjetër pak më të madh me emër “Rescue in Albania” i cili bën fjalë për shpëtimin e Hebrenjëve që jetonin apo erdhën në Shqipëri gjatë Holokaustit. Shënimet për librin “Shpëtimi në Shqipëri” i mori nga ish-presidenti i Shqipërisë Ramiz Alija, kongresisti amerikan me prejardhje arbëreshe, legjendë e gjallë e lobizmit për interesa kombëtare shqiptare në Washington, Joseph J. DioGuardi, në vitin 1990 gjatë vizitës në Shqipëri me kongresistin e njohur për të drejtat e njeriut Tom Lantos.

Historikisht, Kisha Ortodokse serbe ka luajtur rol nxitës në të gjitha luftërat në ish-RSFJ. Bekimin për krimet e kryera gjatë luftërave, kryekriminelët serbë i merrnin nga Kisha Ortodokse. Të tillë ishin edhe Ratko Mlladiq e Radovan Karagjiq.

Ata bekoheshin nga priftërinjtë ortodoksë serbë për veprat kriminale në Bosnjë.

Më pas, të njëjtit vranë e masakruan qindra myslimanë boshnjakë gjatë viteve të 90-ta.

Të njëjtin rol, Kisha Ortodokse serbe e ka luajtur pothuajse në vazhdimësi, duke përkrahur edhe kriminelin Millosheviq në luftën e fundit në Kosovë, dhe çdo serb që shkonte në luftërat që Serbia i ka bërë në Slloveni, Kroaci e Bosnjë.

Bazuar në këto, historianët thonë se Kisha Ortodokse u rreshtua përkrah politikave serbe për vrasje, masakra e gjenocid.

Madje, kjo u pa edhe në sulmin terrorist të 24 shtator2023 nga një formacion paraushtarak serb, në dhe përreth Manastirit të Banjskës, në Dardani.

Këta terroristë, që qëllim e kishin aneksimin e veriut të Republikës së Dardanisë , pikërisht ditën e diel zgjodhë të kryenin sulm terrorist, ku u vra rreshteri i policise së Dardanisë Heroi Afrim Bunjaku.

Madje, ky manastir ishte përdorur si strehë e terroristëve dhe armatimit që ata përdornin.

Një paralajmërim të tillë, në muajin maj e kishte dhënë deputetja britanike, Alicia Kearns, që sipas saj, armët zhvendoseshin me ambulanca dhe fshiheshin nëpër kisha.

Edhe ish-komandanti i NATO-s, gjenerali Wesley Clark, i cili drejtoi fushatën e bombardimeve të NATO-s kundër forcave serbe në vitin 1999, thotë se që prej shumë vitesh manastiret serbe në Kosovë janë përdorur si strehë e nacionalizmit serb dhe për fshehjen e arsenalit të armëve serbe.

Se nacionalizimi serb është kultivuar e promovuar, dëshmojnë edhe pamjet e Manastirit të Graçanicës për festën e Vidovdanit, të mbajtur më 28 qershor të këtij viti.

Mbishkrime e këngë nacionaliste çdoherë i karakterizojnë liturgjitë e mbajtura në këto manastire.

Në një video tjetër të siguruar nga Instituti për Studime të Luftës Hibride, OCTOPUS, shihen serbët në Manastirin e Draganacit, në veri të Gjilanit, ku këndojnë këngë duke madhëruar Rusinë, e shohin ëndrra për okupimin e Kosovës.

Përveç kësaj, në këtë objekt kulti, priftërinjtë inkurajojnë fëmijët për këto motive edhe duke i paguar. Lidhur me këtë, Frashër Demaj nga Akademia e Shkencave të Kosovës, thotë se Serbia historikisht i ka përdorur manastiret për interesa politike.

“Serbia praktikisht i ka përdorur manastiret, do t’i përdorë edhe në të ardhmen për të sulmuar dhe për të bërë përpjeke edhe për t’i denigruar edhe institucione dhe forcat e RKS-së”, ka thënë Akademik Prof.dr. Frashër Demaj nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe e Akademisë së Shkencave Shqiptaro-Amerkane(AAAS).

Duke iu referuar sulmit terrorist të 24 shtatorit, historiani Arbër Arifi thotë se relacioni kishë-shtet vazhdon të funksionojë.

“Binomi kishë -shtet ende funksionon dhe krejt këto probleme që vijë brenda kësaj natyre pikërisht burimin e kanë aty që duhet ndahet kisha nga shteti njëherë e përgjithmonë”, tha historiani Arbër Arifi.

Ndërkohë Policia e Kosovës, më 25 shtator sekuestroi arsenal armësh në Manastirin e Banjskës, në vlerë mbi 5 milionë euro

Nga këndvështrimi politik i Profesor Dr. Milazim Krasniqit: ” Arshi Pipa në poezinë “Kosovës”, farkon sintagmën “vulën e dhunës”, të cilën shqiptarët të Kosovës ia ka shkaktuar mbi vetulla “kamxhiku sllav”, duke fiksuar kështu edhe pamjen fizike të shëmtuar nga sunduesi. “Sot tjetërkush ta gezon frutin e punës/mbi tokën tande, Kosovë, je skllav!/Ta shof përgjakun, heu, vulën e dhunës,/ qi t’la mbi vetulla kamxhiku sllav!”

E gjithë kjo poezi e Pipës vërtet është antologjike dhe do të duhej të futej në librat shkollorë, si një vlerë artistike e papërsëritshme, por sintagmat “vula e dhunës” dhe “kamxhiku sllav”, përtej transponimit artistik të realitetit dhe përjetimit estetik të veprës artistike, na japin koordinatat e shkakut dhe pasojës së gjendjes së njeriut shqiptar në Kosovë. “Vula e dhunës” është pasoja që ka mbetur e gravuar në fytyrën e njeriut shqiptar të Kosovës nga “kamxhiku sllav”, që është shkak i vuajtjes dhe gjymtimit të tij. Këto dy sintagma janë të përshtatshme për ta kuptuar historinë e dhunës mbi shqiptarët nga sundimi sllav dhe pasojat që ka lënë ai sundim njëshekullor në shoqërinë e Kosovës dhe në shtetin e ri. Dhuna ka qenë konstanta e jetës së njeriut shqiptar në Kosovë që nga viti 1912 e deri në vitin 1999, me oscilime të ndryshme, brenda të cilave disa herë janë lancuar projekte për zhdukjen e plotë fizike të tij, ndërsa dy herë është provuar edhe krimi i gjenocidit.

Kosova si viktimë e krimeve të gjenocidit përgjatë një një shekull

Herën e parë gjenocidi kundër shqiptarëve në Kosovë është zbatuar kur ajo ra nën pushtimin serb, në kasaphanën që prodhoi komploti ballkanik dhe rus i vitit 1912, i emërtuar si Lufta e Parë Ballkanike. Ajo nuk ishte luftë ballkanike, sepse katër shtetet ballkanike (Serbia, Greqia, Bullgaria e Mali i Zi) kishin një aleancë ushtarake të detajuar, për të copëtuar tokat shqiptare, gjoja nën prekekstin e dëbimit të Perandorisë Osmane nga Ballkani. Pra, në të

ashtuquajturën Lufta e Parë Ballkanike, shtetet ballkanike ishin bashkë, në një komplot kundërshqiptar të paketuar si kundërosman. Komploti antishqiptar e antiosman i shteteve ballkanike vetëm në vitin 1913 u shndërrua në luftë ballkanike, pasi shtetet komplotiste nuk iu përmbajtën akordit për copëtimin e tokave shqiptare. Ky definim i saktë është shumë i rëndësishëm, për dy arsye, e para, ngase këtu e ka farën armiqësia ndërmjet shqiptarëve e serbëve për Kosovën, lufta e të cilëve ende nuk ka përfunduar dhe e dyta, ngase krimi i gjenocidit, meqë atëherë mbeti i pandëshktuar, u përsëritë në vitin 1998-1999. Studiuesi amerikan, Justin McCarthy, në studimin e tij “Vdekje dhe dëbim-Spastrimi etnik i myslimanëve osmanë, 1821-1922”, duke folë për numrin enorm të viktimave muslimane në Perandorinë Osmane sjellë edhe këtë dëshmi për shqiptarët: “Konsujt britanikë dhe të vendeve të tjera, shpesh kanë raportuar me saktësi atë që iu është bërë shqiptarëve, ndonëse politikanët nuk lejuan që publiku i vendeve të tyre të shikonte raportet e konsujve. Për shembull, diplomatët mbajtën shënim se menjëherë mbasi Mali i Zi mori trojet shqiptare të veriut, në vitin 1878, të gjithë shqiptarët e territoreve të pushtuara ose u vranë ose dëbuan me dhunë. Të dhënat e Luftërave Ballkanike tregojnë se në Ballkanin Qendror dhe Perëndimor, 27% e myslimanëve kanë vdekur dhe 35% e tyre kanë marrë arratinë. Shqiptarët pësuan një vdekshmëri që ishte, të paktën, po aq e madhe.”(f. 16) Prej kësaj dëshmie del rezultati se 62% e shqiptarëve ose janë vrarë, ose e kanë braktisur vendin e vet! Pra, vrasja

dhe dëbimi i 62 për qind të shqiptarëve, jo vetëm që nuk është shpallë gjenocid, po në fakt është fshehur dhe ëthë shpërblyer nga Fuqitë e Mëdha të atëhershme evropiane. Faktikisht, ky është gjenocidi më i madh në përqindje i një populli të vrarë e të dëbuar në truallin e Evropës, por që qëllimisht është fshehur! Meqë gjenocidi i vitit 1912 Serbisë i është shpërblyer, ajo e ka përsëritur atë në vitet 1998-1999. Edhe në gjenocidin e dytë u tentua e ashqutuajtura “zgjdhje përfundimtare”, me dëbimin e gjysmës së shqiptarëve nga Kosova, me vrasjen e mijëra civilëve dhe me realizimin e taktikës së “tokës së djegur”, për të cilën pati folë edhe ish sekretari i OKB-së, Kofi Anani. Kosova as kësaj here nuk ka ngritë (ende) padi as për gjenocidin e viteve 1998-1999, ndonëse ai mund të faktehet lehtësisht.

Po qe se e evokojmë me këtë rast definicionin e OKB-së mbi gjenocidin (1948), na rezulton saktësisht se në Kosovë Serbia ka kryer gjenocid në të dyja rastet, më 1912-1913 dhe më 1998-1999. Në artikullin 2 të Konventës së OKB-së për gjenocidin, thuhet: “Sipas kësaj Konvente, me gjenocid nënkuptohet cilido nga aktet e përmendura më poshtë, të kryera me qëllim të shkatërrimit, në tërësi ose pjesërisht, të ndonjë grupi nacional, etnik, racor os religjioz, e ato janë:

- (a) Vrasje e anëtarëve të grupit,
- (b) Shkaktim i dëmeve serioze trupore ose mentale ndaj anëtarëve të grupit,
- (c) Imponim i qëllimshëm i kushteve të jetës mbi grupin, të kalkuluara për të shkaktuar shkatërrimin e tij fizik në

tërësi ose pjesërisht,

(d) Imponim i masave me intencë të pengimit të lindjeve brenda grupit,

(e) Transferim me forcë i fëmijëve të grupit në një grup tjetër.

Të katër format e krimit të gjenocidit janë të faktueshme në rastin tonë, për çka ka dëshmi të shumta.

Bile, jo vetëm për gjenocidin e vitit 1998-1999, por edhe për atë të vitit 1912. Fjala vjen, gazetari amerikan i gazetës “The New York Times”, Piktthall, duke qenë dëshmitar okular i marshimit të armatës së kral Petrit në tetor 1912, ka shkruar: “Masakrat që kryen serbët në Kosovë, nën Kryqn’ e Krishtenë, kapërcejnë çdo instikt gjakpirësie.” Ndërsa konsulli austro-hungarez në Shkup, raportonte se me të hyrë në Prishtinë, më 22 tetor 1912, forcat ushtarake serbe kishin ekzekutuar pesë mijë shqiptarë. Dëshmi të tjera thonë që me të hyrë në Prizren, armata serbe ka vrarë 5000 shqiptarë dhe gjaku ka rrjedhë si përrua lagjeve të qytetit. (Shih: Srbija i Albanci, Çasopis za kritiko znanosti, Lubljana, 1989.) Edhe ushtari i mobilizuar dhe gazetari socialist serb, Dimitrije Tucoviqi, ka lënë dëshmi tronditëse për krimet e armatës serbe në Kosovë e veçmas në krahinën e Lumës, ku sipas dëshmisë së tij, armata serbe i markonte fshatrat me gëlqere se gjoja aty kishte rënë murtaja, pastaj atje hynin ushtarët nëpër shtëpi dhe i digjnin njerëzit të gjallë. Në një artikull Tucoviqi dëshmon: “Për dy orë fshati u zhduk me skena që është vështirë të përshkruhen. Të shtënat i rrëzonin gratë që i mbanin

foshnjat në gjinj, skaj nënave të vdekura qanin fëmijët e tyre të vegjël që rastësisht kishin shpëtuar nga plumbat: trupat e malësoreve të bukura, belholla si bredhat, përdridheshin si krimbat në fushë, gratë lindnin nga frika. Për dy orë u vranë 500 shpirtra.” Një një rast tjetër Tucoviqi dëshmon se si ushtarët serbë i lidhnin civilët shqiptarë rreth sanave, pastaj ia futnin flakën sanës dhe ashtu i digjnin njerëzit e gjallë! Faktikisht këto kanë qenë mjete gjenocidale, sikundër që edhe qëllimi fillestar i komplotit ballkanik ka qenë gjenocidal: qëllimi ishte që nën preteksitn e luftës kundër Perandorsisë Osmane, të zhdukej kombi shqipar dhe tokat e tij të ndaheshin ndërmjet serbëve, bullgarëve, grekëve e malazezve. Pra, edhe qëllimi e edhe mjetet e përdorura kanë qenë tipike gjenocidale, edhe në komplotin ballkanik të vitit 1912. Ëshë gjithsesi ilustrativ për ekzistimin e qëllimit të gjenocidit edhe fakti se Serbia ka financuar dhe ka përdorur në terren edhe organizatat speciale terroriste, si “Këshilli Kryesor i Organizatës Çetnike”, të idejuar nga ministri i jashtëm Spallajkoviç, “Narodna Odbrana” (1908), të udhëhequr nga gjenerali Bozhidar Jankoviç dhe organizata tjetër terroriste, “Dora e Zezë”(1911), e cila udhëhiqej nga koloneli famëkeq, Dragutin Dimitrijeviç-Apisi.

Ndërmjet vitit 1912 e viteve 1998-1999, kur u përsëritë krimi i gjenocidit serb kundër shqiptarëve në Kosovë, ka pasur edhe disa tentativa të dëbimit dhe të spastrimit etnik: Elaborati i Vaso Çubrilloviçit (1937) Programi i Çubrilloviçit për pakicat (1945), Elaborati i Stevan Moleviçit, Projekti i Drazha Mihajloviçit (1941),

Projekti i Ivo Andriqit (1937?) , Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve (1986.) Fjala vjen, Në dokumentin “Instruksionet”, të Drazha Mihajloviqit, në kapitullin “Përdorimi i aradhave çetnike në Mal të Zi”, pika 2, lideri çetnik propozonte : “Forcat pjesërisht të veprojnë nëpër Çakorr në drejtim të Rrafshit të Dukagjinit me detyrë që në këtë drejtim të spastrohet territori nga shqiptarët, si dhe t’u pritët rruga atyre që do të ndiqen nga Peshteri-Sanxhaku.” Ndërsa në Elaboratin “Problemi i pakicave kombëtare në Jugosllavinë e re”, (1945) Çubrilloviqi propozonte: “Në qoftë se dëshirojmë të arrijmë qëllimin e ndërlidhjes së ndërsjellë të Malit të Zi, të Serbisë e të Maqedonisë, Kosova e Rrafshi i Dukagjinit duhet ta ndryshojnë me themel përbërjen etnike të tyre. Para së gjithash duhet të spastrohet Rrafshi i Dukagjinit si krahinë kufitare, fqinje e Malit të Zi, e cila është e përshtatshme për kolonizimin e malazezve.” Ndërsa, gjenocidi i viteve 1998-1999 de facto është vërtetuar edhe në Tribunalin e Hagës, ku u dënuan për krimet në Kosovë krerët e shtetit serb, ndonëse emri gjenocid nuk iu vu krimeve të bëra, për shkaqe thjesht politike.

Kosova si çështje religjioze serbe dhe çështje nebuloze shqiptare

Kosova si shtet që ende ka mbikëqyrje ushtarake (KFOR) dhe civile (EULEX dhe rezoluta 1244) ndërkombëtare, ka dalë prej kësaj historie të gjatë të dhunës dhe krimeve të gjenocidit. Edhe pse e ka shpall pavarësinë më 17 shkurt 2008 dhe është njohur nga njëqind e dhjetë shtete të botës, Kosova është direkt

ende e kërcënuar nga Serbia, e cila nuk e njeh si shtet. Përkundrazi, në Kushtetutën e Serbisë Kosova mbahet në preambullë si pjesë përbërëse e shtetit serb. Poashtu Kisha Ortodokse Serbe ngulmon që Kosova është Serbi dhe do të mbahet e tillë edhe me dhunë. Patriarku i KOS, Irinej, edhe në mesazhin e Krishtlindjeve të këtij viti ka thënë: “Kosova dhe Metohia janë Jerusalemi ynë, toka jonë e shenjtë.” Në një rast tjetër ka deklaruar se siç është marrë me dhunë, Kosova do të kthehet nën Serbi me dhunë. Nga ana tjetër, për çdo vit, në të ashtuquajturën festë e Vidovdanit (27 qershor) grupe ekstremistësh serbë nga mbarë Serbia vijnë në Gazimestan, ulërasin sloganin “Kosova është Serbi”, përleshën me policinë dhe lënë mesazhe kërcënuese se do të kthehen e do të hakmirren. Slogani më tipik i Kishës Ortodokse Serbe është “Ovvetiti Kosovo”(të hakmirremi për Kosovën), që i referohet betejës që serbët e kanë humbur në ballafaqim me osmanët në vitin 1389. Pra ata planifikojnë hakmarrjen ndaj shqiptarëve, të cilët i njëjtësojnë me osmanët, ashtu siç kanë bërë edhe në Bosnje e Hercegovinë, veçmas në Srebrenicë. Pra, çështja e Kosovës nga aspekti serb, nuk është vetëm çështje politike, ideologjike e nacionale, po më së shumti është çështje religjioze. Motivimi i dhunës më së shumti e ka burimin te përjetimi religjioz i çështjes së Kosovës nga shumica e serbëve të djeshëm e të sotëm, përjetim të cilin e përdorin për të arsyetuar dëbimin e shqiptarëve nga “toka e shenjtë serbe” dhe për vrasjen masive të tyre, si gjoja pasardhës të vrasësve të shejtit të Kishës serbe, car Lllazarit.

Fatkeqësisht, Kosova e sotme, nuk ka ndonjë projekt me të cilin do ta amortizonte ose do ta rivalizonte projektin religjioz serb për Kosovën si “Jerusalem serb” dhe “tokë e shenjtë serbe.” Me përpjeket që janë bërë nga historiografia dhe publicistika marksiste shqiptare, për t’i paraqitur shqiptarët si gjoja aleat të Serbisë kundër osmanëve, në Betejën e Kosovës të vitit 1389, vetëm sa i janë shtuar kreditet Serbisë për argumentimin e saj se ajo ishte dhe është lidere e Ballkanit dhe se Kosova në atë kohë ka qenë tokë serbe. Tentimi që t’i konkurohet Serbisë për pronësi të shqiptarëve mbi atë betejë, është naivitet, sepse Serbia e ka patentuar me shekuj pronësinë mbi atë betejë, duke e falsifikuar e duke e mitizuar në përmasa mitologjike e religjioze. Mundësia tjetër e shqiptarëve, por që nuk po jep rezultate, është ndërtimi i një narracioni për Dardaninë antike dhe për prejardhjen dardane të shqiptarëve të saj. Por, mungesa e dokumentimit të gjuhës dhe e dëshmimeve të tjera të forta, këtë tentativë e mban pezull. Një mundësi tjetër është që të ndërtohet narracioni konkurues shqiptar për Kosovën si tokë e triumfit të Islamit, që në shekullin XIV, por shqiptarët nuk e kanë guximin që ta lancojnë këtë narracion, për shkak të rrethimit islamofobik ballkanik e gjithë evropian. Ndërsa, tentimi që të mbahet rivaliteti me narracionin e serbëve, me vlerat e Krishterimit latin, nuk ka potenciale, ngase vetëm rreth 5 për qind e shqiptarëve të Kosovës i përkasin këtij konfesionit. Pra, shqiptarët nuk e kanë ndonjë naracion konkurues me serbët për të kaluarën e Kosovës. Kjo mungesë mund të shfaqet shumë

kërcënuese në të ardhmen dhe të prodhojë dhunë të re. Pse? Ngase serbët duke e trajtuar si çështje religjioze, vazhdimisht mund të mobilizojnë jo vetëm Kishën, po edhe një pjesë të madhe të kombit serb për luftë në Kosovë, ndërsa shqiptarëve do t'u mungojë një motivim më i fortë për ta mbrojtur Kosovën nga agresioni serb i radhës, veçmas nëse triumfon versioni që Kosovën e kanë një atdhe tranzitor, drejt një shteti tjetër, Shqipërisë së bashkuar! Pra, njëra nga dobësitë e shtetit të Kosovës është përjetim i tij si tranzitor prej shqiptarëve, ndërsa njëri nga adutet më të forta të serbëve është se e trajtojnë si atdhe biblik prej serbëve. Me kohë qasja serbe dhe përjetimi religjioz i Kosovës prej tyre, mund të shndërrohet në përparësi të pakthyeshme dhe pastaj u mbetet vetëm ta presin rastin për revansh, në kontekstin e ndonjë ndryshimi gjeopolitik të favorshëm për ta. Nga ana e tyre, strategët ushtarakë serbë ashtu thonë, pra, presin fuqizimin e Rusisë dhe dobësimin e Amerikës, për ta zbatuar revanshin. Pra, dhuna nuk është vetëm histori, po edhe plan veprimi për të ardhmen e shtetit serb, të elitave serbe, shoqërisë serbe, kombit serb dhe mbi të gjitha i Kishës serbe, si emblema e tyre.

A do të transformohen shqiptarët e Kosovës, apo do të mbeten peng i mendësisë serbe të dhunë

Ato plane ogurzeza të serbëve do të mund të parandaloheshin vetëm nëse do të ndodhte një transformim i vërtetë i shqiptarëve të Kosovës dhe një fuqizim konkret i shtetit të tyre. Transformimi i shqiptarëve të Kosovës! Tingëllon si oksimoron! Prej

çkahi drejt çkahit, duhet të jetë ky transformim? Transformimi do të thotë shkëputje nga shumë sedimente e sentimente politike, kulturore e madje edhe antropologjike, më shumë se sa nga ato gjeopolitike, prandaj edhe janë më komplekse dhe më të vështira për t'i arritur. Në fakt, në aspektin gjeopolitik, intervenimi i NATO- i vitit 1999, me Marrëveshjen e Kumanovës dhe rezoluta 1244 e Këshilli i Sigurimit, bashkë me Planin e Ahtisarit, e kanë krijuar një kontekst për shkëputjen e Kosovës nga trashëgimia serbe dhe transformimin e saj, gjë që është proklamuar me pavarësimin e Kosovës në vitin 2008. Por trashëgimia politike, kulturore e antropologjike me prejardhje sllave ende nuk ka filluar as të analizohet e lëre më që të sanohen pasojat e saj në shtetin e ri dhe në shoqërinë e re. Shpërthimi i dhunës dhe hakmarrjes së shqiptarëve ndaj serbëve në vitin 2004, ka dhënë sinjalin e qartë se pasioni i dhunës dhe hakmarrjes ndër shqiptarë është prezente dhe pret klimën e përshtatshme që të shpërthejë. Paraprakisht uzurpimet e shumta të shtëpive dhe të pronave serbe nga ana e shqiptarëve, pas vitit 1999, kanë provuar se edhe në mesin e shqiptarëve ka jo pak persona që nuk e kanë problem ta përdorin dhunën për të arritur qëllime pasurore e politike. Kjo prirje për dhunë në vitet e fundit është drejtuar ndaj vetë shqiptarëve, që nga sulmet fizike ndaj zyrtarëve shtetërorë, përdorimi i gazit lotsjellës në parlament, sulmi me zollë ndaj godinës së Kuvendit e deri te shkatërimi i pronës private të kundërshtarëve politikë. Pra, elemente të dhunës ka jo pak brenda

shoqërisë së sotme të shqiptarëve të Kosovës, që tërhiqet rëshanë, si trashëgimi politike, kulturore e antropologjike nga jetesa në sundimin serb. Kjo trashëgimi negative është duke e penguar transformimin. Meqë Kosova nuk ka pasur ndonjë traditë të jetës politike të pavarur, ajo trashëgiminë në këtë fushë e ka të huazuar. Paradoksalisht, huazimi më i dukshëm është nga vetë Serbia, okupatori i deridjeshëm i saj, i cili gjatë nëntëdhjetë vjetëve ka injektuar në mendësinë tonë politike e kulturore disa nga idetë dhe nga praktikat e ndjekura prej saj. Pra, është fjala për injektim të padukshëm e tinëzar të atyre ideve dhe praktikave, e jo për një huazim të ndërgjegjshëm. Ku shihet kjo trashëgimi politike, e mbetur si një virus i fshehur në jetën politike të vendit tonë?

E para, është përgjasimi me Serbinë në konceptimin e shtetit. Serbia që nga krijimi i saj si shtet e deri sot, gjithmonë është karakterizuar si „shtet i papërfunduar“. Kjo do të thotë se kufijtë që ka pasur e edhe ata që i ka sot, nga serbët konsiderohen si të përkohshëm, që vetëm pritet një moment i përshtatshëm që ata të ndryshojnë, duke krijuar ndonjë strukturë më të madhe shtetërore, ndonjë bashkim sipas sloganit „Të gjithë serbët në një shtet“. Me këtë koncept politik, Serbia ka provokuar edhe Luftën e Parë Botërore, pas vrasjes së dukës Ferdinand në Sarajevë në vitin 1914. Me këtë koncept edhe Millosheviçi e filloi agresionin e Serbisë ndaj Kroacisë, duke piketuar kufirin e ri në linjën Karlovac-Virovitica-Karlobag. Ndërsa, në Bosnjë e

Hercegovinë Serbia synoi të merrte sa më shumë territore, gjë që edhe rezultoi me një akord morbid ndërmjet Millosheviçit e Tuxhmanit, me ç'rast gjatë një darke ata e ndanë shtetin boshnjak, duke e vizatuar ndarjen në një sallvetë! Fatkeqësisht, një pjesë e mendimit politik e kulturor shqiptar në Kosovë e më gjerë, është i atillë që Kosovën e koncepton si “shtet të përkohshëm”, i cili u dashka që sa më shpejt të bashkohet me Shqipërinë. Sipas këtij konceptimi, për t’u bashkuar me Shqipërinë, ky shtet duhet të bëhet i dështuar e mandej të bëhet bashkimi me “shtetin amë”. Përderisa të jetë aktive kjo mënyrë e konceptimit të shtetit në jetën politike të vendit, kjo do të jetë e rrezikshme për suksesin e Kosovës si shtet, sepse një shtet i dështuar nuk mund të jetë i aftë për bashkim me askënd. Përkundrazi, një shtet i dështuar mbetet cak legjitim i ndërhyrjes së komunitetit ndërkombëtar. Koncepti për shtetin partiak është koncept tipik i praktikave politikave serbe, e jo i atyre evropiane. Partia/partitë që e marrin pushtetin në Serbi, nuk kanë më kufizime në politikat qeverisëse, po bëjnë çfarë të duan dhe si të duan. Edhe pushteti gjyqësor mbetet i varur dhe nën presionin e pushtetit politik, ashtu që askush nuk përgjigjet as për abuzime dhe krime të rënda. Po të shohësh në Serbi, praktikisht asnjë nga vrasjet e gazetarëve dhe politikanëve opozitarë nuk është ndriçuar plotësisht dhe shumë nga fajtorët janë të lirë. Fatkeqësisht, as në Kosovë nuk ka ndonjë ndjeshmëri për ndriçimin e vrasjeve politike që kanë ndodhur pas çlirimit të vendit.

Trajtimi i kundërshtarëve politikë si armiq, është praktikë tradicionale e politikës serbe. Po të shikohet historia e luftës politike në skenën e Serbisë, ajo është monstruoze, me vrasje mbretërisht, kryetarësh e hierarkësh të lartë të shtetit e të partive politike. Kjo praktikë e shëmtuar e ka bërë Serbinë gjatë këtyre njëqind e njëzet e pesë vjetëve, një shtet të frikshëm, ku goja mund t’u mbyllet kundërshtarëve edhe me thika e me plumba. Te ne kjo nuk është dukuri, por është tendencë latente, që nuk duhet të injorohet. Kam frikë se po të mos ishte prezenca e fuqishme ndërkombëtare e KFOR-t dhe e EULEX-it, edhe kjo trashëgimi negative, tipike për politikën serbe, do të kishte reflektimet e saj të errëta në jetën politike të vendit.

Folklorizmi dhe populizmi janë elementë të ligjërimit politik edhe ndër ne, ndërsa në ligjërimit politik serb, janë dominuese. Thënia e famshme e Petar Petroviq Njegoshit, “Le të bëhet ajo që nuk mund të bëhet”, është filozofia kryesore e folklorizmit dhe populizmit serb, i cili përpiqet t’i paraqesë si të mundshme gjërat që nuk janë të mundshme. Këtë tendencë e gjeni edhe në ligjërimet e jo pak politikanëve tanë, si ajo për bashkimin kombëtar.

Praktika e vjedhjes së votave është traditë e politikës serbe, ndonëse në vitet e fundit kjo dukuri është eliminuar, pasi e ka eliminuar opozitën.) (Sulmet që u bënë ndaj Valdete Dakës janë tregues se te ne ajo skemë do të mund të tentohej, po të mos ishte këtu Daja Sem që e mbron “me stupc” diplomatik KQZ-në.)

Një tjetër trashëgimi negative e politikës serbe është edhe ndikimi i shërbimeve sekrete në politikë dhe në jetën e vendit. Ndërhyrja e shërbimeve sekrete në Serbi ka qenë e tillë që ka prodhuar vrasjen e mbretit Aleksandër Obrenoviqit, të ish presidentit Ivan Stamboliqit, të kryeministrit, Zoran Gjingjiqit, po të përmenden vetëm disa nga titullarët më të lartë të pushtetit në Serbi. Gjatë sundimit komunist serbo-jugosllav, shërbime sekrete UDB dhe shërbimi sekret i ushtrisë, KOS, kanë bërë shumë krime të shumta kundër kundërshtarëve ideologjikë, si brenda ish Jugosllavisë, ashtu edhe jashtë saj. Edhe disa nga atentatet ndaj shqiptarëve janë vepra të këtyre shërbimeve famëkëqija. Serbia e ka krijuar atë traditë të keqe që shërbimet sekrete të kenë primatin e pararojës politike dhe kombëtare. E frikshme për çdo shtet, sepse ky model e ngulfat demokracinë dhe e mban popullin në frikë. E lidhur me këtë praktikë të ndërhyrjes së shërbimeve sekrete është edhe thashethemnjaja kundër kundërshtarëve politikë e njerëzve më përgjithësi, e cila i helmon marrëdhëniet midis njerëzve. Thashethemet dhe shpifjet gëlojnë edhe sot në politikën dhe në jetën shoqërore serbe. Mjafton të lexohen gazetatat ditore në gjuhën serbe dhe të shihet se lufta politike edhe sot bëhet me thashetheme dhe me shpifje më shumë se me gjithçka tjetër. Kjo trashëgimi negative politike, kulturore e antropologjike, e cila është mjaft prezente ndër ne, do të duhej të çrrënjosej plotësisht, duke shkuar drejt evropianizimit të komunikimit, ku ballafaqimi i

argumenteve dhe gjykimi kritik e logjik është parimi kryesor i çdo komunikimi.

Pasurimi enorm dhe joligjor i politikanëve dhe qeveritarëve është një traditë e famshme e Serbisë. Ajo edhe motivon shumë konflikte dhe qërime hesapesh me metoda të dhunshme të pasanikëve, që kanë fituar duke i shërbyer pushtetit. Rast tipik është ai i biznesmenit kontravers, Mishkoviqit. Të gjitha këto janë elemente të politikave të dhunshme, që prodhojnë paligjshmëri dhe e dënojnë shtetin me ngecje dhe e kompromentojnë para botës. Si të tilla këto mendësi, këto struktura dhe praktika, nëse nuk shmangen radikalisht, nuk do ta lejojnë as transformimin e shoqërisë e as fuqizimin e shtetit të Kosovës. Do ta mbajnë si peng të dhunës.

Pra, pa një shkëputje të plotë nga trashëgimia politike, kulturore e antropologjike serbe, vurrata e kamxhikut sllav për të cilën shkruante Arshi Pipa në poezinë “Kosovës”, do të mbetet si shëmti e dukshme edhe në fytyrën e shqiptarit të sotëm. Madje edhe kur ai kamxhik kalon në duart e tij!

SHËRBIMET SEKRETE SERBE

Shërbimi i Sigurimit të Shtetit (Služba državne sigurnosti, :Служба државне безбедности; Служба за државна безбедност; Služba državne varnosti), i njohur edhe me emrin e tij origjinal si Administrata e Sigurimit të Shtetit, ishte organizata sekrete e policisë së Jugosllavisë komuniste. Në çdo kohë ishte më i njohur me akronimin UDBA, i cili rrjedh nga emri origjinal i organizatës: Uprava državne bezbednosti (“Administrata e Sigurimit të Shtetit”). Shkurtesat SDB (serbe) ose SDS (kroate) u përdorën zyrtarisht pasi organizata u riemërua në “Shërbimi i Sigurimit Shtetëror”. Në dekadat e fundit të saj, ajo përbëhej nga 8 organizata gjysmë të pavarura të policisë sekrete – 1 për secilën nga 6 republikat federale jugosllave dhe 2 për krahinat autonome (Kosovë dhe Vojvodinë) – të koordinuara nga selia qendrore federale në kryeqytetin

e Beogradit. Edhe pse funksiononte me më shumë përmbajtje se agjencitë e policisë sekrete në shtetet komuniste të Evropës Lindore, UDBA ishte një mjet i frikshëm kontrolli. Pretendohet se UDBA-ja ishte përgjegjëse për “eliminimet” të dhjetëra armiqve të shtetit brenda Jugosllavisë dhe ndërkombëtarisht (vlerëson rreth 200 atentate dhe rrëmbime). Eliminimet variojnë nga ato të udhëheqësve kroatë ustashe të Luftës së Dytë Botërore Ante Paveliq dhe Vjekoslav Luburiq (në Argjentinë dhe Spanjë), tek shkrimtari emigrant kroat Bruno Bushiq dhe shkrimtari emigrant serb Dragisha Kashikoviq, megjithëse kriminelët e luftës duhet të dallohen nga ata që u vranë vetëm për mospajtim ose arsye politike apo ata shqiptarar Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla e shumë të tjerë që u likuiduan nga shërbimi sekret serbo-jugosllavë, ish UDB-a.

Me shpërbërjen e Jugosllavisë, republikat e shkëputura vazhduan të formojnë agjencitë e tyre të policisë sekrete, ndërsa Shërbimi i Sigurimit Shtetëror i RF të Jugosllavisë mbajti emrin e tij të kohës së UDBA-së. Funksionet UDBA formoi një pjesë të madhe të shërbimeve të inteligjencës jugosllave nga viti 1946 deri në 1991, dhe ishte kryesisht përgjegjëse për sigurinë e brendshme të shtetit. Pas vitit 1946 UDBA-ja pësoi ndryshime të shumta në siguri dhe inteligjencë për shkak të çështjeve aktuale të asaj kohe, duke përfshirë: luftimin e bandave; mbrojtja e ekonomisë; Kominform/Informbiro; dhe aspiratat burokratike. Në vitin 1945 dhe 1946, për shembull,

UDBA u organizua në rrethe. Në vitin 1950, kur u hoqën si autoritete njësitë administrativo-territoriale, UDBA-ja u riorganizua sërish. Gjatë kësaj periudhe aktivitetet e inteligjencës dhe sigurisë u përqendruan më pak në inteligjencë dhe më shumë në sigurinë e brendshme. Kishte një theks në kolektivizmin, vëllazërinë, harmoninë shoqërore, besnikërinë dhe tolerancën ndaj atyre me pikëpamje të ndryshme. Devijimi nga ky grup vlerash u bë një problem i menjëhershëm për shërbimet e sigurisë. Më vonë, përdorimi i forcës u zbut dhe kur filloi procesi i “decentralizimit të pushtetit popullor”, shërbimet e inteligjencës dhe të sigurisë iu nënshtruan riorganizimit të mëtejshëm për të decentralizuar pushtetin dhe për të rritur efektivitetin. Në plenumin e Komitetit Qendror në korrik 1966, udhëheqja politike akuzoi SDB-në se po pengonte reformat drejt vetëadministrimit. Si rezultat, SDB u decentralizua, personeli i saj u reduktua (veçanërisht në nivel federal) dhe u krijuan komisione kontrolli. U nxorën rregullore të reja, duke forcuar iniciativën e pavarur të shërbimeve të sigurimit shtetëror të gjashtë republikave jugosllave dhe krahinave autonome. SDB-së iu hoq funksionet ekzekutive dhe iu besua identifikimi dhe parandalimi i aktiviteteve armiqësore. Ligji për Punët e Brendshme dhe Dekreti për Organizimin e Sekretariatit të Punëve të Brendshme Shtetërore rregullonin autoritetin e sigurisë së inteligjencës si prerogativë e Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit në Ministrinë e Brendshme. Riorganizimi i mëposhtëm trajtoi çështje që lidhen me kompetencën e

federatës (siguria shtetërore, trafiku ndërkufitar, shtetasit e huaj, pasaportat, prezantimi dhe përhapja e shtypit të huaj dhe shtetësia federale). Struktura Aktiviteti i inteligjencës dhe sigurisë u organizua në këtë mënyrë: Pasi OZNA (Одељење заштите народа / Odeljenje zaštite naroda, “Departamenti për Mbrojtjen e Popullit”) u shfuqizua, veprimtaria e inteligjencës u nda midis ministrive të ndryshme federale: Ministria Federale e Brendshme nga Administrata e Sigurimit të Shtetit dhe Ministria Federale e Jashtme. Çështjet nga Shërbimi për Hulumtim dhe Dokumentacion (SID) i cili grumbullonte informacione të jashtme politike; Inteligjenca ushtarako-mbrojtëse u trajtua nga Departamenti i 2-të i GS – KOS (Kontraobaveštajna služba / Контраобавештајна служба / “Shërbimi i Kundërzbulimit”) i Ushtrisë Popullore Jugosllave. SDB në republika nuk ishte autonome, por ishte e lidhur me shërbimin federal, i cili bashkërendonte punën dhe nxirrte udhëzime. Sigurimi i shtetit rregullohej me legjislacion sekret (Gazeta Zyrtare sekrete), i cili parashikonte përdorimin e operacioneve speciale. SDB ka kryer kontrole në shtëpi, përgjime të fshehta brenda lokaleve, përgjime telekomunikacioni, vëzhgim të fshehtë të njerëzve dhe përgjime të fshehta të letrave dhe dërgesave të tjera. Me interes parësor për SDB-në ishte siguria e brendshme; identifikimi dhe pengimi i aktiviteteve të “armikut të brendshëm” (d.m.th. “djathtas borgjeze”, klerikalistët, anëtarët e Kominform-it, nacionalistët dhe separatistët). Puna e inteligjencës jashtë vendit konsiderohej më pak e rëndësishme dhe ishte nën kontrollin federal. SDB

ishite një “policë politike”, që i përgjigjej organizatës së partisë nga e cila merrte udhëzimet e saj dhe të cilës i raportonte. SDB-ja ishte aq e rrënjosur në sistemin politik, sa që një nga detyrat e saj ishte përgatitja e “Vlerësimeve të Sigurisë Politike”; pra vlerësime fjalë për fjalë për të gjitha sferat e jetës. Gjatë veprimtarisë së saj, SDB-ja gëzonte një gamë të gjerë pushtetesh, duke përfshirë kompetencat klasike të policisë (identifikime, marrje në pyetje dhe arrestime). Organizata e SDB-së ndryshonte vazhdimisht dhe bënte përmirësime, por mbeti e lidhur me njësinë qendrore në kryeqytetet e republikave dhe grupet më të vogla të punës në terren. Të gjitha informacionet dhe të dhënat derdeshin në njësinë qendrore në kryeqytet dhe prej andej u dërguan përdoruesve. Grupet në terren kishin kontakte pune me autoritetet lokale, por nuk iu përgjigjën atyre. Aktivitetet Periudha 1946-1986 Një nga veprimet e para të suksesshme të UDBA-së ishte operacioni Gvardijan, i cili i mohoi Bozhidar Kavranit mundësinë për të depërtuar në grupet e ish-ustashëve për të nisur një kryengritje kundër Jugosllavisë, duke pushtuar përfundimisht vetë Kavranin. Nga viti 1963 deri në vitin 1974, shërbimet e inteligjencës së sigurisë u morën me një sërë ngjarjesh politike të brendshme dhe të jashtme. Në vend, pati konfrontime politike si para dhe pas Plenumit të Brionit (1966), shpërthime liberale dhe demonstrata masive studentore majtiste në Beograd në vitin 1968, Hrvatsko proljeće (Pranvera Kroate) ose “MASPOK” (lëvizja masive) në Kroaci në 1971. Inkursioni nacionalist i grupit të Bugojnos në zonën e

Radushës (1972) dhe një ringjallje e nacionalizmit në republikat jugosllave. Ngjarja më e rëndësishme jashtë vendit ishte pushtimi i trupave të Traktatit të Varshavës në Çekosllovakë në vitin 1968. Këto ishin rrethanat në kohën kur u miratua akti i parë për punët e brendshme të republikave individuale në vitin 1967. Sipas këtij akti, punët e brendshme trajtoheshin drejtpërdrejt nga organet administrative komunale dhe sekretariatet e punëve të brendshme të secilës republikë ose nga krahinat e tyre. Trupat. Kjo ishte hera e parë që nga viti 1945 që republikat fituan kontroll dhe ndikim më të madh mbi organet e tyre individuale të sigurisë dhe shërbimet e sigurisë së inteligjencës. Shërbimi i Sigurimit Shtetëror (SDB) është përcaktuar me ligj si shërbim profesional në kuadër të Sekretariatit Republikan të Punëve të Brendshme (RSUP). Natyrisht, pjesa më e madhe e kompetencave të saj mbeti brenda institucioneve federale, siç parashikohet nga Akti për trajtimin e çështjeve të brendshme nën kompetencë të organeve administrative federale (1971), i cili përcaktonte se sekretariati federal i punëve të brendshme do të koordinonte punën e SDB-së në republika dhe provincat. Hapat e mëtejshëm u ndërmorën me transformimin e administratës shtetërore, miratimin e Aktit Federal për Administratën Shtetërore (1978) dhe Aktit të Republikës (1978). Akti i sapomiratur për punët e brendshme ngarkoi Sekretariatit të Republikës së Punëve të Brendshme (RSUP) me çështjet e sigurisë së shtetit, të cilat më pas u shndërruan në çështje të RSUP dhe nuk iu dha më trajtim i veçantë “në RSUP”.

Kjo rezolutë mbeti në fuqi deri në ndryshimet e vitit 1991 të aktit për punët e brendshme. Periudha pas-1986 Roli i inteligjencës dhe sigurisë ndryshoi pas vitit 1986, kur brenda Partisë mbretëroi një mentalitet tjetër dhe nisën proceset e demokratizimit. Agjencitë e sigurisë së inteligjencës u sulmuan dhe shumë njerëz filluan të shkruanin publikisht dhe të kritikonin SDB-në. Organizata partiake u shfuqizua në SDB dhe filluan përpjekjet e para për të vendosur kontrollin parlamentar. Zgjedhjet e para demokratike shumëpartiake në 1990, të cilat përforcuan procesin e demokratizimit, jehonë brenda Sekretariatit Federal të Punëve të Brendshme (SSUP) dhe Shërbimit Federal të Sigurimit të Shtetit (SSDB), të cilët po luftonin për të mbajtur kontrollin mbi SDB-të individuale në republika. e cila u bë gjithnjë e më e përçarë. Ata ishin ende ligjërisht të lidhur me organet federale, por po ndërgjegjësoheshin se vepronin dhe punonin në republikën e tyre të veçantë. Disa kuadro profesionistë, veçanërisht ata të “fushës së brendshme” (që kishin të bënë me “të djathtën borgjeze”, klerikalistët dhe lëvizjet studentore) nisën të largoheshin nga shërbimi. Konflikti po shtohej dhe arkivat e SDB-së po shkatërroheshin sistematikisht. Në kërkimin e roleve të reja, SDB-të gjithashtu filluan të kufizojnë informacionin që po i dërgonin SSDB-së. Ata përfundimisht e kufizuan informacionin e tyre në shërbimet e huaja të inteligjencës. Së bashku me dobësimin e pozitës së SSDB-së, u bënë përpjekje nga Shërbimi i Sigurimit i Ushtrisë Popullore Jugosllave ose KOS për të forcuar bastionet e veta në republikat e

ndryshme dhe në SDB-të individuale. Përpyekjet dështuan sepse vareshin nga kuadrot e kombësive të tjera të punësuar ende në SDB-të, por që nuk kishin akses në bazat e të dhënave dhe nuk kishin fuqi vendimmarrëse për shkak të orientimit të tyre “jugosllav”. Dosjet e publikuara së fundmi përmbajnë informacione për 1 milion qytetarë të Republikës Socialiste të Sllovenisë dhe ish-republikave të tjera të ish-Jugosllavisë, dosjet e të cilëve UDBA në Slloveni mbante shënime. Në vitin 2003 dhe 2010, në faqen e internetit udba.net ishte e mundur të shiheshin emrat e agjentëve të UDBA-së në Slloveni, disa prej të cilëve janë ende aktivë në Ushtrinë Sllovene dhe Ministrinë e Brendshme. Qeveria e Sllovenisë kërkoi menjëherë heqjen e faqeve nga faqja e internetit, kështu që ato aktualisht nuk janë të aksesueshme. Agjencia e Inteligjencës së Sigurisë (Bezbednosno-informativna agencija / BIA) apo BIA Serbe është përgjegjëse për mbledhjen, raportimin dhe shpërndarjen e inteligjencës dhe kryerjen e kundërzbulimit në interes të sigurisë kombëtare të Serbisë. Historia BIA u formua më 1 gusht 2002 si pasardhëse e Shërbimit të Sigurimit Shtetëror (SDB), i cili ekzistonte nga viti 1991 deri në 2002. Funkzioni i saj është i ngjashëm me atë të CIA-s në Shtetet e Bashkuara ose MI6 në Mbretërinë e Bashkuar.

Në maj të vitit 2017, Bratislav Gashiq, ish-ministër i Mbrojtjes dhe bashkëpunëtor i ngushtë i presidentit, Aleksandar Vuçiq, u emërua në krye të Agjencisë së Inteligjencës së Sigurisë. Pas emërimit të tij, Gashiq pezulloi aktivitetet e tij në Partinë Progresive Serbe

(SNS) në pushtet. Në gusht të vitit 2017, në Kuvendin Kombëtar ka mbërritur për miratim një amendament për Ligjin për Agjencinë e Sigurisë dhe Informacionit, i cili forcon kompetencat e drejtorit të agjencisë. Ky veprim u dënua nga disa zyrtarë, duke përfshirë Komisionerin për Informim të Rëndësisë Publike Rodoljub Shabiq dhe ish-bashkëministrin e Punëve të Brendshme Bozho Preleviq. Ata kanë deklaruar se këto amendamente janë antikushtetuese dhe në këtë mënyrë krijojnë një platformë për “agjencinë e inteligjencës partiake” të SNS-së, që synon opozitën dhe qytetarët kundërshtarë të regjimit në pushtet. Drejtorët Në korrik 2008 erdhi Sasha Vukadinoviq dhe u largua drejtori i mëparshëm der BIA Radomir Bulatoviq qe kish qene ne detyre qe nga prill 2004.

VRASJE, PËRDHUNIME, TORTURA

Ky shkrim dokumenton torturat, vrasjet, perdhunimet, debimet me force dhe krime të tjera lufte të kryera nga forcat e qeverisë serbe dhe asaj jugosllave kundër shqiptarëve të Kosovës nga 24 marsi deri më 12 qershor 1999, periudha e sulmeve ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë.

Shkrimi deshmon për një fushatë sistematike të koordinuar dhe të organizuar nga nivelet më të larta të qeverisë serbe dhe jugosllave të asaj periudhe për të terrorizuar, vrarë dhe shperngulur shqiptarët etnike të Kosovës.

Natyrisht këto krime nuk ishin të izoluara nga njëri tjetri.

Ky shkrim paraqet kontekstin historik dhe politik të luftës dhe një kritike të reagimit të komunitetit ndërkombëtar ndaj zhvillimit të krizës gjatë dekadës së fundit.

3 kapituj dokumentojne gjithashtu shkeljet e bera nga kryengritesit shqiptare te Ushtrise Çlirimtare te Kosoves (UÇK), te cilet kryen rrembime dhe vrasje te civileve gjate dhe pas luftes, si dhe shkeljet e kryera nga NATO, e cila deshtoi ne minimizimin e viktimave civile gjate bombardimeve ne Jugosllavi.

Megjithate fokusi kryesor i ketij raporti eshte dhuna shteterore e ushtruar nga qeverite serbe dhe jugosllave ne vitin 1999 kunder qytetareve shqiptare etnike te Jugosllavise.

Lufta – Ofensiva e Vitit 1999 Ofensiva e qeverise serbe dhe jugosllave ne Kosove, e cila filloi me 20 mars 1999 kater dite para se te fillonte bombardimi i NATO-s, ishte nje fushate e planifikuar metodikisht dhe e zbatuar me perpikmeri.

Ndryshimet kyçe ne aparatin e sigurimit te Jugosllavise ne 1998, duke perfshire emerimin e kreut te ri ne sigurimin e shtetit serb si dhe ne Shtabin e Pergjithshem te Ushtrise Jugosllave, tregojne qe ne ate kohe u bene pergatitjet per ofensiven luftarake në Kosovë.

Ne fillim te vitit 1999 vihet re nje rritje e dukshme e prezences ushtarake dhe armatosja e civileve serbe etnike.

Aksionet e policise dhe ushtrise ne fund te shkurtit dhe ne fillim te marsit perreth Vushtrrise dhe Besjanës, te emertuara nga qeveria si “ushtrimet e dimrit” siguruan lidhje hekurudhore dhe rrugore ne veri me Serbine.

Shkelje te renda te se drejtes nderkombetare humanitare kane karakterizuar te gjitha ofensivat e

meparshme te qeverise, por periudha e bombardimeve te NATO-s shenoi sulme te papara mbi civiliet dhe shpernguljen me force te me shume se 850,000 shqiptareve etnike nga Kosova.

Per here te pare ne luftën e Kosovës, luftimet u zhvendosen nga zonat fshatare ne ato qytetare.

Ndersa fushata e qeverise duket se ishte nje perpjekje per te shtypur UÇK-ne, me fillimin e bombardimeve te NATO-s kjo fushate u shnderrua ne me shume se kaq.

Me ndermarrjen e nje ofensive me te madhe, presidenti i atehershem i Jugosllavise Slobodan Miloseviç perfitoi nga bombardimet e NATO-s qe te zbatonte nje plan per te shtypur UÇK-në dhe bazen e tyre mbeshtetese ne popull, si dhe per te shpergular me force nje pjese te mire te popullsise shqiptare te Kosoves.

Askush nuk mundi te parashikonte shpejtesine dhe shkallen e shpernguljes.

Sipas Komisionierit te Larte te Kombeve te Bashkuara per Refugjatet (UNHCR), gjate 3 javeve te para te bombardimeve te NATO-s, 525,787 refugjate nga Kosova vershuan ne vendet fqinje.

Thuhet se forcat e qeverise Serbo-jugosllave shperngulen 862,979 shqiptare etnike nga Kosova dhe disa qindra mijera te tjere u zhvendosen brenda per brenda Kosoves, perveç atyre qe ishin zhvendosur para marsit 1999.

Me shume se 80 perqind e gjithe popullsise se Kosoves – 90 perqind e se ciles perbehej nga shqiptare- u zhvendosen nga shtepite e tyre.

Zonat e njohura per lidhjet e tyre me UÇK-ne u goditen me rende. Komunat e Drenasit dhe

Skenderajt ne Regjionin e Drenices, djepi i UÇK-se, ishin skena te masakrave te shumta ndaj civileve, si dhe te ndalimeve arbitrare, torturave, shkaterrimeve sistematike te shtepive dhe pasurise se civileve.

Vrasjet masive, shpernguljet me force, dhe shkaterrimi i pasurise civile ishin te zakonshme gjithashtu ne komunat jugperendimore te Gjakoves , Rahovecit dhe Therandës, ku shume fshatra e kishin mbeshtetur prej kohesh UÇK-ne.

65 perqind e shkeljeve te dokumentuara nga Human Rights Watch kane ndodhur ne pese komunat e lartpermendura.

Shpjegimet mbi abuzimet ne komunat e tjera jane me komplekse dhe me pak bindese. Komunat e Pejes dhe Lipjanit , te cilat kishin nje numer te konsiderueshem popullsie serbe, ishin piketuar per shperngulje masive te shqiptareve etnike, ndersa vrasjet ishin me te lokalizuara ne fshatra te tille si ne Sllovi, Ribar , Lubeniq , Qyshk dhe ne qytetin e Pejes.

Megjithese gjate 1998 dhe fillimit te 1999 UÇK-ja ishte aktive ne komunen e Pejes dhe prezente ne pjesen me te madhe te komunes perendimore se Lipjanit, ka pak apo aspak fakte per te bere lidhjen e UÇK-se me disa nga fshatrat ku ndodhen masakrat.

Vrasjet ishin pasoje e nje plani me te gjere operacionesh per te terrorizuar popullsine qe te largohej nga Kosova, duke perdorur ushtrine, policine dhe forcat paramilitare.

Gjate 1998 dhe fillimit te 1999 prezenca dhe dhuna e ushtruar nga UÇK-ja ishte e vogel, per shembull, ne

komunen veriperendimore te Burimit me popullsi etnike te perzier.

Megjithate, kjo komune pesoi shperngulje masive te shqiptareve vendas drejt Malit te Zi te nxitur nga djegia dhe grabitja e shtepive te tyre.

Burimi ishte gjithashtu dhe skena e nje nga incidenteve me te pergjakshme te luftes, ku forcat serbe vrane ne maj 1999 me shume se 90 shqiptare etnike te burgosur ne burgun e Dubraves, nderkohe qe sulmet ajrore te NATO-s kishin vrare per dy dite rreth 19 te burgosur.

Shperngulja me force ishte e organizuar mire, gje qe tregon se ajo ishte planfikuar paraprakisht.

Fshatrat ne zonat strategjike u “spastruan” per te siguruar linjat e komunikimit dhe kontrollin e zonave me te gjera.

Zonat ku UÇK-ja kishte mbeshtetje dhe ato ku ajo nuk ishte prezente, u sulmuan ne aksione te perbashketa nga policia, ushtria dhe paraushtaraket.

Qytete te medha u “spastruan” duke perdorur autobuze, trena dhe karvane te gjata traktoresh qe drejtoheshin drejt kufijve :Shqipëri,Mali i Zi dhe Maqedoni.

Refugjatet u shtrenguan te largohen ose u transportuan ne menyre te organizuar nga shteti I Serbisë ne drejtim te kufijve, sipas nje programi te pergatitur per shperngulje me force dhe deportimi te karakterizuar nga nje shkalle shume e larte koordinimi dhe kontrolli.

Human Rights Watch dokumentoi gjithashtu praktiken e njohur te “spastrimit te identitetit”:

refugjateve shpesh iu mirreshin dokumentet e identitetit dhe detyroheshin të hiqnin targat nga makinat dhe traktoret e tyre para se të lejoheshin që të kalonin kufirin.

Para se të arrinin kufirin, shume shqiptareve iu shkaterruan dokumentet personale, gjë që tregon se qeveria po perpiqej të bente të pamundur kthimin e tyre.

Shperngulja masive e shqiptareve të Kosovës mund t'i kete sherbyer nje sere qellimesh.

- ajo mund të kete patur si qellim të ndryshonte perberjen demografike të Kosovës – nje politike e permendur shpeshhere gjate gjithë historisë nga politikanet nacionaliste ekstreme serbe.

Keto ndryshime demografike mund të kishin çuar në ndarjen eventuale të Kosovës në dy pjese, nje për serbet dhe nje për shqiptaret.

- shpernguljet mund të kene patur si qellim të destabilizonin vendet fqinje: Shqipëri dhe Maqedoninë.

Se fundi, synimi i shpernguljes masive të shqiptareve mund të kete qene t'i mbante forcat e NATO-s në vendet fqinje në menyre që të pengohet nje sulm nga toka ose, se paku, të dobeshet vendosmeria e aleances së NATO-s.

Në rast se qellimi ishte dobeshimi i vendosmerisë së komunitetit nderkombetar, kjo natyrisht që deshtoi, pasi imazhet e refugjateve të pervuajtur vetem sa provokuan zemerimin publik dhe shtuan thirrjet për veprim.

Vrasjet e qellimshme dhe te paligjshme te civileve – ekzekutimet pa gjyq – ishin nje pjese e rendesishme e fushates “se spastrimeve”. Ne te gjithe Kosovën , civile te cilet dihej mire qe nuk ishin luftetare dhe nder te cilet kishte shume gra dhe femije, u vrane nga policia serbe, ushtaret e ushtrise jugosllave, dhe forcat paraushtarake te implikuara ne vrasjet e stilit “ekzekutim ne vend”.

Ne tërësi vrasjet kishin tre motive te qarta.

E para ishte pershpejtimi i procesit “te spastrimit” nepermjet kercenimit dhe ngjalljes se frikes.

E dyta ishte eleminimi i individeve qe dyshoheshin se luftonin ne rradhet e UÇK-ne apo e ndihmonin ate, dy gjera qe shpeshhere ishte veshtire te dalloheshin nga njera-tjetra. Nder individet e vene ne shenjester kishte udheheqes te shquar politike, aktiviste te te drejtave te njeriut dhe biznesmene te pasur.

E treta ishte kryerja e vrasjeve per hakmarrje: disa masakra u kryen pasi forcat serbe dhe jugosllave pesuan humbje nga ana e UÇK-se.

Megjithese kane filluar te dalin shifra te besueshme, numri i sakte i viktimave te luftes ne Kosove mbetet i panjohur dhe eshte shnderruar ne nje çeshtje debati mjaft te madhe.

Human Rights Watch, permes hulumtimeve te saj, ka dokumentuar 3453 vrasje te kryera nga forcat qeveritare serbe dhe jugosllave, por gjithsesi ky numer eshte me i vogel sesa numri perfundimtar, pasi ai bazohet vetem ne 577 intervista (intervistat e bera gene te menduara mire qe te lejonin vleresimin e te dhenave per te gjithe Kosoven). Ne te njejten kohe,

numri i viktimave sigurisht nuk është aq i madh saç sugjeruan gjatë luftës disa zyrtarë të qeverive perendimore apo të NATO-s, sipas të cileve shifra arrinte deri në 100,000. Deri në korrik 2001, Gjykata Nderkombetare Penale për ish-Jugosllavine (International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia (ICTY)) kishte zhvarrosur përafërsisht 4,300 njerëz që besohen të kene qene viktime të vrasjeve të paligjshme të kryera nga forcat serbe dhe jugosllave në Kosovë. Ky numër është sigurisht më i vogël se sa numri i përgjithshëm i të vrarëve nga trupat qeveritare. Me e rëndësishmja është se ka fakte të pakundershtueshme lidhur me venien dore në varre dhe zhvendosjen e trupave të vdekur nga trupat serbe dhe jugosllave, siç filloi të konfirmonte në verën e vitit 2001 qeveria serbe e ardhur në pushtet pas Milosevicit. Human Rights Watch dokumentoi përpjekjet për të fshehur apo eliminuar trupa në Terrnje), Gjakovë, Izbice , Rezallë, Krushe e Madhe dhe Krushe e Vogel ,Therandë, Sllovi, Poklek, Kotle , dhe Pastasel .

Veç kësaj, sipas International Committee of the Red Cross (ICRC)) 3,525 persona, duke përfshirë dhe serbë etnike, figurojnë të zhdukur nga ky konflikt.

Analiza statistikore e bërë nga Human Rights Watch dhe Shoqata Amerikane për Perparimin e Shkencës (American Association for the Advancement of Science (AAAS)) zbulon një metodikë vrasjesh që nxjerr më tej në pah natyrën sistematike të fushatës qeveritare.

Kur studiohet shperndarja kohore e ekzekutimeve pa gjyq, per shembull, shfaqen tre vale qe dallohen qarte ne mbi Analizen Statistike te Shkeljeve.

Kjo nuk eshte nje pasqyrim perfekt i vrasjeve, meqenese Human Rights Watch nuk i zgjodhi rastesisht te intervistuarit.

Sidoqofte, natyra ekstreme e valeve me tre amplituda e qarta gjate nje periudhe te shkurter, tregon bindshem se vrasjet nuk ishin rezultat i rastesishem i dhunes se forcave qeveritare serbosllave.

Perkundrazi, ato ishin planifikuar me kujdes dhe vinin ne jete operacione qe i sherbenin qellimit strategjik te qeverise Serbe të kryeqetnikut Slllobodan Millosheviq, Sheshel, Arkan etj.

Ne te njejten menyre, egzekutimet pa gjyq te kryera gjate kesaj kohe ne komuna të Kosovës shenojne ngritje te ngjashme te dhunes ne periudha te shkurtra.

Fushatat hysterike te vrasjeve ndodhen neper komuna ne periudha te qarta kohore, duke sugjeruar keshtu ekzistencen e nje urdheri strategjik per kryerjen e ketyre vrasjeve ne zona te caktuara.

Perdhunimet dhe dhuna seksuale ishin gjithashtu komponente te kesaj fushate.

Perdhunimet ndaj shqiptareve nuk ishin akte te rralla e te izoluara kryer nga individe te forcave serbe dhe jugosllave, por instrumente per te terrorizuar popullsine civile, per te zhvatur para nga familjet e ketyre vajzave dhe per t'i shtrenguar njerezit te braktisin vatrat e tyre.

Human Rights Watch ka gjetur te dhena te besueshme per nentedhete e gjashte raste te dhunes seksuale gjate periudhes se bombardimeve te NATO-s, dhe numri real sigurisht eshte shume me i madh.

Ne pergjithesi perdhunimet e kryera ne Kosove mund te grupohen ne tre kategori: perdhunime te kryera ne shtepite e vete grave, perdhunime te kryera gjate largimit dhe perdhunime te kryera gjate ndalimeve.

Ne kategorine e pare, forcat e sigurimit hynin ne shtepite private dhe perdhunonin grate para antareve te familjes, ne oborr apo ne dhomen ngjitur.

Ne kategorine e dyte, njerez te debuar qe endeshin ne kembe apo me traktore ndaloheshin, grabiteshin dhe kercenoheshin nga Ushtria Jugosllave, policia serbe apo paramilitaret.

Ne qofte se familjet nuk mund te jipnin para, atehere forcat e sigurimit iu thonin qe vajzat e tyre do te merreshin dhe perdhunoheshin.

Ne disa raste, edhe pse familjet kishin dhene para, atyre iu ishin rrembyer vajzat.

Ne kategorine e trete, dhunimet u kryen ne qendrat e perkohshme te ndalimeve ne vende te tilla si ne shtepi apo hambare te braktisura.

Shkaterrimi i pasurise se popullsise nga trupat qeveritare me 1999 shenoi rritje te madhe.

Sipas nje studimi te UNHCR-se, ne nentor te vitit 1999, pothuaj 40 perqind e te gjithe shtepive te banimit ne Kosove ishin demtuar rende ose shkaterruar plotesisht.

Me shume u demtuan komunat qe kishin lidhje te forta me UÇK-ne, pjeserisht sepse sulmet kunder tyre kishin filluar qe ne 1998.

U demtuan gjithashtu edhe zona te tjera qe nuk kishin lidhje me aktivitetet e UÇK-se, si per shembull qyteti i Pejes, ku u shkaterruan me shume se 80 perqind e shtepive te qytetit.

Po ashtu u demtuan shkollat dhe xhamite.

Sipas nje vleresimi te OKB-së per demtimet ne 649 shkollat e Kosoves, me shume se nje e pesta e shkollave te perfshira ne kete vezhgim ishin te demtuara rende dhe me shume se 60 perqind ishin te shkaterruara plotesisht.

Ne te gjithë Kosoven, forcat serbe dhe jugosllave qellimisht nxorren ujin e puseve jashte perdorimit duke hedhur ne to kimikate, kafshe te ngordhura, apo kufoma njerezish.

Human Rights Watch ka dokumentuar ne kater fshatra raste ku jane hedhur viktimat ne depot e ujit.

Nje numer i pafund deshmitaresh dhe viktimash deshmuar per Human Rights Watch se si forcat qeveritare iu grabiten atyre gjerat e çmuara, duke perfshire dhe unazat e martesës e makinat, si ne shtepite e tyre, ashtu dhe rruges gjate debimit te tyre.

Police, ushtare dhe vecanerisht anetare te njesive paramilitare i kercenonin njerezit me jeten e tyre ne rast se ata nuk jepnin nje sasi te mire parash, zakonisht marka gjermane.

Grabitje te tilla jane permendur vazhdimisht dhe nga forcat e sigurimit, te cilet u shprehen per median nderkombetare pas luftes.

Per disa prej tyre, kjo ishte arsyeja qe ata shkuan ne Kosove.

Disa vullnetare treguan se ata ishin liruar nga burgjet ne Serbi me kusht qe ata te sherbenin ne ushtri apo polici.

Ky raport dokumenton gjithashtu praktiken, sipas se ciles te ndaluarit detyroheshin te hapnin transhe apo te pastronin bunkere, si dhe praktiken e perdorimit te civileve si mburoja njerezore per te mbrojtur trupat nga sulmet e NATO-s apo UÇK-se.

Qeveria jugosllave gjithashtu vuri ne toke mina antitanke dhe antinjerez, veçanerisht pergjate kufirit me Shqiperine dhe Maqedonine, ka shume te ngjare, si pregatitje per nje sulm nga toka.

Zinxhiri i Komandimit Forcat qeveritare te perfshira ne konflikt ishin nje kombinim kompleks i policeve dhe forcave policore speciale te Ministrise se Puneve te Brendshme serbe, ushtareve dhe njesive ushtarake speciale te Ushtrise Jugosllave, forcave paraushtarake, milicise lokale, dhe i nje morie forcash qe vinin nga vendet e tjera. (Rusi ,Ukrajinë, Hungari etj).

Te gjithë keta vepronin nen urdherat e qeverise ne Beograd.

Ushtria Jugosllave kishte komanden e pergjitheshme gjate periudhes se bombardimeve te NATO-s. Sipas ligjit, ajo kishte nen varesine e saj policine dhe forcat paraushtarake, megjithese zyrtaret e larte ne Ministrine e Puneve te Brendshme serbe ushtruan dukshem nje influence te rendesishem gjate fushates. Ushtria kontrollonte rruget kryesore dhe kufijte duke koordinuar dhe lehtesuar keshtu “spastrimin etnik”.

Policia dhe forcat paraushtarake u perfshine ne menyre me te drejtperdrejte ne debimin e civileve dhe shkaterrimin e fshatrave, per te cilen kishin mbeshtetjen e artilerise se ushtrise.

Gjate ketyre operacioneve burrat veçoheshin nga grate dhe femijet per t'u marre ne pyetje per UÇK-ne dhe egzekutoheshin ne vend.

Sipas ligjit jugosllav, Ushtria Jugosllave (Vojska Jugosllavije, apo VJ) eshte nen komanden e presidentit te Jugosllavise ne kohe lufte dhe ne paqe.

Deri me tetor te vitit 2000, president ishte kryekrimineli serb Slobodan Milosevic.

Ushtria Jugosllave eshte nen kontrollin e Keshillit te Larte te Mbrojtjes, i perbere nga presidentet e Serbise, Malit te Zi dhe Jugosllavise dhe kryesuar nga presidenti i Jugosllavise.

Shefi i Shtabit te Pergjithshem te Ushtrise gjate luftes ishte Gjeneral. Dragoljub Ojdanic, i cili u emerua pas luftes si Minister i Mbrojtjes se Jugosllavise, post te cilin e mbajti deri ne tetor 2000.

Ushtria Jugosllave ndahet ne tre armata.

Armata e Trete, e komanduar gjate luftes nga Gjeneral kolonel . Nebojsa Pavkovic, ishte pergjegjese per Kosoven dhe Serbine e jugut.

Ne gusht te 2001, Pavkovic ishte Shefi i Shtabit te Pergjithshem te Ushtrise Jugosllave.

Gjate luftes nen Pavkovicin vinte Gjeneral major . Vladimir Lazarevic, i cili komandonte Korpusin e Prishtines te Armates se Trete te vendosur ne Kosove. Nen komanden e Lazarevic ishin pese brigada, nje njesi policore ushtarake dhe nje regjiment aviacioni.

Emrat e komandanteve të këtyre njësive : “Forcat e Konfliktit”. Struktura e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë , drejtuar gjatë luftës nga Ministri Vlatko Stojiljkovic, është me e komplikuar sesa struktura e Ushtrisë Jugosllave, e cila ka një zinxhir transparent komandimi.

Brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë bënin pjesë policia e rregullt e Kosovës, e komanduar nga Streten Lukic, forcat policore speciale (Posebne Jedinice Policije, apo PJP) të komanduara nga Gjeneral Lt. Obrad Stevanovic, dhe Forcat Antiterroriste (Specijalna Antiteroristicka Jedinica, apo SAJ), të komanduara nga Kolonel. Zivko Trajkovic. Gjeneral Kolonel Vlastimir Djordjevic ishte kreu i sektorit të sigurimit publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si dhe asistent i ministrit të punëve të brendshme. Qeveria e re e Serbisë zëvendësoi Djordjevic dhe Stevanovic në janar të vitit 2001, por ngriti në detyrë Lukic si shef të sigurimit publik dhe zëvendësministër të Punëve të Brendshme.

Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë përmban gjithashtu dhe shërbimin e sigurimit, apo siç quhet ndryshe, policinë sekrete, e cila luajti një rol të madh në Kosovë.

Përveç aktiviteteve të fshehta për monitorimin dhe sulmimin e aktivisteve politike shqiptare etnike dhe të UÇK-se, siguri i shtetit dislokoi gjithashtu njësi operative speciale, JSO-ne (Jedinica za Specijalne Operacije), dhe ndihmoi organizata të ndryshme paraushtarake.

Te njohur gjithashtu si “Beretat e Kuqe” apo “Djemte e Frenkit” (sipas Frenki Simatovic, nje personalitet kyç ne Ministrine e Puneve te Brendshme, i cili njihet si themeluesi i grupit), JSO-ja komandohej gjate luftes nga Miload Lukovic, nje njeri i njohur si “Legjia”.

Deri ne janar te vitit 2001, ne krye te sigurimit te shtetit te Serbise ishte Gjeneral Kolonel . Radomir Markovic.

Markovic u hoq nga detyra ne fund te janarit dhe u arrestua nje muaj me vone nga policia serbe, pasi akuzohej per perfshirje ne sulmin e vitit 1999 kunder politikanit serb Vuk Draskovic.

Kreu i sigurimit te shtetit ne Kosove gjate luftes ishte psikologu klinik i MUP-it serb David Gajic.

Se fundi, forca te ndryshme paraushtarake si dhe forca te huaja ishin aktive ne Kosove, kryesisht nen kontrollin e qeverise qendrore.

Pervec faktit qe ata ishin nder forcat me te dhunshme ne Kosove, nje nga aktivitetet primare te paraushtarakeve ishte vjedhja dhe grabitja. Megjithese linja e sakte e komandimit dhe kontrollit te forcave paraushtarake mbetet jo e qarte, ajo çfare dihet eshte se ata kane bashkevepruar ngushte me Ushtrine Jugosllave dhe policine serbe. Paraushtarket, te cilet jane shprehur per shtypin nderkombetar pas luftes, kane thene se zyrtare lokale iu jepnin lista me emrat e shqiptareve etnike te vene ne liste per t’u vrare.

Disa prej paraushtarakeve ishin liruar nga burgjet e Serbise, me kusht qe te luftonin ne Kosove.

Ne disa raste individe te policise apo ushtrise u perpoqen te paralajmeronin apo te mbronin shqiptaret

etnike nga forcat paraushtarake, megjithese keto ishin raste te rralla. Si rregull, milicet dhe policia bashkepunonin ngushte me njesite paraushtarake, shpesh duke krijuar nje kordon per levizjen e forcave paraushtarke rreth komuniteteve te vena ne shenjester. Grupet dhe njesite e ndryshme brenda Ministrise se Puneve te Brendshme e bejne zinxhirin e komandimit me pak te dukshem sesa ne Ushtrine Jugosllave, megjithese eshte e qarte se autoriteti final per Ministrine e Puneve te Mbrendshme i perkiste presidentit jugosllav Slobodan Milosevic.

Sipas ligjit jugosllav, ne gjendje lufte, Ushtria Jugosllave ka nen juridiksionin e saj policine e Serbise, duke e bere keshtu Slobodan Milosevic de jure dhe de facto komandant te policise gjate periudhes se bombardimeve te NATO-s.

Zevendes kryeministri i atehershem i Jugosllavise Nikola Shainovic ka luajtur gjithashtu nje rol te rendesishem.

E drejta nderkombetare eshte e qarte lidhur me pergjegjesite e udheheqesve qe organizojne apo lejojne kryerjen e krimeve te luftes.

Si autoret e krimeve, ashtu edhe udheheqesi ushtarak apo politik qe urdheron krimet ose qe nuk merr masa per parandalimin e tyre ose denimin e fajtoresve, jane njelloj pergjegjes.

Siç provohet ne kete shkrim , shtrirja dhe natyra sistematike e abuzimeve ne Kosove e ben te pamundur te besosh qe udheheqja serbe dhe jugosllave, megjithe mohimet e tyre publike, nuk ishte ne dijeni te atyre shkeljeve.

Rastet e denimeve te anetareve te forcave te sigurimit per kryerjen e krimeve te renda, si per vrasje, jane te pakta.

Perkundrazi, periudha e pasluftes shenoi qindra ngritje ne detyre dhe shperblime per personelin e policise dhe ushtrise, duke perfshire dhe disa prej udheheqesve te larte te tille si Dragoljub Ojdanic, Nebojsa Pavkovic, Vladimir Lazarevic, Obrad Stevanovic, Sreten Lukic, Vlastimir Djordjevic, and Zivko Trajkovic, si dhe shume komandante brigade ne Korpusin e Prishtines.

Nje liste e plote e ketyre promovimeve dhe shperblimeve eshte perfshire shpeshë në shkrimet e mija të botuara në librat e mijë dhe në mdiumet ndërkombëtare.

Gjykata e Krimeve te Luftes Pas nje fillimi te ngadalte ne 1998, Gjykata Nderkombetare Penale per ishJugosllavine filloi nje hetim te plote te krimeve te luftes ne Kosove.

Me 27 maj 1999 gjykata beri te ditur padine me te rendesishme deri tani: Slobodan Milosevic, president i Jugosllavise dhe kater zyrtare te tjere te larte akuzoheshin per “vrasje, persekutime dhe debime ne Kosove” per periudhen 1 janar 1999 deri ne fund te majit te po ketij viti.

Te paditurit e tjere jane: Milan Milutinovic, president i Serbise dhe anetar i Keshillit te Larte te Mbrojtjes, Dragoljub Ojdanic, Shef i Shtabit te Pergjithshem i Ushtrise Jugosllave, Nikola Sainovic, zevendes kryeminister i Republikes Federale te

Jugosllavise (FRY), dhe Vlajko Stojiljkovic, ministri serb i Puneve te Brendshme.

Hetimet e Gjykes Nderkombetare Penale per ish-Jugosllavine vazhdojne, duke perfshire dhe nje inspektim te krimeve te UÇK-se.

Me 1 prill 2001 policia serbe e arrestoi Miloseviçin me akuzen e korrupsionit.

Me 28 qershor 2001, ai u transferua ne Gjykatën e Krimeve te Luftes ne Hage.

Deri ne gusht te vitit 2001 te pandehurit e tjere vazhdojne te jene te lire. Gjykata beri gjithashtu nje vleresim te brendshem te aksioneve te NATO-s gjate luftes duke arritur ne konkluzionin qe nuk kishte baze per hetime te metejshme. Vleresimi i Human Rights Watch mbi fushaten ajrore te NATO-s ndryshon ne nje fare mase.

Megjithese Human Rights Watch nuk ka gjetur fakte se NATO ka kryer krime lufte, NATO ka shkelur te drejten nderkombetare humanitare duke mos marre masa paraprake te mjaftueshme per te identifikuar prezencen e civileve, ndersa sulmonte karvanet apo objektivat levizese. Ne shkurt te vitit 2000 "Vdekjet e Civileve Gjate Fushates Ajrore te NATO-s", bombardimet e NATO-s shkaktuan vdekjen e pothuaj 500 civileve ne te gjithe Jugosllavine.

Rreth 56 apo 60 perqind e te gjitha vdekjeve i perkisnin Kosoves. Perdorimi i bombave therrmuese (cluster) nga NATO, megjithese u pezullua gjate konfliktit, eshte kritikuar ne kete raport.

Si arme te pakontrollueshme ne vetvete kur perdoren ne zona civile dhe per shkak te shkalles se larte te

mosfunksionimit ne momentin e perdorimit, bombat therrmuese paraqesin nje rrezik serioz dhe joproportional per popullsine civile.

Ne periudhen 24 mars – 7 maj 1999, ne Kosove dhe ne pjesen tjeter te Jugosllavise u hodhen me shume se 1,500 bomba therrmuese. Abuzimet nga UÇK-ja Sic eshte paraqitur ne kapitullin “Histori”, UÇK-ja ishte pergjegjese per abuzime serioze te kryera ne vitin 1998 duke perfshire rrembimet dhe vrasjet e serbeve dhe shqiptareve etnike te konsideruar si bashkepunetore te shtetit.

Ne disa fshatra qe ne vitin 1998 ishin nen kontrollin e UÇK-se, rebelet debuan serbet nga shtepite e tyre. Disa prej atyre qe mbeten nuk jane gjetur ende dhe mendohen te jene rrembyer dhe vrare nga UÇK-ja.

Sipas Komitetit Nderkombetar te Kryqit te Kuq, nentedhjete e shate serbe te Kosoves qe rezultonin te zhdukur ne vitin 1998 vazhdonin te mungonin deri me 15 maj 2000. UÇK-ja burgosi rreth tetedhjete e pese serbe gjate sulmit te saj ne Rahovec me 19 korrik 1998.

35 prej tyre u liruan me vone, por te tjeret deri ne gusht 2001 vazhdojne te rezultojne te zhdukur.

Me 22 korrik 1998 UÇK-ja mori kontrollin e minieres se Belaceves prane Obiliqit. Ate dite u kapen nente serbe qe vazhdojne te rezultojne ne listat e te zhdukurve te Komitetit Nderkombetar te Kryqit te Kuq.

Ne shtator te vitit 1998, policia serbe nxori nga Liqeni i Radonjices (Radonjic) prane Gllogjanit (Glodjane)

tridhjetë e katër kufoma që mendohet të jenë kapur dhe vrare nga UÇK-ja.

Midis tyre kishte dhe shqiptarë etnike. Akuzat me të renda në drejtim të UÇK-ja para kësaj ngjarjeje kanë të bëjnë me vrasjen e njezet e dy civilëve serbë në gusht në fshatin Klecka, ku policia deklaroi se kishte zbuluar pjesë trupash njerezish dhe një furrë që ishte përdorur për të djegur trupat. Gjithsesi, mënyra se si u bënë këto akuza vëne në dyshim vlefshmerinë e tyre. UÇK-ja, e cila prej 1996 në 1999 evoluoi nga një grup gueril i paorganizuar në levizje të armatosur dhe së fundmi në një forcë të armatosur me të fuqishme, përdori taktikë ushtarake në 1998 dhe 1999 që rrezikuan jetën e civilëve. Ngadonjëherë njësi të UÇK-së organizonin prita, sulmonin forcat e policisë apo postat e ushtrisë të vendosura pranë fshatrave dhe terhiqeshin duke i lënë fshataret të ekspozuar ndaj sulmeve hakmarrese.

Keto sulme ngadonjëherë u shndërruan në masakra të mëdha, gjë që ndihmoi që çështja e UÇK-së të bëhej e njohur dhe që konflikti të nderkombtarizohej.

Disa elemente të UÇK-së janë përgjegjës për sulmet që ndodhën pas perfundimit të konfliktit ndaj serbëve, romeve, popullsive tjetër joshqiptarë, si dhe ndaj rivaleve politike shqiptarë.

Mënjëherë pas mbërritjes së NATO-s në Kosovë, pati djegie dhe grabitje sistematike të shtëpive të serbëve, romeve dhe minoriteteve të tjera, si dhe shkatërrime të kishave dhe manastireve ortodokse.

Ky shkatërrim u kombinua gjithashtu me bastisje dhe kercenime për t'i debuar këta njëzëz nga shtëpitë e tyre apo nga komuniteti.

Deri në fund të vitit 2000 me shumë se 210,000 serbë ishin larguar nga Kosova nga frija .

Pjesa më e madhe e tyre u larguan gjatë gjashtë javëve të para pas hyrjes së NATO-s.

Pjesa që mbeti u përqendrua kryesisht në enklava monoetnike, si në pjesën veriore të Mitrovicës, Fushe Kosovës dhe Graçanicës.

Rreth 1000 serbë dhe romë janë vrarë apo rezultojnë të zhdukur që nga 12 qershori 1999.

Banda kriminale apo individë hakmarrës mund të jenë përfshirë në disa prej këtyre incidentëve që nga fillimi i luftës.

Por, megjithatë, përgjegjës për shumë prej këtyre krimeve janë disa elemente të UÇK-së.

Një shpjegim i pjesshëm është dëshira për hakmarrje, por pas këtyre sulmeve vihet re një qëllim politik i qartë: largimi i popullsisë joshqiptare nga Kosova për të justifikuar një shtet të pavarur.

Shqiptarët etnike nuk përjashtohen nga dhuna. Shqiptarët e akuzuar për “bashkëpunim” me autoritetet serbë janë rrahur, rrembyer apo vrarë, veçanërisht në komunat e Prizrenit, Gjakovës dhe Klina.

Pas zgjedhjeve lokale të 28 tetorit 2000 ka patur sulme kundër aktivistëve të partive politike, veçanërisht kundër LDK-së.

Roli i Bashkësisë Nderkombëtarë Reagimi i ngadalte i komunitetit ndërkombëtar duhet fajësuar pjesërisht për dhunën e pasluftës.

OKB dhe NATO nuk arritën që të ndemerrnin që në fillim veprime decisive për të parandaluar zhvendosjet me forcë dhe vrasjet e popullsisë joshqiptare të Kosovës, çka shënoi një precedent për periudhën e pasluftës.

Nga mesi i vitit 1999 nuk kishte veçse një grup të vogël policësh të OKB-së, situatë që detyroi trupat e KFOR të NATO-s të kryenin funksionet e policisë civile, për të cilat ata nuk ishin të përgatitur. NATO ishte me shumë e preokupuar për mbrojtjen e trupave të saj, sesa për mbrojtjen e civileve.

Edhe pas dy vjetësh të përfundimit të luftës nuk është vendosur akoma një sistem gjyqësor efektiv, gjë që ka kontribuar në krijimin e një atmosfere mosndëshkimi.

Refreni i njohur i Kombeve të Bashkuara është që dobesitë e rendit publik janë rezultat i mungesës së burimeve. Është e vërtetë që nuk ka fonde të mjaftueshme për të paguar policinë, gjykatësit dhe prokurorët, por e meta thelbësore është mungesa e vullnetit politik. Zyrtarë të lartë të NATO-s dhe Kombeve të Bashkuara e dinë që persona të lidhur me UÇK-në, duke përfshirë dhe disa figura kyçe të politikës së Kosovës, janë të implikuar në dhunën kundër minoriteteve dhe në aktivitete kriminale, por ata kanë preferuar të mos konfrontohen. Në fakt këto nuk janë gabimet e para të komunitetit ndërkombëtar lidhur me Kosovën.

Perendimi nuk e mbeshteti sa duhet levizjen paqesore te shqiptareve te Kosoves nga 1990 deri me 1998 dhe gjate luftes se Bosnjes dhe Kroacise ishte me shume i preokupuar ta mbante Kosoven larg vemendjes se medias.

Perendimi qendroi duarkryq nderkohe qe UÇK-ja u forcua, shteti jugosllav reagoi dhunshem dhe provinca u perfshi ne nje konflikt te armatosur.

Gjate gjithë Luftës komuniteti nderkombetar nuk mbajti nje qendrim te unifikuar per zgjidhjen e krizes. Slobodan Miloseviçi e perdori kete mungese harmonie ne favorin e tij, duke bere marreveshje sa me nje shtet me nje shtet tjetër, duke fituar keshtu kohe per te avancuar fushaten e tij. Anetare te komunitetit nderkombetar perfituan gjithashtu nga kjo mungese uniteti, duke fajesuar njeri tjetrin per mosveprim.

Ne rastet kur komuniteti nderkombetar denoi me force dhunen, atehere fjalet dhe veprimet simbolike nuk kishin me kuptim kundrejt shtyrjes se afateve, mosrespektimit te kushteve, zbatimit jokorrekt te sanksioneve qe shkonin deri ne heqjen e tyre.

Raporti arrin ne konkluzionin se interesi ne ruajtjen e zgjidhjes se politike ne Bosnje dhe alergjia ndaj ndryshimit te kufijve nderkombetare nuk e lejuan komunitetin nderkombetar te kuptoje domosdoshmerise se parandalimit te abuzimeve para se ato te shkallezoheshin ne lufte te hapur. Nese komuniteti nderkombetar deshironte te mbeshteste integritetin territorial ne Ballkan, ai duhej te kishte nxitur ate lloj uniteti kombetar qe vjen nga respektimi i te drejtave te te gjithë shtetasve, respektim qe vertete

ka munguar ne Kosove dhe ne pjese te tjera te Ballkanit. Lejimi i shkeljeve serioze pa i denuar ato ka sjelle pikerisht ate qe komuniteti nderkombetar ka kerkuar te shmange – mungesen e stabilitetit rajonal.

Se fundi, faji kryesor per tragjedine e Kosoves duhet te bjere mbi ish-presidentin e Jugosllavise Slobodan Miloseviç dhe mbi udheheqjen e atehershme te Serbise dhe Jugosllavise, te cilet jo vetem qe nuk kerkuan kompromise paqesore me shqiptaret e Kosoves, por planifikuan dhe kryen nje fushate te dhunshme si kunder kryengritesve, ashtu dhe kunder civileve.

Te gjitha faktet tregojne perfshirjen e tyre direkte ne krime lufte te formes me te rende.

Fitorja e Opozites Demokratike te Serbise ne zgjedhjet e vjeshtes se vitit 2000 hapi rrugen per ndryshime ne shoqerine serbe dhe jugosllave dhe per nje zgjidhje paqesore te konflikteve te gjata ne rajon.

Por stabiliteti i qendrueshem ne Kosove, Serbi dhe ne rajon nuk do te arrihet pa nxjerre pergjegjesite per krimet e kryera nga ana e shtetit jugosllavë si dhe pasardhësëve të Millosheviqit...gjegjisht presidentit të rinjë serb që po etrason politikën e Millosheviqit, Sheshelit etj.e ky është i perkdheluri i Evropës demokratike dhe Rusisë së Vladimir Putinit , presidenti serb Aleksandër Vuçiçi.

VENDAS DHE ARDHACAKË

Vendbanimet e tyre që kanë pasur në Serbi deri më tani saktësisht nuk dihen por supozohet se vijnë nga pjesë të ndryshme të Ballkanit.

Disa nga serbët e Kosovës kane jetuar për shume breza në Kosovë.

“Nga dokumentet e Vatikanit shihet qartë veprimi i klerit ortodoksë serb në sllavizmin e shqiptarëve dhe në uzurpimin e kishave katolike, sidomos në Prizren, në Mitrovicë, Novobërd, në Mal të Zi etj., për çka edhe papa ka intervenuar pranë autoriteteve serbe”..

Terrori i Kishës ortodokse serbe ndaj shqiptarëve katolikë dhe ortodoksë, për t'i asimiluar, ka qenë në vazhdimësi i madh.

Taksat e rënda kishtare e shtetërore, dhe detyrimet e tjera materiale e shpirtërore, siç ka qenë imponimi i klerit serb që edhe shqiptarët katolikë t'i pagëzojnë fëmijët e tyre në kishën ortodokse serbe me emra sllavë, kanë bërë që shumë shqiptarë kanë humbur përkatësinë fetare katolike dhe kombësinë e tyre shqiptare.

Mirëpor shumica e tyre janë anëtarë të familjeve, të cilat kanë marrur tokën e shqiptarve të dhuruar nga organet e qeverisë Serbe të bazuara në Doktrinën e shejt serbe në atë kohë (1927) e që në Kosovë thuhej se bëhen "Reforma agrare".

Si do që të jetë, numri i te ardhurve serbë nga territori i tashëm 2006 i Serbisë, ndër vite nuk mund të dihet saktësisht për shkak të pengesave politike në institucionet dhe entet e Serbisë, të cilat kanë mbledhur më parë (sikurse gjatë luftës së fundit) të gjithë regjistrat, që kanë të bëjnë me te ardhurit dhe me Kosovën.

Si do që të jetë, nga ato pak shënime studiuesit janë të mendimit se "Vendosja e kolonistëve serbë dhe malazezë në Kosovë filloi që nga viti 1912, por u zbatua në mënyrë intensive gjatë viteve 1919 – 1924 si dhe atyre 1934 – 1941. Në atë periudhë, në Kosovë, u vendosen më se 39 mijë serbë dhe malazez dhe u krijuan 374 koloni, pëkatësisht vendbanime të reja sllave"

Për sa i përket statistikave, punimi Reforma agrare dhe kolonizimi i Kosovës na jepë shënime të detaluara sa i përket veprimeve të institucioneve serbe.

Në Enciklopedinë e Përgjithshme të Entit Leksikografik të Jugosllavisë, Zagreb, 1977, fq. 81 thuhet:

”Shqiptarët, popull me prejardhje indoevropiane thrakase - ilire. Banorët më të vjetër në Shqipëri kanë qenë Ilirët; vetë emri Shqiptar rrjedhë nga emri Ilir- të fisit Albana”.

Në historinë e studimeve mbi Ballkanin gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX Jireceku radhitet ndër studiuesit e parë, veçanërisht për studimet e tij për bullgarët, serbët. Konsiderohet si autori i punimit të parë serioz historik me karakter shkencor mbi popujt ballkanik, “një kollos i madh i shkencës”, i cili dha një kontribut të madh mbi historinë e popujve të Ballkanit.

Historia e Serbëve – Originali: Geschichte der Serben Historia botërore

Autor: Kostandin Jirecek (Costantin Jierecek) Shqipëroi: Elda Gjana-Boriçi

Shtëpia botuese: 55 Viti: 2010 f. 330 Pesha: 0.42 Kg.

ISBN: 978-99943-56-73-7

“Pas studimeve të panumërta monografike të cilat janë botuar në “Arkivin për gjuhësinë sllave” dhe në raporte të mbledhjeve të “Akademisë së Vjenës”, Constandin Jirecek ishte njeriu i duhur, dhe madje mund të thuhet i vetmi, që të merrte përsiper “Historinë e serbëve”, të serisë “Historia e shteteve”, dhe të cekët një fushë punimi, e cila kërkon jo vetëm zotërimin e gjuhës, por në të njëjtën masë edhe njohjen e metodave të hulumtit të historisë dhe të shkencës gjuhësore, si dhe marrjen parasysh jo vetëm të artikujve pafundësisht të shpërndarë, por

edhe punën përgatitore bibliografike dhe grumbullimin e burimeve më të domosdoshme.

Kështu historia e serbëve, u bë historia e parë e vërtetë e përmbledhur në gjuhën gjermane...” – Herman Onken .

Në historinë e studimeve mbi Ballkanin gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX Constandin Jireceku radhitet ndër studiuesit e parë, veçanërisht për studimet e tij për bullgarët, serbët.

Konsiderohet si autori i punimit të parë serioz historik me karakter shkencor mbi popujt ballkanik, “një kollos i madh i shkencës”, i cili dha një kontribut të madh mbi historinë e popujve të Ballkanit.

Gjatë veprimtarisë së tij shkencore e cila përfshin gati dyzetë vjet, Constandin Jericek u kushtoi punime gati të gjithë popujve të Ballkanit, ku ndër të tjera u mor dhe me studimin e Kanunit të Dushanit, dhe të Statutit të Dobrovnikut.

Ka shkruar punime nga lëmi i historisë, i letërsisë, filologjisë, etnografisë.

Gjithsësi kontributin më të madh e ka në fushën e historisë dhe të historisë së gjeografisë.

Kush janë të parët në Ballkan – shqiptarët apo serbët?

Të përkujtojmë gjithmonë gjenocidin mbi popullin shqiptar në mënyrë që mos ta harrojmë të kaluarën, sepse pa të nuk ka edhe të ardhme.

Të mos harrojmë të kaluarën, ndërtojmë të ardhmen. Jepuni vlerë “rrënjëve” tuaja, kombit...

Është e rëndësishme që të dini se nga vini, të keni në mendje historinë e kombit tuaj, atë të vendit në të cilin

jeni rritu, gjithmonë kureshtare për historinë e vjetër për kombin tuaj....

George Fred Williams më 1914 ka shkruar: “Po të kthehemi në parahistori, para se rapsodët homerikë t’u këndonin hyjnive dhe heronjve mitologjikë, para se të shkruhej gjuha greke, jetonte një popull i njohur me emrin Pellazg. Shqiptarët janë të vetmit që kanë ardhur deri më sot nga kjo racë e fuqishme parahistorike. Vetëm vitet e fundit është përcaktuar se Pellazgët kanë qenë Ilirët e lashtë... Këta Ilirët kaluan edhe në Itali me emrin Toskë, siç quhen ende edhe në Shqipëri, ndërsa në Itali kanë mbetur si Toskë, toskane, etruskë... Shqipja ka qenë gjuha e vërtetë e Homerit, sepse grekët e kanë huazuar nga rapsodët Pellazge eposin e tyre të shquar... Shqipja ka qenë gjuha amtare e Aleksandërit të pushtimeve të mëdha dhe e Pirros së Epirit, një prej gjeneralëve më të mëdhenj të historisë... Është tragjedi tej çdo përfytyrimi, që kjo racë e madhe dhe shumë e lashtë të katandiset në këtë gjendje, e cila meriton të quhet skandali i qytetërimit Evropian. Nuk është për t’u çuditur që pushtuesi otoman ndalonte çfarëdolloj gjermimesh në tokën shqiptare, që mund t’i kujtonin popullit lavdinë e tij të dikurshme... Ç’pasuri e madhe dijesh e pret arkeologun kur toka shqiptare të hapë thesaret e historisë sPellazgëve!”

.Kjo është përgjigja që shokon serbët!

Serbët nganjëherë janë edhe për keqardhje! Një pjesë e mirë e tyre ende besojnë se janë populli më i vjetër në Ballkan. Madje kanë libra shkencorë të pseudo-historianëve të tyre që përpiqen të “argumentojnë” se

edhe “Adami dhe Eva flisnin serbisht”, se “serbët janë kombi më i vjetër në rruzullin tokësor”, dhe se “prej kombit serb lindën kombet dhe gjuhët tjera”.

Përpyekja e “kombi hyjnor” ka filluar të zbres shkallëve teposhte, të prekë realitetin.

Në librin e Historisë për klasën e VI-të shkruhet : “Sllavët e vjetër ishin pritur në Gadishullin Ballkanik nga Ilirët vendas, të cilët më pas u shpërndanë në disa fise, dhe njëri prej këtyre fiseve mbijetoi. Popujt e Evropës Perëndimore, në shekullin XX-të, këtë fis e njohën me emrin Shqiptar.”

Ky libër i autorit Radeta Mihalçiq, për nxënësit e klasave të gjashta të shkollave fillore në Republikën e Serbisë, vazhdon të mbetet temë për opinionin publik serb, pasi në të thuhet se shqiptarët janë vendas të këtij gadishulli, dhe se kanë ardhur në Ballkan shumë me përpara se sa Sllavët.

“Për të qenë më të qartë, jemi duke folur për Ilirët, fiset ilire, me shkallë të ndryshme civilizimi, që populluan Ballkanin Perëndimor dhe prej të cilëve rrjedhin edhe Shqiptarët, siç u njohën edhe nga popujt dhe vendet e Evropës Perëndimore”, shkruan e përditshmja serbe Telegraf.

Në leksionin “Sllavët e jugut dhe vendasit”, në mes të tjerash thuhet: “Megjithë këtë, vendësit që kanë jetuar së bashku në grupe më të mëdha nuk u sllavizuan. Shqiptarët ruajtën gjuhën, doket, zakonet dhe simbolet tjera të tyre kombëtare. Një pjesë e sllovenëve të ardhur pranoi gjuhën dhe zakonet e shqiptarëve dhe u asimilua”, transmeton e përditshmja serbe citatin nga ky libër.

Redaktori në Institutin për tekstet shkollore të historisë, Nebojsa Jovanović, shpjegon “dilemën” me të cilën një pjesë e serbëve assesi nuk mund ta pranojnë, pasi disa prej tyre besojnë se edhe Adami dhe Eva flisnin serbisht.

“Në publik është folur shpesh, në kuptimin pozitiv apo negativ, rreth nevojës për rishikimin e historisë. Disa janë të frikësuar dhe e dënojnë çdo përpjekje për të rishikuar historinë, ndërsa të tjerët shtrojnë nevojën që më në fund të diskutohen disa gjëra, të shkruhen saktë dhe të flitet me ndershmëri. Është edhe pala e tretë që abuzon me këtë situatë duke e paraqitur atë sikur ‘historia do të kthehet me kokë teposhtë’”, ka thënë Jovanovic.

Jovanović ka thënë se është duke iu referuar librit të historisë, e jo disa librave shkencorë, me të cilat, sipas tij është bërë përpjekje që me pseudo-histori e teza të ndryshme të tregojnë se “serbët ishin njerëzit më të vjetër, që madje Adami dhe Eva ishin serbë dhe flisnin serbisht, dhe që nga kombi serb dhe serbët lindën të gjithë popujt dhe gjuhët tjera që ekzistojnë në ditët e sotme”. “Ne jemi një komb që është krenare për historinë e tij të lavdishme dhe kemi rastin që për këtë të dëgjojmë diskutime të hapura dhe shumë të nxehta në rrugë, në një bar, në tubime dhe festime. Por kur diskutohet kjo temë, të vetmit që heshtin janë historianët, sepse ata nuk i pyet askush asgjë dhe librat e tyre nuk i lexon askush. Shumë herë kam qenë dëshmitar në situata të tilla, shumë herë jam bindur se literatura kryesore e këtyre historianëve është

‘interpretimi’ i historisë, lëndë në të cilën ata vet dikur janë vlerësuar me një dysh”, ka thënë Jovanoviq.

“Kur këta njerëz marrin në dorë librin e mësimit të fëmijëve të tyre, ata me të vërtetë e kuptojnë se disa mësimë kanë ndryshuar. Megjithatë, përshtypje të këtyllë do të kenë edhe ata që kishin pesë në histori. Sepse, disa mësimë nga historia me të vërtetë kanë ndryshuar. Për shembull, sot në tekstet shkollore të historisë mësohet shumë më shumë rreth Luftës së Parë Botërore se që mësoj më parë, kur e tërë Lufta e Parë Botërore përshkruhej, mësohej, në një orë mësimi”, ka thënë Jovanoviq, duke shtuar se ndryshime në të shkruarit e historisë ka pasur edhe kur bëhet fjalë për Luftën e Dytë Botërore.

Por Telegraf.rs e ka vështirë të pajtohet dhe vazhdon të komentojë librin, i cili thotë gjysmë të vërtetën. “T’iu kthehem edhe njëherë shqiptarëve. Pra kur arritën serbët në Gadishullin Ballkanik, ata gjetën Ilirët. Ky popull i quajtur Ilir u nda në fise dhe njërin prej tyre Evropa Perëndimore në shekullin XX i quajti ‘Albanians’. Ata e quajnë veten e tyre ‘Shqiptarë’, dhe nga këtu rrjedh emërtimi ‘Shiptari’, kur atyre iu referohen serbët” shkruan kjo e përditshme. “Duhet të theksohet se shqiptarët (gjoja fisi shqiptar) në historinë e tyre të gjatë, ndryshe nga pjesa tjetër e ilirëve që kishin shtetin dhe qeverinë e tyre, madje edhe mbretër (Mbretëreshën Teutë, me kryeqytetin e saj në Risan, etj), nuk përbënin një komb kushtetues, dhe në këtë drejtim ata u emancipuan vetëm në shekullin e XX-të”, komenton e shokuar dhe e zhgënjyer media serbe, të këtij gadishulli, dhe se kanë ardhur në Ballkan shumë

më përpara se sa Sllavët. “Për të qenë më të qartë, jemi duke folur për Ilirët, fiset ilire, me shkallë të ndryshme civilizimi, që populluan Ballkanin Perëndimor dhe prej të cilëve rrjedhin edhe Shqiptarët, siç u njohën edhe nga popujt dhe vendet e Evropës Perëndimore”, shkruan e përditshmja serbe Telegraf, e cila edhe vet e ka vështirë për të pranuar “rishikimin e historisë”, ani pse, përsëri i shtrembëruar. Në këtë libër, në leksionin “Sllavët e jugut dhe vendasit”, në mes të tjerash thuhet: “Megjithëkëtë, vendasit që kanë jetuar së bashku në grupe më të mëdha nuk u sllavizuan. Shqiptarët ruajtën gjuhën, doket, zakonet dhe simbolet tjera të tyre kombëtare. Një pjesë e sllovenëve të ardhur pranoi gjuhën dhe zakonet e shqiptarëve dhe u asimilua”, transmeton e përditshmja serbe citatin nga ky libër. Redaktori në Institutin për tekstet shkollore të historisë, Nebojsha Jovanović, shpjegon “dilemën” me të cilën një pjesë e serbëve assesi nuk mund ta pranojnë, pasi disa prej tyre besojnë se edhe Adami dhe Eva flisnin serbisht. “Në publik është folur shpesh, në kuptimin pozitiv apo negativ, rreth nevojës për rishikimin e historisë. Disa janë të frikësuar dhe e dënojnë çdo përpjekje për të rishikuar historinë, ndërsa të tjerët shtrojnë nevojën që më në fund të diskutohen disa gjëra, të shkruhen saktë dhe të flitet me ndershmëri. Është edhe pala e tretë që abuzon me këtë situatë duke e paraqitur atë sikur ‘historia do të kthehet me kokë teposhtë’”, ka thënë Jovanovic. Jovanović ka thënë se është duke iu referuar librit të historisë, e jo disa librave shkencorë, me të cilat, sipas tij është bërë përpjekje që me pseudo-histori e teza të

ndryshme të tregojnë se “serbët ishin njerëzit më të vjetër, që madje Adami dhe Eva ishin serbë dhe flisnin serbisht, dhe që nga kombi sedheserbët lindën të gjithë popujt dhe gjuhët tjera që ekzistojnë në ditët e sotme”. “Ne jemi një komb që është krenare për historinë e tij të lavdishme dhe kemi rastin që për këtë të dëgjojmë diskutime të hapura dhe shumë të nxehta në rrugë, në një bar, në tubime dhe festime. Por kur diskutohet kjo temë, të vetmit që heshtin janë historianët, sepse ata nuk i pyet askush asgjë dhe librat e tyre nuk i lexon askush. Shumë herë kam qenë dëshmitar në situata të tilla, shumë herë jam bindur se literatura kryesore e këtyre historianëve është ‘interpretimi’ i historisë, lëndë në të cilën ata vet dikur janë vlerësuar me një dysh”, ka thënë Jovanoviq. “Është e rëndësishme që të dini se nga vini, të keni në mendje historinë e familjes suaj, atë të vendit në të cilin jeni rritur”, shpjegon Aldo Cazzullo. “Unë kujtoj gjithçka dhe jam gjithmonë kureshtarë për historitë e vjetra të prindërve të mi, por jo nostalgjike. Këtë e demonstroi fakti që nuk kam mbajtur asgjë nga fotot që më kanë bërë me personazhet që kam intervistuar me objekte të tjera të lidhura me udhëtimet e punës”. Shqiptarët janë komb kryesisht i vendosur në Gadishullin Ballkanik: në Shqipëri, ku përbën rreth 83% të popullsisë, në Kosovë rreth 93% dhe në Maqedoni rreth 25%.[14] Në numër më të vogël, shqiptarë ka në Serbi, Mal të Zi, Greqi, Itali, Turqi e Kroaci, si dhe në vende të ndryshme të mërgatës. Flasin gjuhën shqipe, e cila i takon familjes së gjuhëve indo-evropiane. Sipas fesë, kryesisht janë myslimanë

ose të krishterë (ortodoksë ose katolikë). Ata flasin gjuhën shqipe dhe e kanë origjinën në territoret antike të Ilirisë dhe Epirit në Ballkanin perëndimor (Evropë). Shqiptarët janë rreth 13 milionë , megjithëse sot më shumë se gjysma e shqiptarëve jetojnë jashtë Shqipërisë dhe Kosovës, ndërkohë që pjesa dërrmuese e tyre jeton në Ballkan. Ka komunitete historike shqiptarë në Itali (Arbëreshët), Greqi (Arvanitët), Mali i Zi, Ukrainë, Serbi, Turqi, Egjipt, Bullgari, Bosnja, Kroacia, Rumania, Sllovenia, Maqedonia e Veriut, dhe më shumë kohët e fundit në Evropë në Austria, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Suedia, Zvicra, dhe në Amerikë në Argjentina, Brazili, Kanada dhe Shtetet e Bashkuara. Në shtetin e Maqedonisë, po ashtu edhe shtetet përreth Shqipërisë dhe Kosovës, si Serbia, Greqia, dhe Mali i Zi, janë munduar që ta zvogëlojnë numrin e banorëve Shqiptarë, dhe shumë prej tyre janë asimiluar dhe identifikohen si Turq, Boshnjak apo kombësi të tjera. Shkak i ndaljes së shkollimit në gjuhën Shqipe në shtetet përreth Kosovës dhe Shqipërisë. Ne Maqedoni janë se paku 927,000 banorë Shqiptarë sipas një dhënie, dhe kjo do të thotë se numri me rreth 500,000 banorë në Maqedoni është gënjeshtër e madhe, kurse ne vitin 1981 janë regjistruar se paku 600,000 banore te etnisë Shqiptare. Ne disa vende numri i Shqiptareve krejtësisht është shpallur mbi 15,000,000. Ne Turqi banojnë se paku 1000,000 Shqiptare, po ashtu edhe ne Greqi, populli Arvanitas është mbi 2000,000 banore, dhe nuk kane asnjë shkollë te fillore apo te mesme qe zhvillohen ne këto dy shtete për popullin

Shqiptare (Arvanitasit). Po ashtu edhe ne Presheve, Bujanovc dhe Medvegje, qe janë pjese e Kosovës Lindore, ka banore me probleme te arsimit dhe te drejtave te tyre te barabarta, qe janë drejta njerëzore. Origjina e shqiptarëve Thuhet se në kohët parahistorike, para se poetët e Homerit të këndonin për perënditë e tyre dhe heronjtë e përrallave, përpara se të shkruhej gjuha greke, rronte një popull i quajtur Pellazg. Herodoti (484 – 425 p.e.s.) iu veshë Pellazgëve historinë dhe i përmend shumë më parë se sa qytetërimin e grekërve; punimi i ashpër që mbulon anët e Panteonit në Athinë akoma quhet Pellazgjik. Këta ndërtnan mure të mëdhenj që quhen ciklopikë dhe për të cilët Prof. Pokok thotë që janë ndërtnuar shumë më përpara se të ekzistonin grekët e Homerit. Prej kësaj race të fortë parahistorike mbetën vetëm Shqiptarët. Vetëm më vonë u kuptua se Pellazgët qenë Ilirët e vjetër, e para degë Indo-Europiane, perandoria e të cilëve shtrihej që nga Azia e Vogël deri në Adriatik dhe nga Veriu deri në Danub. Nga studimet e shkrintarëve të rinj, si Prof. Maks Myller dhe Prof. Pot, në gjuhën Shqipe u bë e qëndrueshme kjo origjinë. Këta Ilirianë, që rrojnë akoma në Shqipëri si Toskë, u shpërndanë edhe në Itali dhe njihen si Toskë, Toskanë, Etruskë. Është e kotë të kërkohet për perënditë e Greqisë në etimologjinë e gjuhës së saj. Në gjuhën Shqipe këto janë shumë të qarta dhe domethëniet e tyre shumë të drejta. Kur do të jetë studiuar mirë gjuha shqipe dhe kur do të jenë zhvarrosur gojëdhënat e saj, atëherë shumë nga veprat e Homerit do të rishkohen dhe ca nga ato do të jetë

nevoja edhe të korigjohen. Herodoti nuk e pati ditë që emrat e heronjve të veprës së Homerit ishin fare qartë në gjuhën Pellazgjike. E deri edhe emri i vet i Homerit mund të gjurmohet në gjuhën Shqipe: I mirë, dhe në formën Imiros do të thotë poezia e mirë. Droilos, Droili(os), ai që druhet, frikacak. S humë të tjera mund t'i shtohen kësaj liste. Nuk është çudi nëse njerëzit që kanë studiuar gjuhën shqipe të thonë se kjo është gjuha origjinale e Homerit dhe që grekët morën nga poetët Pellazg të shumtën e këngëve të trimërive dhe ato heroike. Sa dituri e madhe e pret arkeologun kur toka Shqiptare do të hapi thesarin e historisë Pellazgjike! Këta dhe shumë rrjedhime të tjera dëshmojnë që Shqiptarët sot janë mbi tokën e të parëve dhe flasin gjuhën e stërgjyshërve të tyre. Edhe përpara se dega helene të njihej në malet e Thesalisë, Shkodra, qyteti kryesor i Shqipërisë, ishte pa dyshim kryeqyteti i mbretërisë madhështore të Ilirisë. Shqipja ishte gjuha amtare e Aleksandrit të Madh që pushtoi botën dhe e Pirros së Epirit, një nga gjeneralët më të mëdhenj që përmend historia dhe përballues i fundit i ushtrive pushtuese Romake. Një tragjedi, përtej përfytyrimit të tragjedisë, është kjo që një racë e vjetër dhe e fortë erdhi në një gjendje kaq të keqe dhe mizore, gjë e cila shikohet si skandal i qytetërimit European. Nuk është për çudi që otomanët nuk lejuan ndonjë gjermim në tokën Shqiptare, sepse ajo mund t'i sillte ndërmend këtij populli lulëzimin e parë. Në shkencën shqiptare dhe nga shumë autorë të huaj prejardhja ilire dhe autoktonia e shqiptarëve është e vërtetuar. Mirëpo, sikurse në kohët e kaluara edhe sot nga

autorë të ndryshëm dhe qarqe antishqiptare ka orvajtje për mohimin e prejardhjes ilire të shqiptarëve për qëllime të caktuara. Për shembull, para disa ditësh, deputetja prof. dr. Jelisava Kaleziq në seancën e Kuvendit të Malit të Zi u shpreh: nuk është e vërtetë teza se shqiptarët janë me prejardhje ilire. Në gazetën "Dan", Podgoricë, Mali i Zi, më 21. korrik 2016. Akademiku Zoran Llakiq, nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi, e botoi një artikull në të cilin mohon prejardhjen ilire të shqiptarëve dhe autoktoninë e tyre. Ndër të tjerat, thotë: Shqiptarët janë të ardhur nga Rumunia në Mat, përmbi Tiranë në shekullin X të erës tonë. Ndërsa në vitin 548 të erës tonë në Durrës kanë ardhë serbo-malazezët. Më tutje Llakiqi thotë: Shqiptarët në tërë hapësirë ku jetojnë, jo vetëm që nuk janë popull autokton, por as pakicë kombëtare. Në të vërtetë ata janë diasporë. Më pas me 24 korrik 2016. në gazetën "Dan" e botova një shkresë ku prezantova disa njohje shkencore nga autorë të huaj dhe shqiptarë mbi prejardhjen ilire dhe autoktonin shqiptare, meqenëse, kjo gazetë mjaftë lexohet në Mal të Zi. E quaj të arsyeshme se çështja e prejardhjes ilire të shqiptarëve dhe autoktonia e tyre në vazhdimësi të aktualizohet dhe të përhapet në opinione të ndryshme publike. Për arsye se pak a shumë ndeshemi me një propagandë antishqiptare të mohimit të historisë kombëtare shqiptare, për qëllime armiqësore. Për shkak të hapësirës së kufizuar, po fokusohem vetëm në disa hulumtues të njohur shkencor. Filozofi i njohur Gotfrid Vilhelm Lajbnic(1646-1717) u mor me lidhjen e shqipes me

gjuhët e tjera. Në letrën e tij të 10 dhjetorit 1709, e cituar më 1897 në revistën rumune Albania, deklarohet se në bazë të studimeve të tij është bindur se "shqipja është gjuha e ilirëve të lashtë". Historiani suedez, Hans Erik Tunman(1746-1778) , profesor universitetit në Gjermani, ishte një nga shkencëtarët e parë, që u mor me studimin mbi origjinën e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar. Ai bëri kërkime në burimet greke, latine e bizantine dhe studioi fjalorin trigjuhësh të Teododhor Kavaljotit(greqisht, sllavisht e ship) të botuar më 1770. Në veprën e tij për historinë e popujve të Evropës Lindore (1774), arriti në konkludim se shqiptarët janë vazhdues autoktonë të popullsisë së lashtë ilire. Johan Georg Fon Han(1811-1869), teoricieni austriak është marr me studimin e gjuhës shqipe së bashku me gjuhëtarin Konstadin Kristoforidhi. Më 1854 ai botoi veprën e tij, me tre vëllime, Studimet Shqiptare, mbi kulturën, gjuhën dhe historinë shqiptare. Ai ishte, ndoshta i pari që studioi fjalorin e ilirishtes së vjetër. Ai vërtetoi se shumë emra vendesh të viseve shqiptare ishin vazhdim i drejtpërdrejtë i emërtimeve të dikurshme ilire. Në bazë të studimeve të tij, arriti në përfundimin se gjuha shqipe ishte vazhduese e ilirishtes. Gjuhëtari i njohur , Franc Bop (1791-1867), profesor në Universitetin e Belinit, botoi veprën e tij më 1854, duke vërtetuar përfundimisht se shqipja bën pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane dhe nuk rrjedh nga ndonjë gjuhë tjetër në Evropë. Gustav Majer (1850-1900), profesor në Universitetin e Gracit dhe antar i Akademisë së Shkencave të Vjenës, botoi studimin e tij

Mbi pozitën e gjuhës shqipe në rrethin e gjuhëve indoevropianen, më 1883. Ai njihet veçanërisht për hartimin e Fjalorit etimologjik të gjuhës shqipe, më 1891. Në sajë të studimeve të thella shkencore arriti në përfundimin se gjuha shqipe rridhte nga ilirishtja dhe përbënte një degë më vete në familjen e gjuhëve indoevropiane. Maksimilian Lamperc (1882-1963), pas vizitës që bëri në Shqipëri si emisar i Akademisë së Shkencave të Vjenës, menjëherë u shqua si studiues i folklorit dhe mitologjisë shqiptare. Pastaj, në Laipcig vazhdoi studimet në fushën e albanologjisë, mbajti leksione rreth saj në universitet dhe në vitet 1954-59 hartoi dhe botoi Veprën mbi gjuhën shqipe, në tre vëllime. Në studimet e tij mbështeti tezën e prejardhjes së shqiptarëve nga ilirët dhe të gjuhës shqipe nga ilirishtja. Shkencëtari, Edwin Jacques, thekson: Nuk ka pikë dyshimi që shqiptarët e sotëm janë historikisht pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve. Shkencëtari, Serge Metais, shkruan: Sipas të gjithë treguesve – pikësëpari, për shkak të vetë gjeografisë – ilirët kanë qenë praardhësit e shqiptarëve. Në prag të pushtimit romak, ata zinin të gjithë pjesën perëndimore të Ballkanit, nga Istra deri në Epir. Në brendësi të gadishullit, ata ishin vendosur, në veri, të paktën deri te rrjedha e lumit Sava dhe, në lindje, deri te Morava e Jugut dhe në rrjedhën e sipërme të Vardarit. Më tutje studiuesi Metais shton: Në shekullin II të erës sonë, ku ilirët ndodheshin nën zgjedhën romake, gjeografi Ptolemeu bënte fjalë për ekzistencën e një fisi të albanëve (Albanoi) , kryeqyteti i të cilëve qenkösh Albanopolis. Profesor Eqrem Çabej (1908-1980), pa

dyshim, është figura më e shquar në fushën e albanologjisë. Për gati gjysmë shekulli ai bëri studime, botoi vepra të shumta nga gjuha dhe letërsia shqipe, ndonëse bëri hulumtime edhe në lëmin e etnografisë, folklorit dhe etimologjisë, leksikologjisë, të origjinës së gjuhës shqipe, marrëdhëniet e saj me gjuhë tjera indoevropiane dhe njësimin e normës letrare. Në bazë të studimeve subtile shkencore arriti në përfundim se shqiptarët janë pasardhësit e ilirëve dhe të banorëve të parë indoevropianë në Ballkan. Kumtesa e tij gjuhësore në Kolokuiumin e Parë mbi Studimet Ilire (15-20 shtator 1972) dhe shkrime të tjera të shumta ”vërtetuan në mënyrë bindëse origjinën ilire të gjuhës shqipe dhe autoktoninë e popullit shqiptar”. Profesor Kostallari, ish drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë, arriti po të njëjtin përfundim si dhe kolegu i tij Çabej. Gjithashtu, Aleks Buda, ish-kryetari i Akademisë së Shkencave e Shqipërisë, në një konferencë që drejtoi, më 2-4 korrik 1982, theksoi ”vazhdimësinë iliro-shqiptare dhe autoktoninë e shqiptarëve në trevat e tyre.” Mbi origjinën e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptarë janë marr dhe profesorët e njohur: Shaban Demiraj, Mahir Domi e të tjerë.

Publicisti i mirënjohur nga Gjakova Ing. Fahri Xharra, shkruan: “Serbët në të vërtetë kanë origjinë turke.

Dr. Skender Rizaj pyet dhe jep përgjigje: “Po serbët kush janë”?! “Gjykuar sipas burimeve historike të njohura deri tani, mund të thuhet se serbët me prejardhje “nuk janë sllavë, siç nuk janë autokton në Ballkan, aq më pak në Kosovës. Ani pse për këtë flasin

me të madhe thuajse bota, sidomos shkenca nuk i njeh”.Për origjinën e një populli, qofshin ata edhe sllavët, rol të veçantë kanë shkencat ndihmëse të historisë sidomos: Arkeologjia dhe poçaria e filigranologjia, armët dhe mënyra e varrosjes te Ilirët, paleografia çirilike, te sllavët, diplomatika (sidomos dokumentet në latinisht dhe greqisht, kronologjia, seragjistika, heraldika, gjenealogjia, bibliografia, arkivistika, toponimia, fitonomia etj., në përgjithësi te popujt etj.

“Serbët në të vërtetë kanë origjinë turke. Kanë prejardhje nga fisi turko-avar”. Rreth shekullit VII, ata me shumë fise tjera turke kaluan lumin Danub dhe u vendosën në krahun e djathtë të rrethinës të Smedereves. Ishin si të gjitha fiset turke nomadë dhe kalorës. Z . Rizaj, thekson: “As emri serb nuk ka origjinë sllave”, është emër profesioni me etimologji iraniane-turke”. Ai pastaj shton: “Serbët para se të vendoseshin në Ballkan kanë qenë mercenar në shërbim të sundimtarëve iranian, dhe si mercenarë edhe erdhën këndeje parit. Ky status i këtyre kalorësve-avar në ambientin e ri të Ballkanit u garantua edhe nga perandorët bizantin. ”

“ Sipas studimeve të historianëve rus Artamanovit dhe Pletnjevrit si dhe atyre serb Jovan Deretiçit ,Mihajlo Stanishiçit ; disa fise shqiptare ,dikur në mes të shekullit 8 -të e 9-të ,pas presionit të fqinjëve të tyre kaukaz Hazarëve, u larguan nga nga territori i tyre i lindjës në brigjet e Liqenit Kaspik(në Azerbaixhanin e sotëm dhe në Dagestan) ,me anën e Arabëve

mbërrijtën n jugun e Italisë. ” Këto fliten nga serbët për ne. Ne gjëja se erdhëm nga ato anë.

Një gjë që gjatë studimeve të mia për serbet e kam konstatuar është se e tërë ” historia ” e tyre e shkruar nga ata dhe miqtë e tyre nuk është gjë tjetër vetëm se një histori e vjedhur nga ne ,ndërrim emrash dhe përshtatje për mbulimin e zbrastirës së tyre histore me diçka që kurrë s`ka qenë e tyre.

“Serbët në të vërtetë kanë origjinë turke. Kanë prejardhje nga fiset turko-avare” e të nisur nga tokat e Persisë , Iranit të sotëm. Mjete moderne të kohës na e bëjnë të mundur që të arrijmë në përfundime spektakolare për prejardhjen e serbëve, të vetquajtur ”popull hujnor” . Në konferencen e quajtur ”Elementet Etnik paraslavik në Ballkan dhe etnogjeneza e sllavëve të Jugut ” (1968) arrihet në përfundim se” deri ne ditet e sotit arkeologjia nuk ka mundesi te na jep një dokument për një ardhje masive të sllavëve ne siujdhesen ballkanike gjatë shek.6 -të .Por ata ishin thjeshtë turko-avar.

”Sot sllovenët, kroatët, boshnjakët dhe serbët, janë përfundimisht vetëm folës të gjuhëve sllave, por për të parët e tyre mund të pyetet se çka ishin: avar, turq, bullgarë apo dicka tjetër (Denis Bašić The roots of the religious, Ethnic and Natioanl Identity of S.S.B.H)

”Civilizimi i Persisë ka lënë gjurmë të thella në kulturën dhe idenë e serbëve. Fiset e tyre jetonin në kuaj, kurse vendbanimi i tyre ishte qerrja e tërhequr nga buajt. Sipas veshmbathjës, zakoneve, kulturës nuk dalloheshi nga fiset nomade Persiane. Nga kapuçi i tyre e ka prejardhjen edhe e kapuçi i famshëm serb –

šajkača (shajkaqa)”, (Miodrag Milanović: Srpski stari vek- etnogeneza Srba). Ndryshimi në mes të serbëve të sotit dhe ”serbëve të dikurshëm” është shumë i madh thotë në librin e tij ”Srbi u srednjon veku” historiani serb Sima Çirkoviç.

Një ngjashmëri apo një origjinë e serbëve me fisin e sotëm Kashkai të Iranit.? Kush janë këta Kashkai (Persisht قاشقاي)? Një aglomeracion nomadësh që sot jetojnë në provincat Fars, Huzestan dhe Isfahan. I flasin dy gjuhë, ate persishte dhe gjuhën Kashkai , gjuhë që i takon familjes së gjuhëve turke. Kashkai ishin gjithmonë por edhe sot e kësaj dite janë popull nomad blegtoral. Çdo vit shetisin me kopetë e tyre nga kullosat malore të verës në veriun e Shirazit dhe deri 500 km në kullosat e tyre të dimrit në ultësirat e ngrohta në afërsi të Gjirit Persik.(Hawley, Walter A. (1913) Oriental Rugs Antique & Modern. Reprint:Dover Publications,New York)

Fiset e Azisë Qendrore të shtyrë nga luftërat, zënka ndërfishnore dhe përmytjet kanë qenë të detyruar që t`i lëshojnë stepat e tyre në mënyrë që të kërkojnë toka të “|reja” për ta., sikur se hunët vizigotët ,parabullgarët duke pushtuar Indinë dhe Europën. Racat turke duke i braktisur vendët e tyre ku me shekuj ishin rritur filluan herët të lëvizin në mes të Maleve Altai dhe Kaspikut. Një kashkajas shkruan : “ Ne jemi racë turke dhe të gjuhës turke ; disa thonë që jemi pasardhës të fisit turk Ogur, të njohur nga ashpërsia e tyre dhe sjellja prej bishe , dhe emri i ynë Kashkai rrjedhë nga Kashka Turke që do të thotë” Kali me yllin e bardhë në ballë” Ne jemi të ardhur nga Kashgari “

Janë të njohur për rrobat e tyre prej leshi.

Çdo rrjedhë historike, në mënyrë të vet është një dëshmi e jo vetëm zhvillimit dhe fatit të vet, por edhe rrjedhës së civilizimit të tij dhe rrymimeve nëpër të cilat ka kaluar një popull; e njejtë me te edhe veshmbathja e tij.” Ashtu edhe shajkaqa e cila në veshjet popullore serbe e ka vendin e vet, dhe për serbët vlenë si diçka kombëtare me theks të posaçëm për historinë të cilën e ka kaluar dhe në të njetën kohë si përkujtues i historisë dhe fatit të një populli dhe të njejtë kohë si sinonim për Serbin (Mile Nedeljković ŠAJKAČA poreklo i značaj srpske kape)”

“”Kur serbet si vullnetarë iu bashkuan ushtrisë së krishterë austriake në luftë kundër Islamit , në të njetën kohë duke e ëndërruar çlirimin e vendit të tyre nga Turqit (Mile Nedeljković, po aty)’ atëherë serbët morën falas uniformën e përgatitur nga austro-hungarezët. Në këtë me rëndësi të posaçme ishte kapuçi “shajkaqa” që ushtria serbe e barti në kokë në luftërat 1876-1878.””. Pse Austria kur e dezenjoi uniformën e ushtarit serb e parapau edhe shajkaqen ? Për t`iu treguar prejardhjen e tyre apo diçka tjetër.?

Nga studimet për shajkaqën shihen dilema në mendimet e historianëve serb për “krenarinë“ serbe. Disa absolutisht nuk pajtohen me këtë krenari. ”Civilizimi i Persisë ka lënë gjurmë të thella në kulturën dhe idenë e serbëve. Fiset e tyre jetonin në kuaj, kurse vendbanimi i tyre ishte qerrja e tërjequr nga buajt. Sipas veshmbathjës, zakoneve, kulturës nuk dalloheshi nga fiset nomade Persiane. Nga kapuçi i tyre e ka prejardhjen edhe e kapuçi i famshëm serb –

šajkača (shajkaqa)”(Miodrag Milanović : Srpski stari vek- etnogeneza Srba). Pra ,nga dëshira e tyre për të treguar ”autoktoninë ” në këto toka nuk pajtohen që dikush t`u nxjerrë në pah të kaluarën e tyre si dhe prejardhjen e vërtetë.

Ka shumë gjëra që të japin fakte për origjinën e tyre turko -avare, por duhet studjuar. Natyra e shkrimit tim të sotëm nuk më lejon të zgjerohem shumë, por ja edhe një shembull: Emri serb “Gospodar ” për “Zotëriun” rrjedhë nga Altaikët të cilët fjalën e kishin huazuar nga persishtja ”Gospanddar ” që thoshte dikur “pronar i deleve”.

Serbët u konvertuan në Krishtërimin ortodoks me urdhërin e Herakliusit, në mënyrë që me anën e fesë të zbutë kaosin të cilën e sollën avaro-turko-sllavët në tokat e Ilirikumit.

(Librat që e tregojnë prejardhjen turko-avare të serbëve ”Balkan worlds: the first and lastEurope”

Traian Stoianovich; “The Cambridge Medieval History Series “volumes 1-5 By J.B. Bury; “The Roots of the Religious, Ethnic, and National Identity of the Bosnian ... Denis Bašić; “In Search of the Lost Tribe: The Origins and Making of the Croation Nation “ Osman Karatay etj. etj.)

A ËSHTË LUKASHENKO I ÇMENDUR ?

“Lukashenko është i çmendur! Flinte me automatik”, eksperti Karamuço bën publike faktet tronditëse dhe zbulon qëllimin e tij të frikshëm: Ai është butoni i vërtetë i kuq i Putinit!

Studiuesit pretendojnë se kanë gjetur shenja të skizofrenisë që mund të gjenden në flokët e njeriut.

Në një studim të botuar në revistën shkencore “EMBO Molecular Medicine”, studiuesit zbuluan se sulfuri i hidrogjenit ishte i pranishëm në trurin e njerëzve dhe minjve me simptoma të çrregullimeve mendore dhe se ai veprimi si një biomarker për këtë gjendje mjekësore.

Skizofrenia karakterizohet nga një larmi simptomash duke përfshirë halucinacione, të sëmurët dëgjojnë zëra, kanë iluzione dhe mendim të paorganizuar dhe nuk kanë gamën e plotë të emocioneve si një person

mesatar. Rreth 1% e popullsisë së botës vuan nga skizofrenia, e cila zakonisht ndodh nga fundi i adoleshencës deri në moshën 30 vjeç në jetën e një personi. Si faktorët mjedisorë, ashtu edhe ata gjenetikë kontribuojnë në shfaqjen e skizofrenisë.

Studiuesit nga Japonia testuan minj që kishin frenime të larta ose të ulëta para-pulsit. Minjtë me frenime më të ulëta para-pulsit u gjet se kishin një sasi më të lartë të një enzime specifike që ndihmon në prodhimin e sulfurit të hidrogjenit dhe për këtë arsye kishin nivele më të larta të këtij gazi. Duke zvogëluar sasinë e enzimës së prodhuar nga minjtë, studiuesit ishin në gjendje të përmirësonin frenimet e tyre para pulsit.

Për të hetuar nëse të njëjtat zbulime mund të shiheshin te njerëzit, studiuesit shikuan trurin e njerëzve me skizofreni që kishin vdekur tashmë dhe zbuluan se një enzimë specifike u gjet në përqendrimë më të larta në trurin e të sëmurëve sesa në trurin e njerëzve të shëndetshëm. Ekipi hulumtues gjithashtu studioi gjëndrat e flokëve të 149 njerëzve me skizofreni dhe i krahasoi ato me ato të 166 njerëzve të shëndetshëm. Përsëri, nivelet e enzimës që prodhon sulfur hidrogjeni ishin më të larta në pacientët me këtë çrregullim mendor.

Nivelet e larta të enzimës besohet se çojnë në ndryshime në zhvillimin e ADN-së që vazhdojnë edhe në moshën e rritur. Një nga autorët e studimit, Takeo Yoshikawa, i Laboratorit të Psikiatrisë Molekulare në Qendrën Japoneze RIKEN për Shkencën e Trurit, i tha Newsweek se ilaçet që përdoren aktualisht për të trajtuar skizofreninë u zbuluan më shumë se gjysmë

shekulli më parë, por nuk janë efektive për 30% të pacientët.

“Sidoqoftë, kompanitë farmaceutike kanë braktisur përpjekjet për të krijuar ilaçe të reja,” tha ai.

Yoshikawa arrin në përfundimin se ky hulumtim pritet të japë një shembull të ri për zhvillimin e ilaçeve. Frenuesit e enzimave që sintetizojnë hidrogjen sulfur duket se janë të rëndësishëm në trajtimin e skizofrenisë, të paktën për pacientët që nuk mund të ndihmohen nga ilaçet ekzistuese.

Presidenti i Federatës Ruse, Vladimir Putin & Presidenti i Bjellorusisë, Alexander Lukashenko

Profesori i Kriminologjisë pranë fakultetit të Drejtësisë në Tiranë, Ervin Karamuço, zbërtheu sot sjelljen e Putin, Zelensky-t dhe Lukashenkos me gjuhën e trupit.

I ftuar në emisionin “Wake Up”, duke folur fillimisht për Lukashekon, Karamuço u shpreh se “ai është i çmendur”. Sipas tij, ai flinte me automatik pasi thoshte se do vinin ato të NATO-s.

Profesori shton se Lukashenko është butoni i vërtetë i Putin dhe se duan që të krijojnë një korridor që lidh Bjellorusinë me Kaliningradin, që është midis Polonisë dhe shteteve të tjera evropiane.

“Lukashenko është i çmendur. Mjeku i tij psikiatër është larguar në vitin 2000 urgjent nga Bjellorusia sepse kishte kartelë. I tha kam pasur kartelën tënde. Ai bëri publike faktin që në 1982 ky e la ushtrinë, ose

më mirë u përjashtua nga ushtria sepse pati probleme të rënda të çrregullimeve paranoide. Ky flinte me automatik gjumë se thoshte do vijnë ato të NATO-s. Ne flasim gjithmonë me burime, jo me 1 por me 2-3 burime mbi biografinë, që janë shumë të rëndësishëm për ne, sepse është një gjë shumë serioze. Profesorët nuk flasin kot asnjëherë. Dhe ky program e ka identifikuar me kohë Lukashenkon për shkak të problemeve të tij, të kartelës së tij psikiatrike, si një person me çrregullime të mëdha. Çrregullimi paranoid shoqërohet me një sëmundje mendore, kjo mund të jetë ose bipolare ose skizofreni, forma nga më të ndryshmet. Por çfarë ndodh në raport me Putin? Ky është butoni i vërtetë i Putin. Do ju them një fakt mjaft interesant gjeo-politik. Nuk është ai butoni i kuq që thonë shumë veta, butoni i vërtetë është Lukashenko. Pse? Sepse përveçse është i nënshtruar për shkak të paranojës, është kokëfortë, i ka të gjitha, domethënë është një ish-kryetar koperative në biografinë e tij, i ka propozuar Putinit së fundmi që të krijojë atë që quhet suvalki, korridor.

Çfarë është korridori suvalki? Është një korridor që lidh Bjellorusinë me Kaliningradin, që është midis Polonisë dhe shteteve të tjera evropiane. Por duke krijuar këtë korridor, duke e marrë de facto si pushtim, ndërpret rrugët e kalimit të tre vendeve baltike. E prandaj ka një përqendrim shumë të madh të forcave të NATO-s në atë zonë, sepse e dinë që ky është një mendje e çmendur që edhe mund të bëjë këtë”, zbulon Karamuço.

Sa vijnë e bëhen gjithnjë e më shumë këmbëngulëse zërat se Vladimir Putin është i sëmurë: ai dyshohet se vuan nga çrregullime të trurit të shkaktuara nga skizofrenia, nga sëmundja e Parkinsonit ose nga sulme zemërimi të shkaktuara nga trajtimet steroide për të kuruar kancerin, nga i cili thuhet se është prekur.

Ajo që i rikthehet problemeve të supozuara shëndetësore të presidentit rus, është britanikja “Daily Mail”, një gazetë jo gjithmonë e besueshme, por shumë e informuar që citon burime të inteligjencës perëndimore pranë Kremlinit: zyrtarë ekspertë të “Five Eyes”, “Pesë Sytë”, të aleancës së inteligjencës që përfshin Australinë, Kanadanë, Zelandën e Re, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pas sjelljes së Carit mund të ketë edhe shpjegime delikate të natyrës fizike dhe mjekësore.

Raporte të shumta perëndimore, do të kishin arritur në këtë përfundim, duke mbivendosur në sjelljen e presidentit 69-vjeçar rus, ënjtjen e dukshme të qafës dhe kokës që u shfaq në videot më të fundit dhe distancimin e konsiderueshëm fizik të vendosur gjatë vizitave të liderëve të huaj në Kremlini.

“Në pesë vitet e fundit ka pasur një ndryshim të dukshëm në procesin e tij të vendimmarrjes, njerëzit e afërt kanë vënë re gjithashtu një qartësi më të vogël në të folur dhe në të kuptuarit e botës rreth tij”, shpjegoi një burim për “Daily Mail”, duke konfirmuar se, mungesa e mirëkuptimit do të ishte edhe për shkak të mungesës së mendimeve kontradiktore në rrethin e tij të ngushtë, gjë që do ta pengonte të kuptonte

dështimin e pushtimit ukrainas. “Ai thjesht nuk është i informuar”, vazhdon ai.

Historia e “Daily Mail”, ndoshta bazohet në një burim të vetëm, është e dobët dhe e vështirë për t’u konfirmuar, por ajo përforcon dyshimet që janë shfaqur muajt e fundit: zgjedhjet e Putinit do të ndikoheshin nga Parkinsoni, nga një formë më gjenerike e demencës ose nga përdorimi i zgjatur i steroideve për trajtimin e kancerit, i cili do të prishte ekuilibrin e tij.

Teoria e fundit, do të konsiderohej gjithashtu e besueshme nga inteligjenca britanike. Distanca e madhe e mbajtur në takimet e javëve të fundit me liderët e huaj – deri në gjashtë metra, si në rastin e presidentit francez Emmanuel Macron – do të konfirmonte gjithashtu ekzistencën e sëmundjeve të mëparshme, të cilat do të rrisnin rrezikun e vdekjes nëse ai infektohej me Covid ose përdorimin e barnave që pengojnë sistemin imunitar, duke e bërë më të lehtë infeksionin.

Menjëherë pas takimit me Macron, një zyrtar francez konfirmoi se Putin “nuk dukej njësoj” si dy vjet më parë, sepse ai ishte “jashtë kontrollit”.

Britanikët – por edhe amerikanët – besojnë gjithashtu se kanë një dukshmëri të madhe të asaj që ndodh në dhomat e Kremlinit: kjo shpjegon gjithashtu vendimin e pazakontë për të bërë publike të gjitha informacionet e inteligjencës, të cilat normalisht duhet të mbeten sekrete, për të parashikuar – dhe ndoshta shmangin – lëvizjet e Moskës.

“Dukshmëria jonë është e jashtëzakonshme: krahasuar me Xi Jinping dhe Kinën, ne kemi cilësi të jashtëzakonshme”, tha një burim londinez për “Daily Mail”.

“Edhe një vëzhgues sipërfaqësor nuk mund të mos jetë i mahnitur nga metamorfoza somatiko-fizionomike që ka pësuar fytyra e Putinit gjatë viteve: nga krahasimi midis një fotoje rinore apo të pjekur dhe disa fotove të fundit si ajo në “UnHerd”, në të cilën vështrimi kërcënues dhe shikimi i munguar i përmbahet tipareve, duke filluar nga faqet e hiper-vaskularizuara nga botoksi”, shkroi Sandro Modeo për “Corriere”-n javën e kaluar në artikullin e tij të gjatë, në të cilin trajtonte edhe hipotezat për problemet e mundshme shëndetësore të liderit rus.

“E para ka të bëjë me shpinën”, shpjegoi ai, “ose problemet e mundshme me shtyllën kurrizore për shkak të lëndimeve të mëparshme sportive, siç përmendi dikur vasali bjellorus Lukashenko, apo edhe një neoplazmë të palcës kurrizore, simptomat e së cilës do të ishin të pajtueshme me disa vështirësi në ecje dhe disa shqetësime posturale të Putinit”/ “Daily Mail”; Përshtati: Gazeta “Si”.

... Rusia e filloi ofensivën ushtarake kundër Ukrainës. Tanke, avionë, autoblanda me dhjetëra mijë ushtarë dhe oficerë garantuan qytete e fshatra të shumtë të Ukrainës, duke shkelur në mënyrë flagrante të drejtën ndërkombëtare dhe Kartën e OKB-së të sovranitetit të shteteve.

Vladimir Putin dëshmoi se nuk ka asgjë ndryshe nga Adolf Hitler. Ai duket se është ndjekësi më

besnik i udhëheqësit të nacional-socialistëve gjermanë të viteve '30 të shekullit të kaluar.

Ngjashmëritë dhe madje identitetet janë të njëjta. Sidomos në filozofinë e luftës. I vetmi dallim është se Putin i ka dhënë kohë vetes më shumë sesa Hitleri. Nuk është nxituar aq shumë deri tani. Por tash po vepron me kryeneçësi dhe kokëfortësinë e Hitlerit.

Adolf Hitleri erdhi në pushtet duke shfrytëzuar padrejtësitë e Konferencës së Parisit ndaj Gjermanisë si fuqi humbëse e Luftës së Parë Botërore, më saktë ndaj Francës, e cila kishte insistuar në cenimin e integritetit territorial të Gjermanisë. Vladimir Putin erdhi në pushtet me kritikën e ashpra ndaj Perëndimit, të cilin e bën përgjegjës për shpërbërjen e ish Bashkimi Sovjetik. Shpërbërjen e BS Putin e konsideroi që në ditën e parë si president “tragjedinë më të madhe” për vendin e tij. Dhe prej këtu nisi e gjitha çfarë ka ndodhur më vonë Gjeorgjinë dhe çfarë po ndodh sot me Ukrainën në dy faza.

Hitleri erdhi në pushtet me premtimin e “bashkimit të botës gjermane” dhe rivendosjes së drejtësisë. Putin vijoi në shekullin XXI me të njëjtin premtim për “bashkimin e botës ruse”, përfshirë dhe ato popuj e kombe që flasin sllavisht ose i përkasin besimit ortodoks. Ai elaboroi teza të frikshme para se të hidhej në veprim për shkëputjen e rajoneve të Gjeorgjisë, përkatësisht Abkazinë dhe Osetinë e Jugut (2008), ose të Krimesë në vitin 2014. Derisa erdhi te agresioni për aneksimin e Ukrainës.

Krimea u aneksua në mars të vitit 2014 me pretendimin se në gadishull po kryhej dhunë kundër

rusëve. Ndërkohë që asgjë e tillë nuk kishte ndodhur. Putin fabrikoi asokohe gënjeshtren se “Në Kiev dhe zonat ku banojnë rusët ishin formuar formacione nacional-socialiste (naziste) të cilat kërcënonin rusët e Ukrainës”. Por as kjo nuk ishte e vërtetë. Asnjë lloj krimi nuk kishin bërë ukrainasit kundër rusëve dhe minoriteteve të tjera në vendin e tyre. Thjesht ata anuluan një ligj të Viktor Janukoviçit ku refuzohej Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit me BE-në. D.m.th shprehën vullnetin për t’u integruar në BE.

Ky vullnet i lirë i ukrainasve dhe përfaqësuesve politikë të tyre nuk i pëlqeu presidentit të Rusisë. Ai e donte Ukrainën zonë të vetën të ndikimit dhe imponimit. Ashtu siç ka sot Bjellorusinë dhe shumicën e republikave të Kaukazit. Në të kundërtën do të përdorte forcën, siç nisi ta dëshmojë që prej të hënës së shkuar, veçmas ditën e sotme. Edhe Hitleri me të tilla formula e filloi luftën. Fillimisht “mori në mbrojtje sudetët” dhe pushtoi Çekinë. Më pas nisi Luftën e Dytë Botërore me pushtimin e Polonisë.

Putin, njësoj si Hitleri, ka si tipar të tijin kërcënimin. Ndërsa Evropa e kohës së Hitlerit iu nënshtrua kërcënimeve të kancelarit gjerman, Evropa e sotme është e trembur dhe e përçarë. Polonia, Hungaria, presidenti çek dhe ai kroat, kryeministri slloven, politikanë në Sllovaki e Bullgari, shumica e politikanëve dhe e opinionit publik në Serbi, madje dhe fraksione parlamentare në Francë, në Austri, Itali e gjetkë bëjnë Kollonën e Pestë në Bashkimin Evropian dhe i japin fuqi Moskës. Këto segmente evropiane ende nuk po shohin se armët që vringëllojnë në Ukrainë do

të stacionohen në vendet baltike e Detin e Veriut, në brigjet perëndimore të Detit të Zi dhe madje në brigjet lindore të Adriatikut. Atëherë bashkëpunëtorët e sotëm të Putinit do të ndjejnë dridhma përpara tij! Ish-ministrja e Jashtme e Austrisë, Karin Kneissl, e cila e ftoi para disa vitesh Putin në dasmën e saj, nuk do t'i përulet më Carit rus për ta ftuar në vallëzim, por do të zvarritet para tij!

Prandaj bota duhet të bëhet bashkë. Madje jo vetëm Evropa dhe SHBA-të, NATO dhe BE. Këto lokomotiva të politikës botërore duhet të tërheqin me vete të gjitha vendet paqedashës. Duhet vënë kriteri i qëndrimeve: – Nëse je me paqen e rendin botëror, reago, protesto dhe izoloje politikën hitleriane të Vladimir Putin. Në të kundërtën nuk mund të jetë asnjë shtet dhe vend sovran i sigurt.

Vetëm unifikimi evropian mund ta ndalë Vladimir Putin. Ndërkohë ka ardhur momenti që Gjermania të rifitojë të drejtat e plota për t'u përgatitur për mbrojtje, përfshirë dhe të drejtën e zhvillimit të arsenalit bërthamor. Nëse Britania e Madhe, Gjermania, Franca dhe të gjitha vendet e tjera evropiane bashkohen, atëherë Putin do të detyrohet të rikthehet në kufijtë e Rusisë dhe të respektojë të drejtën sovrane të shteteve sipas Kartës së OKB-së. Ndryshe rendi botëror do të shkatërrohet dhe bota do të ketë një fat shumë më të trishtë se ai i Luftës së Dytë Botërore, thotë mes tjerash politikologu i njohur shqiptar prof.dr.Enver Bytyçi.

GRADAT E SPIRO BUTKËS

Duke ndjekur emisionin e TV Dukagjinit, me titull: “Të pathënat për UCK-në”, të përgatitur prej gazetarit, Ermal Panduri, transmetuar në datën 10 tetor 2018, e cila është intervista ku kanë folur: bashkëluftëtari i Zahir Pajazitit Fadil Begu, kryetari i Organizatës së Veteranëve të UÇK-së për Shqipërinë, Sokol Poga, Komandanti i Qendrës Stërvitore të UCK-së në Helshan, kolonel Maliq Doci, një prej furnitorëve kryesorë për formacionet e UCK-së prej Hasi në brendësi të Kosovës Qamil Cahani, dhe autori i këtij reagimi.

Mirëpo, në fund të asaj interviste, gazetari Panduri i ka bashkangjitur edhe një intervistë të ish-oficerit nga Shqipëria, i njohur me emrin Spiro Butka, por de fakto mbiemrin e ka Bucka, i vetgraduar kolonel. Mirë ka bërë, e drejt e tij si gazetar. Por, sikundër do ta shpjegojmë më pas, kjo shtesë e tij është qëllim keq.

Themi për Spiron “i vetgraduar”, për faktin se nuk e ka gëzuar kurrë atë gradë ushtarake sa ka qenë oficer efektiv në Ushtrinë e Shqipërisë. Kjo për arsyen e

thjeshtë se, kur Spirua është liruar nga Ushtria e Shqipërisë , (në gjysmën e dytë të viteve ’70-të të shekullit XX), jo vetëm që Ushtria Shqiptare nuk kishte grada, por që të gëzoje atë gradë duhej të ishte minimalisht komandant Brigade (Regjimenti), ndërkohë që ai zotëri ka qenë shef stërvitjeje a shef operativ Brigade, që po të ishin gradat në atë kohë, do t’i takonte maksimalisht grada major, por kurrë kolonel.

Por ky zotëri, me sa po duket, e ka qejf vetgradimin, pasi edhe kur krijoi Armatën Kombëtare Shqiptare në vitin 2003, për të cilën u fut edhe në listën e zezë të Presidentit të SHBA, Xhorxh Bush (i vjetri), edhe atëherë u vetgradua Gjeneral-Kolonel, (për t’u barazuar me Enver Hoxhën kur iu dha kjo gradë në Kongresin e Përmetit, 24 maj 1944, kur vendosi gradat), dhe zgjodhi për pseudonim një emër e mbiemër madhështor për t’u paraqit si i lindur nga Zoti për beteja të mëdha ushtarake, Vigan Gradica. Edhe mbiemrin Gradica e ka zgjedhur për të na thënë se është Mehmet Gradica i kohës sonë! Kjo tregon se djallëzia e tij është e pa arritshme.

Por që të mos largohemi nga tema, z. Ermal Panduri përveç që i ka censuruar thëniet tona për “viganin” Spiro Bucka, por e mbyll qëllimisht atë intervistë me thëniet e tij. Dhe kuptohet se cili është qëllimi i këtij gazetari: që t’i paraqesë të pavlera e të paqena gjithçka folën e treguan parafolësit, protagonistët e vërtetë të atyre ngjarjeve që ata trajtuan e folën për operacionin “Shigjeta” si dhe për çështjen e të qenit të Spiro Buckës dëshmitar prefencial i Prokurorit, Elez Blakaj.

Ç'është gjithë kjo dashuri dhe përkrahje e prokurorëve dhe e disa gazetarëve në Kosovë ndaj një magazinieri të UÇK-së që vepronte gjatë luftës në qytetin e Kuksit dhe kurrë në Kosovë, madje i përkrahur pa rezerva edhe nga Azem Syla, e i mbështetur pas lufte edhe nga shumica e ish-anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?! Ku vallë flen lepuri?

Dhe ajo që është interesante në intervistën e Spiro Buckës, në këtë emision, është shprehja e tij: “Unë, po të kisha 3000 ushtarë do ta çliroja Prizrenin”. Ç’paska humbur Kosova një fat të madh!

Kjo deklaratë pompoze e Vigan Spiro Buckës tregon se, ky zotëri ose nuk ka pirë ilaqet kur ka dhënë intervistën, ose nuk e kanë çuar për ta vizituar te mjeku psikiatër. E themi këtë për vet faktin se ai bie ndesh me ato çka ka thënë në shumë shkrime të tij. Në ato shkrime, ai është deklaruar se na paska qenë emëruar nga Azem Syla zëvendës Komandant i Operacionit “Shigjeta”. Madje ka deklaruar edhe tjetrën: e ka komanduar atë luftim, (le ta quajmë operacion), nga një largësi 20-30 kilometra larg, pasi, sikundër tregojnë të gjithë pjesëmarrësit në të quajturin Operacioni “Shigjeta”, ai ka qenë në një zyrë në ish-Uzinën Mekanikë të Kuksit!

Dhe kjo duhet të jetë një risi në artin ushtarak botëror dhe jo vetëm shqiptar, që ta drejtosh luftimin nga një zyrë, pa dritare dhe në një largësi të tillë, duke mos qenë nevoja ta shohësh fare as frontin e jo më vijën e parë të luftimeve.

Mirëpo, dimë që në mal të Pashtrikut dhe në Koshare u grumbulluan e u angazhuan në luftim gati 5000

ushtarë. Nëse do të pranojmë se ky zotëri ka qenë zëvendës komandant i atij operacioni të planifikuar nga Shtabi Përgjithshëm dhe jo nga ministri Azem Syla, sikundër na e paraqet ky, në disa dokumente me nënshkrimet e Azem Sylës, si është e mundur që nuk e çliroi Prizrenin? Dhe kjo do të ketë ndodhur për faktin se kanë qenë më shumë ushtarë se sa i duheshin Spiros, ishin 5000 dhe jo 3000, prandaj nuk e ka marrë mundimin ky “trim vigan” që ta çlironte Prizrenin!

Ngaqë kanë qenë 5000 dhe jo 3000 luftëtarë, prandaj ky zëvendës komandant operacioni nuk mundi të çlironte edhe ato 300-1000 metra të territorit të Republikës së Shqipërisë që ishin pushtuar e fortifikuar nga forcat serbe, prej Qafës së Prushit e deri Gorozhup. E paskemi vrarë mendjen kot se pse nuk u realizua detyra për hapjen e korridorit të furnizimit si në Koshare edhe në Pashtrik, ngaqë kanë qenë më shumë se sa i nevojiteshin, Viganit Spiro Bucka. Pse nuk na e ka thënë më pare ky vigan, që mos të ishim lodhur kaq shumë.

Dhe me këtë deklaratë mburravece të këtij “trim vigani”, gazetari Ermal Panduri na e mbyll intervistën e “të pathënave për UCK-në”. Turp, e faqe e zezë, kur duan të na i paraqesin si të vërteta këto broçkulla mburravece të një ish-oficeri të përjashtuar nga tre ushtri, dy shqiptare e një ndërkombëtare, si i padenjë për të qenë oficer ushtrie: nga Ushtria e Republikës së Shqipërisë, nga TMK-ja dhe nga KFOR-i .

FRANZ KAFKA MODERNISTI I MADH

Franz Kafka (i lindur më 3 Korrik, 1883 në Pragë të Austro-Hungarisë, sot Republika Çeke; vdiq më 3 Qershor, 1924 në Vjenë të Austrisë) ishte një nga shkrimtarët e historive të shkurtra, dhe modernistët më të mëdhenj të gjuhës gjermane të shekullit XX.

Disa nga shkrimet e tij mbetën të pambaruara dhe u botuan pas vdekjes së tij, megjithëse dëshira e tij ishte që ato të asgjësoheshin – të cilat janë bërë ikona në letërsinë e Perëndimit.

Pjesa e tij më e njohur përfshin një tregim të shkurtër me emërtimin “Die Verwandlung” (Metamorfoza, Shëndërrimi) dhe romani i tij i pambaruar “Der Prozess” (Procesi) dhe “Das Schloß” (Kështjella).

Mbiemri “kafkor” ka hyrë në përdorim të shënojë rrethanat e rëndomta të llojit absurd dhe surreal zakonisht të gjetura në veprat e Kafkës.

Kafka u lind në një familje hebre gjermano-folëse të klasës së mesme në Pragë, kryeqyteti i Bohemisë, një mbretëri që në ato kohë ishte pjesë e monarkisë së dyfishtë të Austro-Hungarisë.

Disa nga veprat që mund të shtjellohen dhe të përkthyer në shqip janë: “Procesi”, “Metamorfoza”, “Kështjella” në formën e romanit por dhe nga proza e tij e shkurtër në formën e tregimit.

Disa nga tregimet e tij janë “Një Leksion Akademik”, “Populli i Minjve”, “Barbarët”, etj.

Fatkeqësisht veprat e tij janë në shumicën e tyre të humbura dhe për më tepër nga vetë dëshira e autorit për t’i asgjësuar ato.

Kryesorja ç’ka mund të fillojë një analizë për këtë shkrimtar, është vënia re e një ndryshimi rrënjësor të formës në veprën e tij dhe në përmbajtje.

Ai shpesh përdorë një formë të veçantë dhe të thatë simbolike ku majmunët flasin, njerëzit transformohen, portretizohen në mostra etj, pra një realitet jashtëtokësor për të analizuar bujtinën tokësore në formën e saj më reale.

Ky konstatim mund të duket kontradiktor në vetvete por nis nga një simbolikë surreale që kërkon vëmendje për problemet e mëdha universale që prezanton Kafka.

Në analizën e “Procesi”-it vihet re një e vërtetë tronditëse e realitetit me njeriun e thjeshtë brenda, dhe sistemet që ndryshojnë dhe e shikojnë këtë të fundit si një pengesë apo një të mirë për to.

Kafka parapëlqen një të vërtetë të skajshme ku sheqerosjet artistike nuk janë më vlerë në veprën e tij.

Personazhi përgjithësisht është njeriu i rëndomë, jo hero i që bën diferencën. Kafka injoron pa e marrë fare parasysh esencën romantike të letërsisë dhe hidhet i tëri në kërkim të shpëtimit universal të cilin e shpreh: “Vetëm kur shkrimtari rastësinë mund ta kthejë në ligj dhe ta bëjë njeriun të pavdekshëm, vetëm atëherë ai ka një rol në art dhe vetëm atëherë roli i tij është profetik”.

Kafka nuk qëndron te ekzagjerimi dhe optimizmi emotiv, ai është ulur këmbëkryq dhe na shikon të gjithëve.

Në personazhin e “Proces”-it zotit “K.”, sistemi gjigant i pushtetit i bën grafikun e jetës pa e shpjeguar se për se e trajton ashtu deri në vendimin për ta vrarë pa i dhënë shpjegim.

Nga ana tjetër kjo mund të analizohet dhe në të kundërt; vetë zoti “K.” nuk ka aftësinë për të kuptuar sistemin, megjithëse përpiqet që të kuptojë diçka, përsëri është i mbytur në paqartësi.

Në secilin kah vlerësimi, rezultati i kësaj marrëdhënie është një absurditet fatal ku qenia, ambienti, logjika, hapësira, ekzistenca në vetvete është tejet e pakuptueshme dhe pa mundësi për të pasur një debat ndërmjet tyre, gjithashtu e tmerrshme në efektin e saj.

Zoti “K.” mund të shikohet në disa drejtime të tjera, ai nuk është vetëm njeri por dhe ligjësi skolastike, e cila në një periudhë të caktuar humbet ekzistencën e saj pasi një ligj tjetër e nxjerr atë të pavlerë.

Kjo është një e vërtetë jo e dëmshme në dukje por si do të justifikohen gjithfarë energjish dhe përpjekjesh

njerëzore që qenë frymëzuar nga ajo që tashmë është e pavlerë dhe për tu fshirë.

Një kuptim tjetër i përfolur për “Procesi”-in është dhe pyetja teologjike që ai përmban.

Përgjithësisht dogma fetare është një përhapje e arsyes se jeta është një përpjekje për të merituar një perfeksion pas vdekjes.

Feja përmban shumë rregulla që duhen ndjekur dhe pasojat që vijnë nga mosndjekja e tyre, por Kafka i bërtet këtyre arsyeve me faktin se jo të gjithë i njohin dhe i kuptojnë këto ligje.

Pse do të duhet të kenë të njëjtin fat si mos-zbatuesit vullnetar e të vuajnë dënimin kapital.

Kafka kërkon shtojcën “biblike” që duhet të përmbajë logjikën për fatin e këtij grupi. Ka dhe shume tematika të tjera më sekondare nga ato që u përmendën më sipër.

Zoti “K” në disa rrethana që i krijohen kryen marrëdhënie intime me një vajzë pa modalitet klasik të njohjes, bisedës ose ndjesisë emocionale dhe kur se çfarë veprimesh paraprijëse për të kaluar në marrëdhënie seksuale, por e realizon atë në një formë apriori sikur të mos ketë vend për kushtëzime dhe justifikime. J. P. Sartre citon në një paragraf se: “Shpirti ka më shumë të drejtë se arsyeja” pasi kjo e fundit është e asgjesshme nga vet ajo kurse shpirti është një formë e qenësishme apriori.

Por veprimi i zotit “K.” mund të shihet dhe si një protestë e Kafkës me dy elementë.

I pari sistemi (qoftë teologjik, politik, tradicional, etj.) që vepron në mënyre injoruese ndaj individit dhe ky i

fundit i përgjigjet atij me të njëjtën monedhë duke krijuar kështu plotësimin instiktiv ndaj dëshirave rastësore.

Në këtë logjikë Kafka është disi në atmosferën e Niche-s por me ndryshimin se nuk e ka qëllim në vetvete por një përgjigje e natyrshme dhe e rrjedhur nga kushtet.

Kjo vepër dhe po ashtu vepra në tërësi e Kafkës me të drejtë është një ortek që sa me shumë thellohesh aq më i madh bëhet, deri sa orteku është vetë globi që banojmë.

Letërsia e Kafkës është një ambient i ankthshëm; është një situatë e një zgjimi e njëkohësisht i një fataliteti.

Kafka nuk është dekadent, ai bën një portret të gjërave por nuk mundohet të rrënojë, të mohojë apo të zgjedhë mjete për të asgjësuar, ai thjesht paraqet ftohtësisht acarin e absurditetit.

Një kryevepër mund të cilësohet padyshim vepra “Metamorfoza”.

Si zakonisht tek Kafka dhe këtu ambienti është një natyre simbolike. Kafka e fillon veprën e tij me mëngjesin në të cilin një person ndjen që po shndërrohet në kandër.

Mëngjesi është i zakonshëm në shkrimet e tij, zgjimi që personifikon shpresën e re, emocionet e reja, të gjitha këto turbullohen menjëherë sapo personi fillon kontaktin me botën, ai rrënoqethet nga atdheu zhgënjyes.

Grigori i transformuar tashmë krijon fillimisht një shqetësim të thellë në familje. Të gjithë ata në këtë moment janë të përkushtuar rreth tij. Gjenialiteti i

Kafkës është se ai e paraqet Grigorin në ndryshimin fizik apo mekanik por jo shpirtëror dhe të ndërgjegjes. Grigori e kupton të gjithë situatën rreth tij dhe ka një pikëllim të madh që tanimë as mund ta shprehi nën petkun e kandrës.

Por ç'është në të vërtetë "Kandra"?

S'është gjë tjetër veçse krijesë e një natyre anti-njeri, e një natyre të tmerrshme dhe pa kthim. Ajo është më tepër, nuk është krijim i individit, por e një trysnie fati të cilin askush prej nesh nuk e zgjedh me vetëdije.

Grigorit gjithë kjo gjëmë i vjen pasi ai është shumë i përkushtuar në punë, e cila e ka bërë efektin e saj të çuditshëm, jo duke i dhënë të mirat që çdo njeri pret por duke e shndërruar në një qenie të çuditshme dhe të trishtueshme që e pengon të realizojë natyrshëm dëshirat njerëzore qoftë dhe më minimalet.

Në fund familjarët e lodhur dhe përfundimisht të bindur se krijesa që kanë përballë nuk është me djali apo vëllai i tyre por një "kandër", e trajtojnë si të tillë dhe Grigori vdes në ngashërimin e pashprehur dhe disi në pritje të "zgjidhjes" që do ti sjelli vdekja.

Megjithëse përshkrimi i mësipërm i këtij romani është mjaft i shkurtër kemi mundësinë të analizojmë disa ide përmbajtëse në të. Shkrimet e Kafkës, në ndryshim nga tregimet e stërzgjatura, përgjithësisht zgjaten me përtesë vetëm për të thënë atë që duhet dhe pa ceremonira formale.

Nëse do ta nisim nga fundi Grigorit i ka ardhur në maje të hundës por siç kemi thënë me lart Kafka nuk është dekadent (të gjejë mjete për të asgjësuar apo

zhdukur situata) Grigori ndihet thellësisht i pa shpresë për momentin por ai nuk tenton vetëvrasjen.

Ai zgjidhjen e merr si pasojë e një veprimi pasiv mbi situatën dhe e lë veten tërësisht të shkrihet në fatin që i racionoi Jeta.

Vdekja është një zgjedhje e natyrshme e tij por jo me ekzaltim e për mundësinë e ndreqjes por duke çliruar pamundësinë përballë natyrës absurde që e rrethon.

Kafka në vetvete është një protestues i madh; është vetë protesta.

Ai nuk krijon arsyetime fatale por paraqet botën dhe në këtë drejtim protesta e tij nuk ka hierarki drejtuese, ajo lind apriori për të gjithë që nga momenti i zgjimit në absurd gjithashtu ajo nuk ka mjete lufte përveç reflektimit mbi situatën.

Grigori jemi të gjithë ne të mekanizuar me elementë që fati arbitrar na etiketon çdo kohë dhe që janë të pa evitueshëm.

Jo vetëm kandra por dhe vdekja është e njëjta gjë ashtu si Grigori nuk i bënte ballë dhe s'e kuptonte transformimin ashtu dhe vdekja e kaplon njeriun në vite e ndihmuar nga plagosjet e përpjekjes për lumturi dhe qetësi që i lakmojmë për ditë të gjithë ne.

Kandra është i alkoolizuari që nëpërmjet alkoolit donte të prekte gëzimin por që endet i shkatërruar rrugëve, kandra është "At Sergei" (Tolstoi) që duke u drejtuar vetëm nga shpirti i amshuar u kthye në një përdhunues.

Ajo është gjithçka që prodhon absurdi dhe jeta pa pika referimi dhe që prezanton fytyrën e saj nëpërmjet këtyre fenomeneve.

Nëse kemi hyre pak në esencën e fundit të veprës dhe në mesin e saj fillimi është ndryshe. Njerëzit tronditen nga transformimi, mortaja, burgosja, etj.

Ata mbajnë një qëndrim ndaj halleve që u bien nga qielli.

Mos vallë Kafka e merr njeriun si një qenie me manual të paracaktuar përdorimi të cilin e ka të stamposur në ndërgjegje dhe orientohet midis të mirës dhe të keqes? Vetë Kafka është një njeri që i dorëzohet trasendentës? Ai e lë hapur apo pa zgjidhur vetë këtë dilemë me dëshirën për të asgjësuar krijimtarinë e tij apo me saktë pyetjet e tij dhe si Grigori shikon nga ylli i mëngjesit, pas vdekjes.

Në vazhdën e krijimeve pikante të Kafkës me interes është tregimi “Një Leksion Akademik”.

Këtu paraqitet një personazh shumë i përfolur, të transformimit majmun në njeri. Kafka nuk e shikon zhvillimin nga ana estetike por kuptimore.

Majmuni tashmë njeri ndihet përballë lirisë së zgjedhjes.

Ai nuk i referohet vetes në anën e cilësisë organike por të ndërgjegjes. Pikërisht, për shkrimtarin, njeriu ka koordinata arsyetive dhe jo të një problemi vizual dhe të lëvizjes.

Për kuptimin tradicional të lirisë ajo çka deklaroi Kafka për të është të paktën e çuditshme. Majmuni, tashmë njeri është i pikëlluar për lirinë e zgjedhjes pasi është përgjegjës për rrjedhën e gjërave ndërkohe që nuk është i sigurt për pasojat e zgjedhjes së tij.

Bota tashmë ka formën që ai zgjedh por e tmerrshme pasi ai të vetmin vend ankimi dhe ndëshkimi ka veten.

Kjo tek “Zarathuastra” (F. Niche) është një çlirim i qenies për tu perfeksionuar, tek Kafka është një fatalitet.

Ai është thellësisht në kërkim të fesë, të para-projektit rruga e të cilit nuk do ta zhgënjente njeriun. J. P. Sarter mendonte se njeriu nuk është prodhim fizik dhe ndërgjegjësor i vetvetes, Kafka megjithëse më i hershëm pasi e kalon koshiencën e këtij postulati mendon se gjithashtu njeriu s’mund të projektojë veprimin e vetvetes.

Ai është një qenie e trishtuar për pozicionin që ka. E gjithë kjo të bën ta mendosh mbase të pezmatuar ndaj zotit, natyrës por mbase si një nxitje drejt kërkimit të zotit të humbur ose të një depresioni të pashmangshëm nga kotësia dhe boshllëku që nuk japin shpjegim. Forma e tregimit është krijuar afërsisht si monolog e cila fatkeqësisht mund të interpretohet si një shprese e venitur për përgjigje, kurse fakti që ai e hedh në letër është një veprim i vetvetishëm siç është mendimi.

Kafka është një qenie gjeniu dhe pikëllues njëkohësisht, sikur të qe i pashmangshëm dëshpërimi i një shpirti të lartë në realitetin tokësor. Veprat na duhen.

Shkrime dhe përkthime (përzgjedhje) 1909: Një libër lutjesh grash (Ein Damenbrevier) 1909: Një bisedë me të luturin (Gespräch mit dem Beter) 1909: Një bisedë me të dehurin (Gespräch mit dem Betrunkenen)

1909:Aeroplani në Brescia (Die Aeroplane in Brescia)
1911: Rihardi dhe Samueli (Richard und Samuel)
1912: Zhurmë e madhe (Großer Lärm) 1913:Soditje
(Betrachtung; me 18 tekste prozë) 1913: Gjykimi (Das
Urteil) 1913: Fokisti (Der Heizer) 1915:
Metamorfoza (Die Verwandlung) 1915: Para ligjit (Vor
dem Gesetz; pjesë i romanit “Procesi”) 1918: Vrasja
(Der Mord) 1918: Një doktor vendi (Der Landarzt)
1919: Në koloninë ndëshkuese (In der Strafkolonie)
1921: Kalorësi i kovave (Der Kübelreiter) 1924:
Një artist i urisë (Ein Hungerkünstler)

LETËRSIA MODERNE SHQIPTARE

E pasur dhe e bukur është gjuha shqipe, nga e cila shqiptarët krijuan një kult të vërtetë; megjithëkëtë është fare pak e zhvilluar: rrethanat historike krejt të posaçme dhe sidomos një sundim i huaj prej më shumë se 5 shekujsh i vonuan për një kohë shumë të gjatë çdo farë rilindje kulturore popullit shqiptar të dashuruar për liri.

Letërsia shqiptare që zhvillohet në vitet e tridhjeta në Kosovë, kishte disa shenja parandaluese: ajo ishte e shkëputur nga letërsia amë dhe nga një pjesë e traditës letrare.

Letrarët dhe letërsia në Kosovë, pothuaj nuk ishin fare në kontakt me të dhe nuk ishin të informuar për atë çka ndodhte në fushën e letërsisë brenda kufirit të shtetit shqiptar.

Në Kosovën letrare herë pas here ilegalisht, mund të depërtonte ndonjë vepër ose autor nga periudha e

viteve 1930, kryesisht përmes atyre pak nxënësve që shkolloheshin aso kohe në Shqipëri.

Pas Luftës së Dytë botërore (vitet 1950), krijuesit e parë të letërsisë shqiptare në Kosovë , për mbështetje kishin kryesisht letërsinë gojore (të pasur) dhe fare pak kishin vepra nga fondi letrar i traditës si dhe kishin fare pak përvojat e huaja letrare, në radhë të parë ato sllave.

Nga emrat e shkrimtarëve, të cilët e kishin filluar veprimtarinë e vet letrare para luftës, do të përmendim këtu vetëm Esat Mekulin , Hivzi Sulejmanin.

Esat Mekuli u shqua me lirikën e angazhuar shoqërore dhe kombëtare të shkruar gjatë viteve 1930, ndërsa Hivzi Sulejmani solli përvojën e parë më serioze në llojin e prozës së gjatë me romanin dy vëllimesh “Njerëzit I” dhe “Njerëzit II”, si dhe “Fëmijët e lumit tim”.

Para tyre Hivzi Sulejmani do të shkruante disa nga tregimet, që edhe sot tingëllojnë moderne.

Ishte poezia ajo që arriti majat e letërsisë shqiptare në Kosovë, duke filluar nga fundi i viteve 1950 e sidomos me emrat: Mark Krasniqi, Din Mehmeti, Fahredin Gunga, Rrahman Dedaj, Enver Gjerqeku, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Besim Bokshi, Eqrem Basha, Sabri Hamiti, Flora Brovina, Iljaz Prokshi, Afërdita Skënderi, Gani Xhafolli, Naim Kelmendi, Agim Vinca, Nuhi Vinca, Fahredin Shehu e shumë të tjerë.

Ndërsa në prozë dalloheshin: Anton Pashku, Ramiz Kelmendi, Azem Shkreli, Nazmi Rrahmani, Rexhep Qosja, Rexhep Hoxha, Mehmet Kajtazi, Mehmet Kraja, Ramiz Kelmendi, Shyqri Galica Adem Gashi, Musa

Ramadani, Iljaz Prokshi, Agim Vinca, Nuhi Vinca, Naim Kelmendi, Abdyl Kadolli, Gëzim Ajgeraj e disa të tjerë.

Edhe në Kosovë shumë shkrimtarë patën fatin të burgosen, të persekutohen apo të arratisen e të jetojnë jashtë truallit të tyre (Adem Istrefi etj).

Pushteti serb ushtronte dhunën më të egër ndaj intelektualëve që me pushtetin e fjalës përpiqeshin të afirmojn vlerat kombëtare shqiptare.

Kështu e pësuan rreptë nga kjo censurë: Adem Demaçi, Ramadan Rexhepi, Kapllan Resuli (i cili pasi u arratis në Shqipëri u burgos edhe këtu) etj.

Krahas letërsisë shqiptare që krijohet dhe botohet kryesisht në Prishtinë, ajo krijohet dhe botohet edhe në mesin e shqiptarëve të Maqedonisë, kryesisht me prozën dhe poezinë e Murat Isakut, Teki Dervishit, Abdylazis Islamit, e më pas, me veprën letrare të Resul Shabanit, Adem Gajtanit, Agim Vincës, Din Mehmetit etj.

Vlenë të përmendet dhe një personalitet i shquar i kulturës, Luan Starova, (shqiptari më i përkthyer sot pas Ismail Kadaresë etj), por shumica e veprave të tij nuk janë në gjuhën shqipe.

Letërsia moderne shqiptare në diasporë

Edhe pse e zhvilluar në kushte të një izolimi gjeografik e ideologjik, fati dhe perspektiva e letërsisë bashkëkohore shqiptare atë duhet ta vështrojmë edhe nga konteksti më i gjerë gjeografik, pra edhe përtej kornizës ngushtësisht nacionale.

Pavarësisht nga zhvillimet brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe brenda viseve etnike si: Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Luginë të Preshevës, Çameri ,kjo letërsi pati dhe njohu zhvillime dhe në diasporë.

Sa i takon zhvillimeve të saj në diasporë, letërsia shqiptare mund të shikohet gjeografikisht brenda dy vatrave: Vatra historike e diasporës shqiptare: Greqi, Rumani, Bullgari, Turqi, Danimarkë, Norvëgj, etj.

Vatra të reja të diasporës shqiptare: Itali, Francë, Zvicër, Gjermani, Danimarkë, Norvegji ,Shtetet e Bashkuara të Amerikës,Canadë etj.

Zhvillimet më të rëndësishme të letërsisë bashkëkohore shqiptare në diasporë ndodhën në Itali, aty ku sot e kësaj dite jetojnë rreth 90.000 arbëreshë, që vazhdojnë të flasin shqipen.

Në përgjithësi mund të thuhet se një “rilindje” e letërsisë arbëreshe ndodhi diku rreth fundit të viteve 1950, kur dhe nisi të botohej në Romë revista “Shejzat”nga Ernest Koliqi , e më pas revistat “Zgjimi”, “Katundi ynë”, “Zjarri”, “Zëri i Arbëreshëve”, “Lidhja”, “Bota shqiptare” etj.

Këto revista ndikuan në krijimin dhe publikimin e një brezi poetësh e shkrimtarësh që shkruanin në arbërisht.

Veç të tjerash, një pjesë e tyre funksionoi edhe si shtëpi botuese, duke publikuar vepra të tëra me poezi ,si dhe vepra të ndryshme letraro-publicistike.

Ndër shkrimtarët më të rëndësishëm të kësaj vatre duhen përmendur:Francesko Solano (1914), i njohur me pseudonimin Dushko Vetmo, i lindur në Kozencë.

Dushko Vetmo, pas një periudhe të gjatë qëndrimi në Argjentinë, Uruguai dhe Kili, ku dhe shugurohet për prift, Françesko Solano alias Dushko Vetmo, kthehet në vendlindje.

Ai ishte aktivë në shumë fusha letrare – ishte poet , prozator dhe dramaturg.

Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë : “Burbuqe t`egra,” 1946, “Shkretëtira prej gurit”(dramë, 1974), si dhe “Tregimet e Lëmit ” etj.

Domenico Bellizzi (1931), ishte prift nga Frasnita. Ai është i njohur me pseudonimin Vorea Ujko. Është një ndër trashigimtarët më të denjë të Jeronim De Radës si dhe të Zef Serembes.

Vorea Ujko alias Domenico Bellizzi me poezinë e tij arriti nivele të spikatura të ligjërimit poetik, veçanërisht me veprat: “Zgjimët e gjakut”, “Këngë arbëreshe”(1982),” Hapma derën zonja meme”(1990) etj.

Karmell Kandreva (1931), poet, bartës i identitetit kombëtar me anë të një ligjërimi poetik origjinal si dhe luftëtar i angazhimit social të arbëreshëve në ruajtjen e gjuhës dhe kulturës origjinale, ka shkruar triologjinë poetike: “Shpirti i arbërit rron”; “Shpirti i arbërit rron”, “Arbëreshi tregon”, “Vuan dega e hershme” etj.

Zef Skiro Di Maxhio (1944), poet, përkthyes dhe dramaturg i shquar. I angazhuar edhe si drejtor i revistës “Bota shqiptare”, i shquar për tonin e tij ironik e shpesh sarkastik, ai është autor i rreth dhjetë librave poetikë, ndër të cilat vlen të përmenden: Njëpër udhët e parrajsit shqiptare e t`arbreshë. Poemë gjysmëserioze arbëreshe si “Orëmira”, “Për tokën fisnike të Horës” etj.

Padyshim që letërsia arbëreshe vazhdon jetën me të tjerë shkrimtarë, shumica syresh të rinj, duke luajtur kështu një rol të rëndësishëm në diversitetin kulturor shqiptar, por edhe atë italian.

Një tjetër vatër e rëndësishme historike, ku kanë lulëzuar shkrimet shqipe që në fundin e shekullit XIX dhe ku jeta kulturore e elementëve shqiptarë ka qenë e organizuar më së miri, është Rumania.

Një ndër personazhet më të rëndësishëm të letrave bashkëkohore shqiptare është Viktor Eftimi (1889 – 1972) , autor i rreth njëqind vëllimeve letrare të shkruara në rumanisht.

Mjaftë prej veprave të tij dramatike janë ndërtuara mbi bazën e motiveve shqiptare e të fëmijërisë së tij në malet e vendlindjes.

Po aq e rëndësishme sa është edhe Rumania në pikëpamje të jetës kulturore shqiptare mbetet edhe Bullgaria, ku janë njohur organizime të hershme të komunitetit shqiptar.

Një figurë mjaft e rëndësishme në letërsinë tonë shqipe është edhe Thoma Kaçori, i cili shkroi në shqip disa romane e libra me tregime.

Në vatrat e reja të zhvillimit të letërsisë bashkëkohore shqiptare hyjnë ato vende në të cilat emigruan për motive kryesisht politike një pjesë e shkrimtarëve të talentuar shqiptarë, që duke mos u pajtuar me diktaturën dhe duke ndjerë etjen për liri, realizuan në periudha të ndryshme të regjimit komunist eksodet e sforcuara.

Një nga shkrimtarët e diasporës me peshë më të madhe që jetoi e krijoi në Gjermani, është Martin

Camaj (1925 – 1992). Vepra e tij hyë në fondin më të shquar të letërsisë bashkëkohore shqiptare.

Ndërsa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës zhvilloi veprimtarinë më të madhe studimore e letrare është Arshi Pipa (1920- 1997), një ndër punëtorët më të mëdhenj të letrave shqipe, intelektual i shquar, poet, përkthyes, studiues e polemist.

Më 1944 ai drejtoj revistën “Kritika” dhe po këtë vit botoi librin e parë me poezi Lundërtarë. Në SHBA, ku emigroi në vitin 1958, punoi si profesor në disa universitete amerikane deri sa doli në pension.

Si dëshmi e asaj që kishte përjetuar në kampet dhe burgjet komuniste ai botoi në Romë vëllimin me poezi “Libri i burgut 1959”, dhe më vonë dhe vepra të tjera.

Vlenë theksuar edhe një dyzinë shkrimtarësh dhe studiuesish letrarë që krijojnë në diasporë si Ernest Koliqi, Kostë Çekrezi, Gj.Bubani, S.Malëshova, Z.Fundo, Tajar Zavalani ,Eshref Ymeri, Rasim Bebo, Gjek Marinaj, Kolec Traboini, Agim Bacelli,Adnan Mehmeti,Kozeta Zylo, Raimonda Moisu,Iliriana Sulkuqi,Rita Salihu,Mëhill Velaj, Anton Kote, Sotir Andoni ,Peter Prifti, Dalan Luzi,Zef Pergega, Luigj Çekaj, Albana Mëlyshi, Ramiz Gjini, Dalip Greca ,Fatmir Terziu, Engjell Shehu, Gëzim Ajgeraj, Elvira Dones, Ornela Vorpsi, Anilda Ibrahimimi, Besa Myftiu ,Kozeta Nushi ,Hasan Aliaj , Shefqet Dibrani, Brahim Avdyli, Ymer Shkreli, Pal Sokoli etj.

Në gjuhë të huaj, por me tema shqiptare

Vlenë theksuar që në diasporë kemi disa poetë që shkruajnë në gjuhë të huaj .Ata medoemos duhet të

përfshihen në historinë e letërsisë shqipe apo duhet të konsiderohen pjesë e letërsisë së gjuhëve në të cilat krijojnë, shtrohet thujtse në të gjitha konferencat shkencore që zhvillohen në Tiranë, Prishtinë, Shkup, Tetovë.

Në Itali është prezent një numër bukur i madh i letrarëve shqiptarë që shkruajnë libra në gjuhën italiane me botimet e tyre, fare pak njihen në Shqipëri. Shkrimtarja rumune Herta Muller ,e cila shkruan në gjuhën gjermane do t'u drejtohej me këto fjale atdhetarëve të saj kur mori çmimin "Nobel" në letërsi:..." sepse dhe ne vetë mendojmë -se ata nuk janë shkrimtarët tanë"... "Atdheu është çka flitet" Fenomei i tillë është botëror , ku shqiptarët nuk kanë pse të jenë përjashtim.

Nuk është një proces i stisur apo i paramenduar. Ai lind së brendshmi dhe nuk është thjesht një proces normal i të shkruarit. Janë shumë shkrimtare të ekzilit , që po prezantohen me shumë sukses në botën letrare. Kësaj radhe veçojmë pesë shkrimtare femra.

Elvira Dones që botohet nga "Feltrinelli" dhe "Einaudi", Anilda Ibrahim, Ornella Vorpsi ("Einaudi") dhe Kozeta Nushi-Alikaj, janë katërshja e letërsisë shqiptare e mërgimit në Itali.

Kësaj katërshje i bashkohet edhe Besa Myftiu, që jeton në Zvicër e boton në Francë me logon e shtëpisë botuese të Parisit " Fayard".

Përtej faktit se shkruajnë në gjuhë të huaj dhe jo në gjuhën e nënës, ajo çfarë i bashkon këto shkrimtare është dhe tematika që trajtojnë në veprat e tyre.

Shkrimtaret tona shkruajnë , në veten e parë e here – herë në vetën e tretë.

Kjo gjë është gjithmonë e pranishme. E shkuara gjithashtu; fëmijëria nën diktaturë, mentaliteti, dramat sociale, zakonet dhe kanunet e vendit të origjinës janë pjesë e rrëfimeve në krijimtarinë e tyre. Tema të identitetit mbeten të preferuara për këto autore shqiptare, që jo rastësisht kanë zgjedhur të krijojnë në gjuhë të huaj...

“Shkrimi në gjuhë të huaj të jep liri, distancë” thotë shkrimtarja Besa Myftiu. Ajo për fat të keq historitë e saja nuk i shkruan në shqipen tonë të bukur.

Ndjehet e frustruar kur tenton të shkruajë në shqip. I druhet dhe paragjykimeve , ndaj ka zgjedhur rrëfimin në gjuhën frënge. Ajo është e bija e shkrimtarit Mehmet Myftiu. Besa Myftiu , ka botuar 9 libra në frëngjisht, i fundit është libri “Dashuri në kohën e komunizmit”, botuar nga “Fayard” në Francë.

Edhe shkrimtares Ornela Vorpsit gjithaq i nevojitej distanca për ta parë më qartë të shkruarën. Italishtja ishte për të një zgjedhje organike. Ajo thotë : “Po të kisha jetuar në Shqipëri, ndoshta nuk do isha bërë shkrimtare. Ishte ekzili që më tregoi këtë rrugë. Nuk ishte ndonjë zgjidhje për të tradhtuar Shqipërinë, siç më sulmojnë shpesh. Ishte një zgjidhje shumë organike. Duke menduar pse kisha nevojë të shkruaja në italisht, pashë se në mënyrë organike kisha nevojë për distancë nga ajo çka tregoj” (përfundon citati).

Ajo veten tashmë e sheh si shkrimtare në një vend të huaj e që shkruan po ashtu në një gjuhë të huaj.

Ornela Vorpsi vazhdon të shkruajë në gjuhë italiane, por siç thotë dhe vetë, në të njëjtën kohë mendon dhe flet katër gjuhë.

Gjuha e nënës mbetet gjuha e parë, sepse shqipja për të është gjuha që mbart kujtimet e fëmijërisë e për këtë ajo ndjehet thellësisht e tërësisht shqiptare. “Besoj se gjuha e romaneve të mia është një sintezë e shumë kulturave, e shumë gjuhëve të përzierja së bashku”.

Janë të paktë shkrimtarët që arrijnë të jenë kreativë në dy gjuhë të huaja, por Elvira Dones sigurisht që ia ka dalë. Ajo është shkrimtare, gazetare dhe dokumentariste, autore e shtatë romaneve, dy vëllimeve me tregimeve, artikujsh e filma dokumentarë.

Tema si prostitucioni, drama sociale, lufta etj., e kanë bërë Elvira Donesin shkrimtare të mirëpritur në qarqet letrare. Letërsinë e saj e shkruar në dy gjuhë; në gjuhën e nënës shqip dhe në gjuhën italiane. Raporti i saj me gjuhën që zgjedh për të shkruar fillon qysh kur libri nis të ngjizet.

Ajo thotë :“Është thelbësore atmosfera e fillimit, fjalitë e para ndoshta dhe një fjalë e vetme që “godet” në njëren gjuhë në vend të tjetrës”(përfundon citati). Pikërisht kjo i ndodhi Elvira Donesit kur shkroi romanin “Luftë e vogël e përkorë”, ritmi gjuhësor u krijua natyrshëm në gjuhën e saj të dytë, italishten.

“Pashë se kisha nisur rrëfimin në italisht edhe për një arsye tjetër, për të cilën me sa duket kisha nevojë: më shërbente si filtër mbrojtës”, thotë Dones .

Në këtë rast është “terreni” për të cilën shkruan ai që zgjedh gjuhën, për shkrimtaren Elvira Dones. Ajo ka

në proces dy libra; njërin të shkruar në gjuhën italiane dhe tjetrin në shqip, që shumë shpejt do të jenë në duart e lexuesve.

Edhe pse këto shkrimtare zgjedhin një gjuhë tjetër, bashkohen në një pikë: shfrytëzimi i temës së identitetit. “A ka nevojë të shkruaj në shqip për të rrëfyer Shqipërinë e sotme?”- bën pyetjen retorike Anilda Ibrahimimi.

I ka qëlluar shkrimtares Anilda Ibrahimimi të lexojë në shtypin shqiptar (online) sesi shqiptarët e fyejnë në komentet e tyre për zgjedhjen e italishtes si gjuhë letrare.

Ajo thotë : “Nuk ka asnjë akt tradhtie nga ana ime drejt gjuhës mëmë. Zgjedhjen time e shoh si përrallë të një personi të ndërgjegjshëm që e do gjuhën e vet në atë farë mënyre sa të hiqet mënjanë duke thënë: unë s’jam në gjendje, ka të tjerë që e bëjnë më mirë se unë, Shqipëria ecën përpara edhe pa mua! Nuk jemi të pazëvendësueshëm...”(përfundon citati).

Kjo është revolta e saj në përballjen për së largu me lexuesin shqiptar. Ndoshta për këtë arsye ajo edhe Ornella Vorpsi refuzojnë vazhdimisht që librat e tyre të përkthehen në gjuhën shqipe.

Ëndërr për poeten shqiptare Kozeta Nushi-Alikaj është” Të publikoj shpejt librin në italisht.Do të desha që edhe Italia, që në të kaluarën i ka bërë keq Shqipërisë, të mbështesë futjen e saj në Bashkimin Evropian.Dhe grekët, që besojnë të jenë ortodoks, janë kriminelë dhe duhet të jenë të parët që të dalin nga Bashkimi Evropian.”(përfundon citati).

Kështu pohon Kozeta Nushi – Alikaj, një 40 vjeçare shqiptare, që po bën 10 vjet në Itali .Impenjimi i saj, interesi i saj i lartë për politikën, zbulohet menjëherë nga fjalët që zgjedh, nga argumentet që përcjell.

Në politikën shqiptare, po edhe në atë botërore, të gjithë flasin me fjalë të shëmtuara, që në fakt duhet të zhduken nga fjalori; populli nuk është injorant, është vetëm i lodhur, i dhembin veshët. Unë mendoj se të mirët janë pak dhe hiqen mënjanë, duke mos dashur të ngatërrohen në politikë.

Kozeta ka lindur në Vlorë, e njohur në botë me portin e saj të rëndësishëm detar, po është rritur në Fitore.Është kristiane, ortodokse, po thjesht preferon të quhet bijë e Zotit. Dhe e prekur thellë në shpirt, e përлотur, me fjalët që i mblidhen lëmsh në grykë, shqipton me shpirt të plagosur: – Mendoj se Zoti e ka sakrifikuar Shqipërinë... Jemi të vegjël, po jemi shumë të fortë edhe pse për më shumë se 500 vjet kemi qenë të shtypur nën thundrën e të huajve. Jemi pak, por jemi si pikat e oqeanit.

Do të doja që edhe gratë të jenë të interesuara për letërsinë ,politikën, në mënyrë që bota të përmirësohet. Kozeta është e diplomuar në gjuhë ruse dhe gjuhë angleze. Ka bërë disa përkthime librash të rëndësishme, ka përkthyer Dostojevskin, Çehovin që ishin autor të ndaluar në Shqipëri, si dhe ka përkthyer autorë norvegjezë nga gjuha ruse.

Më i madhi pasion i Kozetës është shkrimi – më parë një dëshirë; tani që kam zbuluar impenjimin politik, është edhe një mision, – të cilit i dedikohet jo vetëm në

shqip, duke publikuar në italisht, falë mbështetjes së Carlo dhe Marina Salvadorit.

Kozeta, se shpejti do të botojë në italisht librin “Një jetë e mbetur ëndërr“.

Tashmë në qarkullim është libri poetik i autorës Kozeta Nushi –Alikaj “Rizgjimi i ëndrrave”nga Shtëpia Botuese “Rugova Art”-Prishtinë,2014.

Kohë më pare shkrimtarija shqiptare përktheu për herë të parë në shqip novelen e shkrimtarit rus F.M Dostojevski “E drojtura”(Krotkaja) të cilën e botoi Shtëpia Botuese “Aferdita & Omsca”-Tiranë.

Shkrimtari i mirënjohur Dritero Agolli,thotë: “Kisha kohë pa lexuar dicka kaq të bukur, – Pylli ynë po rrallohet, e ti do te jesh trashëgimtarja e vërtetë dhe e denjë e ditëve që do të vijnë,... e pendës që di të shkruaj kaq bukur shqip”,thotë Agolli për novelën e Dostojevskit “Krotkaja” e përkthyer nga Kozeta Nushi ,e cila ka studiuar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Tiranë, në Departamentin e Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike.

LETËRSIA KINEZE BASHKËKOHORE

Tetori njihet si muaji i letërsisë dhe për faktin se është muaji kur ndahen çmimet “Nobel”, ku përfshihet dhe letërsia.

Republika e Kinës si një vend me kulturë të lashtë dhe letërsi po aq të lashtë dhe bashkëkohore ka historinë e saj të çmimeve “Nobel”.

Në vitin 2012 shkrimtari kinez Mo Yan u bë i pari përfaqësues i letërsisë kineze i cili fitoi çmimin “Nobel”.

Bei Dao

Edhe poeti i njohur kinez Bei Dao u nominua më çmim “Nobel” për letërsi.

Bei Dao është emri i shkrimtarit kinezo-amerikan Zhao Zhenkai. Ndër poetët më të njohur kinezë të brezit të tij, ai shpesh konsiderohet si kandidat për Çmimin Nobel në Letërsi. Përveç poezisë, ai është autor i veprave të shkurtra artistike, eseistike dhe një kujtimore.

Si evoluojë ndër vite përvoja e autorëve kinezë me çmimin Nobel?

Mo Yan

Përpara shkrimtarit kinez Mo Yan, shkrimtari kinez Shen Congwen iu afrua Nobelit në vitin 1988, duke u nominuar në 5 pretendentët për çmimin prestigjioz, por vdekja e tij e pengoi në marrjen e çmimit “Nobel”.

Shen Congwen

Veprat e Mo Yan-it janë romane historiko-epike që karakterizohen nga realizmi halucinat , dhe të cilat përmbajnë elemente të humorit të zi. Ndër temat kryesore në veprat e Mo Yanit është pandryshueshmëria e lakmisë dhe korrupsionit të natyrës njerëzore, përkundër ndikimit të ideologjive. Ngjarjet e shumë tregimeve të tij ai i vendos në qytetin e lindjes Gaomin verilindor në provincën Shandong, të Republikës Popullore të Kinës, dhe ai përdor imazhe verbuese, komplekse dhe shpeshherë të dhunshme. Mo Yan thotë se e kuptoi se mund ti bënte “anëtarët e familjes, të njohurit, fashatarët...” personazhe të romaneve të tij, pas leximit të romanit *The Sound and the Fury* të shkrimtarit amerikan Wiliam Faulkner . Mo Yan satirizon me zhanrin letrar të Realizmit socialist Kinez duke i vendosur punëtorët dhe burokratët në situata absurde.

Shkrimet e Mo Yanit shquhen për dallimet e turbullta mes “të shkuarës dhe të ardhmes, të vdekurve dhe të gjallëve, si dhe të mirës dhe të keqes”. Mo Yan shfaqet në romanet e tij si personazh gjysmë-autobiografik që ritregon dhe modifikon rrëfimet tjera të autorit.

Personazhet femërore shpesh rebelohen ndaj roleve gjinore që i përcakton tradita si p.sh. në romanin “*Gjinj të mëdhenj, vithe të gjera*“, nëna e familjes Shangguan pasi dështon që t’i bëjë burrit djem, fillon ta tradhtojë me burra tjerë, duke mbetur shtatzënë me një misionar suedez, një ushtar japonez etj. Pushteti i meshkujve poashtu paraqitet në mënyrë cinike në po të njëjtin roman, ku ka vetëm një hero mashkull.

Më 11 tetor 2012, Akademia Suedeze e shpalli Mo Yanin laureat të Çmimit Nobel Për Letërsi me motivimin “me anë të realizmit halucionant i bën bashkë përrallat popullore, historinë dhe të tashmen”. Kur e fitoi çmimin në moshën 57 vjeçare, më 2012, ai u bë laureati i 109-të i tij, dhe i pari shtetas i Republikës Popullore të Kinës që e fitoi. Per Wästberg, anëtar i akademisë suedeze, në fjalimin e tij shpjegoi: “Mo Yan është poet që i shkul posterat stereotipikë të propagandës, duke e nxjerrë në pah individin nga një masë anonime e njerëzve. Me anë të talljes dhe sarkazmës, Mo Yan sulmon historinë dhe falsifikimet e saj, si dhe deprivimin dhe histerinë politike

Kreu i Akademisë Suedeze, Peter Englund tha në mënyrë më pak zyrtare: “Ai ka një stil tepër të veçantë të të shkruarit. Nëse lexon një gjysmë faqe nga Mo Yani, e njeh menjëherë se është e atij”

Në rregulloren suedeze të çmimit “Nobel”, çmimi nuk jepet autorëve pas vdekjes.

Librat e botuar të shkrimtarit kinez Mo Yani (Guan Moye) janë disa:

- *Klani i sorgumit të kuq* (1986)
- 《天堂蒜薹之歌》 *Baladat e hudhrave* (1988)

- 《十三步》 *Trembëdhjetë hapa* (1988)
- 《食草家族》 *Familja ime bimëngrënëse* (1993)
- 《酒国》 *Republika e verës: Një roman* (1993)
- 《丰乳肥臀》 *Gjinj të mëdhenj & vithe të gjera* (1995)
- 《红树林》 *Pylli i kuq* (1999)
- 《四十一炮》 *Pow!* (2003)
- 《生死疲劳》 *Jeta dhe vdekja po më lodhin* (2006)
- 《檀香刑》 *Vdekja dru sandali* (2008)
- 《蛙》 *Bretkosa* (2009).
- Në gjuhën shqipe janë përkthyer romanet:•*Bretkosa* (2013)Romani ‘Bretkosa’ është romani i parë i përkthyer drejtpërdrejt nga gjuha kineze në gjuhën shqipe.
- •*Ndryshime* (2014)
- •*Klani i Sorgumit të kuq*(2017)
- Shkrimtari Guan (lindi më 17 .02.1955) i njohur me pseudonimin Mo Yan, është shkrimtar kinez fitues i çmimit Nobel për letërsi në vitin 2012. Mo Yan është një shkrimtar shumë i popullarizuar, të cilin kritiku Donald Morrison , në revistën” TIME” e përshkruan si “njëri ndër më të nohurit, shpeshherë i ndaluar, dhe përgjithsisht në grupin e shkrimtarëve kinez të piratizuar”, ndërsa JIM LEACH e përshkruan si versionin kinez të FRANC KAFKËS dhe i JOSEPH HELLERIT . Për publikun perëndimor është bërë i njohur me romanin “Klani i sigurimit të kuq” botuar më 1986 në Kinë, i cili u adaptua edhe në verzionin filmik. Akademia Suedeze e cila Yanit ia ndau Nobelin në vitin 2012, e përshkruan Yanin si shkrimtar “I cili,

me realizmin e vet magjik, i lidh tregimet popullore, historinë dhe të sotmen moderne.”

LU XUN

Akademia suedeze e çmimeve Nobel ka vlerësuar kontributin e shkrimtarit Lu Xun në letërsinë kineze dhe e ka njoftuar atë nëse do të dëshironte të nominohej për këtë çmim në vitin 1927.

Përgjigja e tij ishte se “Liang Qichao nuk do ta pranonte këtë çmim ndaj as unë nuk jam i gatshëm për të përfituar këtë shumë parash”.

Lu Xun (*Tradicionale*: 魯迅, *e Thjeshtësuar*: 鲁迅, *Pinyin*: Lǔ Xùn), ishte pseudonimi i Zhou Shuren (*Tradicionale*: 周樹人, *i Thjeshtësuar*: 周树人, *Pinyin*: Zhōu Shùrén) (25.9.1881-19.10.1936) ishte një nga shkrimtarët më të mëdhenj së Kinës së shekullit XX. I konsideruar nga disa si themeluesi i letërsisë moderne kineze, ai shkruante në stilin baihua (白話) dhe në kinezishten klasike.

Punimet e Lu Xun-it u influencuan nga Lëvizja e 4 majit në atë pikë sa që u aklamua nga regjimi komunist mbas 1949.

Sipas tij Akademia suedeze e Nobelit, nuk duhet ta japë çmimin thjesht për të favorizuar Kinën, pasi kështu populli kinez do të ndjehej i fyer.

Lao She

Lidhur me popullaritetin e Lao She, mësohet se i biri Shu Yi ka deklaruar se shkrimtari Lao She duhet të ishte nderuar me çmim në vitin 1968, por Akademia Suedeze e çmimeve Nobel nuk arriti të komunikonte me të, pasi kishte ndërruar jetë në vitin 1966.

Shu Yi

Cmimi i atij viti iu dha shkrimatrit japonez Yasunari Kawabata.

Kjell Espmark

Në vitet e mëvonshme, njëri nga anëtarët e Komitetit të Çmimeve Nobel, pikërisht Kjell Espmark ka deklaruar se Akademia i kishte kërkuar shkrimtarit kinez nëse pranonte të nominohej për çmimin prestigjioz, por ai falë modestisë nuk kishte pranuar.

Kjell Erik Espmark ishte një shkrimtar suedez, historian i letërsisë, anëtar i Akademisë Suedeze dhe profesor i Historisë së Letërsisë në Universitetin e Stokholmit. Ai u zgjodh në Akademinë Suedeze më 5 mars 1981 dhe u pranua më 20 dhjetor 1981. Kjell Espmark pasoi gjuhëtarin Elias Wessén në vendin nr.16.

Lin Yutangu

Në vitin 1975, Lin Yutangu zgjodh zëvendëspresident i PEN International dhe të gjithë anëtarët ishin dakord të rekomandonin kandidaturën e tij për çmimin Nobel në emër të kësaj organizate. Ai u nominua por nuk arriti të përzgjidhej si fitues i Nobelit.

Në vitin 2000 Akademia suedeze e çmimit Nobel përzgjodhi Ba Jin për çmimin e vitit 2001.

Ai konsiderohej si një nga shkrimtarët më të shquar në letërsinë moderne kineze, pasi veprimtaria e tij letrare gjysmë shekullore kishte lënë gjurmë të mëdha në rrethet artistike.

Por vetë shkrimtari nuk pranoi ti jepej çmimi Nobel.

Mo Yan mbetet fituesi i vetëm i këtij çmimi deri me tash.

Në këtë kronologji të çmimeve “Nobel” për letërsinë dhe autorëve kinezë vërehet modestia e shumë shkrimtarëve kinezë ndër vite, të cilët kanë refuzuar çmimin, por dhe ndarja e dy prej tyre nga jeta, pa mundur që pas nominimit të merrnin çmimin e njohur.

Letërsia kineze bashkëkohore ka mjaft autorë veprat e të cilëve janë përkthyer në shumë gjuhë të botës letrare kineze po njihet dita-ditës nga lexuesit kudo dhe me siguri autorët kinezë do të jenë pjesë e listës së shkrimtarëve fitues të çmimit të Akademisë Suedeze “Nobel”.

“Pranë çdo burri të suksesshëm qëndron një grua”
Një fjalë thotë se “Pranë çdo burri të suksesshëm qëndron një grua”.

Kjo shprehje lidhet

me Thomas Christian Sudolf profesor i Universitetit amerikan të Standfordit, i cili ka fituar çmimin Nobel në vitin 2013 për fiziologjinë qelizore dhe molekulare.

Chen Lu

Kur mori çmimin ai ja dedikoi bashkëshortes kineze Chen Lu, profesore e asociuar e neurokirurgjisë, psikiatrisë dhe shkencave sociale pranë Universitetit amerikan të Standfordit.

Zoti Sudhof tha se “Bashkëshortja ime është një shkencëtare e mrekullueshme e cila më ka këshilluar gjatë gjithë karrierës sime shkencore dhe kjo ndihmë ka qenë vendimtare për mua.”

Sudhof është anëtar i bordit të Akademisë Kineze të Shkencave, pranë Institutit të Biofizikës në Pekin dhe shpesh udhëton në Kinë për shkëmbime akademike.

Zbulimi i profesorit Sudhof në fushën molekulare pritet të ndikojë pozitivisht në studimet e ndryshme të sëmundjeve nervore, ndër të cilat autizmi dhe skizofrenia.

E shoqja kineze, njëherësh akademike pranë Universitetit prestigjioz të Standfordit ka një kontribut të veçantë në nderimin e këtij shkencëtari me çmimin “Nobel”.

Në një intervistë ekskluzive për median kineze “Global Times” ajo ka treguar se ata si çift shkencëtarësh kurrë nuk i kanë dhënë rëndësi reklamimit në media të punës së tyre.

Për ta rëndësi të veçantë ka përgjegjësia shkencore ndaj publikut.

Ajo shton se komuniteti shkencor në SHBA vlerëson potencialin shkencor të Kinës, investimet e jashtëzakonshme në fusha të ndryshme të shkencës si dhe arritjet e shkencëtarëve kinezë.

Ndërsa nobelisti amerikan Sudhof shpreh besimin se shumë shpejt ndonjë shkencëtar kinez do të jetë fitues i Nobelit.

Ai e mbështet këtë besim në përvojën e tij të bashkëpunimit me institucionet kërkimore dhe shkencore të Kinës si dhe me arritjet e shumë prej shkencëtarëve kinezë në arenën ndërkombëtare.(E.Merepeza)

**LETËRSIA AMERIKANE NGA KOLONIALËT
BASHKOHOR DERI TË LETËRSIA ANTI-
TARDICIONALE, NË POEZI, PROZË DERI NË
POLITIKAT ANTI ESTABLISHMENTIT DHE AJO
BASHKOHORE (1939)**

Letërsia amerikane nuk lehtësisht i jep hua klasifikimit sipas periudhës kohore. Duke pasur parasysh madhësinë e Shteteve të Bashkuara dhe popullsinë e saj të ndryshme, shpesh ndodhin disa lëvizje letrare në të njëjtën kohë. Megjithatë, kjo nuk i ka ndaluar dijetarët letrar që të bëjnë një përpjekje. Këtu janë disa nga periudhat më të zakonshme të letërsisë amerikane nga periudha koloniale deri në të tashmen.

Periudha Koloniale (1607-1775)

Kjo periudhë përfshin themelimin e Jamestown deri në Luftën Revolucionare. Shumica e shkrimeve ishin të

natyrës historike, praktike ose fetare. Disa shkrimtarë që nuk mungojnë nga kjo periudhë përfshijnë Phillis Wheatley , Pambuk Mather, William Bradford, Anne Bradstreet dhe John Winthrop . Përshkrimi i parë i skllëvërve , *një tregim i vuajtjeve të pazakonta dhe çlirimi i zjarrtë i Hammonit britanik, një njeri i zezakët* , u botua në Boston në 1760.

Epoka Revolucionare (1765-1790)

Duke filluar një dekadë para Luftës Revolucionare dhe duke përfunduar rreth 25 vjet më vonë, kjo periudhë përfshin shkrimet e Thomas Jefferson , Thomas Paine , James Madison dhe Alexander Hamilton . Kjo është ndoshta periudha më e pasur e shkrimit politik që nga antikiteti klasik. Vepra të rëndësishme përfshijnë “Deklaratën e Pavarësisë”, *Dokumentet Federaliste* dhe poezinë e Joel Barlow dhe Philip Freneau.

Periudha e Hershme Kombëtare (1775 – 1828)

Kjo epokë në Letërsinë Amerikane është përgjegjëse për veprat e para të dukshme, siç është komedia e parë amerikane e shkruar për skenën – *Kontrasti* nga Royall Tyler, 1787 – dhe libri i parë amerikan – *Fuqia e simpatisë* nga William Hill, 1789. Uashingtoni Irving , James Fenimore Cooper dhe Charles Brockden Brown merren me krijimin e një fiction të veçantë amerikan, ndërkohë që Edgar Allan Poe dhe William Cullen Bryant filluan të shkruajnë poezi që ishin dukshëm të ndryshëm nga ajo e traditës angleze.

Rilindja Amerikane (1828 – 1865)

I njohur gjithashtu si Periudha Romantike në Amerikë dhe Epoka e Transcendentalizmit, kjo periudhë pranohet zakonisht të jetë letërsia më e madhe amerikane. Shkrimtarë të mëdhenj përfshijnë Walt Whitman, Ralph Waldo Emerson, Henry David Thoreau, Nathaniel Hawthorne, Edgar Allan Poe dhe Herman Melville. Emerson, Thoreau dhe Margaret Fuller merren me formimin e literaturës dhe idealeve të shumë shkrimtarëve të mëvonshëm. Kontribute të tjera kryesore përfshijnë poezinë e Henry Wadsworth Longfellow dhe tregimet e shkurtra të Melville, Poe, Hawthorne dhe Harriet Beecher Stowe. Përveç kësaj, kjo epokë është pika e inaugurimit të Kritikës Amerikane të Letërsisë, të udhëhequr nga Poe, James Russell Lowell dhe William Gilmore Simms. Vitet 1853 dhe 1859 sollin romanet e para afrikano-amerikane: *Clotel* dhe *Our Nig*.

Periudha Realiste (1865 – 1900)

Si rezultat i Luftës Civile Amerikane, Rindërtimit dhe Epokës së Industrializmit, idealet amerikane dhe ndërgjegjësimi vetë-ndryshuan në mënyra të thella dhe letërkëmbimi amerikan u përgjigj. Disa nocione romantike të Rilindjes Amerikane zëvendësohen me përshkrime realiste të jetës amerikane, të tilla si ato të përfaqësuara në veprat e William Dean Howells, Henry James dhe Mark Twain.

Kjo periudhë gjithashtu krijoi shkrime rajonale, siç janë veprat e Sarah Orne Jewett, Kate Chopin, Bret Harte, Mary Wilkins Freeman dhe George W. Cable.

Përveç Walt Whitman, një tjetër poet master, Emily Dickinson , u shfaq në këtë kohë.

Periudha natyrore (1900 – 1914)

Kjo periudhë relativisht e shkurtër përcaktohet nga këmbëngulja e saj për rikrijimin e jetës, pasi jeta është në të vërtetë, madje edhe më shumë sesa realistët në dekadat e mëparshme. Shkrimtarë të natyralizmit amerikan si Frank Norris, Theodore Dreiser dhe Jack London krijuan disa nga romanet më të fuqishme në histori letrare amerikane. Personazhet e tyre janë viktima që bien pre e instinkteve të tyre bazë dhe faktorëve ekonomikë dhe sociologjikë. Edith Wharton shkroi disa nga klasikët më të dashur të saj, si *“Custom of the Country”* (1913), *Ethan Frome* (1911) dhe *House of Mirth* (1905) gjatë kësaj periudhe kohore.

Periudha Moderne (1914 – 1939)

Pas Rilindjes Amerikane, Periudha Moderne është mosha e dytë më me influencë dhe e pasur artistikisht e shkrimit amerikan. Shkrimtarët e saj të mëdhenj përfshijnë poetë të tillë si EE Cummings, Robert Frost , Ezra Pound, William Carlos Williams, Carl Sandburg, TS Eliot, Wallace Stevens dhe Edna Shën Vincent Millay . Novelistë dhe shkrimtarë të tjerë prozë të kohës përfshijnë Willa Cather, John Dos Passos, Edith Wharton, F. Scott Fitzgerald, John Steinbeck, Ernest Hemingway, William Faulkner, Gertrude Stein, Sinclair Lewis, Thomas Wolfe dhe Sherwood Anderson. Periudha Moderne përmban brenda saj disa lëvizje të mëdha duke përfshirë Epokën e Xhazit, Rilindjen e

Harlemit dhe Gjeneratën e Humbur. Shumë nga këta shkrimtarë u ndikuan nga Lufta e Parë Botërore dhe zhgënjimi që pasoi, veçanërisht emigrantët e Gjeneratës së Humbur. Për më tepër, Depresioni i Madh dhe Marrëveshja e Re rezultuan në disa prej shkrimeve më të mëdha sociale të Amerikës, siç janë romanet e Faulkner dhe Steinbeck dhe drama e Eugene O'Neill.

Gjenerimi i Beatit (1944 – 1962)

Shkrimtarët Beat, të tillë si Jack Kerouac dhe Allen Ginsberg, ishin të përkushtuar ndaj letërsisë anti-tradicionale, në poezi dhe prozë, dhe në politikat anti-establishment. Kjo periudhë kohore pa një rritje në poezinë dhe seksualitetin e rrëfimit në letërsi, gjë që rezultoi me sfida ligjore dhe debate mbi censurën në Amerikë. William S. Burroughs dhe Henry Miller janë dy shkrimtarë veprat e të cilëve ballafaqohen me sfida të censurës dhe të cilët, së bashku me shkrimtarët e tjerë të kohës, kanë frymëzuar lëvizjet kundërkulturore të dy dekadave të ardhshme.

Periudha Bashkëkohore (1939 – E pranishme)

Pas Luftës së Dytë Botërore, literatura amerikane është bërë e gjerë dhe e larmishme në aspektin e temës, mënyrës dhe qëllimit. Aktualisht, ka pak konsensus se si të bëhet klasifikimi i 80 viteve të fundit në periudha apo lëvizje – ndoshta më shumë kohë duhet të kalojë, para se studiuesit të mund t'i bëjnë këto përcaktime. Kjo është thënë, ka një numër të shkrimtarëve të rëndësishëm që nga viti 1939,

veprat e të cilëve tashmë mund të konsiderohen si “klasike” dhe që ka të ngjarë të bëhen kanonizuar. Disa nga këto janë: Kurt Vonnegut, Amy Tan, John Updike, Eudora Welty, James Baldwin, Sylvia Plath, Arthur Miller, Toni Morrison, Ralph Ellison, Joan Didion, Thomas Pynchon, Elizabeth Bishop, Tennessee Williams, Sandra Cisneros, Richard Wright, Tony Kushner, Adrienne Rich, Bernard Malamud, Saul Bellow, Joyce Carol Oates, Thornton Wilder, Alice Walker, Edward Albee, Norman Mailer, John Barth, Maya Angelou dhe Robert Penn Warren.

Letërsia amerikane, më e rëndësishmja në botë Shkrimtari amrikan Philip Roth, kandidat për çmimin “Nobel” për letërsi, vjen në një rrëfim për romanin e tij më të ri “Përrulja”, ndërsa flet edhe për debatin e nisur mbi veçimin e kulturës amerikane, si edhe mbi Presidentin Obama, të cilin ai e mbështeti Philip Roth tani gjendet në shtëpinë e tij në Upper West Side. Është një apartament me një elegancë të madhe, i mbushur me aparatura teknologjike, gjë kjo që nuk pritej. Sapo është kthyer nga shtëpia në Connecticut, ku kaloi verën, duke mbushur dhe kompletuar romanin e ri, i cili së shpejti pritet të dalë në Amerikë nën titullin “The Humbling”, (“Përrulja”) duke nisur kështu menjëherë rrugën drejt një romani tjetër të ri, të cilit nuk ia ka vendosur ende emrin. Më parë, pat thënë se e ndjente shumë peshën e pleqërisë dhe se kishte një ndjesi boshe për ëndrrat e tradhtuara dhe për humbjen e njerëzve të dashur. Me këtë prodhim konstant librash duket sikur i përgjigjet para së

gjithave një ndjesie gabimi, por kjo prodhimtari është para së gjithash mënyra krenare për të përkufizuar veten dhe të përjetësojë nëpërmjet krijimtarisë konceptin e vet të ekzistencës. Kur i thua se gjatë intervistës do të preket edhe tema e polemikave mbi veçimin e dyshuar të kulturës amerikane, ai reagon me një buzëqeshje plot habi. “Nuk arrij të kuptoj se cili është argumenti i kësaj polemike”, më shpjegon duke tundur kokën. “Ndonjëherë të vjen të pyesësh madje edhe se përse diskutohet mbi një gjë të tillë. Por unë parapëlqej të flas për ato që shkruaj dhe do të shikosh që nëse e nisim kështu do ta prekim edhe atë argument”. Përujta për të cilën flet titulli i romanit të tij të fundit lind nga një çmagjepsje e hidhur: Roth është një shkrimtar tepër i pastër dhe i qartë për të rënë pre e dobësisë së keqardhjes, por fletët lënë të shfaqet një unazë prekëse që na thotë se jeta është më shumë se vetëm një mister i dhimbshëm. “Shumë më kanë pyetur se si unë kaq papritmas shkrova për një personazh të ri në moshë”. Dhe nuk shton gjë tjetër, por çohet prej kolltukut për të treguar një foto ku shfaqet me një uniformë ushtarake, e shkrepur gjatë kohës së luftës në Kore. Është pikërisht periudha në të cilën zhvillohen ngjarjet në roman dhe në foto Roth ka të njëjtën moshë me protagonistin e romanit Marcus Messner. “Gjatë kohëve të fundit kam shkruar vetëm për të moshuar”, tregon e sakaq fikson fotografinë, “dhe ja ku të rrëfej se isha pak i lodhur me këto personazhe. Kësaj here doja të tregoja një histori të paeksperiencë dhe dëshpërimi të një periudhe historike që kemi tendencë ta harrojmë. Unë u bëra

pjesë e atij konflikti të tmerrshëm, por që për fat të mirë ajo luftë mori fund para se të nisesha”. Si ndodhi që edhe një herë ju zgjodhët të sillnit në vëmendjen e lexuesit një tregim me nisje erotike dhe konflikte me botën akademike? Më interesonte të tregoja shtypjen seksuale, atë që ndodhte para viteve ‘60. Ngjarjet zhvillohen në një kolegji, ku ofrohen edhe elemente të tjera shtypjeje e konfliktesh, edhe pse më duhet të them se si docent unë kam pasur një eksperiencë interesante. Dyshoj se ndonjë do të ketë guxuar ndonjëherë t’ju krijojë probleme. Mbi këtë pikë nuk do të dëshiroja të komentoja. Them vetëm se më kanë dhënë liri atëherë kur vendosa të nisja një kurs mbi Bellow dhe Kafkën. Dy shkrimtarë që u analizuan për kontrast të njëri-tjetrit. E njëjta gjë ndodhi edhe për sa u përket kurseve mbi autorët francezë, si Mauriac, Celine dhe Gide. Gjatë përballjes me dekanin e universitetit ju e cilësoni “indinjatën” si fjalën më të bukur të gjuhës angleze. Nuk është se domosdoshmërisht këtë e mendoj edhe unë, por them se ishte një cilësim i duhur për psikologjinë e protagonistit të romanit tim, gjithaq e duhur edhe për atë moment tensionimi. Marcus është një hebre konservator që gjendet në një ambient protestantësh dhe dashurohet me një “shiksa”, një “të edukuar”. Olivia është para së gjithash një vajzë e bukur, tërheqëse, me një shpirt të lirë. Kur nisa të shkruaj për të nuk e kisha menduar që ajo mund të kishte elemente kaq dramatike. Personazhi është zhvilluar së bashku me romanin deri sa mbërriti në dëshpërimin e vet. Rritja është gjithnjë një akt shkëputjeje? Nuk jam

edhe kaq kategorik. Varet nga prindërit dhe nga fëmijët. Ju mendoni se është thelbësore të luftosh dhe të përulesh, por në librat tuaj përvojat shkaktajnë të tjera dhimbje. Është thelbësore të luftosh për lirinë që ka një vlerë të patjetërsueshme, por si e tillë mbart me vete edhe probleme, plagë dhe dhimbje. Megjithatë, eksperiencat sjellin edhe kënaqësi dhe jeta e përditshme na mëson edhe të kundërtën: shumë njerëz nuk luftojnë aspak dhe duken të lumtur me të mos ndryshuarin. Advertisements REPORT THIS AD Marcus “gjen belanë” kur refuzon të frekuentojë shërbesën fetare, duke shpjeguar që zgjedhja nuk lind prej faktit që është një hebre i vëmendshëm, por sepse është një ateist i zjarrtë. Është një përkufizim që ju shkon për shtat edhe juve? Unë jam ateist, por nuk e ndiej të nevojshme të përdor termin i “zjarrtë”. Ndërsa Marcusi i ri me sa duket e ndjen këtë nevojë. Në “The Humbling”, romanin që sapo e keni bërë publik për shtypin, protagonistin është sërish një i moshuar. Është një aktor teatri, 64 vjeç, që zbulon se nuk di më të aktrojë. Është një histori mbi dramën e të zbuluarit, që papritmas nuk ke më talent. Një tjetër ngjarje e hidhur, e shënjuar nga një humbje. Do të të them që unë kështu e shikoj jetën? Mjaftojnë librat për ta thënë. Por çfarë mendoni për polemikën mbi veçimin e kulturës amerikane? Është një polemikë kaq qesharake saqë nuk arrij as ta kuptoj. Unë mendoj që letërsia amerikane, nga pas lufta e deri në ditët tona, ka qenë më e rëndësishmja në botë me autorë si Faulkner, Hemingway dhe Bellow. Edhe në ditët tona kemi shkrimtarë të rangut të parë, si Don DeLillo, E.

L. Doctorow, Cynthia Ozick, Joyce Carol Oates, apo Toni Morrison. Ndihem i shoqëruar nga kolegë të shkëlqyer. Ju nuk e keni fshehur asnjëherë një lloj shkëputjeje ndaj filmave që janë ndërtuar mbi romanet tuaja. Nuk është ndonjë sekret i madh që unë nuk jam entuziast për atë që është bërë me romanet e mi.

Por dua të jem i qartë: mendoj se kinemaja është një lloj arti aspak inferior në krahasim me letërsinë dhe mendoj se ekzistojnë filma të mirë dhe të këqij, ashtu si romane të mirë dhe të këqij. Për shembull, kohët e fundit kam parë “L’heure d’été” i Oliver Assayas që mu duk shumë i bukur. Një vit më parë keni thënë se mbështesnit fitoren e Obamës. Sot ndiheni i kënaqur? Shumë. Më ka ardhur shumë mirë dhe vlerësoj atë që po bën dhe po tenton të bëjë....

SHËNIME PËR ZEF ZORBEN

Zef Zorba lindi më 1920 në Kotorr të Malit të Zi në një familje shqiptare.

Mbas mbarimit të gjimnazit në Shkodër, më 1941 regjistrohet në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, dega e Studimeve Politike në Universitetin e Padovas në Itali.

I ndërpret studimet më 1943 për shkak të Luftës së Dytë Botërore dhe kthehet në Shkodër, ku fillon punën si nëpunës banke.

Në vitet 1945-1946 punësohet si regjisor në Shtëpinë e Kulturës së Shkodrës, ku vë në skenë mjaft pjesë dramatike me tingëllim të qartë desident si “Juda Makabe” e Fishtës, “Armiku i Popullit” i Ibsenit etj.

Ndoshta edhe për këtë arsye arrestohet më 1946 dhe burgoset nën akuzën e agjitacion e propagandës. Vuan dënimin ndër kampet e punës dhe “riedukimit” deri në vitin 1951.

Më vonë punon ndër ndërrmarrje të rrethit të Shkodrës si llogaritar deri në vitin 1980, kur dhe del në pension.

Ndërron jetë më 6 janar 1993 në Shkodër. Në heshtjen e thellë të këtij gjysmëshekulli, Zorba, i pajisur me një kulturë të mrekullueshme vizatoi figurën e intelektualit të vërtetë, larg kompromiseve.

Zef Zorba është një nga poetët më të shquar të letrave shqipe të gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë, pra e asaj periudhe që në mënyra të ndryshme është quajtur si kohë e komunizmit shqiptar.

I arrestuar në moshën 26 vjeçare, bashkë me gruan e tij të re, pas lirit nga burgu, pesë vite më pas, më 1957, ai, natyrë e ndjeshme artistike si rrallëkush, e kuptoi se rruga e vetme e tij në art nuk mund të ishte veçse ajo e mënjanimit dhe e mbylljes në vetvete.

Ai zgjodhi rrugën e krijimit të poezisë që nuk do të shihte dritën e botimit. Një poezi pa lexues, është një vepër pa jehonë, që nuk shkon te të tjerët dhe as sjell prej të tjerëve asgjë.

Zef Zorba zgjodhi hermetizmin, si formën më natyrale që i shkante poetit me atë fat. Ai është nga të rrallët poetë shqiptarë, që bëri eksperimente avanguardiste, aq pak të pranishme në poezinë shqipe. Një nga këto është synimi për një martesë të lumtur të poezisë dhe muzikës, duke gërshetuar teknikat e tyre. Ndërkaq, ky pasion i tij për avanguardizmin, nuk pengon që herë pas here, pas vargjeve të tij të ndihet fryma dhe ritmika e Dantes.

E njëjta frymë zotëron në përkthimet e tij që nga Ungareti te T. S. Eliot. Dalja nga mjegulla e Zef Zorbës,

ashtu sikurse e të përjashtuarve të tjerë, për të zënë vendin e tyre në mozaikun e riparuar të letrave shqipe të shekullit XX, do të sjellë drejtpeshimin e munguar në këto letra.

Kështu ka shkruar Zef Zorba në një vjershë të datës 29 mars të vitit 1975, mu në mesin e natës totalitare.

Të njëjtën poezi të trishtueshme ai e mbyll me vargun: “Veç drita s’ka mbarim”. E kjo do të thotë se edhe kur ka qenë i ligështuar në shpirt, në thellësi të tij ai ka besuar se perdja do të ngrihej përsëri e, për rrjedhojë, akti do të vazhdonte.

“Buzë të ngrira në gaz”, është libri i vetëm i botuar nga poeti brilant Zef Zorba. I botuar për herë të parë në vitin 1994, vetëm një vit pas vdekjes së poetit dhe i kaluar thuajse në heshtje të plotë, ky vëllim poetik vjen sërish në duart e lexuesve, si një ribotim i përmirësua dhe një mundësi reale për ta zbuluar këtë poet të veçantë.

Libri, i cili harkon sipas autorit vitet 1945–1980, në variantin e përmirësuar (që del në qarkullim këto ditë nga shtëpia botuese “Princ”), përfshin edhe një poemë krejt të panjohur e të pabotuar më parë: “Baladë dritash për Lalin”, e shkruar më 29. 03.1975.

Zef Zorba , është një poet antologjik. Ai ka refuzuar të botojë në kohën e diktaturës dhe refuzimin e kishte estetik. Ndërkohë që gjithë poetët e tjerë merreshin me poezinë totalitare, ai ka përkthyer poetët më të mëdhenj të shekullit njëzet, si Ungareti, Montale, Kuazimodo, Eliot, Frost, etj, përkthime këto që Zorba i ka lënë si libra të përfunduar, gati për botim”. “Zorba është një zë i vetmuar në shkretëtirën e asaj kohe.

Poezia e tij është e rrallë në të gjithë Evropën Lindore, pasi në asnjë nga vendet ish-komuniste nuk është shkruar në këtë mënyrë dhe s'ka pasur refuzime të kësaj natyre si rasti i Zorbës. Kjo është edhe një lloj rezistence që ta jep vetëm talenti dhe arti i vërtetë, një rezistencë thuajse biblike që ka lidhje edhe me qytetërimin perëndimor të cilit i përket fort Zef Zorba.

Vepra

Libri i tij i parë, Buzë të ngrira në gaz, u botua pas vdekjes pasi kishte shkruar tinëz përgjatë diktaturës komuniste në Shqipëri, cilësuar si “letërsia e sirtarit”. Çmohet si një poet i veçantë i letërsisë shqiptare dhe përfaqësues kyç i modernizmit dhe hermeticizmit.

Është cilësuar ndër autorët klandestinë me Kasëm Trebeshinën, Daut Gumenin, Primo Shllakun që në qerthullin e vogël të tyre rimerrnin fillin e këputur të vazhdimësisë së letërsisë shqiptare dhe e rimëkëmbnin lidhjen me autorë si Mitrush Kuteli, Ernest Koliqi e Lasgush Poradeci.

DINJITETI I HUMBUR

Jorge Francisco Isidoro Luis Borges do t'i mjaftonte vetëm një fjali për ta dhënë mrekullisht thelbin e dinjitetit: “Individ dinjitoz është ai që ia del të jetë në paqe me veten dhe me të tjerët”.

Thënia e njohur e Immanuel Kantit se “Individi pa dinjitet s'mund të prodhojë vepra dinjitoze”, duket që u përket atyre postulateve që s'vjetrohen kurrë, pavarësisht konotacioneve që mund të fitojë fjala “dinjitet” në kohërat moderne apo postmoderne.

Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, përmes një shprehje fare pak dinjitoze, jepen dy shpjegime të fjalës “dinjitet”: 1. Tërësia e vlerave morale të njeriut a të një grupi njerëzish (nderi, krenaria etj.); vetëdija që ka njeriu a një grup njerëzish për këto vlera e për të drejtat e veta në shoqëri dhe nderimi i tij për vetveten; shfaqja e jashtme e kësaj vetëdije dhe e këtij nderimi.

Dinjiteti kombëtar.

Dinjiteti i njeriut (i familjes, i ndërmarrjes, i institutit). Me (pa, plot) dinjitet. Ngre (ul, fyen, merr nëpër këmbë) dinjitetin. S'ka pikë dinjiteti. Flet (sillet) me dinjitet. 2. Cilësia e mirë a vlera e lartë e diçkaje që e bën atë të çmohet. Me dinjitet artistik. Vepër plot dinjitet.

A ka dinjitet shkrimtari i sotëm shqiptar?

Jo pa dhimbje, derisa flas edhe për veten më duhet të përgjigjem (zë-ulët): “Jo”.

Si për ta ngushëlluar veten dhe kolegët e mi, po shtoj se problematika në fjalë, domethënë “dinjiteti i humbur i shkrimtarit” duket së është një shqetësim mbarë-kombëtar çka lidhet, me siguri, me “dinjitetin e humbur” të vetë letërsisë.

Sipas studiuesit Ridvan Dibra ”Konsumizmi i shfrenuar, triumfi i imazhit, realitetet elektronikë, ekspansioni i medias etj. duket se vërtet ia kanë lëkundur letërsisë dinjitetin e dikurshëm”.

(Në parantezë, gjithherë e kam fjalën për autorë dhe letërsi serioze, që rreken t’u rezistojnë kohërave dhe ndërrimit të përvitshëm të modave).

Amerikani, Joseph H Bloom njëri ndër emrat më të lavdishëm të kritikës letrare bashkëkohore, shprehet plot dhimbje: “Talentet e mëdha janë shurdhuar një herë e mirë nga realiteti i medias amerikane.

Kush mund t’i rivalizojë me parodi lajmet e televizorit, gazetës dhe fjalimet e qeveritarëve?

Realiteti amerikan është më grotesk dhe më qesharak se cilado parodi, sado e mirë qoftë...”. (Kur realiteti

amerikan paraqitet i tillë, imagjinojeni tonin, të dashur miq).

Të dënuar të përballen e të jenë pjesë e një realiteti të tillë, disa prej shkrimtarëve shqiptarë bashkëkohorë (post-modernë që të gjithë!) duket se kanë zgjedhur rrugën më të lehtë e më të shkurtër: e kanë hequr nga vetja e tyre dinjitetin, sikur ai të ishte zorrë qorrë a diç tjetër e panevojshme.

Kujt i është shitur dinjiteti?

Së pari, pikërisht asaj për të cilën kanë nevojë më shumë. Asaj që të bën të njohur e “person publik” edhe pse mund të kesh botuar vetëm dy-tre tekste të dyshimtë. Asaj që të bën të famshëm e delirant, deri edhe në ëndrra me Nobel. Asaj “lubie” që për ta shuar urinë e vet të përditshme, “gëlltit çorbën” e gatuar prej lloj-lloj grafomanësh e sharlatanësh. Domethënë medias.

Argumente?

– Shikojeni paraqitjen e shkrimtarëve nëpër gazeta ditore, ekranet televizivë: herë fodullë e herë kinse shpërfillës, teksa për hir të pranisë mediatike dëshmohen të gatshëm të debatojnë e diskutojnë për lloj-lloj argumentesh e problematikash jashtë fushës së dijeve të tyre, domethënë jo letrare.

(Para disa ditëve , një poet i lakuar bashkëkohor fliste plot kompetencë për avantazhet e centraleve atomikë).

– Lexuesi i pasionuar i lexon intervistat apo auto-intervistat e tyre nëpër faqet kulturore të përditshmeve tona: megalomani e neveritshme, vetëmburrje e

vetëvlerësime foshnjarake, mungesë e plotë etike, modestie e qytetarie.

“Kur flet libri, autori duhet të heshtë”, përsëriste para pak kohësh postulatit e njohur të filozofit gjerman me origjinë polake Friedrich Wilhem Nietzsche:” Merrni pjesë në promovimet për çdo libër të botuar: seanca të bezdisshme hipokrizie mes “miqsh të gotave dhe të femrave” e që fill të nesërmen media e unshme i bën publike.

– Shfletoni librat e botuar: foto autorësh delirantë e me pamje profetike (kujtesë: post-modernizmi nuk e pranon autorin-profet), shënime entuziaste në kapakët e pasmë, që do ta skuqnin nga turpi edhe vetë Xhejms Xhojsit (James Joyce) për shembull etj.

Shkrimtari bashkëkohor shqiptar (përsëri u kërkoj ndjesë përjashtimeve) duket i etur për njohje e famë, qoftë edhe për një “filxhan lavdi”.

Dhe këtë lavdi (i yshtur, si duket, edhe nga ndonjë rast pararendës) kërkon ta arrijë sa më shpejt e më lehtë, duke e konsideruar punën e tij kryesore, domethënë punën e mundimshme me tekstin letrar, si punë të dorës së dytë. Kurse parësore për të bëhen:

1. paraqitjet e vazhdueshme mediatike në gazeta dhe televizionet tona ;
2. pjesëmarrjet nëpër lloj-lloj mitingjesh e festivalesh letrarë anë e kënd Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Globit;
3. radhitja e sa më shumë çmimeve të fituara (jo pak të dyshimtë e fiktivë) etj.

Këtë situatë sipas Ridvan Dibrës “ në thelb tragjikomike – të letrave tona pas viteve 1990, e “favorizojnë” edhe dy mungesa extra, tipike shqiptare:

1. Mungesa thujtë e plotë (uluritëse kjo mungesë!) e kritikës letrare, e cila, kuptohet nëse do të ekzistonte, mund t’ia dilte (ndoshta?) t’i “ulte gjelat që këndojnë majë togut të tyre plehut” dhe të nxirrte në pah vlerat e mirëfillta letrare-estetike.

2. Mungesa e plotë e organeve të specializuara letrare, estetike e kritike (me siguri, duhet të jemi i vetmi vend në botë me një mungesë të tillë!), ku shkrimtarët mund të botonin, diskutonin e debatonin mes vedi dhe jo të silleshin si futuristët e para 100 viteve, duke i mbajtur mëri njëri-tjetrit e duke u zënë me grushte klubeve”, thotë Dibra.

E megjithatë, humbjen e dinjitetit ndër shkrimtarë nuk e justifikon asnjë mungesë apo situatë, sado të pafavorshme qofshin ato. Sepse pasojat kanë filluar të duken. Gjithnjë e më shumë po shtohen zërat (dashakeqë e nostalgjikë), që rreken t’ia mohojnë çdo vlerë letërsisë shqipe të pas viteve 1990, duke e vendosur bile në rrafshet krahasuese me realizmin socialist.

Gjithashtu, të gjitha sjelljet që përmenda më sipër e që dëshmojnë mungesë dinjiteti nga vetë shkrimtarët shqiptarë, ftohin dhe largojnë edhe më lexuesit seriozë. Dhe besoj që një dukuri e tillë bëhet e dhimbshme sidomos për ata shkrimtarë të përkushtuar, që kanë dhënë e vazhdojnë të japin vlera të qëndrueshme e të spikatura letrare (Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Kongoli, Fatos Kongoli, Eshref Ymeri, Bardhyl

Londo,Xhevahir Spahiu, Fatos Arapi,Zija Çela, Visar Zhiti,Fatmir Terziu,Skënder Buçpapaj,Mujë Buçpapaj, Izet Duraku, Përparim Hysi,Agron Shele,Amiko Kasaruho,Fatime Kulli,Raimonda Moisiu,Rexhep Shahu, Albana Nexhipi,Zef Pergega, Edmond Tupja, Ema Andrea, Elona Tabaku,Rasim Bebo, Ferida Ramadani-Zmijani,Vullnet Mato,Mimoza Hysa, Ligor Shyti,Flutura Aça, Jerida Kulla, Eljan Tanini, Fran Ukcama, Linditë Ramushi Dushku, Rami Kamberi, Raimonda Maleçka, Vjollca Tiku Pasku, Riza Lahi, Andi Meçaj, Lisjana Demiraj, Kabil Bushati, Rexhep Qosja, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Ibrahim Rugova, Ramiz Kelmendi, Din Mehmeti, Adem Gashi, Flora Brovina, Qerim Ujkani, Reshat Sahitaj, Naim Kelmendi, Skënder Zogaj, Shyqri Galica, Rushit Ramabaja, Migena Arllati, Kadrush Radogoshi, Dibran Fylli, Mehmet Kajtazi, Anton Pashku, Ruzhdi Baloku, Sejdi Berisha, Halil Haxhosaj, Iljaz Prokshi, Akil Koci, Adem Zaplluzha, Nebih Bunjaku, Musa Ramadani, Mehmet Kraja, Zejnullah Rrahmani, Bilall Maliqi, Bedri Zyberaj, Shefqet Dibrani, Nazmi Rrahmani, Xheladin Çitaku, Xheladin Mjeku, Begzad Baliu, Zeqir Fazliu, Agim Desku, H. Berisha, Mentor Thaqi, Musa Jupolli, Esat Loshaj, Hydajet Hyseni, Rexhep Ferri, Gëzim Ajgeraj, Makfire Maqedonci-Canolli, ...etj).

E përsëris se dinjiteti i shkrimtarit bashkëkohor paraqitet problematik edhe ndër shoqëritë tjera më civile se e jona.

Porse aty nuk mungojnë edhe aktet e qëndresës e të sfidës. Sa për ilustrim, po përmend vetëm dy shembuj.

Shkrimtari i famshëm çek Milan Kundera (01.04.1929) ka më shumë se 33 vjet (1982) që nuk jep intervista, i bindur tashmë në hipokrizinë dhe artificialitetin që ato, shpeshherë, përmbajnë në vetvete.

Kurse novelisti amerikan Thomas Ruggles Pynchon (08.05.1937-), njëri prej zërave më interesantë të narratives bashkëkohore amerikane (natyrisht post-modern!), ka publike vetëm një foto të hershme në internet, kurse gazetarët që i kërkojnë intervista, i përzë me të shara.

Jam i bindur se ithtarët e post-modernes mund t'i konsiderojnë si donkishoteskë këto raste, duke shtuar se statusi i shkrimtarit ka ndryshuar dhe nuk është si ai i para 100 viteve.

Por nuk e besoj që ka pasur, ka dhe do të ketë ndonjë epokë, kur statusi i shkrimtarit përcaktohet nga bjerrja e dinjitetit të tij.

Nga shkrimtarët e pas viteve 1990, përveç një letërsie cilësore e ndryshe, (vepra të tilla nuk mungojnë) kam pritur e besuar edhe në akte dinjiteti e qytetarie, duke iu kundërvënë kësisoj pararendësit famëkeq realizëm socialist, që u shqua pikërisht për mungesë dinjiteti e qytetarie.

Nëse fillimet dukeshin premtuese e shpresëdhënëse, tashti e pohoj me dhimbje se ndihem i zhgënjyer.

Thjesht ndërrim diktaturash, më duket. Nëse dje dinjiteti i shitej apo i falej diktaturës komuniste, sot i shitet apo i falet “diktaturës mediatike”. Kurse vitet 1930, ku mund të gjenim jo pak modele dinjiteti e

qytetarie edhe ndër shkrimtarë, duken gjithnjë e më të largët.

Mediat dhe televizionet tona ngrenë pyetjen: Sa dhe si vlerësohen shkrimtarët dhe poetët në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Lindore, dhe a kanë ata një lloj statusi?”

Hedhja e këtij “asi” në tryezë, në mos qoftë thjesht sa për të fituar një emision a një intervistë në TV tona apo gazete, më shumë, duket se është njëfarë ndihme që media jep që shoqëria të kuptojë diçka më shumë se ç’ndodh dhe ç’pretendohet në këtë kohë dhe në këtë klimë të përgjithshme “mosvëmendjeje ndaj shkrimtarit, librit dhe leximit”.

Ndonëse vetë do të këshilloja që mediat tona elektronike, të shkruara etj., në vend të pyetjeve retorike, të krijojnë më shumë hapësirë, duke shtuar fletë apo kohë televizive për letërsinë, përsëri grishem t’i përgjigjem kësaj pyetjeje, që në të vërtetë edhe para përgjigjes sime ka njohur qindra përgjigje e rrugëzgjdhje të mbetura në rrafsh konstatimi dhe utopie.

E formuluar në kohë, pra “sa dhe si vlerësohet shkrimtari sot” kjo pyetje të bën të mendosh përmes opozicioneve dje-sot, këtu-atje, Lindje-Perëndim, si dy modelet ku shkrimtari vendoset përballë shoqërisë dhe pret që ajo të reagojë me vlerësim, shpërfillje apo thjesht të hyjë në komunikim të natyrshëm.

Për të qenë të besueshëm duhet të kujtojmë edhe atë fazë të jetës krijuese ku shkrimtarët e Lindjes (përfshi këtu edhe shkrimtarët shqiptarë nga Kosova dhe Shqipëria) u krekoseshin shkrimtarëve të Perëndimit

se kishin gjithçka falas dhe të garantuar: shërbim mjekësor falas, arsimim falas, shtëpi falas, studio falas, piano, penela e bojëra, pushime dhe leje krijimtarie të garantuar një herë në vit dhe botime të sigurta, njëlloj si dhe honorarët.

Njëra anë e balancës, duket haptazi, qe plot. Ana tjetër e balancës kishte vetëm një njësi, himnizimin e kësaj parajsë e cila përmes letërsisë së ideologjizuar, më shumë se përmes vetë indologjisë, bëhej jo vetëm e besueshme, por e dashur dhe e ëndërruar, duke krijuar edhe në mungesë lirie të shprehuri idiolatrinë mbi “statusin shoqëror të shkrimtarit”.

Të gjorët shkrimtarë të Perëndimit!

Ndiheshin të dëbuar nga kjo parajsë! Atyre u mungonte, siç dhe u mungon statusi. Por modeli i shkrimtarit të Lindjes tanimë ka rënë dhe ka mbetur vetëm ai i shkrimtarit përballë një shoqërie vlerash përfshi këtu edhe ato të tregut.

Të mësuar me atë gjendje, falsiteti më shumë sesa vërtetësie, iluzioni më shumë sesa serioziteti, shkrimtarët shqiptarë, sidomos pjesa më e madhe e atyre që i kanë jetuar të dy kohët, por jo pak edhe nga ata që krijimtarinë e kanë nisur pas viteve 1990, ndihen keq dhe ankohen për mungesën e statusit shoqëror (kupto shtetëror).

Këtë “nostalgji për status” ata kërkojnë ta paguajnë jo vetë, por t’ua paguajë shoqëria e cila prej tyre jo rrallë etiketohet si turmë lexuesish të padenjë, që gati-gati nuk i meriton shkrimtarët e saj të mëdhenj. Por në vend të presin që dikush të bëjë diçka për ta,

shkrimtarët nuk mund të jenë të kënaqur me gjendjen mazokiste të rënies së lirë që po pëson “esnafi” i tyre.

Ankesat për mungesë statusi dhe vëmendjeje tingëllojnë si një vetëlinçim publik. Kjo për faktin e thjeshtë se “esnafi” i shkrimtarëve, sipas atyre që shoh e dëgjoj çdo ditë, për mua rezulton se është më i përfaqësuari në Shqipëri e më pak në Kosovë.

Shkrimtarët (ose të ngjashmit) prej vitesh i gjemë këshilltarë në Presidencë, në Kryeministri, në Ministri të Arsimit, Ministri të Kulturës, e në të tjera ministri që nuk kanë lidhje me kulturën. Ata i gjemë drejtues institucionesh kulturore, anëtarë bordesh ku miratohen strategji, projekte, politika e tekste për lexim.

Ata janë pjesë e kryesive dhe kolegjiemeve të medieeve tona. Janë dhe kanë qenë parlamentarë, ministra, profesorë, dekanë, rektorë profesorë e gjer tek mësues të thjeshtë. Ata janë pra të kudondodhur.

Studiuesi Arian Leka thotë “Atëherë kujt ia kërkojnë shkrimtarët “statusin” dhe përse u duhet ai? Kujt i adresohen dhe a nuk e kuptojnë se ndodhen para pasqyrës sa herë që flasin për statuse shkrimtarësh dhe mungesë vëmendjeje nga shoqëria e cila pret t’i shohë ata sa më pak të rreshtuar nën modelin shkrimtarë të të gjitha llojeve bashkohuni”?

Në sesionin letrar të FNP “Drini poetik”, që mbahet çdo here më 8 e 9 qershor në Prishtinë-Prizren- ka krijuar hapësira multimediale që kanë të bëjnë me çështje të procesit letrar po aq edhe me raportet e letërsisë me realitetin ideologjik nën diktaturë dhe më vonë, me një kohë të re ku shkrimtari e humbi pozitën mbështetëse

të mecenatit shtetëror i cili ishte njëfarësoj edhe “porositësi” i veprës së artit.

Letërsia shqipe nuk ka pasur fatin e letërsive të tjera. Shtrohet pyetja”.

Po nëse shkrimtari “vdes” në momentin që libri është në duar të lexuesit”, Fatos Kongoli jep këtë përgjigje: “Unë jetoj me një libër derisa sa e përfundoj së shkruari. Mendoj se kur botohet, ai nuk është më imi.” Por ai e shikon të arsyeshme rishikim e një vepre gjatë ribotimeve. Kjo është diçka që ai vetë e ka bërë.”

Dhe kur bëhet fjalë për rishikimin e veprave dhe korrigjimet e asaj që ke shkruar edhe dyzet vjet përpara, një shembull për t’u komentuar është shkrimtari Ismail Kadare i cili në një deklaratë të tij pohon se kjo lidhet me procesin letrar në kushtet e mungesës së lirisë së shkrimtarit.

Unë kam parasysh atë çka Ismail Kadare ka thënë në një intervistë se gjella e burgut paskesh dalë më e mirë për një numër arsyesh.

“Nuk e kam kuptuar se çfarë ka dashur të thotë Kadare. Gjella e burgut që ha tjetri gatuhet më mirë apo gjella e burgut që ha vetë.”, shton shkrimtari Visar Zhiti.

Si kanë ndryshuar shijet e lexuesit?

Ajo që ne quajtëm liri ka ndryshuar jo vetëm për krijuesin, por dhe për lexuesin. Tashmë shkrimtarët tanë janë një hap me lexuesin evropian.

Ne Kosovë, Shqipëri etj., jemi fatlum në krahasim me mjaft vende të tjera sepse kemi më shumë lexues.

Shkrimtari Zija Çela thotë “Nuk besoj se do të kem shpëtuar pa ndonjë kompromis të këtij lloji, për një fragment apo një fjalë të shkruar. Një shembull: si vjen letërsia. Në vitin ‘84 kam qenë në Kukës dhe kam shkruar një roman, “Burrat nuk dalin nga lufta”.

Po të botohen sot katër recesionet e saj kohe, është krejt ndryshe.

Përfundimi i recesioneve dhe i redaksisë ishte “Sipas Zija Çelës burrat kanë dalë nga lufta”, nuk quhej më një roman dekadent. Në vitin ‘90 ka qenë një kohë e ethshme për të botuar shkrime të cilat nuk ishin botuar, aq më tepër të dokumentuara me recesione.

Kuptova se ai që ishte kundër këtij botimi, tani isha unë, sepse kishin kaluar vite dhe nëse ideologjia është afatshkurtër, beteja estetike është e përjetshme. Standarti gjithmonë krijon më shumë hapësirë për komunitetet, por e ngushton hapësirën e individit.

Thelbi i një shkrimtari është individualiteti i tij, që të jetë i ndryshëm nga të tjetër. Nëse censura në vendin tonë tashmë është lënë mbrapa, ajo që nuk lihet mbas është autocensura.

Gara me veten është preferenca ime. Por mund të them se e kemi ende të mangët kulturën e leximit, kuptohet se faktorët mund të jenë të natyrshëm. Ruajtja e kulturës së leximit është e domosdoshme.

Natyrisht që ndryshimi është shumë i madh. Por ka dhe një ndryshim tjetër që e sfumon këtë ndryshim, pasi njeriu e krijon lirinë brenda vetes.

Mund të jesh i burgosur dhe mund të jesh i lirë në mendime. Mund të jesh i lirë, por je i burgosur pasi nuk mendon ashtu siç duhet. Në këtë kuptim dhe para

dhe pas nëntëdhjetës shkrimtarët kanë pasur privacionet e tyre. Madje mund t'u ketë kushtuar shumë shtrenjtë.

Kjo situata paradoksale në sistemet diktatoriale ku ndodh që të lindë letërsi më e madhe se në sistemet e lira.

Letërsia nuk është thjesht produkt shoqëror, produkt i një sistemi, por është produkt i një grupi individual.

Pra vepra e një shkrimtari mbetet pavarësisht sistemit, thotë Çela dhe shton: "Këtu janë dy gjëra krejt të ndryshme.

Nuk mund të bëhet krahasimi sepse tirazhet e atëhershme i botonte shteti dhe shteti i blinte. Në kuptimin që vërtet mund të botoheshin librat në njëzet mijë kopje, por shumicat i blinin prapë bibliotekat.

Autori nuk paguante gjë, dhe merrte vetëm një honorar simbolik.

Ndërsa sot, për ata libra që shiten, kemi një shtije reale. Kjo nënkupton faktin se i boton shtëpia botuese dhe i blen publiku.

Si kanë ndryshuar shijet e lexuesit?

Lexuesi është i informuar, vërtet nuk botoheshin shkrimtarë bashkëkohorë kontemporanë, por letërsia e madhe botohej dhe atëherë sepse botoheshin klasikët Homeri, Servantesi, Shekspiri, Tolstoi, etj. Janë shkrimtarët që formojnë shijet, por mungonte pjesa më e madhe e letërsisë.

Këta autorë e formonin shijen atëherë, e formojnë dhe sot. Kur flasim për shije të mirëfillta, mund të themi se

dhe sot kërkohen këto botime. Kërkohet gjysma e modernistëve, ajo pjesë që mungonte.

Por në rast se sot kërkohen shkrimtarë të një letërsie komerciale, atëherë kjo është një gjë tjetër sepse ndodh në të gjithë botën.

Nuk është shija e vërtetë, shija e mirëfilltë. Vërtet Daniele Steel në të gjitha vendet shitet me miliona kopje, por është një letërsi e ditës, një letërsi kalimtare etj.

Dhe krejt në fund theksojë se ka shkrimtarë që nuk kanë bërë kompromise. Të gjithë e kanë bërë kompromise , për pjesë të vogla të cilat duhet të hiqnin apo duhet të shtonin, por e kanë bërë.

Kohë më pare në një intervistë për Radio Radicale, radio kombëtare dhe politike në Itali ambasadori i Bashkimit Evropian në Tiranë, Ettore Sequi shprehet lidhur me nismën e tij në dialogun me shkrimtarë, artistë, filozofë të cilët ndajnë me ambasadorin pikëpamjet mbi integrimin evropian të Shqipërisë.

Duke iu referuar bashkëbisedimit me shkrimtarin e mirënjohur shqiptar, Ismail Kadare, Sequi shprehet se i ka mbetur në mendje shprehja e shkrimtarit ku thotë: “Evropa është shteti natyral i Shqipërisë, i vetmi shtet! Kështu besoj se kjo gjë është pak a shumë perceptimi i të gjithë shqiptarëve. Shqipëria është një vend shumë filo-Evropian.”

Lidhur me personazhin e dytë që ambasadori do të ftonte në bashkëbisedim, Sequi nuk jep një emër konkret por shprehet se do të jetë “një personalitet jo shqiptar dhe shumë i njohur në botën globale.”

I pyetur nga gazetari Artur Nura se a ka dialog mes palëve politike në vendin tonë, ambasadori i kujton politikanëve shqiptarë se “dialog nuk simbolizon monologë të ndryshëm të palëve.”

Duke iu referuar integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, diplomati thotë se “Ballkani dhe në zë të veçantë Shqipëria është duke bërë shumë progres, megjithëse me një seri vështirësish.”

Ambasadori flet edhe për raportet dhe interesat, përgjegjësinë e BE-së për zgjerimin e saj me Ballkanin dhe veçanërisht Shqipërinë.

Ismail Kadare që është një evropian i bindur i botës shqiptare, por që është edhe shkrimtari më i mirë shqiptar, ndoshta edhe në dimensione Ballkanike dhe jo vetëm.

Midis të tjerësh, ka qenë së fundi edhe në listën e shkurtër të konkurrentëve të Çmimit Nobel për letërsinë.

Kështu pra, më duhet të them se pata idenë e këtij dialogimi për të arritur të kuptoja se çfarë një personazh domethënës mendon në lidhje me Evropën dhe të ardhmen Europiane të Shqipërisë.

Kështu kam dashur të shpjegoj dhe dua të shpjegoj, për shembull në intervistën me Kadarenë në mënyrë të kthjellët, se çfarë në fakt, presin shqiptarët nga Evropa.

Një frazë nga ky bashkëbisedim më ka mbetur thellësisht në mendje, Kadare më tha: Evropa është shteti natyral i Shqipërisë, i vetmi shtet! Kështu besoj se kjo gjë është pak a shumë perceptimi i të gjithë

shqiptarëve. Shqipëria është një vend shumë filo-Evropian.

Kadare është një shqiptar evropian. Ai jeton si në Tiranë ashtu edhe në Paris, por unë besoj që na nevojitet të dimë se cili do të jetë personi i dytë që do të vazhdojë këtë dialog me ju?

Sugjerojë publikisht që politikanët tanë, nuk duhet të kenë një diplomë formale universiteti, por duhet të kenë edhe njohuri minimale në lidhje me filozofinë politike perëndimore, pra të njohin minimalisht veprat e Tomas Hobbes, John Lock, (François-Marie Arouet) Volterit dhe Jean-Jacques Rousseau, apo Konrad Adenauer, Alice De Gasperi, Robert Schuman, Altiero Spinali, vizionarët e historisë që frymëzuan Bashkimin Evropian.

Markezi thotë “s’kam dashur që librat e mi të kenë fatin e sanduiçeve. Letërsia e sanduiçeve është letërsia rozë e një gjuhe fakirfukareshë dhe të shterpët. Letërsia e madhe, ku bën pjesë edhe Hrabali, s’ka asnjë lidhje me të. Për mua ka dy lloj letërsie.

Letërsia e fabulës dhe letërsia e stilit. Tek kjo e dyta fabula është thjesht një pretekst. Tek Hrabali i gjejmë të mpleksura të dyja. Duhej ruajtur kjo veçori e veprës së tij. Pastaj ç’është përkthyesi tjetër, në mos po fjalë? Volteri, Borges dhe Pamuk ftillojnë se te secili prej nesh ekzistojnë dy, ose më shumë qenie të tjera. Kësisoj unë s’kam pse të mos ta besoj që ekziston një Hrabal i hedhur nga dritarja me të shtatë macet e tij, por edhe një tjetër që mund ta ketë vrarë veten i lodhur prej vanitetit njerëzor...

**DY FJALË PËR “LEKSIKONIN ENCIKLOPEDIK” TË
AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE ARTEVE
SHQIPTARE AMERIKANE**

Leksikon enciklopedik i Akademisë Shqiptare Amerikane : shkencë, art, kulturë, letërsi / FloriBruqi. – Prishtinë : Flomed, 2020. – 531 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “PjetërBogdani”

929(=18)(038)

ISBN 978-9951-415-08-8

Botimi i parë i “Leksikonit enciklopedik ” për akademikët e Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptare Amerikane etj,shpresojmë që do të plotësojë zbraztësitrat në zhvillimin e shkencës, kultures dhe letërsisë shqiptare, ngase një doracak të tillë nuk ka ekzistuar.

Pas tranzicioneve demokratiuke në trojet shqiptare dhe diasporë zhvillimi i shkencës,letërsisë, artit etj., mori hov si kurrë më parë.

28 Nëntori i vitit 1995 shënonoi këthesë historike për themelimin e Akademisë së Shkencave Shqiptaro-Amerikane në New York. Themelues të Akademisë janë Prof.Dr.Skendër Kodra,Dr.Ulvi Vehbiu,Dr.Adem Harxhi,Dr.Namik Shehu, Mentor Mata,Sanie Selita etj.

Akademia në fakt është një institucion mbarë kombëtar ngase ka anëtar nga Prishtina dhe Tetova e Presheva,nga Tirana, Shkodra Gjrokastra..., dhe Diaspora.

Bashkarisht në këtë Akademi organizuam një së si aktivitetesh shkencore dhe kombëtaresi fjala vjenë Konferenca kushtuar 600 vjetorit të lindjës së Heroit kombëtar Gjergj Kastriot Skenderbeut ,70 vjetorit të lindjës së shkrimtarit të shquar Ismail Kadare.

Konferenca për gjuhën e njësuar shqipe, ku senator i gjuhës dhe cultures kombëtare prof.Peter Prifti mbrojti me argument origjinale rëndësinë historike të Kongresit të Drejtëshkrimit në Tiranë 1972,kundër qëndrimeve subjective, politike dhe antishkencore të profesor Arshi Pipës.

...Akademia e Shkencave dhe Arteve Shqiptare Amerikane në Nju Jork punimet e tyre shkencore i kanë botuar në revistën shkencore të Akademisë “Dituria”.

Ndërsa në vitin 2019 kjo Akademi i botoi dhe përuroi në Prishtinë dy libra të autorëve nga Kosova: Dibran Fylli”Tokë e mbjellë në Varre”(Krimet Serbe në Kosovë 1998-1999) si dhe libri i Jahja Llukës “Përmbledhje shkrimesh”.

Është përgatitur për botim libri i parë “Leksikon enciklopedik”, i cili sadopak do ti plotësojë zbrazëtësitat që janë hetuar në zhvillimin e shkencës, letërsisë, artit, kultures etj. ngase një doracak i tillë biografik dhe bibliografikë deri me tash nuk ka ekzistuar.

Shkencëtarët dhe shkrimtarë tanë etj., edhe pse jetuan dhe krijuan në rrethana të caktuara, ata identitetin e tyre kombëtar e dëshmuuan me veprat e tyre, me përmbajtjet e veprave, me personazhet, me ambientin, e madje edhe me deklaratat e tyre së janë shqiptarë.

Gjatë shkrimit të këti doracakut për 4 vjet pandërprerë na kanë përcjellë edhe probleme të ndryshme në grumbullimin, verifikimin dhe sistemin e të dhënave. Rritja në numër e anëtarëve të Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencës dhe Artit me seli në Nju Jork, Tiranë, Prishtinë e Shkup, ka sjellë prej kohësh nevojën e një enciklopedie ku të pasqyrohet kontributi i anëtarëve të kësaj Akademie që jetojnë në trojet shqiptare dhe në Diasporë. Libri “Leksikon enciklopedik” vjen si një kontribut i çmuar i kësaj akademie që nga themelimi i saj vitin 1995 e deri më sot.

Pas një pune të mundishme dhe të suksesshme autori më bashkëpunëtorët e tij ka arritur që t'i japë lexuesit Enciklopedinë biografike dhe bibliografike të akademikëve të Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencës dhe Artit si dhe disa intelektualëve tjerë që kanë lënë gjurmë në shkencë, letërsi dhe art.

Në këtë mënyrë kemi një tablo të plotë të këtyre autorëve dhe veprave të tyre në Shqipëri dhe Kosovë, Maqedoni dhe Malin e Zi, në Luginën e Preshevës, Medvegjës, Bujanocit, Çamerisë dhe në Diasporë.

Autori së bashku me Stafin redaksional ka punuar me dashuri dhe përkushtim në mbledhjen e këtyre biografive dhe bibliografive të këtyre njerëzve të shquar të trojeve shqiptare dhe të Diasporës.

Shumë prej tyre nuk rrojnë më, ndaj dhe marrja e informacionit ka paraqitur vështirësi. Mirëpo këmbëngulja e tyre ka bërë që asnjë prej këtyre anëtarëve të Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve të mos mungojë, madje të mos mungojë asnjë vepër e tyre.

Kjo tregon seriozitet dhe përgjegjësi, kur merr përsipër të shkruash vepra të përmasave të tilla madhore.

Nuk kanë hyrë në “Leksikon enciklopedik” ata që nuk kanë vepra shkencore, letrare etj., të botuara si dhe ata që nuk i kanë dërguar më kohë biografite dhe bibliografite e tyre.

Njerëzit e interesuar do të kenë mundësinë të njihen jo vetëm me shtrirjen gjeografike ku veprojnë këta autorë, por dhe prurjet shkencore që ata kanë sjellë në të gjitha fushat e dijes njerëzore.

Ky libër enciklopedik do t`u vijë në ndihmë mësuesve dhe nxënësve, pedagogëve dhe studentëve, kërkuesve të rinj shkencor dhe gjithë atyre që janë të interesuar të thellojnë dijet e tyre.

Bashkëveprimi dhe shtrirja gjeografike ku veprojnë këta autorë ka sjellë një përbashkim të vlerave të

krijuara, kanë nxitur njëri-tjetrin për t'u thelluar më tej në fushat ku ata krijojnë apo hulumtojnë.

Rezultatet kanë qenë të kënaqshme dhe lexuesi do të shohë prurjet e secilit autor në fushën përkatëse, sidomos në mjekësi,inxhinieri ,shkenca ekzakte, letërsi dhe albanologji, të cilat lidhen drejtpërdrejtë me identitetin e kombit tonë i cili në rrjedhë të mijëvjeçarëve ka lënë gjurmët e tij.

Ka qenë dhe është detyrë e anëtarëve të kësaj Akademie të thellojnë punën kërkimore shkencore në fushë të Shkencave ekzakte ,mjekësisë ,teknologjisë , albanologjisë duke shkuar në thellëi të mijëvjeçarëve.

Kjo Enciklopedi është hartuar në mënyrë të tillë që nga lexuesi i zakonshëm e deri te studiuesit e fushave të ndryshme të kenë mundësinë që të njihen me arritjet e secilit autor dhe të për zgjedhin prej tyre atë që ata kërkojnë.

Ajo duke patur biografinë dhe bibliografinë e një numri të konsiderueshëm autorësh ka përfshirë të gjitha fushat e dijes duke filluar me arritjet në shkencat natyrore dhe veçanërisht në fushën e mjekësisë, në albanologji dhe gjuhësi, në histori dhe filozofi, në art dhe letërsi, në ekonomi dhe në çdo sferë tjetër të dijes njerëzore.

Artikujt dhe studimet e këtyre autorëve përfshijnë figurat më të rëndësishme historike që u kanë dhënë emrin e tyre ngjarjeve më kulmore të historisë sonë.

Kjo enciklopedi përfaqëson një vepër shkencore. Në kumtesat dhe studimet e këtyre autorëve do të gesh botën shqiptare në të gjithë dimensionin e saj historik nga lashtësia deri në ditët e sotme.

Kjo vepër ka identitet të spikatur kombëtar. Autorët që përfshihen në këtë botim enciklopedik kanë sjellë kontribute të rëndësishme në shkencë dhe arte, sidomos arritjet në fushë të mjekësisë, teknologjisë , jurispondencës , ekonomisë , albanologjisë etj.

Një nga figurat qendrore të kësaj akademie ka qenë kryetari i saj prof. dr. Skëndet Kodra, Ph.D i cili mundi të përbashkojë dijen shqiptare dhe më gjerë, të shtrirë në pesë shtetet ballkanike ku shqiptarët janë pjesë e rëndësishme e tyre dhe në Diasporë dhe që ky kontribut shqiptar po ngrihet vazhdimisht drejt nivelit botëror.

Tashmë Akademia Shqiptaro-Amerikane e Shkencave dhe e Artit me seli në Nju Jork, Tiranë, Prishtinë e Shkup është bërë epiqendra e mendimit akademik që prodhohet në trojet shqiptare duke sjellë gjallëri dhe freski në fushë të artit dhe shkencave.

Akademia Shqiptare Amerikane e Shkencave dhe Arteve është mbështetur fort mbi arritjet e deri tanishme të dijetarëve shqiptarë, i ka parë kontributet e tyre akademike si arritje të çmuara dhe i ka vlerësuar vazhdimisht.

Por çdo arritje është njëkohësisht pikënisje nga ku fillon e ngrihet një arritje tjetër. Në këtë kuptim, duke ruajtur vlerën e arritur, janë bërë përpjekje për arritje të reja dhe që këto kontribute akademike janë të rëndësishme sidomos në fushë të Mjekësisë ,Albanologjisë etj.

Albanologjia ende nuk e ka thënë fjalën e saj përfundimtare, sepse kërkohen studime të thelluara në gjuhësi dhe antropologji, në histori dhe arkeologji,

në besimet pagane që emërtohen pellazgjike dhe që kanë bashkëjetuar me shqiptarët deri në ditët e sotme. Akademia Shqiptare Amerikane e Shkencave dhe Arteve, si akademi e trojeve shqiptare dhe e Diasporës u ka dhënë një ndihmesë të çmuar shkencave ekzakte dhe atyre shoqërore, veçanërisht në fushë të Albanologjisë, ku gjithnjë e më shumë, anëtarët e kësaj akademie kërkojnë të depërtojnë në atë histori që nga historianët quhet parailire.

Nëse për grekët historia para helene apo pellazgjike është e dokumentuar prej autorëve të antikitetit dhe helenët nuk kanë patur asnjë lidhje gjenetike me pellazgët; shqiptarët e sotëm ruajnë tradita dhe zakone që e kanë zanafillën nga ajo periudhë që autorët e antikitetit i emërtojnë pellazgjike siç është adhurimi për lirinë e shenjtë apo adhurimi për malin e Tomorit që kanë qenë rite që kanë përcaktuar identitetin e asaj popullsie që quhej pellazgjike.

Disa nga studimet që janë marrë me periudhat para ilire janë të nivelit akademik dhe përbëjnë arritje të këtij institucioni në botën akademike shqiptare.

Disa nga arritjet e Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve, kanë prekur në thellësi sferat e dijes njerëzore, aty pasqyrohet qartë identiteti ynë kombëtar, autoktonia e shqiptarëve në trojet e veta, marrëdhëniet me popujt e tjerë prej të cilëve ka dhënë dhe ka marrë çfarë shoqëria njerëzore ka arritur në shkencë dhe arte dhe që kanë shërbyer për një ecje të sigurt të njerëzimit drejt progresit dhe përparimit shoqëror.

Aty do të gjesh të pasqyruara marrëdhëniet e popullit tonë nga qytetërimet e lashta mesdhetare deri në ditët e sotme.

Në studimet e autorëve që janë marrë me historinë e shqiptarëve dhe të trojeve të tyre del në dukje se uniteti i shqiptarëve ka patur në themel tolerancën dhe harmoninë midis tyre, tipare që janë manifestuar në të gjitha fushat e jetës.

Në këtë enciklopedi do të gjesh autorë me veprimtari të gjerë dhe me vlera të spikatura në fushën e mjekësisë, teknologjisë ,biznesit , gjuhësisë të cilat konsiderohen studime të mirëfillta shkencore duke i dhënë një shtysë të mëtejshme shkencës shqiptare në veçanti .

Raportet e gjuhës shqipe me gjuhët e popujve fqinj, që nga antikiteti deri në ditët e sotme janë dëshmi e sigurt e ekzistencës së shqiptarëve në trojet ku jetojmë sot që nga kohët parahistorike. Këto studime gjuhësore janë shoqëruar me një dokumentacion të pasur dhe me burime të drejtpërdrejta nga autorë shqiptarë dhe të huaj që janë marrë me origjinën e shqiptarëve dhe gjuhës shqipe.

Letërsia shqipe është gjetur në këto vitet e fundit në kuota të lartësuar që qëndrojnë denjësisht përkrah letërsisë botërore. Ajo shkruhet brenda trojeve shqiptare, por dhe jashtë tyre në Diasporë.

Pavarësisht se ku shkruhet dimensionin i saj artistik ka rrokur gjithë dimensionin e hapësirës botërore.

Ajo troket në çdo portë ku brenda saj ka një qenie njerëzore që lufton për ta bërë botën më të bukur dhe më të mirë.

Letërsia shqipe i ka kapërcyer kufijtë e trojeve të saj, çmohet e vlerësohet ngado, në çdo veprimtari që ka brenda saj përmasën botërore.

Personazhet e letërsisë shqipe aq sa individualizojnë njeriun e shtrirjes gjeografike ku ata veprojnë, po aq lehtësisht u përgjigjen vlerave universale që mbart njeriu i kohëve moderne.

Veprat e artit, sidomos piktura, kanë shtegtuar anë e kënd botës dhe kanë përcjellë botën e pasur shpirtërore të shqiptarit, model nëpër kohra i shpirtit paqësor dhe liridashës.

Në këtë leksikon enciklopedik ku përfshihen më shumë se 300 autorë të trojeve shqiptare dhe Diaspora janë përfshirë të gjitha fushat e dijes njerëzore.

Do të gjesh personalitete të spikatura me kontribute shkencore dhe artistike që janë ngritur vazhdimisht drejt nivelit evropian dhe botëror.

Duke lexuar bibliografitë e këtyre autorëve lexuesi do të gjejë fushën e interesit të tij, do t`u drejtohet lehtësisht bibliotekave dhe librarive.

Ky botim do ta bëjë më të lehtë punën e studentëve dhe pedagogëve, të studiuesve dhe kërkuesve shkencorë.

Duke lexuar këtë libër enciklopedik do të vijë më e plotë pamja e gjithë arritjeve shkencore dhe artistike të deritanishme të realizuara nga Akademia Shqiptare Amerikane e Shkencave dhe e Arteve dhe të gjithë atyre shkrimtarëve dhe studiuesve që kanë bashkëpunuar me këtë institucion prestigjioz të trojeve shqiptare dhe në Diasporë.

**PROJEKT I “ENCIKLOPEDIË” NGA AKADEMIJA
SHQIPTARE-AMERIKANE E SHKENCAVE DHE
ARTEVE ME SELI NË SHBA**

Akademik Prof. Dr. Nijazi Halili, Ph.D.

Shkrimtari, publicisti, hulumtuesi shkencor, anëtar i rregullt i Akademisë Shqiptare Amerikane për Shkencë dhe Arte, Drejtor në Marrëdhënie me Publikun, Prof.Dr.Flori Bruqi,PhD, kësaj radhe na paraqitet me një libër enciklopedie shumë interesant si rezultat i hulumtueseve shkencor të kësaj akademie në fushat e tyre të thella për shkencën dhe artin.

Në këtë libër, që mban titullin “ENCIKLOPEDIA “...., i ndarë në disa kapituj.

Sipas autori ky libër enciklopedie ka një vlerë të veçantë për kohën kur po botohet dhe t’iu epet në dorë lexuesve të shumtë, të cilët janë të interesuar për t’i thelluar njohuritë e tyre në shumë aspekte për çështjen tonë kombëtare.

Enciklopedia e Akademisë Shqiptare-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me seli në SHBA është një libër enciklopedik që trajton artet në të gjitha hapësirat shqiptare, në Shqipëri, në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi edhe në diasporë.

Bashkëpunëtorët e kësaj Enciklopedie janë nga të gjitha trevat ku në këtë enciklopedi kanë punuar studiuese si Skender Kodra, Agron Fico, Adem Harxhi, Arjan Hamiti, Asllan Qyqalla, Bedri Tahiri, Dibran Fylli, Eshref Ymeri, Flori Bruqi, Fritz Radovani, Fatos Daci, Hakif Bajrami, Isuf (Isuf) Dedushaj, Jahja Mustafë Lluka, Kujtim Mateli, Migena Arllati, Mixhait Reçi, Namik Muhedin Shehu, Nehat Jahiu, Nijazi Halili, Naim Salih Kelmendi, Ndue Hila, Petraq Risto, Sulejman Abazi (Neshaj), Shyqiri Bytyqi, Vilhelme Vrana Haxhiraj, Gjin Kol Musa, Zef Mulaj, Isak Shema, Salih Kelmendi ,.... etj. të cilët përbëjnë bordin që ndjek ecurinë. Pjesa dërrmuese e punimeve është hartuar nga ky bord, por janë afruar edhe shumë e shumë studiues të tjerë të njohur për zërat e ndryshme të arteve.

Sipas autorit Bruqi, kjo enciklopedi është e para i këtij lloji në hapësirën shqipfolëse. Ky është një projekt ambicioz në kuadrin e Akademisë Shqiptare-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me seli në SHBA, kur ne e dimë se Shqipëria ende nuk ka enciklopedinë e saj. Ka pasur një fjalor të hershëm enciklopedik dhe tani ka dale në botim fjalori i ri vetëm me dy vëllime, pritët i treti, ndërsa Enciklopedia Shqiptare-Amerikane e Shkencave dhe Arteve me seli në SHBA do të ketë disa vëllime....

Libri i ri enciklopedik i autorit Prof.Dr.Flori Bruqi,PhD, në kuadër të Akademisë Shqiptare-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me seli në SHBA, që po përgatitet tashmë për botim, është enciklopedi që përfshinë kontributin e shumë shkencëtarëve në fushat e tyre.

Enciklopedia ka si specifikë se mbart elementë vlerësues për çdo autor; çfarë ai përfaqëson, cilat janë tiparet, profili i tij, nga se çmohen veprat e tij.

Sipas autorit jepet një përshkrim për figurat më të shquara të shkencës nga AAAS-i. Botimi është një produkt i Akademisë Shqiptare-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me seli në SHBA, mendohet se mbart vlerësimin e mundshëm më të drejtë, nga vlerësime që mund të jepen nga studiues që punojnë në mënyrë individuale. Enciklopedia ka një bord ,emrat më të shquar në fushat e tyre, e kësisoj mendoj se ka dhe një lloj objektiviteti.

Duke qenë se janë studiues që njohin mirë lëmit e veta, vetvetiu ata do të dinë si ta vendosin e t'i japin vendin e duhur çdo zëri të veçantë.

Sipas autorit të kësaj vepre madhore nuk do të jenë vetëm anëtarët e bordit, që do të përgatisin Enciklopedinë, do të ketë edhe të tjerë që do të shkruajnë.

Për artet figurative, nga shkencat ekonomike, shkencat e mjekësisë, shkencat e historisë nga të gjitha trevat shqipfolëse. për shembull, kemi nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, nga Kosova. Por ama peshën kryesore do ta mbetet tek vetë autori.

Mendoj që në këtë enciklopedi autori ka bërë një sistemim të plotë, të ngjeshur të vlerave që ka krijuar arti shqiptar në shekuj, të emrave dhe them se do të jetë një kontribut goxha i mirë. Si për shembull kontribuues të shquar të kësaj enciklopedie janë, shumë akademikë të spikatur të AAAS-it.

Ne nuk do të bëjmë plotësisht historinë. Ajo do të jetë tejet e përmbledhur, koncizë.

Por nuk do të lihen pa përmendur edhe institucionet e artit, kompani muzikore, teatrale, galeritë që janë pjesë përbërëse e artit.

Arti pas viteve 1990 sa do të pasqyrohet dhe a ju duket i vështirë për t'u rrokur, sepse dihet që ai është në formim e sipër dhe sa kohë është i tillë mund të mbartë mungesë qartësie ?

Po shtypi i këtyre viteve, i cili mund të mos jetë përfshirë në botime dhe mund të përmbajë mjaft gjëra interesante, a është llogaritur?

Edhe shtypi periodik me të rejat e tij në fushat e artit do të zërë vend, por nuk besoj të jetë parësor si libri, botimet universitare, shtypi shkencor, arkivat, etj.

Sipas autorit, çdokush do të ndjekë fushën e tij me impenjim maksimal. Synimi i autorit ishte që ta plotësojmë enciklopedinë deri ditën e fundit.

Patëm një të dhënë të re, ne do ta bëjmë pjesë të enciklopedisë.

Veprat e realizimit socialist janë pjesë e historisë dhe nuk mund të veçohen. Ka pasur bota pjesë të errëta dhe përsëri shkruhet për to.

Ashtu edhe ne, shprehet autori se kemi qenë ky popull, kemi pasur këtë kulturë dhe kjo do të thuhet. Më i vështirë është aspekti historik, se njerëzit janë akoma gjallë, konfliktet janë ende të freskëta, por është gjë e madhe krijimi i hapit të parë.

Ndërsa në rastin tonë autori ka një lloj përgjegjësie se është botim akademik, bëhet nga njerëz që kanë nivel të lartë akademik për këtë punë dhe çdo gjë kalohet me përgjegjësi në një sitë profesionistësh . Të dhënat dhe botimet, suplementet e artit, të dhënat e reja që dalin edhe në shtypin periodik do të shfrytëzohen sigurisht.

Çfarë janë botime për artin do të kalohen të gjitha në filtër. Por kjo nuk do të thotë se nuk do të ketë gjëra të reja.

Sipas autorit Enciklopedia.... i ka kaluar te gjitha fazat dhe atë përfundimtare dhe ende nuk e ka pare dritën e botimit megjithëse behet fjale për një vepër me rendësi kombëtare. As imediat qofshin ato te shtypit qofshin radio apo tv nuk informojnë për këtë dem kombëtar qe i behet kulturës shqiptare.

Politika qe e ka zënë ne goje. Mbetja e Akademisë se Shkencave e as qeveria nuk shprehen me asnjë fjale për këtë problem edhe ne fund te shekullit XX.

Lexuesi dhe studiuesi shqiptar dhe ai i huaj do ta lexon dhe studion këtë libër, për dhembjen tonë, të autorit dhe të të gjithë atdhetarëve, për të pasur mundësi të gjykoni...

Burimi : <https://lexo-shqip.net/archives/124246>

SULEJMAN KRASNIQI: “NË SHQIPËRI THASHË, MËMËDHE TË DUA EDHE KËSHTU SIÇ JE”

Pasqyrimi i historisë në veprat letrare të shkrimtarit kosovar Sulejman Krasniqit

Sulejman Krasniqi, U lind në Hoçë të Vogël, në afërsi të Rahovecit (1937) gjatë kohës së Mbretërisë Serbosllave.

Arsimin fillor e ndoqi në vendlindje, ndërsa shkollimin e mesëm në Prizren dhe në Krushë të Madhe.

Sulejman Krasniqi shumë shpejt u dallua për angazhimin e tij në çështjen kombëtare si shkrimtar dhe poet kombëtar.

Ai u burgos nga regjimi serb për veprimtarinë e tij patriotike, ndërsa në vitin 1958 u arratis drejt Shqipërisë, ku kreu studimet e larta pranë Universitetit të Tiranës.

Pas vdekjes së babait të tij në rrethana të mistershme, urrejtja e Krasniqit ndaj regjimit serb ishte rritur.

Ai kishte mbajtur dënimin me burg në Rahovec, Prizren dhe Kalluxherska Bare, në kohëzgjatje prej 1 vit e 2 muaj.

Ai ishte dënuar nën akuzën se shpërndante hapur armiqësi ndaj pushtuesit serb, se i ka ndihmuar shqiptarët që të arratisen për në Shqipëri.

Sulejman Krasniqi në vitin 1958 largohet për në Shqipëri, ku qëndroi në kampet e punës për disa kohë.

Pas 41 vjetëve ai kthehet në Kosovë më 3 korrik 1999. Atje shkoi i vetmuar, kurse u kthye vetë i katërti. Sulejman Krasniqi punoi gjatë gjithë jetës së tij për çlirimin e trojeve shqiptare. Ai mendonte ta bënte këtë me armë por, pas burgosjeve e internimeve, iu rrek penës. Proza e Sulejman Krasniqit, veçanërisht romanet e tij, frymëzohen kryesisht nga historia e popullit shqiptar.

Duke dashur ta nxisë ndjenjën kombëtare te shqiptarët e robëruar, në radhë të parë në Kosovë, ai u jep atyre modele të luftëtarëve të shquar për liri kombëtare çfarë janë: Mic Sokoli, Oso Kuka, Bajram Curri, Azem dhe Shotë Galica etj. Mbi këtë platformë ideoestetike, të themi kështu, bazohen edhe tre romanet që janë objekt i punimit tonë: “Prijësja e komitëve”, “Pushka top, Bajram Curri!” dhe “Oso Kuka”.

Për shumë vite punoi si mësues në shkollat e mesme në Mat dhe Tiranë, ku botoi mijëra tregime dhe artikuj në shtypin periodik.

Sulejman Krasniqi është autor i një numri të madh romanesh, novelash dhe veprash eseistike të botuara

në shqip, ndër të cilat veçohen romanet Mic Sokoli, Rebeli i Bajraqeve dhe Makthi i Hijëve.

Për kontributin në fushën e letrave, Sulejman Krasniqi është laureuar me “Çmimin e Republikës”, dhe është dekoruar me “Urdhrin e Punës” nga Kuvendi i Shqipërisë.

U nda nga jeta në Tiranë më 16 07. 2011.

Opusi letrar i Sulejman Krasniqit është i gjerë. Ai është autor i mbi 20 veprave letrare, kryesisht në gjininë e prozës dhe të dramës. Krijimtaria letrare e këtij autori nuk merr fund me kaq. Janë disa vepra të pabotuara në dorëshkrim të cilat autori i ka përmendur më 2007. Ato janë: “Vajza e shtypshkronjës”, “Të jetosh midis dashurive”, “Shtegtimi i prostitutave”, pastaj një vëllim me artikuj politiko-shoqërorë, si dhe një vëllim me tregime. Sulejman Krasniqi i takon atij brezi që përjetoi si fëmijë shtypjen e egër të regjimit serb të kohës së Rankoviçit. Ishte mashkulli i vetëm në familje. Ai ishte edukuar nga prindërit me frymë kombëtare.

Në romanin “Prijsja e komitëve” është e dukshme përfshirja e rrëfimitarit në historinë që tregon. Autori ka gjurmuar me vite në Malsinë e Gjakovës për të marrë informacione të bollshme për gratë e asaj pjese, të cilat shërbejnë si prototip (model) i Shotë Galicës. Romani “Prijsja e komitëve” trajton bëmat e femrës kaçake, përpjekjet e saj për liri. Boshti rreth të cilit zhvillohet ngjarja prej fillimit të romanit deri në mbarim ka të bëjë me dy linja tematike: e para ka të bëjë me luftën ndërmjet Shotë Galicës dhe Ukë Gunës për ta marrë drejtimin e komitëve, udhëheqjen e tyre

(Shotë Galica kishte përkrahjen e popullit, kurse Ukë Guna përkrahjen e disa fshatarëve), kurse linja e dytë tematike ka të bëjë me luftën e pakompromis të Shotë Galicës ndaj forcave serbe. Romanin “Prijësja e komitëve” e përbëjnë edhe disa mikrotëma, si: tema e vëllavrasjes, tema e marrjes së Ramës binjak nga Milan Ivanoviçi etj. Sulejman Krasniqi romanin “Prijësja e komitëve” e shkruan në vetën e tretë njëjës (ajo). Narratori në këtë roman flet për ngjarje të përfunduara dhe të njohura për lexuesin. Autori trajton nëpërmjet figurës së Shotës barazinë në luftë në mes të gruas dhe burrit.

Edhe romanet “Pushka top, Bajram Curri!” dhe “Oso Kuka” flasin për bëmat e heronjve emrat e të cilëve qëndrojnë në titujt e këtyre veprave: Bajram Curri dhe Oso Kuka. Si të tilla këto vepra i kanë shërbyer çlirimit të Kosovës, sepse kanë nxitur mendjet dhe shpirtrat e bijave dhe bijve të Kosovës për t’i zgjedhur rrugët dhe mjetet e luftës për liri.

Te romani “Pushka top, Bajram Curri!”, autori paraqet kronologjikisht veprimtarinë e Bajram Currit, jetën e tij prej lindjes deri në vdekje, paraqet bëmat e tij, luftërat e tij, fitoret dhe humbjet. Lufta e tij ishte heroike. Ajo konkretizohet me fitore dhe me respektin që fiton në masë.

Vepra “Pushka top, Bajram Curri!”, ka strukturë të mirëfilltë letrare.

Vepra përbëhet nga dymbëdhjetë kapituj, në një mori personazhesh.

Vepra ka 223 faqe. Narratori ka të bëjë me pikën e shikimit, personin që e tregon ngjarjen.

Ngjarja në romanin “Pushka top, Bajram Curri!” rrëfëhet në vetën e parë, rrëfim ky që Wolfgang Kajzeri (teoricien gjerman) e quan (Ich-Form).

Narratori, tregimtari i romanit, i cili është vetë Bajram Curri, na tregon se kishte lindur në karrocë të burgut. Bajram Curri në cilësinë e tregimtarit, tregon ngjarjet që i kanë ndodhur hap pas hapi. “Kur mbusha tetë vjeç, ndodhi një ngjarje, e cila na detyroi të braktisnim Gjakovën dhe të ngjiteshim në malësi, ku babai bënte një jetë gjysmë komiti”.

Te romani tjetër me temë historike “Oso Kuka”, autori paraqet luftërat e popullit shqiptar karshi atij malazez, në pjesën veriore të Shqipërisë.

Oso Kuka portretizohet në aspektin fizik dhe moral si njeri i fuqishëm e trim, njeri i cili kishte ndikim te shokët. Sulejman Krasniqi, autor i shumë romaneve me temë historike, shkroi romanin “Oso Kuka”, duke pasur në mendje gdhendjen si skulptori në gurë figurën e Oso Kukës.

Oso Kuka është figurë e kompletuar letrare. Ai ka bërë shumë peripeci jetësore deri në vetëflijm për lirinë e atdheut.

Me pak fjalë, ideja themelore e romanit është ta duam atdheun, të punojmë për të mirën e tij, ta duam gjuhën shqipe, t’i duam heronjtë kombëtarë dhe ta respektojmë të kaluarën tonë. Struktura letrare e romanit përbëhet nga tri pjesë të ndara në tridhjetë e dy kapituj.

Pjesë përbërëse e librit janë Defteri i Oso Kukës dhe Buletini i Shkodrës.

Buletini i Shkodrës paraqet kohë pas kohe ngjarjet kryesore në Shkodër.

Romani përbëhet nga 354 faqe.

Pjesë përbërëse të romanit janë edhe letrat dërguar Oso Kukës nga shokë dhe familjarë që janë elemente të romaneve sentimentale. Kapitujt e romanit kanë unitet të plotë gjuhësor dhe tematik, ato paraqesin para lexuesve luftën e pakompromis të popullit shqiptar për liri.

Narratori në romanin “Oso Kuka” është në vetën e tretë “ai”. Po e shënoj një pjesë nga romani, ku faktohet kjo: “Kur u mbyll dosja e vrasjes së Hulinsanit me shënimin ‘Oso Kuka u mbyt në liqen, faji duhet t’i vishet ndonjë tjetri që çon peshë në kendarin e arnautëve’>!...”.³

Vepra e Sulejman Krasniqit në përgjithësi ka kultivuar guximin, trimërinë, shpirtin e sakrificës ndër breza.

Gjuha e veprave të Krasniqit është kryesisht gjuhë e pasur dhe e gjallë shqipe e pasuruar me elemente të ligjërimit popullor.

Nëpërmjet saj autori bën paraqitjen e botës shpirtërore të personazheve, karakteristikat e tyre, bëmat e tyre.

Plani rrëfimor i autorit nuk mbështetet vetëm në fiksjonin, që është shtjella e shkrimit artistik, por edhe në dokumente arkivore e në shkrime historike, ku proza e Krasniqit i afrohet konkretës.

Proza e shkrimtarit nuk është trajtuar meritueshëm në kuadrin e historisë së letërsisë shqipe.

Proza e tij është mundësi e hapur për studime dhe vlerësime dhe e meriton të jetë afër lexuesit tash edhe në të ardhmen.

Vetëm pasi të lexohet në tërësi proza e tij, krijohet një pasqyrë më e qartë rreth saj dhe mund të konkludojmë se krijimtaria dhe jeta e Sulejman Krasniqit janë plotësim i njëra-tjetrës, pra jetës dhe krijimtarisë së tij.

Nëse merremi me njërën prej tyre, do të mësojmë edhe tjetrën. Vepra e tij letrare e ka pasuruar letërsinë shqipe, sidomos duke veçuar cilësinë e rrëfimit që është një nga arritjet më të mëdha të krijimtarisë letrare të këtij shkrimtari.

Sulejman Krasniqi i shkroi shumicën e romaneve të tij me patos patriotik, për çka edhe u kritikua ndonjëherë.

Nuk është përpjekur të thellohet më tepër apo për të kapur më shumë tema të reja në mënyrë që ta mos përsërisë vetveten.

Sa i përket organizimit të jashtëm, anës formale të romaneve, Sulejman Krasniqi nuk ka arritur ndonjë lëvizje të theksuar novatorizmi, por ai e ndjek vazhdimisht modelin e njëjtë të një rruge të trasuar nga të tjerët.

Personazhet e romaneve të Krasniqit janë kryesisht luftëtarë trima, por edhe njerëz të thjeshtë të popullit.

Personazheve kryesore autori u ka bërë një trajtim më të gjerë dhe shumëdimensional. Njohim botën e tyre, shpirtin e tyre, peripecitë dhe sfidat e tyre në kohë të ndryshme.

Personazhet e veprës së Krasniqit janë njerëz atdhedashës të cilët sakrifikojnë jetën e tyre për të mirën e vendit.

Shumica prej tyre janë persona realë, si: Mic Sokoli, Bajram Curri, Oso Kuka, Shotë Galica, Sulejman Vokshi, Ymer Prizreni, Bejtë Kuka, Shaqir Curri, Mehmet Ali Pasha, Azem Galica etj., por në romanet e tij ka edhe personazhe të trilluara të cilat janë pjellë e imagjinatës së shkrimtarit. Bajram Curri, Oso Kuka dhe Shotë Galica gjatë jetës së tyre u shquan si prijës popullorë, si luftëtarë të paepur, si strategë tej pamës. Vepra e Sulejman Krasniqit është e rëndësishme. Si e tillë ajo meriton të studiohet për disa arsye.

Vepra e Sulejman Krasniqit ka rëndësi të veçantë për paraqitjen e figurave përfaqësuese të kohës. Vepra e Sulejman Krasniqit paraqet në mënyrë realiste të kaluarën e popullit shqiptar. Ajo është një model pak a shumë i veçantë në letërsinë shqipe.

Vepra e Sulejman Krasniqit paraqet një konstrukt gjuhësor e cila meriton të studiohet edhe më tej. Vepra e Sulejman Krasniqit nuk është studiuar sa duhet, në aspektin tematik, formal, në aspektin historiko-letrar. Mbi të gjitha, vepra e Sulejman Krasniqit është një ndër dëshmitë letrare më të fuqishme në ndërlidhjen histori-letërsi, e arritur në një nivel të lartë artistik, brenda letrave shqipe. Prandaj, studimi i saj është një kontribut për ndriçimin e vlerave letrare dhe historike të autorit në fjalë.

Nga studiues të ndryshëm veprimtaria atdhetare dhe krijimtaria letrare e tij është krahasuar me shkrimtarin francez Honore de Balzak, i cili konsiderohet baba i romanit realist në Francë.

Ngjarjet në veprën e Sulejman Krasniqit zhvillohen në një pjesë të madhe të territorit shqiptar, duke filluar

nga Bujanoci, Gjakova, Drenica, Shkodra, Vranina, Shpella e Dragobisë, Malësia e Gjakovës, Fushë-Kruja etj., të cilat çdoherë kanë qenë epiqendër të luftërave për liri. Nga këto vende kanë dalë trima të dalluar të cilët kanë kontribuar për çështjen kombëtare.

Stili i veprave të Sulejman Krasniqit është kryesisht epik, i përshtatet përmbajtjes së veprave të Sulejman Krasniqit, jetës së tij, veprimtarisë patriotike të tij.

Vepra romanore e Sulejman Krasniqit paraqitet si një univers kompleks, ku gazi e loti, dashuria e urrejtja, urtësia e çmenduria fqinjërojnë me njëra-tjetrën dhe së bashku realizojnë kuptime të shumëfishta dhe përplotësuese, duke krijuar ndjesi gjithmonë befasuese.

Sulejman Krasniqi qëndron në radhën e shkrimtarëve që i kanë ofruar lexuesit vepra letrare me përmbajtje të pasur artistike.

Raporti histori-letërsi në romanet e Sulejman Krasniqit (Prijësja e komitëve, Pushka top, Bajram Curri! dhe Oso Kuka)

Për relacionin histori-letërsi, për dallimet ndërmjet këtyre dy fushave, është debatuar qysh në antikë. Aristoteli në veprën Poetika, shkruan "... puna e një poeti nuk është të tregojë atë që ka ndodhur, po atë që mund të ndodhte, dmth. gjërat që mund të ngjasin sipas gjasës ose nevojës". Një studim serioz për interesimin e shkrimtarëve shqiptarë për historinë e bëri prof. Agim Vinca në librin Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe (1945-1980). "Duke filluar nga gjysma e dytë e viteve '60, posaçërisht nga viti 1968, mund të thuhet se zë fill interesimi i shtuar i shkrimtarëve

bashkëkohorë shqiptarë për historinë, lashtësinë dhe mitologjinë kombëtare, si dhe për historinë dhe mitologjinë në përgjithësi”. Prof. Vinca edhe në librin Kursi i teorive letrare bën dallimin ndërmjet letërsisë dhe historisë. “Historia flet për njerëz dhe ngjarje konkrete, kurse letërsia flet më tepër gjëra “të përgjithshme”, nocion ky që tek Aristoteli ka pak a shumë atë kuptim që te realistët do të ketë fjala “tipike”.

Përfaqësuesi i rëndësishëm i dramës dhe romanit historik shkrimtari i njohur italian Aleksandër Manconi mendon se historia na ofron ngjarjet, të cilat, të thuash, i njohim së jashtmi, ndërsa letërsia tregon ç’kanë ndier njerëzit.

Studiuesi i romantizmit tonë – kritiku dhe historiani i njohur i letërsisë, akademik Rexhep Qosja, duke u marrë me figurën e Skënderbeut në vizionin e rilindësve, “thekson se historia e shënon të kaluarën e popujve të ndryshëm me indiferencën që shquan shkencat, pa u interesuar për ndjenjat që mund t’u kenë prirë apo mund t’u kenë pasuar ngjarjeve dhe dukurive të ndryshme. Ndërkaq, letërsia si art zhytet në thellësitë e ndjenjës së individit dhe të mbarë popullit, duke shprehur dialektikën e përjetimeve të tij”.

Binomi histori-letërsi në veprën e Sulejman Krasniqit është i pandashëm. Autori u kundërpërgjigjet edhe kritikave të atyre të cilët mendojnë se veprat e tij kanë tematikë të tepruar historike, duke thënë se populli shqiptar i Kosovës ishte popull i pushtuar me shekuj

dhe nuk kishte se si të mos shkruante për tema kombëtare.

Atdhetar i patrembur për çështjen kombëtare dhe lexues i devotshëm i librave historikë, ai merr guximin që ato të cilat i kishte dëgjuar nga më të vjetrit nëpër oda, ato të cilat i kishte përjetuar vetë, ato të cilat i kishte lexuar nëpër libra historikë, t'i ringjallë dhe t'i bëjë romane me vlerë dhe lexueshmëri. Studiuesi Bajram Krasniqi në veprën e tij "Poetika e romanit historik shqiptar", shkruan "(...) romani historik nuk shkruhet me qëllim që t'ia bëjë të njohura lexuesit ngjarjet dhe faktet pozitive nga e kaluara, sepse atë e bën më mirë dija e historisë, por do t'ia zbulojë artistikisht atë që ai ka mësuar nga historiografia".⁵

Autori ka paraqitur fatin e popullit shqiptar si individ, e nëpërmjet tij si kolektiv, bëmat e tij, vuajtjet, gjendjen e rëndë ekonomike e sociale, duke ngritur në pedestal luftën dhe bëmat heroike të Mic Sokolit, Bajram Currit, Oso Kukës, Ymer Prizrenit, Sulejman Vokshit etj. Populli shqiptar është ndër popujt më të vjetër të Ballkanit, një popull i cili me shekuj ishte i pushtuar nga perandori të ndryshme. kështu që historia e popullit shqiptar është e larmishme, me vuajtje, dhunë, masakra, por edhe me trima të ndryshëm të cilët i prodhoi historia kohë pas kohe.

Për t'i lexuar veprat e Krasniqit duhet të kemi njohuri paraprake të ngjarjeve historike, periudhave të lavdishme historike, për individë të cilët punuan për çështjen kombëtare.

Studiuesi Begzad Baliu shkruan se vepra e Krasniqit mund të bëhet objekt studimi në shumë fusha:

“Konteksti historik i veprave të tij: antikiteti dardan në romanin Dardanët, Lidhja Shqiptare e Prizrenit në romanin historik Qielli i përflakur, ripushtimi i Ulqinit në romanin historik Oso Kuka dhe Lëvizja Kaçake në romanin më me ndikim Prijësja e komitëve, Lufta e Dytë Botërore në romanin Shpella e banditëve”.⁶ Ngjarjet e këtyre romaneve vendosen në hapësirë gjeografike të ndryshme, si në Shqipërinë Veriore, Kosovë, Mal të Zi etj.

Albana Sulejman Krasniqi, thotë mes tjerash :“Në veprën e fundit babi, në jetëshkrim, ka treguar se ku u lind. U lind në Hoxhë të Vogël dhe ne si fëmijë gjatë gjithë fëmijërisë tonë, gjatë rinisë tonë, por edhe në moshë madhore e kemi ndjerë Hoxhën e Vogël të pranishme në çdo hap tonin, megjithëse nuk e kishim parë asnjëherë. Kur u kthyem në '99 dhe kur kaluam nga Zhuri, babai na tregoi me një emocion të jashtëzakonshëm se këtu kam ecur, kam kaluar kufirin për në Shqipëri”.

Sipas saj, kthimi në Hoxhë të Vogël ka qenë një moment shumë emocionues. “Ka qenë një moment shumë drithërues, sepse gjetëm Hoxhën e Vogël me tymin që dilte nga çatitë, për shkak të dhunës që ishte ushtruar ndaj këtij fshati, si ndaj gjithë Kosovës”.

“Peripecitë që babi ka përjetuar në Shqipëri i ka përjetuar edhe në Kosovë. Pak më herët ishim në zyrën e kryetarit të komunës dhe një nga historianët i pranishëm tha se “Kur erdha në Shqipëri thashë mëmëdhe të dua edhe kështu siç je”.

Dua ta huazoj këtë shprehje, tha Krasniqi, pasi babi e ka dashur gjithmonë mëmëdheun ashtu siç ka qenë.

Vajza e shkrimtarit të madh tregoi se “ai ka vuajtur gjithmonë qoftë këtu, qoftë atje, asnjëherë nuk ka marrë hakmarrjen si pikënisje për të lidhur marrëdhëniet për të tjerët, gjithmonë ka marrë faljen, pa harruar asgjë. Pa harruar asgjë, as këtu, as atje”.

Ajo e cilësoi babain e saj, si shkrimtari i shqiptarisë. “Ai e ka ndjerë veten shqiptar në të gjithë dimensionet e saj”, tha Krasniqi.

Sulejman Krasniqi është njohës i mirë i historisë. Ai gdhendi figurat historike. Historia duke paraqitur të kaluarën, formëson të ardhmen. Autori ka qëllim që nëpërmjet historisë së letrarizuar, të përçojë te lexuesit ndjenjën e atdhedashurisë, ndjenjën e besnikërisë, ndjenjën e trimërisë. Sikurse në romanet e tjera të tij, edhe në romanet “Prijësja e komitëve”, “Pushka top, Bajram Curri!” dhe “Oso Kuka” paraqitet lufta epike e popullit shqiptar për liri.

Vend meritore për Sulejman Krasniqin, do të zë këto ditë në Tribunën publicistiko -Shkencore të Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, në Festivalin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës që mbahet gjatë muajit qershor në Prishtinë, Prizren dhe Kukës, ku do referojnë shumë studiues të veprës së Sulejman Krasniqit.

Romani “Mic Sokoli”, i botuar vetëm një vit pas përkujtimit të Lidhjes së Prizrenit krijoi një tipologji të veçantë në letrat shqipe . Ai krijoi nga një mjedis i vogël dhe lokal, heroin e përmasave kombëtare që fatin dhe veprimtarinë e vet ia nënshtroi ideve të mëdha kombëtare.

Sulejman Krasniqi mund të themi me plot gojën se është pena e tij që ka gdhendur një personazh që në vetvete bashkë me kompleksitetin e personazheve të tjerë si Ahmet Koronica, Shuaip Spahiu, Haxhi Zeka, Zef Kosharja etj, krijoi universin shqiptar të heroizmit që bie ndesh me agresivitetin shovinist të fqinjëve sllavë keqpërdorimin si plaçkë tregu të shqiptarëve nga pushteti perandorak osman dhe paragjykimi orientalist i fuqive perëndimore”...

Pavarësisht se personazhet nuk shfaqen e dalin nga një vepër në tjetrën, ato kanë një kuptim narrativ që është pak a shumë historia e vetë kombit shqiptar.

Gama e tematikave dhe karaktereve që krijoi janë të ndryshëm, por ato i bashkon vetëdija etnike, identiteti i veçantë historik dhe skalitja e ngjarjeve të mëdha të kombit. Linealiteti jo i rregullt i ngjarjeve historike që trajtoi në romane jo domosdoshmërisht krijon vështirësi për të lexuar eposin historik “Krasniqian”, por nëpërmjet identifikimit të veçantë të personazheve heronj skaliten dhe mbeten më mirë në mendje, njerëz dhe ngjarje që kanë shenjuar kujtesën tonë kolektive dhe historinë kombëtare”.

Në vitin 1990, Sulejman Krasniqi kishte arritur maturinë e vet si shkrimtar, prandaj ai ka arritur të përcjellë mesazhe të forta historike letrare përmes penës së vet për gjithë shqiptarinë që ngriti në mit figurat historike të popullit tonë.

PËR DOSTOJEVSKIN

Fjodor Mihajloviç Dostojevski, lindi më 11 .XI. 1821 ,vdiç më 09 .II. 1881), ishte shkrimtar, eseist dhe filozof rus, ku ndër veprat e tij kryesore janë Krim dhe ndëshkim dhe Vëllezërit Karamazov

Krijimet letrare të Fjodor Mihajloviç Dostojevskit eksplorojnë psikologjinë njerëzore në kontekstin e turbullt politik, social dhe shpirtëror të shoqërisë ruse të shek.19 .Fjodor Mihajloviç Dostojevski konsiderohet nga shumë si paraprijësi apo themeluesi i ekzistencializmit të shek të 20të; libri i tij “Shënime nga nëntoka” (1864), i shkruar me zërin e hidhëruar të “njeriut anonim të nëntokës”, është quajtur nga Walter Kaufmann si “uvertyra më e mirë për ekzistencializëm që është shkruar ndonjëherë”.

Fjodor Mihajloviç Dostojevski njihet si një ndër shkrimtarët më të mëdhenj dhe më me influencë të të gjitha kohërave.

Nëna e Fjodor Mihajloviç Dostojevskit ishte ruse. Parardhësit e tij nga babai ishin nga një vend i quajtur Dostojeve, vendas të provincës së Minskut, jo shumë larg nga Pisk. Mbiemri i familjes paternale supozohet të ketë qene “Rdishev” – para se të merrte eponimin e qytetit “Dostojevski”.

Sipas një burimi, paraardhësit paternal të Dostojevskit ishin fisnikë të polonizuar (szlachta) me origjinë ruse dhe që kishin shkuar në luftë duke bartur mburojën polake të Raduan.

Fjodor, i dyti i shtatë fëmijëve, lindi ne Moskë nga Michail Andrevič, një mjek me origjine lituane e me një karakter ekstravagant dhe despotik që e rrit të birin në një klimë autoritare.

E ëma, Marija Fjodorovna Necaeva, vjen nga një familje tregtarësh. Karakteri i saj është i qeshur dhe i thjeshtë, i pelqen muzika dhe është shumë besimtare. Do të jetë ajo që do t'i mësojë të birit të lexojë duke bërë që të njohë Aleksandr Puškin, Vasilij Žukovskij dhe Biblën. Në 1828 babai, Michail Andrevič, shënohet me të bijtë në librin e artë të familjeve fisnike të Moskës. Në 1831 Fjodor shpërngulet me familjen në Darovoe në provincën e Tulës ku babai ka blerë një tokë dhe në 1834, bashkë me të vëllain Michail, hyn në konviktin privat të L.I.Čermak në Moskë. Në 1837 e ëma, prej kohësh e sëmurë me tuberkuloz, vdes dhe djali, bashkë me të vëllanë, rregjistrohet në konviktin përgatitor të kapitenit Kostomarov, në pritje të provimit të pranimit në Institutin e Inxhinierisë. Me 16 janar 1838 hyn në Gjimnazin e Xhenios Ushtarake të Pjetërburgut, ku studion inxhinieri ushtarake, por duke e frekuentuar pa dëshirë, meqë interesat e tij janë të orientuara drejt letërsisë. Më 8 qershor 1838 babai, që i ishte dhënë pijes dhe keqtrajtonte fshatarët e tij, vritet me shumë mundësi nga ata vetë. Kur merr lajmin e vdekjes të babait, Fëdorit i vjen ataku i parë i epilepsisë, sëmundje që do ta ketë për të gjithë jetën.

Në gushtin e 1841 pranohet në kursin për oficer dhe vitin më pas nëntenent. Verën e mëpasme hyn në shërbim efektiv në komandën e inxhinierisë të Pjetërburgut.

Ka nga ata që besojnë se arti i mrekullueshëm është rrjedhojë e vuajtjes së thellë. Jeta e autorit rus Fjodor Dostojevski, ndër figurat më të shquara të literaturës, ishte dëshmi e kësaj lloj vuajtje. Në moshën 15 vjeçare nëna i vdes nga tuberkulosi; dy vjet më pas vdes gjithashtu edhe i jati, një alkoholist i dhunshëm, ku besohet se u vra nga shërbëtorët e tij. Në vitin 1849, Dostojevski dhe kolegët e tij në rrethin radikal politiko-letrar Petrashevski, arrestohen dhe burgosen. Më pas dënohen me vdekje në 16 nëntor 1849.

I gjithë grupi u detyrua, që të qëndronte në të ftohtin e acartë në pritje të skuadrës së pushkatimit. Në minutin e fundit, vendimi u anulua. Vetëm pas 10 vjet burgimi politik në Siberi kthehet në Shën Peterburg. Fjodor Dostojevski është autori rus i shekullit të 19të që ka shkruar novelat klasike si Krim dhe ndëshkim (1866) dhe Vëllezërit Karamazov (1880). Dostojevski iu kthye jetes së shkrimtarit si profesion pas një karriere të shkurtër ushtarake, ku në vitin 1846 publikoi novelën e tij të parë “Njerëz të varfër”.

Novelat e tij eksploronin detyrimet psikologjike dhe morale të njeriut modern. Ai u bë i famshëm për krijimin e “heroit të rrugës,” një protagonist i mohuar nga shoqëria dhe në kërkim të shpengimit. Jeta e hershme Dostojevski ishte fëmija i dytë nga gjashtë fëmijët e Mikhail dhe Maria Dostojevskit. Babai i Dostojevskit Mikhail ishte një kirurg ushtarak në

pension dhe një alkoolist i dhunshëm, i cili shërbente si doktor në Spitalin Mariinsky për të Varfërit në Moskë.

Spitali ishte i vendosur në një nga zonat më të këqija të Moskës. Monumente lokale përfshinin një varrezë për kriminelë, një azil për të çmendur dhe një jetimore për fëmijë të lënë. Ky peisazh urban i bëri përshtypje të pashlyeshme Dostojevskit të ri, interesimi dhe keqardhja e të cilit për të varfërit, të shtypurit dhe të vuajturit ishte më se e dukshme. Ndonëse prindërit e tij e ndalonin, Dostojevski kishte dëshirë për të shetituar nëpër oborrin e spitalit, ku pacientët e përvuajtur uleshin në diell. Dostojevski i ri kishte qejf të kalonte kohë me këta pacientë dhe t'ia u dëgjonte rrëfimet. Ka shumë tregime për trajtimin despotik që u ka bërë babai i Dostojevskit fëmijëve të vet. Pasi që kthehej nga puna në shtëpi, ai do të bënte një sy gjumë përderisa fëmijët e tij, të cilët urdhëroheshin të ishin absolutisht të qetë, qëndronin prapë babait të tyre me rend dhe largonin mizat që mund të kalonin aty pari pahiri. Sidoqoftë, sipas Joseph Frank, një biografist i Dostojevskit, figura atërore në Vëllezërit Karamazov nuk është bazuar në vet babanë e Dostojevskit. Letrat dhe shënime personale demonstrojnë që këta dy kishin pasur një lidhje mjaft të dashur.

Lista e veprave

“Njerëz të mjerë” (1849) Netochka Nezvanova

“Netochka Nezvanova” (1861)

- “Të fyer e të poshtëruar” (1862)
“Shënime nga shtëpia e të vdekurve” (1864)
“Shënime nga nëntoka” (1866)
“Krim dhe ndëshkim” (1867)
“Kumarxhiu” (1869) ;
“Idioti” (1872)
“Djajtë”(1875)
“Adoleshenti”(1881)
“Vëllezërit Karamazov”
Novela dhe tregime të shkurtra (1846)
Një poemë e Shën Peterburgut” (1847)
Novelë në nëntë letra (1847)
“Zotëri Prokharchin” (1847)
“Qiradhënësia” (1848)
“Polzunkov” (1848)
“Një zemër e dobët” (1848)
“Gruaja e një burrit tjetër dhe një burri nën shtrat”
(1848)
“Një hajn i ndershëm” (1848)
“Një pemë krishtlindjesh dhe një martesë” (1848)
;Netë të bardha (1857)
“Heroi i vogël” (1859)
“Ëndrra e xhaxhait” (1859)
Fshati i Stepançikovës (1862)
“Një tregim i ndyrë” (1865) ,
“Krokodili” (1870) “
“Burri i përjetshëm” (1873) ,
“Bobok” (1876)
“Krotkaja”,
“Një krijesë e butë” (1876)
“Fshatari Marej”,

LETËRSIA DHE PSIKOLOGJIA

Duhet të ekzistojnë gjithmonë dy lloj artesh: arti – arratiak ngase njeriu do të ikë ndërsa ka nevojë për ushqim dhe gjumë të thellë; dhe arti – parabolë, ai art që duhet t'i mësojë njeriut si të çmësojë urrejtjen dhe të mësojë dashurinë.....As që kam ndërmend të marr gjithsecilin shkrimtar emër për emër dhe të shqyrtoj ndikimin e Frojdit tek ta.

Dua vetëm t'ju rrëfej se cili është thelbi i mësimëve të Frojdit; kësodore lexuesi mund të gjykojë vetë për këtë. Po i rendis çështjet më të rëndësishme sa më shkurt të jetë e mundur.

1.Forca e brendshme në të gjitha format e jetës është instinktive: libidoja, që në vetevete është e pandryshueshme dhe e pamoralshme, “fara e çdo veprimi dhe e çdo vetie që meriton të ndëshkohet”.

2.Gjendjet zanafillore të kësaj force gjatë aktivitetit krijues janë në kuptimin e zakonshëm të fjalës, fizike.

Qelizat bashkohen dhe ndahen. Marrëdhënia më e rëndësishme dhe e dukshme mes individëve është marrëdhënia seksuale.

3.Me shtimin e rëndësisë së sistemit nervor qendror me më shumë kontroll qendror se sa periferik, numri i formave të kënaqësisë me të cilat libidoja përshtatet, bëhet kryekrejet më i madh.

4.Njeriu ndryshon nga pjesa tjetër e botës tjetër organike në faktin se evolucioni i tij nuk ka përfunduar.

5.Njohja e vetëdijes shënoi një hap të madh në evolucion dhe gjithçka shenjojmë si të keqe dhe mëkate, është rrjedhojë e kësaj. Frojdi ndryshon nga të dy, Rusoi i cili mohonte rënien, duke ua mveshur të keqen rrethanave fizike (Rusoi mendonte se njerëzit janë të këqinj për kah natyra. Ai e shihte të keqen tek ta dhe bënte një jetë vetmitarësh.) dhe poashtu prej doktrinës teologjike që e quan Rënien rezultat të një zgjedhjeje të paramenduar duke e bërë njeriun kësisoj moralisht përgjegjës.

6.Rezultat i Rënies që një ndërgjegje e ndarë në vend të ndërgjegjes në nivelin e kafshës, që përbëhej më së paku prej tre pjesësh: e pandërgjegjshmja, nëndërgjegjja e vetëdijshme, nëndërgjegjja e vetëdijshme, gjithë çka e moralshmja dhe shoqëria kërkon e që duhet harruar dhe të mos shprehet.

7.Doktrina e shekullit XIX për progresin evolucionist të njerëzores që mposht kafshëroren dhe shuan instinktet shtazore është më së shumti e gënjeshtërt. Paraardhësit filogjenetikë të njeriut ishin të përunjur dhe socialë, ndërkohë që egërsia, dhuna, lufta, të

gjitha të ashtuquajturat instinkte parake nuk shfaqen derisa qytetërimi të ketë arritur një nivel të lartë. Një epokë e artë po të flasim në mënyrë përqasëse (ndërsa kërkimet antropologjike priren drejt kësaj), është një fakt historik.

8. Ajo çka quajmë të keqe ishte dikur e mirë ose është tejkaluar dhe nuk u çua më tej nga mendja e ndërgjegjshme me idetë e saj morale. Është kjo çështje e Frojdit që shtjelloi D.H. Lawrenc-i dhe së cilës i kushtoi jetën e tij: Njeriu është imoral ngase ka mendjen dhe kurrsesi nuk e pranon këtë të vërtetë.

Më e rrezikshmja në shkrimet e Lawrenc-it është lehtësia me të cilën mësimet e tij për të pandërgjegjshmen, me çka kupton nëndërgjegjen e pavetëdijshe, mund të interpretohet si domethënëse që “duhet lënë ndërgjegja jote e vetëdijshe të shprehë veten”, si acte gratuite e Andre Zhidit.

Në marrëdhëniet njerëzore kjo në vetvete mund të ketë një efekt çlirues për individin. Nëse i marri do të këmbëngulte në marrëzinë e tij, do të bëhej i mençur. Porse marrëzia marrëzi mbetet sidoqoftë dhe një këshillë e llojit “Zemërimi është i drejtë – drejtësia kurrë nuk është e tillë”, e cila në jetën private është një kërkesë për ndershmëri emocionale, përbën një këshillë politike të dalëboje, kur kjo do të thotë “bjeru atyre që të kundërshtojnë”.

Po kështu, qëndrimi i Lawrenc-it në faktin se nëse doni të dini se çfarë është njeriu, duhet të këqyrni jetën e tij seksuale, fare mirë mund të bëjë të besojnë shumë syresh që përmbushja e nevojës seksuale është i vetmi aktivitet i nevojshëm.

9. Jo vetëm çfarë ne njohim si mëkat ose krim, por të gjitha sëmundjet janë të qëllimshme. Janë një përpjekje për t'u kuruar.

10. Gjithë ndryshimi, si ai paravajtës, si prapavajtës, shkaktohet prej frustrimit ose tensioneve.

Po të ishte kënaqësia seksuale krejtësisht e mjaftueshme, evolucioni njerëzor s'do të kishte ndodhur kurrë. Sëmundja dhe aktiviteti intelektual janë të dyja reagime kundrejt së njëjtës gjë, por jo të barazvlershme.

11. Natyra e ideve tona morale varet nga natyra e marrëdhënieve me prindërit tanë.

12. Në zanafillë të të gjitha ndjenjave dhe mëkatit është një ndjenjë faji. 13. Kurimi përqendrohet në heqjen e kësaj ndjenje faji, në faljen e mëkateve nëpërmjet rrëfimit, rijetimin e përvojës dhe faljen, kuptimin e domethënies së saj.

14. Detyra e psikologjisë ose artit në lidhje me sa u përmend më sipër, nuk është t'u tregojë njerëzve se si të sillen, por të tërheqë vëmendjen e tyre te ajo çka ndërgjegjia e pavetëdijshme rreket t'u kumtojë dhe duke zgjeruar njohuritë e tyre për të mirën e të keqen, t'i bëjë më të zotë të zgjedhin, që të mund të jenë shumë herë më tepër të përgjegjshëm moralisht për fatin e tyre.

15. Për këtë arsye, Psikologjia u kundërvihet të gjitha përgjithësimeve.

I bën njerëzit t'i përmbahen vetëm një përgjithësimi dhe padyshim do të vijë një kohë kur gjërat të rrjedhin asisoj që ai të mos mund të zbatohet. Atëherë ose do të përforcojë përgjithësimin, situatën,

ndrydhjen, kur t'u fanitet, ose do të përfaqësojë pikëpamjen e kundërt.

Vlera e këshillës varet krejtësisht nga konteksti. Ju nuk mund t'u tregoni njerëzve se ç'duhet të bëjnë, mundeni vetëm t'u rrëfeni parabola: dhe kjo është ajo që mund të quhet me të vërtetë art, histori të veçanta për njerëz dhe përvoja të veçanta e në varësi të nevojave të ngutshme e specifike ai mund të nxjerrë përfundimet e veta.

16. Të dy, Marksi dhe Frojdi, nisen nga dështimet e qytetërimeve, njëri nga të varfrit, tjetri nga të sëmurët. Të dy e shohin sjelljen njerëzore të determinuar, në mënyrë të pandërgjegjshme, nga nevojat instiktive, uria dhe dashuria.

Të dy duan një botë ku zgjedhja racionale dhe vetëdeterminimi janë të mundshëm. Ndryshimi mes tyre është në mënyrë të pashmangshme ndryshim mes njeriut që studion turmat në rrugë dhe njeriut që sheh pacientin, ose të paktën familjen në klinikën private.

Marksi e sheh kahjen e marrëdhënieve mes botës së jashtme dhe të brendshme pa të fshehta, Frojdi anasjelltas. Kështu, të dy janë dyshimtarë kundrejt njëri-tjetrit.

Socialistët akuzojnë psikologët për prishje të status quo-së, ndërsa përpiqen t'i përshtatin neurotikën sistemit social, duke e privuar atë nga një revolucion i mundshëm.

Psikologët kundërpërgjigjen se socialistët përpiqen t'i japin pikë vetes me terma që as vetë nuk i kuptojnë, ose me faktin që etja për para është forma e vetme e

etjes për pushtet – kështu që pasi të kenë marrë pushtetin me revolucion, do të rikrijojnë të njëjtat kushte. Të dy kanë të drejtë.

Për aq sa qytetërimi mbetet siç numri i pacientëve që mund të shërojë psikologu është shumë i vogël, dhe sapo socializmi të marrë pushtetin, duhet të mësojë të drejtojë energjinë e tij të brendshme, pra do të ketë nevojën e psikologut.

Përmbyllje: Frojdi ka patur ndikime të dukshme teknike në letërsi posaçërisht në shtjellimin e kohës dhe hapësirës dhe përdorimin e fjalëve më shumë me vijueshmëri asociative sesa logjike.

Ai e drejtoi vëmendjen e shkrimtarit kah materiale të tilla si ëndrrat dhe neurozat, gjer më tash të shpërfillura; kah marrëdhënie që gjer më tani nuk janë marrë parasysh sikundër është marrëdhënia mes njerëzve që luajnë tenis; ai e ka rishikuar kultin e njeriut hero.

Ai është përvetësuar nga irracionalistët e etur për t'u ikur ndërgjegjes së tyre.

Porse këto nuk qenë... shqetësimi ynë. Unë u rreka të rrëfej se çfarë drite hodhi Frojdi mbi gjenezën e artistit, rendit dhe funksionit të tij në shoqëri dhe çfarë kërkesash ka ai për shkrimtarin serioz.

Duhet të ekzistojnë gjithmonë dy lloj artesh: arti – arratiak ngase njeriu do të ikë ndërsa ka nevojë për ushqim dhe gjumë të thellë; dhe arti – parabolë, ai art që duhet t'i mësojë njeriut si të çmësoj urrejtjen dhe të mësojë dashurinë...

ALI SUTAJ

(1937-1989)

Ali Sutaj, lindi në Llukë të Epërme të Deçanit (1937). Shkollën fillore e kreu në Deçan e Isnig, ndërsa shkollën normale e nisi në Gjakovë dhe e përfundoi në Prishtinë. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Një kohë punoi mësues në disa shkolla të Deçanit. Që kur ishte nxënës në shkollën normale botoi shkrime në revistë "Zëri i rinisë" dhe raportonte nga komuna e Deçanit për gazetën "Rilindja".

Më 1961 u punësua gazetar në gazetën "Rilindje". Përveç lajmeve, raporteve, intervistave, shkroi shumë komente, vështrime, skica, ese dhe analiza nga fusha e politikës dhe letërsisë. ishte kryeredaktor i "Zërit të rinisë" dhe themelues me detyrë i gazetave "Fjala", "Kosovarja", "Shkëndija", "Thumbi", "BAT", "Gep", "Bota e re".

Vlerësohet si themeluesi i të gjitha revistave që kanë dalë në kuadër të “Rilindjes”, madje jo rastësisht e quanin “baba” të tyre. Një kohë punoi në Komitetin Komunal të LK të Prishtinës, prej nga pas vitit 1981, u rikthye në “Rilindje” është autor i librit me ese “Mbresa” (1975) dhe i monografisë “Rilindja 1945-1985”.

Vdiç më 1989 në Prishtinë, dhe u varros në Llukën e Epërme të Deçanit.

Ali Sutaj ishte dhe mbetet “Korife i Gazetarisë kosovare” do të shhkruante Ali Jasjqi. Ali Sutaj e niste një shkrim për iternacionalizmin. Po aty e rrethekonte me shkronja të imta ndonjë fjalë të Fishtës, Naimit apo Lazgushit dhe më poshtë shkruante për fenome të cilat e përcillnin popullin e Kosovës, cep më cep të saj, që nga pleqtë, fëmijët nxënësit dhe intelektualët, me të cilët ishte çdo ditë dhe përkujdesej, së paku për ata gazetarë, të cilët kishin nevojë për të. Më duket, se asgjë nuk do të shkruaj, as nuk do t’ju them asgjë. Sepse fjalët s’më rrijnë në fjali as nuk përbëjnë ndonjë periudhë. Një shkrim i vogël i tij vlen më shumë se dhjetra faqe, që shkruaj a mërmëris unë.

“Mbresa” (Rilindja, 1975) dhe e diskutoi guximshëm në mbledhjen e Komitetit Krahinor të LK-së së Kosovës, më 1977 (kushtuar çështjeve të kulturës), ashtu siç thoshte edhe vetë – “banalisht, faqe dheut”. Shkroi Ali Sutaj “letra poetëve”, pledoaje, komente, por mbi të gjitha shkroi skica me lëng jete, ato që shënojnë datën, për njerëzit dhe gjakimet e tyre, sidomos me ato pyetjet subtile si atij plakut 80-vjeçar gjatë korrjeve, në një arë të Kosovës: “Si po ju merr havaja, mixhë?”, dhe

pasi mori përgjigjen – “Po rigon pak, po Zoti e bën mirë!”, do t’ia dredhojë tjetrën: “Po motin, si e keni?”, për të marrë përgjigjen e dytë – “Hambarët i kemi plot, por po druajmë për fëmijët!”

Për çka do të shkruante sot? Do të fliste për Konicen, Fishten dhe Prenushin, por edhe për Cvajgun, Shekspirin dhe Tolstoin. Do të citonte pak edhe profesor Anton Çetten dhe mandej, do të fliste edhe për luftën e fundit dhe UÇK-në. Do të shkruante me përkushtim për gjithë ata njerëz që ende nuk i kanë gjetur eshtrat e familjarëve të tyre. Në veçanti do të shkruante për Fehmi Aganin, por edhe për Bardhyl Qaushin. Për njerëzit e thjeshtë, plakun e urtë nga Shpenadija, Haxhi Tahirin, si për bariun Shaban Binakun që e rrahen policia serbe dhe vdiq pas pesë dite në Spitalin e Pejës, pse mbante fotografinë e Ibrahim Rugovës në xhep dhe thoshte, se shkijet vetë po shkojnë në Serbi. Ai nuk është gjallë e të shkruante për Hashimin dhe Ramushin, për Kadrinë dhe Arsim Bajramin etj...S’po them, se çka do të shkruante për armiqët e shtetit të Kosovës.

Ali Sutaj ishte gazetar dhe njeri i madh dhe sot letrave shqipe ju mungon një pend e tillë, që të shkruaj për të gjitha këto fenomene, që po e përcjellin shoqërinë tonë, në këto ditë kaq të rënda dhe me persiatje dhe me shumë të panjohura. Ai kishte guxim të shkruante. Të lëmonte për edhe të qëllonte me kamxhik, njëkohësisht. Të thumbonte, por edhe të thurte lavde, jo për ta bërë qejfin, por që të vetëdijsonte mendjen e lexuesit dhe jo vetëm të tij, por edhe të politikës përgjithësisht. Po kur, vetëdijsohen politikanët? Jo po,

ne s'jemi në Evropë. Unë do të shkruaja: "Ne jemi në Ballkan dhe këtu kemi mbetë, si në rërën e gjallë, që s'na lëshon këmbët, sadoqë ne kemi bërë përpjekje, për të dalë nga ky gjysmëferr". Ah, jo! Kështu s'do të shkruante Ali Sutaj. Ai do të çilte derën dhe do ta gjente zgjidhjen me shkrimet e tij, në një kohe të re, që duket, se në fund të një stine të merzitshme, do të ketë dalje nga rrethi vicioz, i gjithë këtyre persiatjeve ballkanike. Ai shkruan:

"... Është 100 vjetori i lindjes së Fishtës..." e nis bisedën.

"E dijë" – thotë ai

"Duhet të shkruajmë diç me këtë rast "- shtoj unë.

Ai vranë vetullat e unë e marr këtë mospajtim. Më pyet pas një kohë të shkurtër:

"Vërtetë, mendon të shkruash mbi Fishtën?"

"Me gjithë mend e kam " –i përgjigjem.

Ja përkujtoj: nuk është fjala, këtu të organizojmë ndonjë manifestim, nuk pletohet t'i ngritët lapidar, të rehabilitohet. Brezi i tanishëm e edhe ai i mëparshëm, e njohin bukur mirë veprën e Fishtës. Ca nga pjesët e "Lahutës së Malësisë" "këndohen edhe në dasma, ndeja të ndryshme, sidomos në fshatrat në veri. Ky shkrimtar është shndërruar në njëfarë Legjende. Është bërë, përçuditërisht, "shkrimtar i shenjtë". Nuk vlen, vallë, të heqim nga ai, nga vepra e tij mbulesën e enigmes"...?

... Shoku im disi u pajtua që të shkruhet diç mbi veprën fishtjane. Tha se është delikate, kjo teren që mund të shklesë lehtë njeriu. Ja pranova ndërhyrjen. Kur u ndamë po atë ditë, në banesë nisa meditimin,

një lloj përkujtimi autorit të “Lahutës së Malësisë” në 100 vjetorin e lindjes.

Kaluan dy a tri vjet. Nisa shkrimet e mia të para. Vjersha. Ali Sutaj punonte te “Zëri i rinisë”. Pa një pa dy mezi i shtypa me makinë te profesor B. Januzaj dy a tri poezi. Baca Ali, i thashë. I kam shkruar këto poezi. Me pa me habi. Ah, ti je ai djali i Bajramit që po merresh me teatrin. Teatër në katund s’ka. Jam në Gjakovë, i thashë. Eh, bëri. Mirë mirë. M’i mori fletët e mua ende më dridheshin duart. Desha ti them se poezitë i kam shkruar dhe janë... Më ndërpreu. I shohim a janë për botim. Baca Ali poezitë mi botoi edhe të “Zëri i rinisë” e më vonë edhe te “Fjala” por edhe te “Jeta e re”.

Kam pyet për ty, më tha. Më ka fol diçka Vehap Shita, më tha. Biqir Musliu të respekton pa masë. A të ka pa, ai vazhdimisht në shfaqje, apo ku njiheni aq shumë? Musa, s’më ka thënë gjë jo. Edhe Ali Podrimja i ka veçuar dy a tri poezi dhe së shpejti do të botohen te “Fjala”. Po për Moisiun ku i ke gjetë gjithë ato shënime. I kam përkthyer disa prej anglishtes të një Enciklopedi për aktorët dhe dramaturgët e botës. Krejt në rregull por nuk të besojnë njerëzit se e njeh anglishten aq mirë sa të përkthesh në shqip. Pastaj duhet ta gjesësh çelësin për të shkruar për aktorin Moisiun. Duhet të lexosh shumë...nejse mos u dëshpëro! Këto ditë Ali Jasiqi më duket të boton diçka te “Jeta e Re”.

Po, baca Ali unë po merrem me prozën, i thashë. Poezi a ke shkruar më. Shkruaj por, rrallë. Proza më pëlqen. Po më dhimbsesh shumë ma bëri ai. Për çka, ndërhyra

unë. Bëri me dorë në ajër. Pse baca Ali, ia bëra. Pse? Më dhimbsesh shumë. Ti nuk e di se kush kanë qenë Vëllezërit Frashëri, më tha. Po i thashë unë. Këtu kam kryer gjimnazin. Pikërisht te “Vëllezërit Frashëri”. Qysh nuk di kush janë ata, u nguta unë të flasë. Ooo...prapë e ngriti dorën. Nuk i njeh jo. Baca Ali. Samiu ka shkruar disa libra dhe ka bërë shumë për Stambollin. Abdyli është luftëtarë. Naimi. Fan Noli e ka thënë se ishte poet mbi poet. Poeti si Naimi s’ka të tjerë... Ti mendon se i njeh? Më ndërpreu. Eh, nuk e din se çka kanë punuar ata. Sa kanë hequr për t’i botuar ato libra. Prapë ngriti dorën. Porositi përsëri për të pi. Njeriu nën ndikim të alkoholit, thashë me vete. Ky donë të më tregoi mua, se kush ka qenë Naimi, Saimi apo Abdyli. Baca Ali, e ngrita zërin. Fol më të vogël . Ti a e di, se ata e kanë pasur, Dangëllinë të vetën. Kush është Dangëllia, ia bëra unë. Unë e di, se katundi i tyre quhet Frashër. Frashëri është një pëllëmbë tokë, ma bëri. Ata e kanë pasur krahinën e tërë Dangëllinë, të vetën dhe atë e kanë “bërë rrushe kumbulla” për të botuar, ato tre a katër libra. Nuk janë tre a katër libra, u nxeha unë. Ka më shumë. Nejse, nejse. Fol më të vogël, më tha përsëri. Prandaj të thash se më dhimbsesh, se baba haxhi nuk lejon ta shesësh një gardh të keq për poezitë as prozën tënde. Ti nuk e di, se kush kanë qenë dhe kush janë ata. Nën ndikim të alkoholit, mërmërita unë me vete. Ky don të më tregojë, kush janë Naimi, Saimi dhe Abdyli? Kaluan vite. Tash rrinim si dy burra të pjekur. Unë ende isha i ri. I ri për shumë gjëra. Zakonisht çdo vikend vinte. Shoku im Dem Sutaj dilte në Pejë dhe e

priste dhe vinte pastaj me te në Deçan. Për një kohë të gjatë përcjellje të mirë i kishte bërë edhe Xhafer Sutaj. Kur vinte në katund i pëlqente të rrinte me pleqtë e sidomos me Haxhi Tahirin....

Aliu e përdorte një thënje të moqme; Mocaniku-mocanikut, shoku -shokut nuk duhet t'i lavdërohet, sepse ata ja njohin njëri-tjetrit të mirat dhe të këqijat. Puna flet për virtytin dhe ndërgjegjen e njerëzve...

Desha të kujtoj edhe diçka.

Sot, mocanikët e tij, shokët, bashkëpuntorët e fjalës e të penës, që gjenden aty ku botohen librat apo revistat, me siguri janë kujtua, apo do të kujtohen që sot, nesër, t'ia mbledhin nëpër shtypin e asaj kohe të gjitha kujtimet, mbresat, skicat, meditimet dhe t'ia botojnë në një libër të veçantë.

Pse jo edhe si monografi.

Borxh ia kemi, e borgji duhet larë, sado vonë, por pa u koritur.

Borxh ndaj tij kanë edhe llukjanët, katundarët e tij...

“Borxh i ka edhe ” Rilindja”, ndonëse vepron në këto kushte kaq të rënda. Janë këto borxhe që duhet larë për jetën e tij dyzetvjeçare në gazetarinë dhe publicistikën tonë...

Se,..se vjen një ditë, fjala e tij e pafund nuk harrohet”, thotë bashkëvendasi i bacës Ali, shkrimtari Arif Molliqi nga Lluka e Epërme emigrant në Hamburg...

Lënda:

1. 140 VJET NGA SHFAROSJA E SHQIPTARËVE NË SANXHAKUN E NISHIT.../ 9
2. DHUNA GJENODICALE E KISHËS SERBE/ 49
3. SHËRBIMET SEKRETE SERBE/ 72
4. VRASJE, PËRDHUNIME, TORTURA/ 81
5. VENDAS DHE ARDHACAKË/ 105
6. A ËSHTË LUKASHENKO I ÇMENDUR ?/ 127
7. GRADAT E SPIRO BUTKËS/ 137
8. FRANZ KAFKA MODERNISTI I MADH/ 141
9. LETËRSIA MODERNE SHQIPTARE / 151
10. LETËRSIA KINEZE BASHKËKOHORE/ 164
11. LETËRSIA AMERIKANE NGA KOLONIALËT BASHKOHOR DERI TË LETËRSIA ANTI-TARDICIONALE, NË POEZI, PROZË DERI NË POLITIKAT ANTI ESTABLISHMENTIT DHE AJO BASHKOHORE (1939)/ 172
12. SHËNIME PËR ZEF ZORBEN/ 182
13. DINJITETI I HUMBUR/ 186
14. DY FJALË PËR “LEKSIKONIN ENCIKLOPEDIK” TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE ARTEVE SHQIPTARE AMERIKANE/ 202
15. PROJEKT I “ENCIKLOPEDIË” NGA AKADEMIJA SHQIPTARE-AMERIKANE E SHKENCAVE DHE ARTEVE ME SELI NË SHBA - Akademik Prof. Dr. Nijazi Halili, Ph.D./ 211
16. SULEJMAN KRASNIQI: “NË SHQIPËRI THASHË, MËMËDHE TË DUA EDHE KËSHTU SIÇ JE”/ 216
17. PËR DOSTOJEVSKIN/ 230
18. LETËRSIA DHE PSIKOLOGJIA/ 235
19. ALI SUTAJ/ 241
20. LËNDA/ 249

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Bruqi, Flori

Diademë letrare V: 140 vjet nga shfarosja
e shqiptarëve në sanxhakun e Nishit... / Flori
Bruqi ; red. Izet Duraku.

- Tiranë : Klubi i poezisë, 2023.

Vol. 5, 252 f. ; 16.5x23 cm

ISBN 9789928337382

1.Historia 2.Shpërngulja me forcë
3.Shqiptarë

94(=18 :497.115)

